



**RAPORT I VLERËSIMIT AFATMESËM  
TË ZBATIMIT TË  
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR  
MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE  
DHE DHUNA NDAJ GRAVE 2022 –  
2026**

Mars, 2026

## PËRMBAJTJA

SHKURTESA DHE AKRONIME .....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
1. HYRJE .....	7
1.1. KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM .....	7
1.2. QËLLIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT AFATMESËM .....	11
1.3. KORNIZA METODOLOGJIKE DHE PARIMET UDHËHEQËSE TË VLERËSIMIT .....	11
2. KORNIZA METODOLOGJIKE E VLERËSIMIT .....	13
2.1. METODAT E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE .....	13
2.2. PROCESI I VLERËSIMIT DHE KUFIZIMET METODOLOGJIKE .....	14
2.3. PYETËSORËT STANDARTË INSTITUCIONALË .....	15
3. KORNIZA LIGJORE, INSTITUCIONALE DHE STRATEGJIKE .....	16
3.1. KORNIZA NDËRKOMBËTARE DHE PËRPUTHJA ME STANDARDET EVROPIANE .....	16
3.2. KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE .....	17
3.3. KORNIZA INSTITUCIONALE .....	18
3.4. KORNIZA POLITIKE DHE STRATEGJIKE .....	19
4. GJETJET NGA VLERËSIMI AFATMESËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE 2022–2026 .....	21
4.1. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRESIT DHE BOSHLLËQEVE STRUKTURORE .....	21
4.2. ANALIZA SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË, DUKE APLIKUAR KRITERET OECD–DAC .....	25
4.2.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK I: PARANDALIMI DHE IDENTIFIKIMI I DHUNËS NËPËRMJET EDUKIMIT DHE VETËDIJESIMIT .....	26
4.2.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK II: AVANCIMI DHE HARMONIZIMI I POLITIKAVE PUBLIKE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE .....	39
4.2.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK III: FUQIZIMI INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE DHE TRAJTIM TË VIKTIMAVE .....	53
4.2.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK IV: SIGURIMI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR VIKTIMAT/TË MBIJETUARAT/MBIJETUARIT .....	68
4.3. VLERËSIMI I SISTEMIT TË TREGUESVE DHE I PERFORMANCËS SË TYRE (2022–2025) .....	79
4.4. PËRMBLEDHJE ANALITIKE E PROGRESIT, BOSHLLËQEVE DHE SFIDAVE NDËRINSTITUCIONALE .....	91
5. ANALIZA NDËR-INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI I STRATEGJISË .....	95
5.1. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE QENDRORE DHE TË DREJTËSISË .....	95
5.2. INSTITUCIONET E PAVARURA DHE AGJENCITË PUBLIKE .....	97
5.3. INSTITUCIONET MBËSHTETËSE DHE PROFESIONALE .....	98
5.4. MEKANIZMAT KOORDINUES DHE BASHKËRENDIMI NDËR-INSTITUCIONAL .....	99
5.5. ZBATIMI I STRATEGJISË NË NIVEL KOMUNAL .....	101
5.6. ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË ZBATIMIN E STRATEGJISË .....	103
5.7. MBËSHTETJA E PARTNERËVE NDËRKOMBËTARË DHE DONATORËVE .....	107
5.8. VLERËSIM I INTEGRUAR NDËR-INSTITUCIONAL I PROGRESIT DHE ZBATIMIT TË STRATEGJISË .....	110
6. GJETJET, SFIDAT DHE REKOMANDIMET .....	112
6.1. GJETJET KRYESORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM .....	112
6.2. SFIDA TË PËRGJITHSHME .....	114
6.3. REKOMANDIME .....	116
A. REKOMANDIME STRATEGJIKE .....	116
B. NIVELI QENDROR .....	116
C. NIVELI LOKAL .....	116
D. ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE .....	117
E. INSTITUCIONET E PAVARURA .....	117
F. PARTNERËT NDËRKOMBËTARË .....	117
6.4. IMPLIKIMET STRATEGJIKE PËR PERIUDHËN 2026–2030/2032 .....	119
6.5. RREZIQET, KUFIZIMET DHE FAKTORËT NDIKUES NË ZBATIM .....	119
6.6. MËSIMET TË NXJERRA DHE DREJTIMET PËR FAZËN PËRFUNDIMTARE .....	120
6.7. PËRFUNDIME DHE PERSPEKTIVA PËRPARA .....	121
7. REFERENCA .....	122

8. SHTOJCAT .....	124
SHTOJCA 1. TË DHËNAT NGA BURIMET E PAVARURA TË MONITORIMIT (2022–2025) .....	124
1.1. Këshilli i Evropës – Vlerësimi i përafritit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit (2022) .....	124
1.2. Komisioni Evropian – Raporti i vitit 2024 për Kosovën (Tetor 2024): Dhuna në baza gjinore, Koordinimi institucional dhe parandalimi. ....	126
1.3. Profili Gjinor i Kosovës 2024 (UN Women / BE / EEAS) dhe zhvillimet ligjore 2022–2024 .....	128
1.4. Raport nga monitorimi i gjykimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë, OSBE, 2024 .....	130
1.5. Misioni i OSBE-së në Kosovë – Mbështetje Programore për Mekanizmat Gjyqësorë dhe Policorë për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2022–2024).....	132
1.6. Përmbledhje e studimeve mbi dhunën në familje të realizuara nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike për periudhën janar 2022 – korrik 2024 .....	133
1.7. Përmbledhje e studimit “Dhuna në baza gjinore përmes këndvështrimit të Gjeneratës Z: Qëndrimet e burrave të rinj ndaj dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe femicidit në Kosovë” të SIT/UNFPA (2024).....	143
1.8. Përmbledhje e studimit “Fuqizimi i Mekanizmave Mbrojtës nga Dhuna në Baza Gjinore në Kosovë” të Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (2024) .....	144
1.9. Përmbledhje e Raporteve të Shoqërisë Civile mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 2023 dhe 2024 .....	145
1.10. Përmbledhja e publikimeve të Ministrisë së Drejtësisë mbi databazën digjitale të rasteve të dhunës në familje (2023–2025).....	146
SHTOJCA 2. PËRMBLEDHJA E KRITEREVE TË RISHIKUARA TË OECD-DAC .....	148
SHTOJCA 3. TË DHËNAT E VETË-RAPORTUARA NGA KOMUNAT .....	150
SHTOJCA 4. KONTRIBUTET E PARTNERËVE NDËRKOMBËTARË .....	152
SHTOJCA 5. TABELA E TREGUESVE PËR VLERËSIMIN AFATMESËM.....	157
SHTOJCA 6. KORNIZA E PROPOZUAR E TREGUESVE PËR STRATEGJINË 2027–2030/2032 .....	165

## SHKURTESA DHE AKRONIME

ADK	Akademia e Drejtësisë e Kosovës
ARKEP	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
DHBGJ	Dhunë me bazë gjinore
DHF	Dhunë në familje
CDF	Fondi për Zhvillimin e Komunitetit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
FGM	Gjymtimi Gjenital Femëror
GLPS	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
KiE	Këshilli i Evropës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
MKL	Mekanizma koordinues lokale
OECD-DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OS	Objektivi strategjik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PSV	Procedura standarde të veprimit
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
RAE	Rome/Romë, Ashkalie/Ashkali, Egjiptiane/Egjiptianë
SIT	Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
UM	Urdhër për mbrojtje
UME	Urdhër për mbrojtje emergjente
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNEG	Grupi i Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
WWP EN	Rrjeti Evropian që Punon me Kryesit e Dhunës
YiHR	Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje vazhdojnë të përbëjnë një nga sfidat më serioze për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Republikën e Kosovës. Ky vlerësim afatmesëm, i zhvilluar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian (BE), sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe kriteret e rishikuara të Komitetit të Ndihmës për Zhvillim të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD-DAC), konstaton se gjatë periudhës 2022–2025 Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të konsoliduar, të koordinuar dhe të bazuar në të drejtat e njeriut, për parandalimin, mbrojtjen dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

Në tërësi, analiza tregon se Strategjia ka kontribuar në konsolidimin e kornizës ligjore, institucionale dhe politike për adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke forcuar koordinimin ndërinstytucional dhe duke krijuar bazat për një sistem më të standardizuar të monitorimit, raportimit dhe llogaridhënies. Ky progres reflekton një zhvendosje graduale nga ndërhyrje të fragmentuara drejt një qasjeje më të integruar dhe të orientuar në rezultate.

Strategjia ka operuar në një kontekst të zhvillimeve të rëndësishme ligjore dhe institucionale. Harmonizimi me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), miratimi i Ligjit Nr. 08/L-185 dhe funksionalizimi i mekanizmave ndërinstytucionalë kanë vendosur themelet e një arkitekture moderne dhe gjithëpërfshirëse të mbrojtjes. Në këtë kuadër, Strategjia vlerësohet me nivel të lartë relevancë dhe koherence, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe acquis të BE-së.

Për qëllime sintetizuese, gjetjet kryesore të vlerësimit strukturohen në tre dimensione: (i) progresi institucional dhe shërbimet, (ii) zhvillimet në sistemin e të dhënave dhe drejtësisë, dhe (iii) sfidat strukturore që ndikojnë në qëndrueshmërinë e sistemit.

### Konkluzionet kryesore të vlerësimit afatmesëm

- **Reagimi institucional është konsoliduar dukshëm**, me funksionalizimin e mekanizmave koordinues lokalë në të gjitha komunat, rritjen e kapaciteteve të Policisë, Prokurorisë dhe shërbimeve sociale, si dhe vendosjen e bazave të forta për ofrimin e shërbimeve të integruara dhe të standardizuara.
- **Shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit janë zgjeruar**, duke përfshirë mbështetje juridike, psikosociale dhe mjekësore, si dhe forcuar mekanizmat e referimit. Megjithatë, qasja në shërbime mbetet jo e barabartë ndërmjet komunave dhe zonave urbane e rurale.
- **Sistemi i të dhënave është përmirësuar ndjeshëm**, me funksionalizimin e Bazës Kombëtare të të Dhënave. Reformimi i mëtejshëm kërkon integrim të plotë digjital ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Qendrave për Punë Sociale dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

### Progresi i arritur (2022–2025)

Gjatë periudhës së vlerësuar janë shënuar përmirësime të prekshme në fushën e parandalimit, shërbimeve dhe qasjes në drejtësi:

- janë zhvilluar fushata të gjera vetëdijesimi dhe programe edukative të orientuara drejt transformimit të normave dhe qëndrimeve sociale;
- është rritur volumi dhe cilësia e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, përfshirë mbështetjen psikosociale, juridike dhe shërbimet e strehimit;
- janë forcuar kapacitetet e hetimit dhe ndjekjes penale, megjithëse procedurat gjyqësore mbeten të gjata dhe jo gjithmonë të harmonizuara me standardet e kujdesit të duhur.

Strategjia ka demonstruar efektivitet në ndërtimin e një sistemi institucional më të koordinuar dhe funksional. Mbi 60 për qind e masave për periudhën 2022–2025 raportohen të jenë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, duke reflektuar një trend të qëndrueshëm progresi dhe rritje të koherencës ndërinstucionale.

Partnerët ndërkombëtarë kanë luajtur rol plotësues në forcimin e kapaciteteve institucionale, harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe zgjerimin e qasjes në shërbime. Megjithatë, rritja e ndikimit të kësaj mbështetjeje kërkon koordinim më të integruar dhe lidhje më të drejtpërdrejta me prioritetet strategjike kombëtare dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

### **Indikacione pozitive të progresit dhe zhvillimeve institucionale**

Analiza e zbatimit të Strategjisë evidenton disa zhvillime pozitive dhe indikacione të rëndësishme të progresit institucional gjatë periudhës 2022–2025:

- rritja e raportimit të rasteve, që lidhet me rritjen e besimit në institucione dhe forcimin e mekanizmave të referimit;
- rritja e numrit të urdhrave të mbrojtjes së lëshuara dhe e efikasitetit të Policisë në reagimin emergjent;
- rritja e kapaciteteve të Prokurorisë për ngritjen e aktakuzave dhe përmirësim gradual në qasjen e gjykatave ndaj rasteve të dhunës;
- forcimi i funksionimit të Mekanizmave Koordinues Lokalë si model shumësektorial.

Këto zhvillime tregojnë se investimet institucionale dhe ligjore po prodhojnë rezultate të matshme dhe ndikim gradual në cilësinë e mbrojtjes dhe aksesin në drejtësi.

### **Sfida strukturore që vijojnë të ndikojnë impaktin**

Megjithëse progresi është i rëndësishëm, disa sfida strukturore vazhdojnë të kufizojnë efektivitetin e plotë të Strategjisë:

- mospërputhje ndërinstucionale në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave;
- qasje jo e barabartë në shërbime ndërmjet komunave, sidomos në zonat rurale;
- mungesë e financimit të qëndrueshëm për mekanizmat lokalë, strehimoret dhe programet e riintegrit;
- ritme të ndryshme të zbatimit ndërmjet sektorëve të drejtësisë, mirëqenies sociale dhe shëndetësisë;
- përfshirje ende e kufizuar e burrave dhe djemve në programet e parandalimit.

Këto sfida kanë karakter transversal dhe ndikojnë në të gjithë zinxhirin e reagimit institucional, nga identifikimi dhe referimi i rasteve deri te mbrojtja, drejtësia dhe riintegrimi.

Një zhvillim i rëndësishëm është miratimi dhe pilotimi i Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve, në përputhje me nenin 16 të Konventës së Stambollit. Për fazën e ardhshme mbetet

prioritet konsolidimi dhe zgjerimi i këtyre programeve, me qëllim parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe forcimin e qasjes parandaluese.

**Përfundime dhe prioritetet për fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026) dhe në funksion të përgatitjes së kornizës së re strategjike pas vitit 2026:**

Strategjia 2022–2026 ka vendosur themelet për një arkitekturë institucionale të integruar dhe të orientuar në të drejtat e njeriut. Në fazën përfundimtare (2026) dhe në funksion të strategjisë së re, prioriteti zhvendoset nga zgjerimi i ndërhyrjeve drejt konsolidimit të rezultateve dhe sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit:

- integrimin të plotë digjital të sistemit të të dhënave ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse;
- forcimit dhe financimit të qëndrueshëm të Mekanizmave Koordinues Lokalë, strehimoreve dhe programeve të riintegrimin;
- përmirësimin të efikasitetit gjyqësor, zbatimit të njëtrajtshëm të urdhrave të mbrojtjes dhe ndjekjes së rasteve;
- zhvillimit dhe zgjerimit të programeve parandaluese që adresojnë normat dhe stereotipet gjinore që nxisin dhunën, duke përfshirë në mënyrë sistematike burrat dhe djemtë në përpjekjet për parandalimin e dhunës dhe promovimin e marrëdhënieve të barabarta gjinore;
- forcimit të rolit mbikëqyrës të institucioneve të pavarura dhe të shoqërisë civile;
- krijimit të një kornize strategjike të re pas vitit 2026, të bazuar në tregues të matshëm, evidenca të standardizuara gjinore dhe qasje të koordinuar shumësektoriale.

Gjetjet e këtij vlerësimi ofrojnë një bazë të rëndësishme evidencash për përmirësimin e politikave publike dhe për hartimin e strategjisë së ardhshme, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe efektiv për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë.

Viti 2026 përfaqëson një moment kritik tranzicioni drejt konsolidimit dhe ri-dizajnit strategjik. Në këtë kontekst, ndërtimi i një strategjie të re të bazuar në evidencë, të dhëna të integruara dhe mekanizma të qartë llogaridhënieje do të jetë vendimtar për përshpejtimin e progresit dhe përputhjen e plotë me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

## 1. HYRJE

### 1.1. KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje në Kosovë mbeten ndër sfidat më të mëdha për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ato ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien fizike, psikologjike, sociale dhe ekonomike të grave, fëmijëve dhe komuniteteve, duke penguar realizimin e plotë të të drejtave dhe pjesëmarrjen e barabartë në jetën publike dhe private. Pavarësisht përparimeve ligjore e institucionale, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje vijojnë të kenë përmasa të mëdha, me pasoja të thella shëndetësore dhe sociale për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe komunitetin në tërësi.

Gjatë periudhës 2022 - 2025, të dhënat e Policisë së Kosovës të regjistruara në Bazën Kombëtare të të Dhënave për Dhunën në Familje dhe Dhunën ndaj Grave, të administruar nga Zyra e Koordinatores/Koordinatorit Kombëtar (Ministria e Drejtësisë), tregojnë se raportimet e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave mbeten në nivele të larta gjatë gjithë periudhës së analizuar. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2022 janë regjistruar 2,764 raste, në vitin 2023 janë regjistruar 2,638 raste, ndërsa në vitin 2024 numri i rasteve është rritur në 2,959. Për vitin 2025 janë regjistruar 2,815 raste. Këto të dhëna tregojnë luhajtje të moderuara ndërmjet viteve, me një rritje të dukshme në vitin 2024 dhe një nivel relativisht të qëndrueshëm të raportimeve në vitin 2025. Në tërësi, niveli i raportimeve gjatë periudhës së analizuar sugjeron një prani të vazhdueshme të fenomenit, ndërkohë që mund të reflektojë një kombinim faktorësh, përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit publik, përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe identifikimit të rasteve, si dhe ndryshime në besimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve ndaj institucioneve.

Në përgjithësi, të dhënat e grumbulluara për periudhën 2022–2024, të cilat përbëjnë bazën kryesore të analizës së këtij raporti, dëshmojnë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje mbeten probleme strukturore dhe të ndërlidhura ngushtë me pabarazitë gjinore, pavarësisht përparimeve në politikëbërje dhe koordinim institucional. Të dhënat e disponueshme për vitin 2025 konfirmojnë se raportimet mbeten në nivele të larta edhe në periudhën më të fundit të analizuar. Në këtë kontekst, rritja e raportimeve interpretohet kryesisht si tregues i forcimit të mekanizmave të referimit dhe i kapaciteteve institucionale për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve, më shumë sesa si rritje faktike e shkallës së dhunës.

Gjetjet dhe analizat e paraqitura në këtë raport synojnë të ofrojnë një bazë analitike për orientimin e politikave dhe ndërhyrjeve të ardhshme, me qëllim adresimin më efektiv të këtyre fenomeneve përmes masave që synojnë parandalimin, mbrojtjen, trajtimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, ndëshkimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të kryerësve të të gjitha formave të dhunës, si dhe forcimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që mundësojnë jetesën pa dhunë, duke u mbështetur në evidencë të shumëfishtë dhe në analizë ndërinstitutionale të të dhënave.

Duke qenë se Strategjia mbulon periudhën 2022–2026, ndërsa ky vlerësim fokusohet në periudhën 2022–2025, gjetjet e paraqitura në këtë raport ofrojnë një bazë të rëndësishme analitike për fazën përfundimtare të zbatimit gjatë vitit 2026, si dhe për orientimin e hartimit të strategjisë së re.

Përgjigja institucionale e Republikës së Kosovës ndaj fenomenit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është forcuar ndjeshëm në vitet e fundit, në mënyrë të veçantë përmes miratimit të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, i shpallur më 9 tetor 2023 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 22 më 12 tetor 2023. Ky ligj shfuqizoi Ligjin Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje të vitit 2010 dhe vendosi një kornizë të avancuar juridike, duke synuar harmonizim të plotë me Konventën e Stambollit dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në përmbajtjen e tij, ligji e zgjeron fushëveprimin përtej dhunës brenda marrëdhënieve familjare tradicionale, duke përfshirë dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore si kategori të veçanta juridike dhe duke e trajtuar dhunën gjinore si shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe formë diskriminimi. Ligji përcakton detyrimet pozitive të shtetit për të vepruar me kujdes të duhur (due diligence) në parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e çdo akti dhune, si dhe në sigurimin e kompensimit dhe riintegritit për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Po ashtu, përkufizimi i marrëdhënieve familjare është zgjeruar përtej familjes biologjike, duke të përfshirë partneret/partnerët aktualë dhe të mëparshëm, bashkëjetesat dhe marrëdhëniet intime jashtë martesës, si një mënyrë për të reflektuar realitetet shoqërore bashkëkohore. Në këtë ligj janë përfshirë gjithashtu edhe dispozita që ndalojnë diskriminimin në trajtimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Një zhvillim i rëndësishëm institucional lidhet me rregullimin më të qartë të rolit të Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave. Edhe në kuadër të zbatimit të strategjive të mëparshme, ky funksion ka ekzistuar në praktikë, ku rolin e Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar e ushtronte Zëvendësministria/Zëvendësministri i Drejtësisë.

Me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-185, roli i Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar përcaktohet në mënyrë më të qartë, duke parashikuar që këtë funksion ta ushtrojë Ministria/Ministri i Drejtësisë, me mandat për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave dhe masave në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, Grupi Koordinues Ndërmintros funksionon si mekanizëm bashkërendues për harmonizimin e politikave dhe veprimeve ndërmjet institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe mirëqenies sociale. Zbatimi praktik u mbështet me Rregulloren për Detyrat, Përgjegjësitë, Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar (vendim i Qeverisë, 27 dhjetor 2024), duke e bërë të plotë funksionalizimin e Zyrës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ngritjen e Sekretariatit të saj. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mekanizmave institucionalë të koordinimit dhe monitorimit të politikave për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 10 të Konventës së Stambollit për krijimin e një organi koordinues përgjegjës për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave në këtë fushë.

Një tjetër risi e Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, është konsolidimi i sistemit të mbrojtjes dhe përkrahjes për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit përmes standardeve të qarta ligjore dhe koordinimit të detyrueshëm ndër-institucional, në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit. Ligji përcakton detyrime të qarta për ofrimin e shërbimeve të integruara, përfshirë

mbështetjen psikologjike, mjekësore, sociale dhe juridike falas, si dhe krijon mekanizma të rinj si Fondi për Viktimat e Dhunës, që mundëson ndihmë emergjente dhe kompensim financiar. Gjithashtu, ai forcon ndarjen e përgjegjësi ndërmjet institucioneve zbatuese, si Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale, Prokurorive dhe Gjykatave, si dhe bën të detyrueshëm trajnimin profesional të të gjitha/gjithë profesionisteve/profesionistëve që merren me parandalimin dhe trajtimin e dhunës. Kështu, ligji i ri përfaqëson një kalim thelbësor nga qasja reaktive në një qasje proaktive, të koordinuar dhe të harmonizuar me standardet evropiane për mbrojtjen, trajtimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave e dhunës në baza gjinore.

Për zbatimin efektiv të Ligjit Nr. 08/L-185, janë miratuar një sërë aktesh nënligjore që sigurojnë operacionalizimin e dispozitave të tij dhe forcimin e reagimit institucional. Ndër më të rëndësishmet janë Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar, Udhëzimet Administrative për Linjën Kombëtare Emergjente dhe Fondin Emergjent për Viktimat, Udhëzimi Administrativ për funksionimin dhe administrimin e Bazës Kombëtare të të Dhënave për rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe Rregullorja për funksionimin e Mekanizmave Koordinues Lokalë, të cilat konkretizojnë mënyrën e veprimit të institucioneve përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal. Këto akte nënligjore përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe procedurat e bashkërendimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe mirëqenies sociale, duke mundësuar një përgjigje të standardizuar dhe të qëndrueshme ndaj rasteve të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

Në tërësi, ky ligj dhe instrumentet nënligjore që e shoqërojnë përfaqësojnë bazën themelore të konsolidimit të përgjigjes shtetërore ndaj dhunës ndaj grave, dhunës në familje e dhunës në baza gjinore, duke e pajisur Kosovën me një kornizë ligjore e institucionale të avancuar në përputhje me Konventën e Stambollit, rekomandimet e GREVIO-s dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave të grave dhe të barazisë gjinore. Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm drejt garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi, mbrojtjes efektive dhe trajtimit e riintegrimit gjithëpërfshirës të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, duke e bërë sistemin institucional më të përgjegjshëm dhe më të ndjeshëm ndaj parimeve të të drejtave të njeriut.

**Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 –2026** përbën dokumentin themelor të politikave kombëtare të Republikës së Kosovës për ndërtimin e një reagimi të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm institucional ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ajo pasqyron angazhimin e drejtpërdrejtë të institucioneve përgjegjëse të nivelit qendror dhe lokal për të luftuar këto shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe rajonale, veçanërisht Konventën e Stambollit dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

Në thelb, Strategjia synon të sigurojë një përgjigje të koordinuar institucionale dhe komunitare ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes fuqizimit të kornizës ligjore, forcimit të institucioneve përgjegjëse dhe ofrimit të shërbimeve të qasshme, cilësore dhe efektive për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Ajo ndërtohet mbi vizionin e një shoqërie të sigurt, të barabartë dhe pa dhunë, ku çdo person gëzon të drejtën për të jetuar i

lirë nga frika dhe kërcënimi i dhunës, ndërsa shteti garanton parandalimin, mbrojtjen, riintegrimin dhe fuqizimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, si dhe llogaridhënien e kryerësve të dhunës.

Në përputhje me këtë vizion, misioni i Strategjisë përcakton se deri në vitin 2026, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe partnerët mbështetës, do të trajtojë me prioritet të gjitha rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; do të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore; do të garantojë qasje në shërbime të integruara dhe të ndjeshme gjinore; do të mundësojë riintegrimin dhe fuqizimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve; do të ndëshkojë dhe rehabilitojë kryerësit e dhunës; si dhe do të rrisë vetëdijesimin e shoqërisë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Për realizimin e këtij misioni, Strategjia ndërtohet mbi katër objektiva strategjike:

1. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit;
2. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare;
3. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve;
4. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Zbatimi i Strategjisë udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë (MD), në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Policinë e Kosovës (PK), Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferave (MFPT), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Zyrën e Avokatit të Popullit (ZAP), si dhe Mekanizmat Koordinues Lokalë (MKL) në nivelin komunal. Në zbatim të drejtpërdrejtë të masave marrin pjesë gjithashtu institucione të tjera të rëndësishme si Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), që siguron ndihmë ligjore falas dhe përfaqësim për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit; Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) që kontribuon përmes ekspertizës ligjore; Akademia e Drejtësisë (AD) dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), që mbështetin ngritjen e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve të drejtësisë dhe administratës publike; si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) që siguron mbikëqyrjen dhe zbatimin efektiv të politikave në nivel komunal. Qendrat për Punë Sociale (QPS) janë gjithashtu struktura tepër të rëndësishme në zbatimin e strategjisë veçanërisht kur flitet për menaxhimin e rasteve.

Përfshirja e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në procesin e zbatimit siguron ndërmjetësimin ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve, veçanërisht për ndërgjegjësim, parandalim dhe ofrimin e shërbimeve psikosociale.

Të gjitha këto institucione janë përgjegjëse për zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit 2022 – 2026. Raportimi për progresin realizohet përmes formatit standard të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, duke siguruar një proces transparent, të unifikuar dhe të bazuar në tregues të matshëm të performancës. Në të njëjtën kohë, progresi në zbatimin e Strategjisë diskutohet dhe monitorohet edhe në kuadër të takimeve të rregullta të Grupit Koordinues Ndërinstitucional, në të cilat institucionet bartëse raportojnë mbi zbatimin e aktiviteteve dhe shqyrtojnë sfidat dhe nevojat për koordinim të mëtejshëm ndërinstitucional.

Në tërësi, Strategjia përfaqëson angazhimin institucional të Republikës së Kosovës për një qasje të integruar, ndërsektoriale dhe të bazuar në të drejtat e njeriut, duke synuar eliminimin gradual të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, si dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të parandalimit, mbrojtjes, trajtimit e riintegritit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara.

Për qëllime të këtij raporti, terminologjia “dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave” përdoret në përputhje me emërtimin zyrtar të Strategjisë Kombëtare 2022–2026. Megjithatë, analiza dhe interpretimi i gjetjeve janë të harmonizuara me qasjen e Konventës së Stambollit, e cila e koncepton dhunën ndaj grave si një formë të dhunës me bazë gjinore dhe e trajton dhunën në familje si pjesë të këtij fenomeni më të gjerë. Në këtë kuadër, referencat në raport lexohen në përputhje me këtë standart ndërkombëtar.

## **1.2. QËLLIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT AFATMESËM**

Ky raport paraqet gjetjet e vlerësimit afatmesëm të zbatimit të Strategjisë, i zhvilluar në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Barazinë Gjinore, me mbështetjen dhe asistencën teknike të UN Women Kosovë dhe financimin e Ambasadës Britanike në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për monitorim dhe vlerësim.

Qëllimi kryesor është të:

- Vlerësojë progresin në arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave të Strategjisë;
- Analizojë efikasitetin dhe koherencën e ndërhyrjeve institucionale;
- Identifikojë sfidat strukturore dhe boshllëqet në zbatim;
- Evidentojë praktikatat e mira dhe modelet funksionale të bashkëpunimit ndërinstytucional;
- Formulojë rekomandime për fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026) dhe për hartimin e strategjisë së re.

## **1.3. KORNIZA METODOLOGJIKE DHE PARIMET UDHËHEQËSE TË VLERËSIMIT**

Ky vlerësim është zhvilluar mbi bazën e kornizës ligjore dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, duke u mbështetur në përkufizimet e Ligjit Nr. 08/L-185 dhe të Konventës së Stambollit. Terminologjia e përdorur, përfshirë termat “dhunë në familje”, “dhunë ndaj grave”, “dhunë në baza gjinore”, “viktimë/e/i mbijetuar”, “kryerës” dhe “masa mbrojtëse, siguron koherencë me kornizë ligjore dhe mundëson krahasueshmëri ndërinstytucionale.

Vlerësimi mbulon periudhën 2022 – 2025, me fokus në nivelin kombëtar dhe me referenca ilustruese nga niveli lokal. Analiza mbështetet kryesisht në raportet zyrtare të institucioneve për periudhën 2022–2024, të plotësuara me të dhëna administrative dhe raportime institucionale për vitin 2025, të dorëzuara përmes formatit standart të Ministrisë së Drejtësisë. Këto të dhëna janë përdorur për të reflektuar zhvillimet më të fundit në zbatimin e Strategjisë,

veçanërisht në lidhje me treguesit e performancës, shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe funksionimin e mekanizmave koordinues.

Vlerësimi bazohet në analizën e dokumenteve ligjore, raporteve zyrtare të zbatimit dhe burimeve administrative të institucioneve përkatëse. Kufizimet kryesore të vlerësimit lidhen me mungesën e të dhënave të standartizuara për disa tregues, si dhe me dallimet në praktikën e raportimit ndërinstytucional. Megjithatë, këto kufizime janë marrë në konsideratë gjatë analizës dhe nuk ndikojnë në vlefshmërinë e përgjithshme të gjetjeve, të cilat mbështeten në triangulim të burimeve të shumta të të dhënave.

Vlerësimi është ndërtuar në përputhje me kriteret e OECD-DAC për vlerësim, duke përfshirë relevancën, efikasitetin, koherencën, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë, të përshtatura në kontekstin e politikave publike për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Procesi i vlerësimit është udhëhequr nga parimet e etikës dhe të drejtave të njeriut, përfshirë parimin “mos dëmto”, respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Qasja ka qenë e përqendruar tek viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe është siguruar që çdo informacion i ndjeshëm të trajtohet në përputhje me standardet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave dhe etikës profesionale.

Qasja metodologjike e ndjekur mundëson një analizë të balancuar ndërmjet progresit të arritur dhe sfidave të identifikuara, duke siguruar një bazë të besueshme për formulimin e rekomandimeve të orientuara drejt politikave dhe për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit.

## 2. KORNIZA METODOLOGJIKE E VLERËSIMIT

Korniza metodologjike e këtij vlerësimi është projektuar në përputhje me standardet e BE-së për monitorim dhe vlerësim të politikave publike dhe me normat ndërkombëtare të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Procesi është udhëhequr nga parimet e transparencës, objektivitetit, gjithëpërfshirjes, barazisë gjinore dhe triangulimit të burimeve. Vlerësimi bazohet në kriteret e OECD DAC: Relevancë, Efektivitet, Efikasitet, Koherencë, Qëndrueshmëri dhe Ndikim, si dhe Normat dhe Standardet e Grupit të Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (UNEG), të cilat kërkojnë përdorimin e evidencave të verifikueshme dhe analizë të balancuar ndërinstucionale.

### 2.1. METODAT E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Për të siguruar një bazë të gjerë, të besueshme dhe të trianguluar informacioni, vlerësimi ka përdorur një qasje të kombinuar të metodave sasiore dhe cilësore:

- **Analiza e dokumentacionit ekzistues (desk review)** që përfshiu Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2022 – 2026; raportet vjetore të zbatimit për periudhën 2022 – 2024; kornizën ligjore dhe politikat përkatëse; si dhe të dhënat nga Baza Kombëtare e të Dhënave për Dhunën në Familje dhe Dhunën ndaj Grave, administruar nga Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës.
- **Analiza e raporteve institucionale për vitin 2025** të dorëzuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë (përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Policinë e Kosovës, Agjencinë për Barazi Gjinore, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe të dhënat e përcjella nga Këshilli i Evropës). Këto të dhëna janë përdorur për të plotësuar analizën e progresit për periudhën 2022–2025 dhe për të reflektuar zhvillimet më të fundit në zbatimin e Strategjisë.
- **Mbledhja e të dhënave shpesh përmes pyetësorëve të dedikuar**, të përgatitur për institucionet përgjegjëse qendrore, komunat, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.
- **Diskutime në grupe të fokusuara**, me përfaqësuese/përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfshirë Mekanizmat Koordinues Lokalë<sup>1</sup>, si dhe me viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës<sup>2</sup> me qëllim përfshirjen e perspektivës së përdorueseve/përdoruesve të shërbimeve dhe vlerësimin e funksionalitetit të mekanizmave mbrojtës.
- **Takime validuese**<sup>3</sup> të organizuara në faza të ndryshme të procesit, me institucione qendrore, përfaqësuese/përfaqësues të nivelit lokal, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë, për të verifikuar dhe konsoliduar gjetjet e vlerësimit.

<sup>1</sup> U zhvilluan dy diskutime përkatësisht në MKL e Gjakovës dhe të Prizrenit, në datën 19 shtator 2025.

<sup>2</sup> Një diskutim u bë në Strehimoren e Gjakovës, në datën 19 shtator 2025.


<sup>3</sup> Janë zhvilluar gjithsej katër takime validuese, përkatësisht: dy takime validuese me institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e strategjisë (një në fazën e parë të përpunimit të të dhënave të mbledhura në datën 18 shtator 2025 dhe një në përfundim të përgatitjes së draft raportit për validimin e gjetjeve të tij, në datën 21 tetor 2025); një takim me zyrtaret/zyrtarët për barazi gjinore të komunave të ndryshme të Kosovës (në datën 18 shtator 2025), si dhe një takim me përfaqësuese/përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile (në datën 22 shtator 2025).

## 2.2. PROCESI I VLERËSIMIT DHE KUFIZIMET METODOLOGJIKE

Vlerësimi shqyrton arritjet kryesore të Strategjisë në raport me objektivat dhe treguesit përkatës, duke analizuar progresin institucional, zhvillimet ligjore, ofrimin e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe funksionimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstytucional.

**Kufizimet metodologjike** lidhen kryesisht me mospërputhje të të dhënave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, raportim të pjesshëm ose me cilësi të ndryshme nga disa institucione dhe komuna, si dhe mungesë të disa të dhënave të standartizuara statistikore. Megjithatë, triangulimi i burimeve dhe procesi i validimit të vazhdueshëm kanë mundur minimizimin e këtyre kufizimeve dhe garantimin e besueshmërisë së gjetjeve. Rezultatet e këtij procesi përbëjnë bazën analitike për vlerësimin e progresit në zbatimin e Strategjisë gjatë periudhës 2022–2025 dhe për formulimin e rekomandimeve të orientuara drejt politikave.

Figura 1: Procesi i vlerësimit



Burimi: Përgatitur nga ekipi i vlerësimit, 2025

Një kufizim shtesë metodologjik lidhet me funksionimin e sistemit të treguesve të Strategjisë. Për një pjesë të treguesve, vlerat bazë nuk janë përcaktuar në fillim të periudhës së zbatimit, ndërsa në raste të tjera mungojnë mekanizmat institucionale për mbledhjen dhe harmonizimin e të dhënave. Si rezultat, për disa tregues nuk ka qenë e mundur të realizohet matja e plotë e progresit. Në këtë kontekst, vlerësimi bën dallim ndërmjet treguesve me kufizime konceptuale dhe atyre që janë të matshëm në parim, por për të cilët mungojnë të

dhëna. Ky dallim metodologjik shërben si bazë për rekomandimet mbi përmirësimin e kornizës së monitorimit në strategjinë e ardhshme.

Qasja metodologjike e ndjekur siguron koherencë ndërmjet analizës së të dhënave, vlerësimit të performancës së treguesve dhe formulimit të rekomandimeve, duke garantuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet evidencës dhe orientimit të politikave.

### 2.3. PYETËSORËT STANDARTË INSTITUCIONALË

Përdorimi i pyetësorëve standartë institucionalë ka përbërë një komponent kyç të mbledhjes së të dhënave parësore, duke mundësuar sigurimin e informacionit të harmonizuar dhe të krahasueshëm mbi zbatimin e Strategjisë. Pyetësorët janë zhvilluar në përputhje me parimet e Grupit të Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (UNEG), duke garantuar mbledhje të të dhënave të strukturuar, të paanshme dhe të përshtatura me mandatin e institucioneve përgjegjëse.

Struktura e pyetësorëve ka kombinuar pyetje të mbyllura (po/jo) dhe pyetje të hapura analitike, duke mundësuar si mbledhjen e të dhënave të standartizuara, ashtu edhe identifikimin e sfidave dhe praktikave institucionale. Pyetjet kanë mbuluar dimensione kyçe të zbatimit të Strategjisë, përfshirë planifikimin dhe buxhetimin, funksionimin e mekanizmave koordinues, masat për parandalim dhe trajtim të rasteve, mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave, si dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve janë analizuar duke përdorur një kombinim të metodave cilësore dhe sasore dhe janë trianguluar me burime të tjera, përfshirë dokumentet strategjike, raportet institucionale dhe të dhënat administrative. Kjo qasje ka mundësuar verifikimin e gjetjeve, identifikimin e mospërputhjeve ndërinstytucionale dhe ndërtimin e një analize të balancuar mbi progresin dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë.

Qasja e ndjekur përmes pyetësorëve ka kontribuar në vlerësimin e kriterëve të OECD-DAC, veçanërisht në analizën e efektivitetit, koherencës dhe efikasitetit të ndërhyrjeve institucionale, duke ofruar evidencë të drejtpërdrejtë nga institucionet zbatuese. Gjithashtu, pyetësorët kanë shërbyer si instrument për të identifikuar boshllëqet në sistemin e monitorimit dhe raportimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në analizën e treguesve të paraqitur në kapitullin përkatës.

Në këtë raport, përdorimi i termave “dhunë në familje”, “dhunë ndaj grave” dhe “dhunë në baza gjinore” ndjek terminologjinë e Strategjisë Kombëtare që po vlerësohet. Në të njëjtën kohë, analiza merr në konsideratë përkufizimet dhe standardet e Konventës së Stambollit, e cila përdor termin “dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje” si pjesë e një kornize më të gjerë të dhunës me bazë gjinore ndaj grave.

### 3. KORNIZA LIGJORE, INSTITUCIONALE DHE STRATEGJIKE

Korniza ligjore, institucionale dhe strategjike e Kosovës për mbrojtje nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore përbën bazën analitike për vlerësimin e relevancës dhe koherencës së politikave publike, në përputhje me kriteret e OECD-DAC. Kjo kornizë shërben gjithashtu për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe funksionalitetin e mekanizmave institucionale përgjegjës për zbatimin e Strategjisë.

#### 3.1. KORNIZA NDËRKOMBËTARE DHE PËRPUTHJA ME STANDARDET EVROPIANE

Politikat e Kosovës për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore janë të ndërtuara mbi një kornizë të konsoliduar ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e cila shërben si referencë për vlerësimin e përputhshmërisë dhe relevancës së politikave kombëtare.

Në qendër të kësaj kornize qëndron Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)<sup>4</sup>, e cila përcakton standardet më të avancuara ndërkombëtare për parandalim, mbrojtje dhe ndëshkim të dhunës ndaj grave e dhunës në familje. Në këtë kontekst, raporti “Vlerësimi i përafritit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit” (2022)<sup>5</sup>, i përgatitur duke ndjekur metodologjinë e GREVIO-s, evidenton përparime në konsolidimin e kornizës ligjore dhe institucionale në Kosovë, por gjithashtu identifikon disa fusha që kërkojnë forcim të mëtejshëm, përfshirë sigurimin e buxheteve të dedikuara për shërbimet për viktimat, përmirësimin e aksesit në shërbime të specializuara, standartizimin e trajnimeve ndër-institucionale dhe mbledhjen sistematike të të dhënave gjinore, llojit të dhunës dhe karakteristikave të tjera individuale. Në këtë kontekst, zhvillimet e fundit reflektojnë gjithashtu përpjekjet për përafritim gradual me Direktivën e Bashkimit Evropian 2024/1385, e cila vendos standarde minimale për të drejtat e viktimave, qasjen në shërbime dhe mekanizmat e mbështetjes dhe kompensimit.

Përveç Konventës së Stambollit dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)<sup>6</sup>, politikat kombëtare ndërtohen gjithashtu mbi Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprimin (1995)<sup>7</sup> dhe Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm<sup>8</sup>, në veçanti mbi Objektivin 5 (OZHQ 5) për barazinë gjinore. Këto instrumente kanë orientuar Kosovën drejt një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe përgjegjshmëri institucionale, duke e lidhur parandalimin e dhunës me zhvillimin e qëndrueshëm dhe fuqizimin socio-ekonomik të grave.

Kjo kornizë ndërkombëtare përbën referencën kryesore për vlerësimin e relevancës dhe koherencës së Strategjisë, duke mundësuar analizimin e shkallës në të cilën politikat kombëtare reflektojnë standardet dhe detyrimet ndërkombëtare.

<sup>4</sup> Shih: <https://rm.coe.int/168046246b>

<sup>5</sup> Shih: <https://rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-sqi/1680a9203f>

<sup>6</sup> Shih: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Konvent%20CEDAW.pdf>

<sup>7</sup> Shih: <https://awenetwork.org/media/6462066697d99.pdf>

<sup>8</sup> Shih: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/zhvillimi-i-qendrueshem/objektivat-per-zhvillim-te-qendrueshem/>

### 3.2. KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore është forcuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-185 (2023), i cili përfaqëson një reformë të rëndësishme në përafrimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Në zbatim të këtij ligji, Qeveria e Kosovës ka miratuar një sërë aktesh nënligjore që synojnë funksionalizimin praktik të sistemit. Këto përfshijnë Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinatores/Koordinatorit Kombëtar, Udhëzimin Administrativ për Linjën Kombëtare Emergjente 24/7 dhe Udhëzimin Administrativ për Fondin Emergjent për Viktimat, të cilat vendosin mekanizma të standartizuar për reagimin emergjent dhe mbështetjen financiare për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Po ashtu, korniza ligjore parashikon zhvillimin e programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të dhunës, për të cilat parashihet hartimi i akteve përkatëse nënligjore që do të rregullojnë mënyrën e zbatimit të këtyre programeve.

Një element kyç i arkitekturës institucionale është edhe Rregullorja për Mekanizmat Koordinues Lokalë (MKL), e cila për herë të parë përcakton strukturën, mandatin, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të MKL-ve, duke i bërë ata shtylla qendrore të koordinimit ndërinstitucional në nivel komunal. Rregullorja siguron takime të rregullta, detyrim raportimi dhe standardizim të procedurave, duke rritur ndjeshëm qartësinë operacionale në nivel lokal.

Përveç Ligjit Nr. 08/L-185, korniza ligjore kombëtare mbështetet në ligje dhe dokumente të tjera sektoriale që përbëjnë infrastrukturën e plotë të mbrojtjes. Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi vendosin parimet e barazisë substanciale dhe mosdiskriminimit, duke e lidhur qasjen e mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve me kornizën më të gjerë të të drejtave të njeriut. Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin përforcon të drejtën e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve për kompensim financiar dhe përfshin mekanizma të dedikuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, duke rritur mbështetjen e tyre socio-ekonomike.

Në kuadër të standartizimit të praktikave ndërinstitucionale, vend të rëndësishëm zënë edhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV). PSV për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, të hartuara nga ABGJ, ofrojnë udhëzime të detajuara për institucionet në trajtimin, referimin dhe mbështetjen e rasteve të dhunës. Paralelisht, PSV për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV) standardizojnë procesin e identifikimit, njoftimit dhe asistencës së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve brenda sistemit të drejtësisë. Për rastet e dhunës seksuale, Protokolle Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale siguron një qasje të harmonizuar dhe të orientuar në të drejtat e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, duke nxitur bashkërendimin midis institucioneve të drejtësisë, policisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale.

Në të njëjtën kohë, në përputhje me nenin 16 të Konventës së Stambollit, janë ndërmarrë hapa për zhvillimin dhe institucionalizimin e programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës. Në këtë drejtim është zhvilluar Kurrikula për Profesionistët që Ofrojnë Programe për Trajtimin

e Kryerësve të Dhunës<sup>9</sup>, e cila synon të forcojë kapacitetet profesionale për zbatimin e programeve të specializuara të trajtimit. Gjithashtu, në vitin 2024 është miratuar Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave<sup>10</sup>, i cili është institucionalizuar në Burgun e Dubravës dhe synon adresimin e sjelljes së dhunshme përmes ndërhyrjeve të strukturuar profesionale, me qëllim parandalimin e përsëritjes së dhunës.

Së bashku, këto instrumente kontribuojnë në forcimin e qasjes së koordinuar ndërinstytucionale në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 7 dhe 10 të Konventës së Stambollit, të cilat kërkojnë zhvillimin e politikave të integruara dhe mekanizmave efektivë të koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Komponentë të tjerë ligjorë, si Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, ndryshimet në Kodin Penal (Ligji Nr. 08/L-188) dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (Ligji Nr. 08/L-187), kanë për qëllim forcimin e ndëshkueshmërisë dhe efikasitetit të drejtësisë penale. Ndryshimet e fundit kanë vendosur masa më të rrepta penale, ndalime shtesë për të dënuarit, si dhe afate të shkurtra për hetimin dhe gjykimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke synuar parandalimin dhe uljen e recidivizmit.

Megjithëse korniza ligjore e Kosovës është në përgjithësi e avancuar dhe e përafuar me standardet ndërkombëtare, disa boshllëqe mbeten, përfshirë mungesën e një dispozite të posaçme për femicidin, adresimin e pjesshëm të dhunës në baza gjinore në hapësirën digjitale dhe sfida në zbatimin praktik të disa instrumenteve, si mbikëqyrja elektronike, për shkak të kufizimeve buxhetore. Këto elemente janë të rëndësishme për vlerësimin e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së kornizës ligjore.

### 3.3. KORNIZA INSTITUCIONALE

Struktura institucionale për zbatimin e kornizës ligjore dhe strategjike është ndërtuar mbi parimin e bashkërendimit ndërinstytucional dhe përgjegjësisë së ndarë ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, duke përbërë një element kyç për vlerësimin e efektivitetit dhe koherencës së zbatimit të Strategjisë.

Në këtë arkitekturë qendrore, një rol të rëndësishëm luajnë edhe ABGJ dhe ministritë e linjës me përgjegjësi sektoriale, përfshirë MAPL, e cila mbështet funksionimin e komunave dhe kontribuon në forcimin e mekanizmave lokalë të koordinimit. Institucionet e pavarura dhe ato mbështetëse shtesë marrin pjesë në parandalimin, identifikimin, shërbimet, referimin dhe mbrojtjen e rasteve të dhunës në familje, duke siguruar funksionalitet të sistemit në të gjithë zinxhirin institucional.

Në nivel lokal, MKL-të përbëjnë hallkën kryesore të zbatimit të politikave dhe procesit të referimit të rasteve. MKL-të bashkojnë përfaqësuese/përfaqësues të institucioneve të sigurisë, drejtësisë, shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit dhe administratës komunale, duke mundësuar një reagim të koordinuar, të integruar dhe të bazuar në standarde të

<sup>9</sup> Shih: [Kurrikula për Programet për Kryerësit e Dhunës Shqip FINAL \(3\).docx](#)

<sup>10</sup> Shih: [Programi Kombëtar ALB](#)

përbashkëta veprimi. Miratimi i rregullores për MKL-të ka krijuar bazën ligjore për funksionimin e tyre të rregullt, detyrimet për raportim dhe rritjen e cilësisë së bashkërendimit.

OSHC mbeten aktorë kyç në këtë ekosistem institucional, veçanërisht në ndërgjegjësim, ofrim të shërbimeve psiko-sociale dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Përmes tyre, zbatimi i strategjisë fiton dimension komunitar, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave të përfitueseve/përfituesve, duke e bërë reagimin institucional më të qashtëm, më të specializuar dhe më të ndjeshëm ndaj perspektivave gjinore.

Funksionimi i kësaj arkitekture institucionale përbën një element thelbësor për analizën e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe për identifikimin e boshllëqeve në koordinimin ndërinstitutional, të trajtuara në kapitujt vijues të këtij raporti.

### **3.4. KORNIZA POLITIKE DHE STRATEGJIKE**

Dokumenti bazë që udhëheq politikat shtetërore në këtë fushë është Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, e cila përcakton vizionin për një shoqëri pa dhunë, me institucione të përgjegjshme dhe shërbime të integruara, të qashtme dhe cilësore për të gjitha viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Strategjia është hartuar përpara zhvillimeve të fundit ligjore dhe rekomandimeve ndërkombëtare, por gjatë zbatimit të saj është përshtatur gradualisht me këto zhvillime, duke reflektuar një nivel të moderuar fleksibiliteti institucional.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë, institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale raportojnë përmes formatit standard të përcaktuar nga Ministria e Drejtësisë, çka mundëson mbledhjen e të dhënave të harmonizuara dhe analizën e progresit në nivel kombëtar dhe lokal. Gjatë vitit të fundit, kërkesa për informacion është shtrirë gjithashtu te organizatat e shoqërisë civile, me qëllim plotësimin e pasqyrës së zbatimit dhe përfshirjen e evidencave të bazuara në përvojën e drejtpërdrejtë me viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe komunitetet.

Partnerët ndërkombëtarë jo vetëm që kanë ofruar mbështetje teknike dhe financiare për ngritjen e kapaciteteve, përmirësimin e sistemit të referimit dhe forcimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara, por gjithashtu raportojnë për kontributet e tyre në zbatimin e Strategjisë përmes të njëjtit format standard të raportimit, duke kontribuar në një pasqyrë më të plotë dhe të koordinuar të progresit në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Stambollit dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Gjatë periudhës 2022–2025, Kosova ka konsoliduar ndjeshëm kornizën ligjore, institucionale dhe strategjike, duke arritur një nivel të lartë përafri me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, sfida mbeten në zbatimin praktik, veçanërisht në nivel lokal, përfshirë mungesën e buxheteve të dedikuara, pabarazitë në ofrimin e shërbimeve dhe nevojën për trajnime të qëndrueshme ndërinstitutionale.

Këto zhvillime dhe boshllëqe përbëjnë bazën për analizën e detajuar të progresit të zbatimit të Strategjisë për vitet 2022–2025, e cila bazohet në të dhënat e raportuara nga institucionet

përgjegjëse, mekanizmat koordinues lokalë dhe aktorët e tjerë relevantë, që do të trajtohet në kapitujt vijues të këtij raporti të vlerësimit.

Këto elemente përbëjnë bazën për analizën e relevancës, koherencës dhe efektivitetit të Strategjisë, të trajtuara në kapitujt vijues, duke lidhur drejtpërdrejt kornizën normative me performancën e zbatimit.

## 4. GJETJET NGA VLERËSIMI AFATMESEM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE 2022–2026

Në këtë kapitull paraqitet një analizë e detajuar e progresit, sfidave dhe ndikimit të masave të parashikuara në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022–2026) për periudhën 2022–2025.

Ky vlerësim analizon performancën e Strategjisë sipas objektivave strategjike, funksionimit të zinxhirit institucional të reagimit dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Analiza mbështetet në raportet vjetore institucionale, të dhënat administrative për periudhën 2022–2025, raportet e Komisionit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare dhe vendore, si dhe në evidencat e mbledhura gjatë këtij procesi vlerësimi.

Qasja e përdorur është në përputhje me kriteret e rishikuara të vlerësimit të OECD-DAC 2019<sup>11</sup>, të cilat përfaqësojnë kornizën më të avancuar ndërkombëtare për vlerësimin e ndërhyrjeve në fushën e zhvillimit, politikave publike dhe qeverisjes. Këto kritere, konkretisht: Relevanca, Koherenca, Efektiviteti, Eficienca, Ndikimi dhe Qëndrueshmëria, shërbejnë si lente analitike për të vlerësuar jo vetëm rezultatet e arritura, por edhe arsyetimin, cilësinë, lidhshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjes në një kontekst që ndryshon vazhdimisht. Aplikimi i tyre në këtë vlerësim siguron një analizë të plotë, të bazuar në të dhëna, të progresit, sfidave dhe mekanizmave institucionalë që ndikojnë në zbatimin e Strategjisë. Kjo qasje harmonizon transparencën me nxjerrjen e mësimave praktike, duke kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe shërbimeve për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Të dhënat dhe detajet e përfshira në Shtojcën 1 të këtij raporti vlerësimi përbëjnë bazën kryesore të analizës së kapitullit 4 dhe sigurojnë gjurmim të plotë të gjetjeve me burime të pavarura dhe të verifikuara.

### 4.1. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRESIT DHE BOSHTËQVE STRUKTURE

Periodha 2022–2025 karakterizohet nga dinamika të theksuara reformuese dhe rritje e përgjegjshmërisë institucionale. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në fushën e harmonizimit ligjor, përmirësimit të mekanizmave të mbrojtjes, digjitalizimit të të dhënave dhe rritjes së kapaciteteve të zinxhirit të drejtësisë. Miratimi i Ligjit Nr. 08/L-185 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore” (12.10.2023) dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022–2026) kanë forcuar qartësisht reagimin institucional, koordinimin ndërsektorial dhe bazën ligjore të mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Një komponent i rëndësishëm i progresit institucional është roli i ABGJ, e cila gjatë periudhës 2023–2024 ka kontribuar në forcimin e kuadrit normativ dhe ngritjen e kapaciteteve ndërinstitutionale. Rishikimi i PSV-ve dhe intensifikimi i aktiviteteve trajnuese dhe koordinuese reflektojnë një angazhim të shtuar institucional. Të dhënat tregojnë se mbi 60 për

<sup>11</sup> Shih: [https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2019/12/better-criteria-for-better-evaluation\\_f7a307eb/15a9c26b-en.pdf](https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2019/12/better-criteria-for-better-evaluation_f7a307eb/15a9c26b-en.pdf)

qind e aktiviteteve të planifikuara janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, duke sinjalizuar progres të moderuar drejt të qëndrueshmit.

Në fushën më të gjerë të të drejtave të njeriut, Qeveria ka operuar një mekanizëm koordinues të rëndësishëm, Grupin Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut, i cili funksionon sipas rregullores Nr.01/2021 dhe i ka mundësuar institucioneve një kuadër të përbashkët për harmonizim të politikave dhe praktikave shtetërore. Ky zhvillim përforcon qasjen e përbashkët të institucioneve ndaj çështjeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë edhe fushën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Megjithatë, analiza e dokumenteve dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile apo organizatat ndërkombëtare, tregon se zbatimi praktik i reformave nuk bëhet në mënyrë të barabartë, veçanërisht në komuna me kapacitete të kufizuara, duke krijuar boshllëqe të dukshme në qasjen në drejtësi dhe në nivelin e mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Në nivel institucional, progresi përgjatë zinxhirit të reagimit mbetet i pabarabartë. Policia e Kosovës paraqet nivelin më të lartë të funksionalizimit operacional, veçanërisht në reagimin emergjent dhe zbatimin e urdhrave mbrojtës. Prokuroritë kanë avancuar në ngritjen e aktakuzave dhe menaxhimin procedural të rasteve, ndërsa Gjykatat vijojnë të aplikojnë në mënyrë jo uniforme masa ndëshkimore, shpesh më të buta, çka kufizon efektivitetin parandalues të sistemit. Qendrat për Punë Sociale (QPS) përballen me kapacitete të kufizuara dhe shpërndarje të pabarabartë, ndërsa strehimoret, pavarësisht rritjes së financimit, mbeten të varura nga burime jo të qëndrueshme.

Në kuadër të forcimit të qasjes në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, rëndësi të veçantë ka pasur edhe ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtareve/gjyqtarëve dhe prokuroreve/prokuroreëve.

Sipas të dhënave të Akademisë së Drejtësisë (AD), gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë janë zhvilluar programe të vazhdueshme trajnimi<sup>12</sup> për gjyqtare/gjyqtarë dhe prokurore/prokuroreë, si në kuadër të trajnimeve fillestare ashtu edhe atyre të vazhdueshme. Këto programe kanë përfshirë në mënyrë sistematike modulet për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave dhe kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale<sup>13</sup> për trajtimin e rasteve, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit.

Një pjesë thelbësore e qasjes efektive në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje mbetet edhe funksionimi i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas (ANJF). Të dhënat e ANJF tregojnë se gjatë viteve 2022–2024 është shënuar rritje e qëndrueshme e numrit të përfitueseve/përfituesve të ndihmës juridike falas në fushën e dhunës në familje (DHF), si në procedurat penale ashtu edhe në ato civile. Vetëm në vitin 2022, ndihmë juridike falas për DHF kanë përfituar 173 persona; në vitin 2023 numri ka arritur në 206 persona (76

<sup>12</sup> Janë trajnuar gjashtë gjenerata të gjyqtareve/gjyqtarëve të sapoemëruar (gjeneratat VIII–XIII) dhe tri gjenerata të prokuroreve/prokuroreëve të sapoemëruar (gjeneratat IX–XI)

<sup>13</sup> Paralelisht, AD ka organizuar një numër të konsiderueshëm trajnimesh të vazhdueshme mbi aspektet penale dhe civile të trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke përfshirë 11 aktivitete trajnuese në vitin 2022, 30 aktivitete trajnuese në vitin 2023 dhe 14 trajnime të specializuara në vitin 2024.


raste penale dhe 130 civile); ndërsa në vitin 2024 janë trajtuar 214 raste (75 penale dhe 139 civile). Rritja e vazhdueshme e kërkesave për ndihmë juridike falas tregon dy elemente të rëndësishme: rritjen e besimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve tek ANJF si portë e qasjes në drejtësi, si dhe nevojën për rritje të kapaciteteve institucionale, sidomos në komunat me ngarkesë më të lartë.

Roli i sektorit shëndetësor mbetet thelbësor në reagimin ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Raportet e Ministrisë së Shëndetësisë për vitet 2023 dhe 2024 dokumentojnë një rritje të konsiderueshme të rasteve të trajtuara në institucionet shëndetësore dhe një forcim gradual të kapaciteteve të përgjigjes klinike. Institucionet shëndetësore kryejnë ekzaminimet fizike, psikologjike dhe procedurat mjeko-ligjore për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, duke qenë një pikë kyçe e identifikimit të hershëm dhe referimit drejt zinxhirit institucional.

Të dhënat administrative për vitin 2025 tregojnë vijimësi të konsolidimit të përgjigjes institucionale, me vazhdim të aktiviteteve në fushën e parandalimit, ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të koordinimit ndërinstitutional. Ky trend konfirmon stabilizimin gradual të mekanizmave të zbatimit në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Analiza ndërinstitutionale tregon se zinxhiri i reagimit ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është konsoliduar në mënyrë jo të barabartë. Policia e Kosovës paraqet shkallën më të lartë të funksionalizimit të protokolleve dhe standardizimit të reagimit emergjent, ndërsa Prokuroritë kanë avancuar në ngritjen e aktakuzave dhe menaxhimin procedural të rasteve. Gjykatat, megjithëse kanë rritur qasjen në urdhra mbrojtës, vijojnë të zbatojnë masa ndëshkimore të buta dhe jo uniforme, gjë që kufizon efektivitetin mbrojtës të sistemit. QPS-të funksionojnë me kapacitete të pabarabarta dhe ngarkesa të larta pune, ndërsa strehimoret, pavarësisht rritjes së financimit publik, mbeten të varura nga burime jo të qëndrueshme për shërbime të standardizuara psikosociale, ligjore dhe të riintegritimit.

Grafik 2. Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Polici për periudhën 2022 - 2025



Burimi: Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje (<https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>)

Të dhënat mbi prevalencën e dhunës duhet interpretuar me kujdes metodologjik, pasi rritja e rasteve të raportuara në periudhën 2023–2025 reflekton përmirësim të zbulueshmërisë dhe

rritje të besimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në institucionet e mbrojtjes, dhe jo domosdoshmërisht rritje të vetë fenomenit.

Në vijim, të dhënat e ANJF tregojnë se zyrtaret/zyrtarët e saj kanë filluar futjen e të dhënave në sistemin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, duke kontribuar kështu në harmonizimin e raportimit institucional dhe rritjen e koherencës së bazës së të dhënave kombëtare.

Një ndër sfidat më të theksuara përgjatë periudhës 2022–2025 mbetet mungesa e një sistemi tërësisht të integruar dhe të standardizuar të të dhënave ndërinstytucionale. Megjithëse është krijuar baza e përbashkët digjitale, institucionet ende raportojnë në platforma të ndryshme dhe me metodologji jo të harmonizuara, duke kufizuar analizën krahasuese, gjurmimin e rasteve të përsëritura dhe vlerësimin e rrezikut. Kjo situatë është theksuar si pengesë strukturore nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës (KiE), OSBE dhe analizat vendore, duke e identifikuar harmonizimin e të dhënave si prioritet kritik për periudhën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026) dhe në funksion të përgatitjes së kornizës së re strategjike pas vitit 2026.

Vlerësimi i shkallës së zbatimit të Strategjisë tregon një intensifikim të dukshëm gjatë 2022–2024, me mbi 85 për qind të veprimeve në proces zbatimi ose të realizuara sipas raportimit të Ministrisë së Drejtësisë.<sup>14</sup> Të dhënat administrative të mbledhura nga institucionet për vazhdimin e zbatimit të strategjisë edhe gjatë vitit 2025, tregojnë gjithashtu progres në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.<sup>15</sup> Kjo dinamikë konfirmon një rritje të përgjegjshmërisë në nivel qendror, pavarësisht sfidave të theksuara lidhur me raportimin e të dhënave dhe bashkëpunimin e autoriteteve lokale. Megjithëse Baza Kombëtare e të Dhënave është funksionalizuar dhe përbën një arritje qendrore, përmirësimi i funksionimit dhe sidomos analiza e përdorimi më i mirë dhe me një gamë më të gjerë i të dhënave që mbledhen nga institucione të rëndësishme si Policia, Prokuroria, QPS-të dhe ASK-ja, mbetet një përparësi për t’u trajtuar me sa më shumë efikasitet gjatë periudhës së mbetur të zbatimit të Strategjisë, por edhe në vitet në vijim.

Të dhënat dhe analizat e përfshira në këtë raport tregojnë se progresi përgjatë zinxhirit ndërinstytucional të reagimit ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ka ndjekur ritme të ndryshme konsolidimi. Kjo dinamikë pasqyron variacionet strukturore mes institucioneve dhe fazat e ndryshme të zhvillimit të kapaciteteve të tyre operacionale. Si rrjedhojë, interpretimi i të dhënave dhe rezultateve kërkon një qasje të balancuar dhe të ndjeshme ndaj kontekstit institucional dhe praktik.

Ky vlerësim mbështetet në analizën sintetike të të dhënave administrative të institucioneve përgjegjëse, raporteve zyrtare të zbatimit të Strategjisë dhe dokumenteve monitoruese ndërkombëtare të shqyrtuara në kuadër të këtij raporti. Këto gjetje ndihmojnë në orientimin e analizës brenda secilit Objektiv Strategjik dhe sigurojnë që vlerësimi të reflektojë një kuptim të plotë të progresit, boshllëqeve dhe ritmeve të institucionalizimit të reformave.

<sup>14</sup> Bazuar në raportet e përvitshme të monitorimit të zbatimit të Strategjisë, për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

<sup>15</sup> Sidomos nga institucione si Agjencia për Barazinë Gjinore, Ministria e Shëndetësisë, Akademia e Kosovës për Sigurinë Publike, Policia e Kosovës, Ministria e Drejtësisë. Progres të dukshëm gjatë vitit 2025 ka edhe në aktivitetet apo ndërhyrjet që mbështeten nga Këshilli i Evropës.

Gjatë vitit 2025, të dhënat administrative të raportuara nga institucionet përgjegjëse tregojnë vijimësi të konsolidimit të përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare 2022–2026. Sipas raportimeve të PK, MD, QPS-ve dhe ABGJ-së, mekanizmat e identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve kanë vijuar të funksionojnë në mënyrë të strukturuar, duke reflektuar rritje të kapaciteteve operacionale dhe një nivel më të lartë të koordinimit ndërinstytucional.

Progresi përgjatë zinxhirit ndërinstytucional mbetet i diferencuar, duke reflektuar dallime në kapacitetet operacionale dhe në nivelin e institucionalizimit të praktikave. Kjo kërkon një interpretim të kujdesshëm të të dhënave dhe një qasje të diferencuar në analizën e performancës. Në këtë kuadër, gjetjet e këtij kapitulli shërbejnë si bazë për analizën sipas objektivave strategjike dhe për identifikimin e boshllëqeve që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme.

Në terma të përgjithshëm, progresi i arritur gjatë periudhës 2022–2025 vlerësohet si i moderuar, me avancime të dukshme në nivel normativ dhe institucional, por me sfida të vazhdueshme në zbatimin praktik, veçanërisht në nivel lokal dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve.

## **4.2. ANALIZA SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË, DUKE APLIKUAR KRITERET OECD–DAC**

Analiza bazohet kryesisht në periudhën 2022–2024, ndërsa të dhënat e vitit 2025 janë përdorur si evidencë plotësuese për të reflektuar trendet më të fundit dhe për të mbështetur interpretimin e zhvillimeve në fazën përmbyllëse të Strategjisë.

Analiza e zbatimit të Strategjisë në periudhën 2022–2025 tregon se progresi në të gjithë zinxhirin institucional të reagimit ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është i diferencuar, duke reflektuar faza të ndryshme të konsolidimit strukturor, pjekurisë institucionale dhe integritit të standardeve ndërkombëtare në praktikën e përditshme. Këto ritme të ndryshme të institucionalizimit janë të pritshme dhe të dokumentuara gjerësisht në literaturën e vlerësimit për politikat shumësektoriale dhe përputhen me gjetjet krahasuese të vendeve të tjera në tranzicion që zbatojnë Konventën e Stambollit dhe acquis të BE-së.

Institucionet e zbatimit të ligjit, veçanërisht Policia dhe Prokuroria, paraqesin përparime më të dukshme në standardizimin e procedurave, rritjen e efikasitetit procedural dhe koordinimin me partnerët sektorialë, duke demonstruar shkallë më të lartë funksionalizimi të reformave të nisura me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-185. Gjykatat dhe QPS-të, ndërkohë, ndodhen ende në proces të forcimit të kapaciteteve teknike, burimeve njerëzore dhe mekanizmave të mbështetjes ndërsektoriale, një proces i natyrshëm ky, duke pasur parasysh rolin e tyre të ndërlikuar në menaxhimin e rasteve të vështira dhe kërkesën për koordinim të thelluar me MKL, strehimoret, shërbimet shëndetësore dhe mjeko-ligjore.

GREVIO dhe standardet e BE-së theksojnë se asimetritë ndërinstytucionale nuk janë domosdoshmërisht tregues të dobësive, por më tepër pasqyrojnë një fazë tranzicioni ku institucionet ndërtojnë kapacitetet e tyre në ritme të ndryshme, në varësi të burimeve, mandatit ligjor dhe kompleksitetit të funksioneve. Në këtë kontekst, interpretimi i progresit

duhet të jetë i ndjeshëm ndaj variacioneve strukturore, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: nivelin e ngarkesës së punës, burimet buxhetore të dedikuara, shkallën e institucionalizimit të trajnimeve të detyrueshme dhe harmonizimin e të dhënave administrative me standartet e Eurostat.

Kuptimi i kësaj dinamike është i domosdoshëm për të siguruar një analizë të balancuar dhe të bazuar në të dhëna, duke ofruar një interpretim realist të arritjeve dhe sfidave. Në këtë mënyrë, rezulton më e qartë se ku është arritur koherencë ndër-institucionale, ku ka ende nevojë për riorganizim të strukturave të bashkëpunimit dhe si mund të fuqizohen instrumentet e llogaridhënies dhe monitorimit për të mbështetur konsolidimin e mëtejshëm të mekanizmave të reagimit. Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme për të orientuar masat e synuara për fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026) dhe në funksion të përgatitjes së kornizës së re strategjike pas vitit 2026, për të siguruar që Strategjia e re (2027–2030/2032) të ndërtohet mbi baza të qëndrueshme, të harmonizuara dhe të matshme.

#### 4.2.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK I: PARANDALIMI DHE IDENTIFIKIMI I DHUNËS NËPËRMJET EDUKIMIT DHE VETËDIJESIMIT

Objektivi Strategjik I synon parandalimin dhe identifikimin e hershëm të dhunës përmes edukimit dhe vetëdijesimit të shoqërisë. Ai adreson faktorët që nxisin dhunën, si stereotipet gjinore, paragjykimet dhe diskriminimin, duke synuar ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve që e justifikojnë dhunën. Në qendër të këtij objekti është integrimi i masave edukative në sistemin arsimor, fuqizimi i rolit të institucioneve, shoqërisë civile, mediave dhe sektorit privat, si dhe krijimi i programeve të trajtimit psiko-social për kryerësit e dhunës. Katër objektivat specifike nën Objektivin Strategjik I fokusohen në: (I.1) ndryshimin e sjelljeve dhe stereotipeve gjinore; (I.2) masat edukative në të gjitha nivelet e arsimit; (I.3) bashkëpunimin ndër-institucional me median dhe sektorin privat për parandalim; dhe (I.4) trajtimin e kryerësve të dhunës, bazuar në modelet evropiane.

**Progresi i përgjithshëm i zbatimit (2022–2024).**<sup>16</sup> Gjatë periudhës 2022–2024 është vërejtur një rritje e qëndrueshme e nivelit të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara nën Objektivin Strategjik I, duke reflektuar konsolidimin e kapaciteteve institucionale, bashkërendim më të strukturuar ndërmjet aktorëve përgjegjës dhe përfshirje më të gjerë të nivelit lokal. Siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, niveli i zbatimit të aktiviteteve është rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke kaluar nga 10 për qind e aktiviteteve të zbatuara plotësisht në vitin 2022 në 53 për qind në vitin 2024.

Tabela 1: Numri dhe përqindja e zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara nën objektivin strategjik 1

Viti	Nr. aktiviteteve	Të zbatuara plotësisht	Të zbatuara pjesërisht	Të pazbatuara
2022	42	10 %	31 %	59 %
2023	41	49 %	37 %	14 %
2024	45	53 %	36 %	11 %

Burimi: Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë, 2022–2024 (<https://md.rks-qov.net/zkn/>)

Ky trend pozitiv tregon se bazat e parandalimit janë forcuar, ndërkohë që rritja e përqindjes së aktiviteteve të tërësisht të zbatuara tregon një qasje më të koordinuar dhe mbështetje të

<sup>16</sup> Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të strategjisë

shtuar nga partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë. Megjithatë, niveli i aktiviteteve të pazbatuara në vitin 2022 tregon se pjesa e parë e periudhës së Strategjisë u karakterizua nga vonesa të natyrshme të nisjes së proceseve, të cilat më pas u adresuan në mënyrë progresive.

## Analiza e treguesve të Objektivit Strategjik I

Tabela 2: Matja e treguesve të objektivit strategjik I dhe objektivave specifike përkatës

TREGUESI NË NIVEL OBJEKTIVI STRATEGJIK:	VLERA BAZË	SYNIMI 2024	ARRITJA 2024	SYNIMI 2026
<b>Përqindja e grave, burrave, vajzave dhe djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme.</b>	Përcaktohet me një studim në vitin 2022	Rritur me 5%	Studimi i planifikuar për vitin 2022 nuk është realizuar; për rrjedhojë mungon vlera bazë dhe progresi nuk mund të matet në mënyrë të krahasueshme.	Rritur me 10%
<b>Indeksi i Sigurisë së Grave</b>	Çdo 0.737 në 1 grua <sup>17</sup>	Çdo 0.85 në 1 grua	0.664 (vendi 100) në 2023/24 (-0.073) <sup>18</sup> ; rikuperim në 0.700 (vendi 82) <sup>19</sup> në 2025/26 (+0.036), por ende nën objektivin 0.85.	Çdo 1 në 1 grua
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet</b>	13 raste të vrasjeve në familje për vitin 2020 <sup>20</sup>	Zvogëluar me 50%	5 raste të vrasjeve në familje për vitin 2024 <sup>21</sup> ; ulje me rreth 75% krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2025 është regjistruar një rast fatal, duke sugjeruar vazhdim të trendit në ulje.	Zvogëluar me 100%
Treguesi në nivel objektivit specifik I.1.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>1. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/ raportuara nga pala e tretë</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Rritur me 10%	Numri i rasteve të denoncuar nga pala e tretë nuk është matur në vitin 2022; për rrjedhojë mungon vlera bazë dhe progresi nuk mund të matet në mënyrë të krahasueshme.	Rritur me 20%
<b>2. Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Treguesi 5.2.2 i OZHQ)</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Të dhënat administrative të Policisë raportojnë 8 raste të dhunimit në vitin 2024; megjithatë këto të dhëna nuk përfaqësojnë prevalencën e fenomenit dhe nuk mund të përdoren për matjen e treguesit të Strategjisë.	Zvogëlohet me 20%
Treguesi në nivel objektivit specifik I.2.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026

<sup>17</sup> Siç paraqitet e matur në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/ËPS-Index-2021-Summary.pdf>.

<sup>18</sup> Siç paraqitet e matur në Indeksën "Gruaja, Paqja, Siguria 2023/24" në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2023/10/WPS-Index-full-report.pdf>

<sup>19</sup> Siç paraqitet e matur në Indeksën "Gruaja, Paqja, Siguria 2025/26" në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2025/10/WPS-Index-2025-Report.pdf>

<sup>20</sup> Vlera është caktuar bazuar në dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës.

<sup>21</sup> Të dhënat e marra nga Databaza kombëtare: <https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>

Numri i sesioneve informuese të zhvilluara për stafin e institucioneve të arsimit parauniversitar mbi shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës.	0 (Udhëzuesi po përgatitet, sesionet do zhvillohen më pas)	60 sesione në 30 komuna	Trajnimet janë zhvilluar në 20 komuna dhe 7 rajone. Megjithëse kjo mbetet nën synimin e planifikuar, shtrirja territoriale përfaqëson një bazë të rëndësishme për zgjerimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve.	16 sesione në 8 komuna të tjera
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik 1.3.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
1. Numri i institucioneve mediatike dhe bizneseve private që mbështeten të miratojnë udhëzime, standarde vetërregulluese e protokolle për të parandaluar diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës.	0	Rritur me 20%	Janë shënuar hapa përpara: nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit nga KPM, ABGJ dhe QKSGJ; letër e hapur mediave për zbatimin e Kodit të Etikës.	Rritur me 50%
2. Përqindja e personave viktimë të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Treguesi i OZHQ 11.7.2)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Të dhënat e OZHQ janë në përpunim; përderisa mungon një raport kombëtar që do të maste dhe vlerën bazë për vitin 2022, nuk mund të matet treguesi në mënyrë të krahasueshme.	Zvogëlohet me 20%
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik 1.4.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
Numri i kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave që trajtohen në programet psiko-sociale, të ngritura sipas parashikimeve në këtë Strategji.	0	Rritur me 30%	Në vitin 2024 u realizuan 24 sesione për 20 kryerës të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në kuadër të Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe standardet evropiane për programet e trajtimit të kryerësve.	Rritur me 60%

Burimi: Të dhënat e mbledhura në kuadër të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare

*Në rastet kur treguesit bazohen në matje të prevalencës (p.sh. treguesit e OZHQ), të dhënat administrative të institucioneve janë përdorur vetëm si evidencë plotësuese dhe nuk përfaqësojnë matje të drejtpërdrejtë të treguesit, duke kufizuar krahasueshmërinë me synimet e Strategjisë.*

**Vlerësimi i treguesve të Objektivit Strategjik I** tregon se institucionet përgjegjëse, së bashku me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt parandalimit dhe identifikimit të dhunës, ndërkohë që disa nga mekanizmat e matjes kërkojnë ende përmirësim dhe harmonizim. Treguesi kryesor që mat qëndrimet shoqërore ndaj mos tolerimit të dhunës nuk është matur, pasi studimi i planifikuar për vitin 2022 nuk është realizuar. Kjo kufizon vlerësimin e progresit në ndryshimin e normave shoqërore, si një

komponent thelbësor i këtij objekti dhe nënvizon rëndësinë e ngritjes së një sistemi të rregullt të matjes së perceptimeve publike, i cili është praktikë e standartizuar në vlerësimet ndërkombëtare.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian (2024)<sup>22</sup> vëren se Kosova ka shënuar përparim në fushatat parandaluese dhe ndërgjegjësuese, përfshirë ndërhyrjet e mbështetura nga UN Women, BE dhe OSBE, që kanë çuar në rritjen e raportimit të rasteve dhe në një vetëdije më të lartë publike mbi dhunën në baza gjinore. Megjithatë, Komisioni thekson se parandalimi dhe vetëdijesimi publik mbeten të fragmentuar dhe kërkojnë institucionalizim në sistemin arsimor dhe politikat komunale. Kjo konfirmon se pavarësisht rritjes së ndërhyrjeve, ndikimi transformues në normat shoqërore të të rinjve mbetet i pjesshëm dhe kërkon intervenime të qëndrueshme dhe të koordinuara.

Studimi “Dhuna në baza gjinore përmes këndvështrimit të Gjeneratës Z” (SIT/UNFPA, 2024)<sup>23</sup> thekson se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve, sidomos djemtë, vazhdojnë të normalizojnë sjellje kontrolluese dhe forma të caktuara të dhunës, duke pohuar se barrierat kulturore dhe stigmën e konsiderojnë ndër raportuesit kryesorë. Këto evidenca tregojnë se komponenti i edukimit parandalues dhe punës me djem dhe burra ka nevojë për institucionalizim dhe pilotime të qëndrueshme, në përputhje me orientimet e BE-së dhe Konventës së Stambollit për transformimin e normave gjinore.

Indeksi i Sigurisë së Grave ka pësuar luhata gjatë periudhës së vlerësimit: një rënie nga vlera bazë (0.737; vendi 77) në vitin 2023/24 (0.664; vendi 100), e ndjekur nga një rikuperim i moderuar në 2025/26 (0.700; vendi 82). Ndërsa rezultati mbetet nën synimin e strategjisë, trendi i fundit tregon përmirësim gradual dhe nënvizon rëndësinë e ndërhyrjeve të koordinuara për të forcuar sigurinë dhe ndjenjën e besimit të grave në vitet në vijim.

Sa i përket fataliteteve nga dhuna në familje, të dhënat tregojnë një trend në ulje gjatë periudhës së analizuar. Në vitet 2022 dhe 2023 janë regjistruar nga 8 viktima çdo vit (4 gra dhe 4 burra), ndërsa në vitin 2024 numri i rasteve ka rënë në 5 viktima (3 gra dhe 2 burra) dhe në vitin 2025 është regjistruar një rast fatal që ka përfshirë një grua. Megjithatë këto zhvillime sugjerojnë përmirësim gradual në reagimin institucional dhe ndërhyrjet parandaluese, numri relativisht i ulët i rasteve kërkon interpretim të kujdesshëm dhe analizë në perspektivë shumëvjeçare, duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë kontekstualë që mund të ndikojnë në këto luhata.

Një zhvillim me rëndësi të veçantë për komponentin e parandalimit është krijimi dhe pilotimi i Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, i zbatuar në Qendrën Korrektuese të Dubravës. Procesi ka filluar me miratimin nga Ministria e Drejtësisë të “Kurrikulës për Trajnimin e Profesionistëve për Ofrimin e Programeve për Kryerësit e Dhunës në Familje në Republikën e Kosovës”, e cila shërbeu si bazë për ngritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e programeve të trajtimit. Në këtë kuadër janë trajnuar 56 profesioniste/profesionistë, përfshirë psikologe/psikologë, sociologe/sociologë,

<sup>22</sup> Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm)

<sup>23</sup> “Dhuna në baza gjinore përmes këndvështrimit të Gjeneratës Z: Qëndrimet e burrave të rinj ndaj dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe femicidit në Kosovë.”, SIT, tetor 2024. Shih: [https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/GVB-Raporti\\_shq.pdf](https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/GVB-Raporti_shq.pdf)

zyrtare/zyrtarë të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, punonjëse/punonjës socialë, si dhe përfaqësuese/përfaqësues të strehimoreve dhe të organizatave të shoqërisë civile.

Në vijim është hartuar dhe miratuar Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, në përputhje me nenin 16 të Konventës së Stambollit si dhe me Standardet Evropiane për Programet për Kryerësit e Dhunës. Pas miratimit të programit janë trajnuar 15 profesioniste/profesionistë për ofrimin dhe fasilitimin e tij. Programi është pilotuar gjatë vitit 2024 në Qendrën Korrektuese të Dubravës, ku janë zhvilluar 24 sesione intensive përgjatë gjashtë muajve, duke përfshirë 20 të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë ndaj grave. Paralelisht është realizuar monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të programit duke përdorur “Impact Outcome Monitoring Toolkit” të Rrjetit Evropian për Punën me Kryerësit e Dhunës (WWP EN).<sup>24</sup> Në vijim të fazës pilotuese, Programi Kombëtar është integruar si pjesë e programeve të rregullta të trajtimit në Qendrën Korrektuese të Dubravës. Këto zhvillime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të programeve të trajtimit të kryerësve të dhunës dhe forcimit të qasjes parandaluese në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe praktikave evropiane në këtë fushë. Zbatimi i programit bazohet gjithashtu në parimin e sigurisë së viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit, duke siguruar që ndërhyrjet me kryerësit të jenë të koordinuara me mekanizmat e mbrojtjes dhe shërbimet mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

UN Women ka kontribuar në parandalimin e dhunës përmes programeve të edukimit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së mekanizmave lokalë të bashkëpunimit. Përmes organizatave partnere, janë realizuar aktivitete të vazhdueshme informuese, trajnime komunitare dhe programe për të rejtat/rinjë që adresojnë normat patriarkale, stereotipet gjinore dhe dhunën me bazë gjinore. Në këtë kuadër, UN Women ka kontribuar edhe në forcimin e bashkëpunimit me mediat përmes mbështetjes së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, me qëllim promovimin e raportimit etik, profesional dhe të ndjeshëm ndaj traumës për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ky angazhim ka ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik, adresimin e narrativave stigmatizuese dhe fuqizimin e rolit të mediave në parandalimin e këtyre formave të dhunës, duke rritur informimin e publikut mbi të drejtat e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes. Paralelisht, në partneritet me organizatat partnere, janë zhvilluar aktivitete të strukturuar ndërgjegjësuere, fushata rinore dhe nisma edukative në shkolla që synojnë adresimin e normave shoqërore dhe stereotipeve gjinore që ushqejnë dhunën. Përmes këtyre ndërhyrjeve janë fuqizuar të rejtat/rinjë që të njohin, parandalojnë dhe raportojnë format e dhunës, përfshirë dhunën digjitale, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit në mjediset shkollore dhe në ndërtimin e një kulture respekti, barazie gjinore dhe mos-tolerance ndaj dhunës. Në tërësi, këto ndërhyrje kanë përmirësuar njohuritë komunitare dhe kanë kontribuar në rritjen e raportimit të rasteve në disa komuna, duke forcuar rolin e arsimit dhe mediave si shtylla kyçe të parandalimit afatgjatë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kontributi i UNICEF ka qenë veçanërisht i rëndësishëm në parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve, përmes programeve gjithëpërfshirëse që synojnë forcimin e aftësive jetësore të fëmijëve, prindërimin pozitiv, përfshirjen e etërve në zhvillimin e hershëm të fëmijës dhe

<sup>24</sup> European Network for Work with Perpetrators (WWP EN), *European Standards for Perpetrator Programmes*, 2018. Shih: [https://www.work-with-perpetrators.eu/fileadmin/www/What\\_you\\_can\\_do/Ensure\\_the\\_quality\\_of\\_your\\_perpetrator\\_programme/European\\_Standards\\_for\\_Perpetrator\\_Programmes/WWPEN\\_Standards\\_2512.pdf](https://www.work-with-perpetrators.eu/fileadmin/www/What_you_can_do/Ensure_the_quality_of_your_perpetrator_programme/European_Standards_for_Perpetrator_Programmes/WWPEN_Standards_2512.pdf)

krijimin e mjediseve të sigurta në shkolla. Përmes rrjeteve të sigurisë shkollore dhe programeve të ndërmjetësimit bashkëmoshatar, mijëra fëmijë janë angazhuar në aktivitete që reduktojnë konfliktet dhe nxisin raportimin e hershëm të dhunës.

UNMIK ka kontribuar në parandalimin e dhunës përmes mbështetjes së aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik, veçanërisht gjatë fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe përmes iniciativave të dialogut gjithëpërfshirës që promovojnë barazinë gjinore dhe ndërtimin e paqes. Këto ndërhyrje kanë rritur ndërgjegjësimin publik për dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe kanë promovuar përfshirjen e grupeve të ndryshme komunitare në proceset e vendimmarrjes.

UNDP dha një kontribut të spikatur gjatë fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” përmes konkursit të pikturës “Youth Draw the Line/Vija që Pikturon Rinia”, një iniciativë frymëzuese që angazhoi shkollat e mesme në mbarë vendin, ku të rinjtë shprehën kreativitetin e tyre duke trajtuar pabarazinë dhe dhunën në baza gjinore. Gara dhe ekspozita e 30 punimeve fituese kontribuan ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në fuqizimin e të rinjve për të përforcuar vlerat thelbësore të barazisë gjinore. Po kështu, fushata ndërgjegjësuere e UNDP me YIHR “Të Drejtat për 365 Ditë”, theksoi se të drejtat e grave janë të drejta të njeriut çdo ditë të vitit, duke nxitur informimin dhe veprimin kolektiv për mbylljen e hendekut gjinor.

Kontributi i UNFPA në OS I ka qenë substancial, duke kombinuar ndërhyrjet e ndërgjegjësimit publik me programe të thelluara të edukimit seksual gjithëpërfshirës, fushata transformuese të normave sociale dhe aktivitete komunitare që angazhojnë djemtë, burrat, besimtarët dhe të rinjtë. Programet me komunitetet fetare, aktivitetet e bazuara në art dhe ndërhyrjet e drejtpërdrejta në shkolla kanë ndikuar në reduktimin e stereotipeve gjinore dhe në promovimin e normave të barazisë.

EULEX ka kontribuar në parandalim përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe programeve edukative për të rinjtë, të cilat synojnë uljen e tolerancës ndaj dhunës, promovimin e të drejtave të grave dhe përafrimin e praktikave të komunitetit me standardet ndërkombëtare. Aktivitetet e orientuara drejt të rinjve kanë pasur ndikim të gjerë në forcimin e vlerave të barazisë dhe në adresimin e dhunës në komunitet.

Këshilli i Evropës ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e qasjes parandaluese përmes mbështetjes për zhvillimin e instrumenteve dhe programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës. Në këtë kuadër, “Kurrikula për Trajnimin e Profesionistëve për Ofrimin e Programeve për Kryerësit e Dhunës në Familje në Republikën e Kosovës” dhe “Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave” janë hartuar dhe zbatuar me mbështetjen dhe mentorimin e Këshillit të Evropës dhe Rrjetit Evropian për Punën me Kryerësit e Dhunës (WWP EN), duke kontribuar në zhvillimin e ndërhyrjeve të specializuara për trajtimin e kryerësve në përputhje me standardet evropiane dhe me kërkesat e nenit 16 të Konventës së Stambollit.

Paralelisht, Këshilli i Evropës ka kontribuar në komponentin e parandalimit përmes programeve për adresimin e normave gjinore dhe stereotipeve, aktiviteteve të edukimit në shkolla dhe fushatave të ndërgjegjësimit mbi dhunën e fasilutuar nga teknologjia. Synimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukative në shkolla ka qenë përkrahja e të rejave dhe të rinjve për të sfiduar stereotipet e dëmshme gjinore dhe për të zhvilluar forma të komunikimit

të respektueshëm dhe të sigurt, si në hapësirën online ashtu edhe në atë offline. Këto aktivitete kontribuojnë në avancimin e qasjes parandaluese të përcaktuar në nenin 12 të Konventës së Stambollit, e cila kërkon adresimin e normave sociale dhe stereotipeve që mundësojnë ose tolerojnë dhunën ndaj grave.

BE ka kontribuar ndjeshëm në parandalim përmes programeve edukative, fushatave kundër stereotipeve dhe dhunës, aktiviteteve me të rinjtë dhe punës me komunitetet – veçanërisht përmes projekteve “Preventing GBV through Education”, “My Story, My Dignity”, “Countering Discrimination and GBV”, “AADA”, “WIntegra” dhe “Rights Amplified”. Përmes këtyre ndërhyrjeve, BE ka ndikuar drejt ndryshimit të normave sociale dhe rritjes së ndërgjegjësimit në komunitete të ndryshme, përfshirë komunitetet rurale dhe personat me aftësi të kufizuara. Megjithëse numri i aktiviteteve parandaluese është rritur ndjeshëm gjatë periudhës së vlerësimit, evidenca për ndikimin e tyre në ndryshimin e qëndrimeve dhe normave shoqërore mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së matjeve të rregullta të perceptimeve publike.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka kontribuar në zbatimin e Strategjisë përmes aktiviteteve në fushën e parandalimit, ndërgjegjësimit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale. Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete edukative me të rejtat/rinjtë në shkolla, psikologe/psikologë shkollorë, mësimdhënëse/mësimdhënës dhe Mekanizmat Koordinues Lokalë kundër Dhunës në Familje në komuna të ndryshme të Kosovës, të shoqëruara me iniciativa informuese në media. Gjithashtu, përmes angazhimit për përmirësimin e politikave publike është arritur rritja e financimit komunal për tetë strehimore të licencuara rajonale nga 71,680 euro në vitin 2022 në rreth 107,000 euro në vitin 2025. Paralelisht, janë ndërmarrë masa për forcimin e përgjigjes institucionale ndaj ngacmimit seksual në administratën publike, përfshirë aktivitete trajnuese, fushata informuese, zhvillimin e një projekt-rregulloreje për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit seksual në vendin e punës dhe një vlerësim të zbatimit të politikave ekzistuese në institucionet publike.

Në tërësi, kontributet e partnerëve ndërkombëtarë kanë qenë thelbësore për zgjerimin e ndërhyrjeve parandaluese; megjithatë, varësia nga financimi i projekteve nënvizon nevojën për institucionalizim dhe financim të qëndrueshëm nga buxheti publik.

*Megjithëse progresi është i prekshëm, masat parandaluese dhe mekanizmat e matjes janë ende në fazë zhvillimi, çka justifikon vlerësimin mesatar të efektivitetit dhe ndikimit sipas kriterëve të OECD–DAC (që paraqitet më poshtë në këtë nënkaptull).*

**Në nivel të Objektivit Specifik I.1**, mungesa e të dhënave të standardizuara për raportimet nga palët e treta dhe mosrealizimi i studimit për OZHQ 5.2.2 e bëjnë të vështirë matjen e progresit në raport me parashikimet e Strategjisë. Të dhënat administrative të Policisë për dhunën seksuale tregojnë 8 raste të raportuara në vitin 2024 dhe 4 raste në vitin 2025 për dhunime seksuale brenda familjes. Megjithatë, këto të dhëna janë indikative dhe nuk përfaqësojnë prevalencën e fenomenit, pasi reflektojnë vetëm rastet e raportuara dhe të regjistruara nga institucionet. Për këtë arsye, interpretimi i tyre duhet të bëhet në kontekstin e rritjes së zbulueshmërisë së rasteve, rritjes së besimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe të komunitetit për raportim, si dhe përmirësimin të procedurave të identifikimit dhe hetimit nga institucionet përgjegjëse. Në mënyrë të ngjashme, rritja e raportimeve nga palët e treta nuk përfaqëson domosdoshmërisht rritje të incidencës së dhunës në familje; në shumë raste ajo

reflekon rritjen e ndërgjegjësimit publik, besimin më të madh në institucionet dhe përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe referimit të rasteve.

**Për Objektivin Specifik I.2**, shënohet progres i rëndësishëm në trajnimet për stafin e arsimit parauniversitar, me mbulim në 20 komuna dhe 7 rajone. Ky zhvillim tregon rritje të kapaciteteve institucionale dhe një bazë të qëndrueshme për zgjerimin e mëtejshëm. Megjithatë, arritjet mbeten nën synimin e planifikuar, çka sugjeron se institucionalizimi i plotë i masave parandaluese në arsimin parauniversitar mbetet një prioritet për fazën në vijim.

**Nën Objektivin Specifik I.3**, nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), ABGJ dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), si edhe komunikimet publike për forcimin e zbatimit të Kodit të Etikës, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt fuqizimit të rolit të mediave dhe bizneseve në parandalimin e dhunës. Megjithatë, mungesa e një mekanizmi të strukturuar për matjen e ndikimit të këtyre nismave tregon se nevojiten instrumente të mëtejshme për vlerësimin sistematik të progresit.

Sa i përket treguesit të OZHQ 11.7.2, të dhënat kombëtare janë në fazë përpunimi, duke reflektuar angazhimin institucional për harmonizim me standardet globale. Kjo situatë tregon progres, por edhe kërkesën për një koordinim më të shpejtë dhe të integruar të raportimit statistikor.

**Objektivi Specifik I.4** ka shënuar progres me zbatimin e një cikli të plotë të Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, i përbërë nga 24 sesione të trajtimit psiko-social të realizuara përgjatë gjashtë muajve, i zbatuar gjatë vitit 2024 në Qendrën Korrektuese të Dubravës për 20 kryerës të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Programi është zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë, e cila ka miratuar Kurrikulën për Trajtimin e Profesionistëve për Ofrimin e Programeve për Kryerësit e Dhunës në Familje dhe Programin Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, si dhe ka ngritur kapacitetet profesionale për zbatimin e tyre. Programi është në përputhje me Konventën e Stambollit dhe Standardet Evropiane për Programet për Kryerësit e Dhunës, dhe është institucionalizuar në Shërbimin Korrektues – Qendra Korrektuese e Dubravës, duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm drejt reduktimit të përsëritjes së dhunës dhe forcimit të qasjes parandaluese.

Në tërësi, arritjet e OS I sugjerojnë një proces në zhvillim, me progres të prekshëm në disa fusha dhe nevoja të qarta për forcimin e sistemit të matjes dhe monitorimit. Përmirësimi i harmonizimit të të dhënave, institucionalizimi i trajnimeve dhe realizimi i studimeve të planifikuara do të jenë elementë kyç për rritjen e efektivitetit të Strategjisë në periudhën e ardhshme.

*Pavarësisht progresit në fushatat e ndërgjegjësimit, edukimin dhe trajtimin e kryerësve të dhunës, ndikimi transformues mbi normat shoqërore mbetet i pjesshëm dhe kërkon ndërhyrje më afatgjata, të integruara dhe të mbështetura nga sistemet e rregullta të matjes së perceptimeve, të cilat aktualisht janë në zhvillim.*

## **Rezultatet sipas objektivave specifike (OS)**

**OS I.1: Ndryshimi i sjelljeve, normave dhe stereotipeve gjinore.** Gjatë viteve 2023–2024 është shënuar progres i dukshëm në ndërgjegjësimin publik dhe angazhimin komunitar për reduktimin e stereotipeve gjinore dhe qëndrimeve tolerante ndaj dhunës. Mbi 20 fushata ndërgjegjësuese janë zbatuar në nivel kombëtar dhe lokal, si “Mos hesht!”, “Dhuna nuk është çështje private” dhe “Mjaft!”, të drejtuara nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UN Women, OSBE dhe organizata të shoqërisë civile. Në nivel komunitar, programe si “Agjentët e Ndryshimit në Komunitet” dhe “Forume Teatrale për Barazi Gjinore” kanë mobilizuar grupe burrash dhe djemsh, duke përfshirë rreth 12,000 qytetare/qytetarë në aktivitetet parandaluese. Dokumentet shtetërore për të drejtat e njeriut për vitin 2024 evidentojnë se komunitat dhe ministritë kanë organizuar një gamë të gjerë aktivitetesh ndërgjegjësuese dhe edukative me fokus të veçantë të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, qasjen në shërbime dhe trajtimin e dhunës në familje. Fushatat përfshijnë ligjëratat me nxënës/nxënës, trajnime me komunitetin, shpërndarje materiale informuese dhe shënimin e ditëve ndërkombëtare, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e ndërgjegjëimit publik dhe uljen e tolerancës ndaj dhunës me bazë gjinore. Një kontribut i rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjëimit publik është dhënë edhe nga ABGJ, e cila ka realizuar dhe transmetuar 15 videospote ndërgjegjësuese në Radiotelevizionin e Kosovës dhe në tre televizione private, me një buxhet total prej 29,891.50 euro. Videospotet kanë trajtuar tema të ndryshme që lidhen me promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë rolin e mekanizmave lokalë koordinues për mbrojtjen nga dhuna në familje, parandalimin e ngacmimit seksual në hapësira të ndryshme (rrjete sociale, sport dhe tek fëmijët), gjuhën e urrejtjes ndaj grave në jetën publike, të drejtat pronësore të grave dhe çështje të shëndetit të grave. Përmes transmetimit në media dhe platforma digjitale, këto materiale kanë kontribuar në informimin e publikut dhe në sfidimin e stereotipeve gjinore, duke mbështetur objektivin e Strategjisë për ndryshimin e normave dhe qëndrimeve shoqërore që tolerojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave.<sup>25</sup>

**OS I.2: Masat arsimore dhe edukimi në institucione.** Integrimi i parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në sistemin arsimor përbën një komponent të rëndësishëm të zbatimit të Strategjisë gjatë periudhës së vlerësimit. MASHTI ka ndërmarrë hapa për integrimin e këtyre temave në procesin arsimor përmes zhvillimit të dokumenteve dhe materialeve mbështetëse për mbrojtjen e fëmijës në kontekstin e shkollës, përfshirë 12 module tematike, ndër të cilat promovimi i barazisë gjinore, parandalimi i dhunës në familje, parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe parandalimi i martesave të hershme. Këto tema trajtohen në kuadër të kurrikulës së Kosovës, veçanërisht përmes lëndës së edukatës qytetare dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare në shkolla. Paralelisht, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, janë zhvilluar aktivitete edukative me nxënës/nxënës të shkollave fillore dhe të mesme mbi dhunën e facilituar nga teknologjia, me qëllim promovimin e sjelljeve të respektueshme dhe të sigurta në hapësirën online. Në këto ndërhyrje janë përfshirë 144 nxënës/nxënës në tri komuna. Megjithatë, mungesa e psikologeve/psikologëve dhe punonjëseve/punonjësve socialë në një pjesë të shkollave vazhdon të mbetet një sfidë për

<sup>25</sup> Shih listën e videospoteve të publikuara nga ABGJ: <https://www.youtube.com/watch?v=NOo9PSMOCr8&t=8s>; <https://www.youtube.com/watch?v=SvHRn4GoY2k>; <https://www.youtube.com/watch?v=nquVSiU2Q-A>; <https://www.youtube.com/watch?v=XQ6qz-zrrtg>; <https://www.youtube.com/watch?v=oifzNhu3bzw>; <https://www.youtube.com/watch?v=X81HgDOXFDc>; <https://www.youtube.com/watch?v=udZHielTjA4>; <https://www.youtube.com/watch?v=ISvixnVGawM>; <https://www.youtube.com/watch?v=MpFOMw8f8lY>; <https://www.youtube.com/watch?v=bDswiLSu1Xc&t=17s>; <https://www.youtube.com/watch?v=NYuCL7TtB1Y>; <https://www.youtube.com/watch?v=N6Mk3qQZq78>; <https://www.youtube.com/watch?v=EgCHdzoEQmY>; <https://youtu.be/8RQ7lcjh7OM>; <https://abgi.rks->; <https://youtu.be/kl30-Pv8T1o>

funkcionimin optimal të mekanizmave të identifikimit dhe referimit të rasteve të dhunës në mjedisin shkollor. Këto ndërhyrje kontribuojnë në forcimin e rolit të sistemit arsimor në parandalimin afatgjatë të dhunës, duke adresuar stereotipet gjinore dhe duke promovuar modele të komunikimit të respektueshëm dhe marrëdhënieve të barabarta mes të rejave/rinjve. Misioni i OSBE-së në Kosovë gjithashtu ka zbatuar fushata të gjera ndërgjegjësimi që synojnë të rejtat/rinjte në shkolla, psikologet/psikologët e shkollave, mësueset/mësuesit dhe Mekanizmat Koordinues Lokalë kundër Dhunës në Familje. Këto aktivitete janë zhvilluar në të gjithë Kosovën, duke përfshirë komunat me shumicë serbe të Kosovës, dhe u plotësuan nga nisma më të gjera për ndërgjegjësimin e komunitetit, siç janë transmetimet radiofonike. Fushatat synonin të rrisnin ndërgjegjësimin për dhunën në familje, të promovonin parandalimin dhe të forconin përgjigjet në nivel komuniteti.

Gjatë vitit 2025 janë vijuar aktivitetet e ndërgjegjësimit publik dhe edukimit komunitar, të raportuara nga ABGJ dhe institucionet përkatëse, të cilat kanë synuar adresimin e normave sociale dhe stereotipeve gjinore që nxisin dhunën. Këto aktivitete përfshijnë fushata informuese, programe edukative dhe iniciativa komunitare, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe raportimit të rasteve.

**OS I.3: Bashkëpunimi me median dhe sektorin privat.** Gjatë vitit 2023 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe Terre des Hommes – Kosovë, duke vendosur bazat për standardizimin e etikës profesionale në raportimin për dhunën. Në vitin 2024, 47 gazetarë/gazetarë u trajnuan në raportim të ndjeshëm gjinor dhe shmangie të stereotipeve, në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Kosovës dhe OSBE-në. Megjithatë janë shënuar hapa përpara, raportet vlerësuese të vitit 2024 theksojnë mungesën e standardeve të unifikuara për raportim mbi dhunën në media dhe ndikimin e mediave sociale në gjuhën diskriminuese. Standardizimi i raportimit mbi dhunën në media mbetet një fushë me potencial të konsiderueshëm për mirësimin, duke kërkuar udhëzime të unifikuara dhe mekanizma monitorimi.

**OS I.4 – Trajtimi psiko-social i kryerësve të dhunës.** Kosova ka filluar të ndërtojë një qasje të institucionalizuar për trajtimin e kryerësve të dhunës, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Në vitin 2023 u hartua dhe u miratua “Kurrikula për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës”, mbi bazën e së cilës u ngritën kapacitetet e profesionisteve/profesionistëve të profileve të ndryshme për zbatimin e programeve të trajtimit. Në vijim, në vitin 2024 Ministria e Drejtësisë miratoi “Programin Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave”, i hartuar në përputhje me Konventën e Stambollit dhe Standardet Evropiane për Programet për Kryerësit e Dhunës, dhe ngriti kapacitetet e 15 fasilitatoreve/fasilitatorëve për zbatimin e tij. Programi u pilotua në Qendrën Korrektuese të Dubravës gjatë periudhës shkurt–korrik 2024, duke përfshirë 20 të dënuar, dhe pas pilotimit është institucionalizuar dhe vazhdon të zbatohet në mënyrë të pavarur në këtë institucion, me një cikël të dytë të zhvilluar gjatë periudhës shkurt–korrik 2025, ndërsa një cikël tjetër ka filluar në nëntor 2025. Programi përfaqëson një ndërhyrje psiko-sociale të strukturuar, që synon sfidimin e normave dhe qëndrimeve që legjitimojnë dhunën dhe transformimin e modeleve të sjelljes së kryerësve, duke kontribuar në reduktimin e rrezikut të përsëritjes së dhunës. Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm në përmbushjen e kërkesave të nenit 16 të Konventës së Stambollit, i cili kërkon zhvillimin e programeve të specializuara për trajtimin e kryerësve me qëllim

parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe rritjen e sigurisë së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

### **Tendencat e perceptimit të sigurisë dhe ndërgjegjësimit publik (2022–2024)<sup>26,27,28</sup>**

Të dhënat e Pulsit Publik të UNDP (2022–2024) ofrojnë një panoramë plotësuese të kontekstit shoqëror në të cilin zbatohet Objektivi Strategjik I. Gjatë periudhës së vlerësimit, perceptimi i përgjithshëm i sigurisë në hapësira publike ka shënuar rritje të qëndrueshme, me përqindjen e qytetareve/qytetarëve që ndihen të sigurt jashtë shtëpisë që është rritur nga 80.4 për qind në vitin 2022 në 83.2 për qind në vitin 2024. Diferencat gjinore në perceptimin e sigurisë mbeten minimale, duke sugjeruar se masat parandaluese kanë kontribuar në rritjen e një ndjenje të përgjithshme të sigurisë për të dy gjinitë.

Megjithatë, të dhënat për ndërgjegjësimin publik rreth dhunës me bazë gjinore tregojnë se ky dimension vazhdon të mbetet më pak i theksuar në perceptimet e qytetareve/qytetarëve. Përqindja e të anketuarave/anketuarve që e identifikojnë dhunën me bazë gjinore si një nga problemet kryesore shoqërore ka mbetur e ulët përgjatë periudhës 2022–2024, me luhatje që variojnë nga 1.2 për qind në vitin 2022, në 0.3 për qind në vitin 2023, dhe në 2.4 për qind në vitin 2024. Këto të dhëna sugjerojnë se ndërsa fushatat ndërgjegjësuere kanë ndikuar në rritjen e perceptimit të sigurisë, ndikimi i tyre në transformimin e qëndrimeve dhe normave shoqërore lidhur me dhunën gjinore mbetet më i kufizuar.

Përveç të dhënave të Pulsit Publik, trendet e Indeksit “Gruaja, Paqja dhe Siguria” (WPS)<sup>29, 30,31</sup> ofrojnë një perspektivë të vlefshme mbi sigurinë e perceptuar nga gratë në Kosovë gjatë periudhës së vlerësimit. Indeksi i Sigurisë së Grave ka shënuar luhatje të konsiderueshme gjatë periudhës së vlerësimit: nga vlera bazë prej 0.737 dhe pozicionimi në vendin e 77-të në vitin 2021/22, ai ka rënë në 0.664 dhe vendin e 100-të në vitin 2023/24, përpara se të shënojë rikuperim të moderuar në 0.700 dhe kalimin në vendin e 82-të në vlerësimin 2025/26. Njëkohësisht, treguesi i sigurisë komunitare është përmirësuar ndjeshëm, duke u rritur nga 65.8 për qind në vitin 2021/22 në 77 për qind në 2023/24 dhe 85 për qind në 2025/26. Këto rezultate sugjerojnë rritje progresive të ndjenjës së sigurisë së grave në komunitet, ndërsa luhatjet në indeksin e përgjithshëm theksojnë nevojën për ndërhyrje të qëndrueshme ndër-institucionale për të siguruar konvergencë midis perceptimit të sigurisë dhe reduktimit real të cenueshmërisë së grave.

Në këtë kuadër, efektiviteti i masave parandaluese të Objektivit Strategjik I rezulton i pjesshëm: është vërejtur progres në ndjenjën e përgjithshme të sigurisë dhe në mobilizimin komunitar, por ndikimi transformues në ndryshimin e qëndrimeve publike ndaj dhunës me bazë gjinore kërkon ende angazhim të qëndrueshëm afatgjatë. Të dhënat e UNDP-së ofrojnë një tregues të rëndësishëm kontekstual dhe nënvizojnë nevojën që fushatat dhe programet

<sup>26</sup> UNDP Kosovë (2022). Shkurtim i Pulsit Publik XXIV – Nëntor 2022. Prishtinë: UNDP Kosovë, fq. 6 – 9. Shih: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxiii>

<sup>27</sup> UNDP Kosovë (2023). Shkurtim i Pulsit Publik XXV – Nëntor 2023. Prishtinë: UNDP Kosovë, fq. 5 – 8. Shih: [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-02/public\\_pulse\\_eng\\_2024\\_final.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-02/public_pulse_eng_2024_final.pdf)

<sup>28</sup> UNDP Kosovë (2024). Shkurtim i Pulsit Publik XXVI – Maj 2024. Prishtinë: UNDP Kosovë, fq. 7 - 10. Shih: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxvi>

<sup>29</sup> Shih: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/WPS-Index-2021-Summary.pdf>

<sup>30</sup> Shih: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2023/10/WPS-Index-full-report.pdf>

<sup>31</sup> Shih: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2025/10/WPS-Index-2025-Report.pdf>

parandaluese të jenë më të orientuara drejt ndryshimit të normave shoqërore, krahas rritjes së sigurisë në hapësira publike.

Këto ndryshime janë në linjë me trendet rajonale, ku përmirësimet në perceptimet e sigurisë shpesh reflektojnë forcimin e përgjithshëm të mekanizmave institucionale të rendit dhe jo domosdoshmërisht reduktim të prevalencës së dhunës.

*Analiza e treguesve dhe të dhënave të mbledhura tregon një qasje progresive, ku shumica e ndërhyrjeve kanë kontribuar në vendosjen e bazave për një qasje më të qëndrueshme të parandalimit, ndërsa ndikimi transformues në normat shoqërore kërkon periudhë më të gjatë zbatimi dhe investime të qëndrueshme ndërinstitucionale.*

### Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik I sipas kritereve të OECD-DAC

Tabela 3: Vlerësimi sipas kritereve të OECD-DAC për Objektivin Strategjik I

KRITERI	VLERËSIMI	ARSYETIMI I BAZUAR NË TË DHËNA
<b>Relevanca</b>	<b>Shumë e lartë</b>	Objektivi adreson drejtpërdrejt faktorët kryesorë që nxisin dhunën, si stereotipet gjinore dhe mungesa e edukimit gjinor. Fushatat e shumta dhe përpjekjet arsimore konfirmojnë rëndësinë strategjike.
<b>Koherenca</b>	<b>Mesatare</b>	Ekziston koordinim i rritur ndërmjet institucioneve (p.sh. nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit, trajnime të përbashkëta), por mungojnë mekanizma të institucionalizuar dhe të qëndrueshëm për integrimin e ndërhyrjeve parandaluese ndërmjet sektorëve (arsim, media, shërbime sociale), duke kufizuar sinergjinë dhe ndikimin e tyre afatgjatë.
<b>Efektiviteti</b>	<b>Mesatar</b>	Shënohet progres i qartë në OS I.1, OS I.2 dhe OS I.4 (fushata, trajnime, programe pilot). Megjithatë, mungesa e vlerave bazë të disa treguesve (5.2.2 dhe 11.7.2) kufizon matjen e plotë të rezultateve.
<b>Efiçienca</b>	<b>Mesatare</b>	Veprimet janë realizuar me mbështetje të gjerë donatorësh dhe partnerësh, çka ka ulur kostot buxhetore publike. Megjithatë, mungesa e një kuadri të përhershëm të investimeve afatgjata kërkon përmirësim.
<b>Ndikimi</b>	<b>I pjesshëm</b>	Ulja e fataliteteve nga dhuna në familje dhe rritja e perceptimit të sigurisë sugjerojnë zhvillime pozitive në përgjigjen institucionale. Megjithatë, mungesa e të dhënave për disa tregues dhe ndikimi ende gradual në ndryshimin e normave shoqërore tregojnë se efektet transformuese kërkojnë periudhë më të gjatë zbatimi.
<b>Qëndrueshmëria</b>	<b>Në zhvillim</b>	Trajnimet në sektorin e arsimit dhe iniciativat e tjera të parandalimit përbëjnë bazë të rëndësishme për institucionalizimin e masave të Strategjisë. Ndërkohë, Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës

ndaj Grave është institucionalizuar dhe zbatohet në mënyrë të pavarur nga Ministria e Drejtësisë, duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të ndërhyrjeve për trajtimin e kryerësve. Megjithatë, disa masa të tjera të Strategjisë vazhdojnë të mbeten të varura nga projektet dhe kërkojnë financim të qëndrueshëm shumëvjeçar për të garantuar zbatim të plotë dhe afatgjatë.

*Burimi: Vlerësimi bazohet në të dhënat e paraqitura në seksionet e mësipërme, duke përfshirë treguesit, raportet vjetore të zbatimit dhe të dhënat administrative të institucioneve përgjegjëse*

*Në përfundim, **Objektivi Strategjik I** ka shënuar progres të rëndësishëm në fushat e ndërgjegjësimit publik, edukimit dhe ngritjes së mekanizmave për trajtimin e kryerësve të dhunës, duke vendosur bazat për një qasje më të koordinuar dhe parandaluese në nivel institucional dhe komunitar. Megjithatë, mungesa e të dhënave bazë për disa tregues kyç, mekanizma më të qëndrueshëm të matjes dhe monitorimit mbeten sfida për periudhën në vijim. Forcimi i sistemeve statistikore, investimet afatgjata dhe bashkëpunimi ndërinstucional do të jenë vendimtarë për rritjen e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së masave në fazën e ardhshme të Strategjisë.*

#### **Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik 1**

Në përmbyllje të analizës, tabela në vijim paraqet rekomandimet prioritare të ndara sipas periudhës së zbatimit, për të siguruar vazhdimësinë ndërmjet fazës përmbylëse të Strategjisë aktuale (2026) dhe në funksion të përgatitjes së kornizës së re strategjike 2027–2030/2032.

Rekomandimet e strukturuar sipas dy periudhave kohore janë formuluar duke u mbështetur në gjetjet mbi efektivitetin, koherencën dhe ndikimin e ndërhyrjeve të Objektivit Strategjik I gjatë viteve 2022–2024, si dhe bazuar në të dhënat administrative të vitit 2025. Për vitin 2026, theksi vendoset në mbështetjen e funksioneve që tashmë kanë treguar progres, si: trajnimi në arsim, standardizimi i praktikave mediatike dhe institucionalizimi i programeve të trajtimit, duke synuar të maksimizojë efektin e Strategjisë aktuale. Për periudhën 2027–2030/2032 rekomandimet zhvendosen drejt transformimit të normave shoqërore dhe krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm financiarë dhe matës, në përputhje me standardet e BE-së dhe organizatave ndërkombëtare. Ky kombinim siguron që nismat ekzistuese të mos ndërpriten, ndërsa Strategjia e re të ndërtohet mbi themelimin e një sistemi të konsoliduar, gjithëpërfshirës dhe të bazuar në të dhëna.

*Tabela 4: Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik 1 sipas periudhës së zbatimit*

<b>2026 (FAZA PËRMBYLLËSE E STRATEGJISË AKTUALE)</b>	<b>2027–2030 /2032 (STRATEGJIA E RE)</b>
Integrimi i plotë i modulit “Parandalimi i Dhunës me Bazë Gjinore” në të gjitha komunat dhe përfshirja e tij në programet e trajnimit për mësimdhënëse/mësimdhënës, psikologe/psikologë dhe punonjëse/punonjës socialë.	Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për transformimin e normave shoqërore dhe roleve gjinore, me integrim të edukimit gjinor në arsimin fillor dhe të mesëm.

Zbatimi i udhëzimeve për raportim të ndjeshëm gjinor në media dhe forcimi i mekanizmave vetërregullues të Komisionit të Pavarur për Media, duke promovuar standarde të unifikuara dhe bashkëpunim të rregullt me shoqërinë civile.	Krijimi i një sistemi kombëtar për matjen periodike të perceptimeve publike mbi dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore, në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.
Zgjerimi i programit të trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues dhe Ministrinë e Drejtësisë, duke u përqendruar veçanërisht komunat me kapacitete të kufizuara.	Zhvillimi i një kornize të qëndrueshme financiare për masat parandaluese dhe rehabilituese, përfshirë partneritete me sektorin privat dhe grantin e performancës komunale.
Themelimi i linjave të qëndrueshme buxhetore për mekanizmat koordinues lokalë (MKL) dhe fushatat parandaluese në nivel lokal dhe qendror.	Përfshirja e komponentit “Burra dhe djem si agjentë të ndryshimit” në programet kombëtare dhe lokale të parandalimit.
Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe ABGJ-së për ndarjen e praktikave të mira, harmonizimin e qasjes dhe raportimin periodik të progresit.	Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar në platforma të BE-së dhe Këshillit të Evropës për shkëmbimin e praktikave mbi parandalimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.
Vijimi i punës për mbledhjen e të dhënave në lidhje me treguesit në mënyrë sistematike, si dhe formulimi i qartë dhe i kujdesshëm i treguesve në dokumentin e ri strategjik për vitet në vijim.	Harmonizimi i sistemit të treguesve me kërkesat e raportimit të BE-së dhe Eurostat, përfshirë integrimin e treguesve të OZHQ dhe treguesve të acquis për barazinë gjinore, si dhe dhunën ndaj grave, dhunën në familje e dhunën me bazë gjinore.

*Burimi: Përpunim i të dhënave nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe analiza e vlerësimit afatmesëm (2022–2024).*

#### **4.2.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK II: AVANCIMI DHE HARMONIZIMI I POLITIKAVE PUBLIKE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE**

Objektivi Strategjik II synon forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional të Kosovës për parandalimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes harmonizimit të politikave publike me standardet ndërkombëtare, veçanërisht Konventën e Stambollit, CEDAW dhe acquis të BE-së, si dhe përforcimit të mekanizmave ndërinstucionalë të bashkëpunimit dhe përgjegjshmërisë. Ai adreson boshllëqet ligjore, nevojën për standardizim procedurash dhe forcimin e koordinimit ndërinstucional, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e të drejtave të grave dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Kosovë. Ky objektivi është gjithashtu në përputhje me Direktivën (BE) 2024/1385 mbi luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke siguruar harmonizim gradual me standardet ligjore të BE-së në fushën e drejtësisë penale dhe mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionalizimi i mekanizmave të koordinimit janë elementë thelbësorë jo vetëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, por edhe për përmbushjen e kërkesave të acquis të BE-së dhe rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtarë monitorues. Në fokus është përmirësimi i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, rishikimi i akteve nënligjore, përditësimi i Procedurave Standarde të Veprimit, forcimi i standardeve të strehimoreve dhe qendrave të shërbimeve mbështetëse, si dhe ndërtimi i kapaciteteve profesionale të institucioneve përgjegjëse në përputhje me nenin 15 të Konventës së Stambollit.

Dy objektivat specifike nën Objektivin Strategjik II fokusohen në: (II.1) përmirësimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore me kuptimin gjinor të dhunës ndaj grave, në të gjitha ligjet dhe politikat përkatëse; dhe (II.2) fuqizimin e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve të zinxhirit institucional – Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, QPS-ve, strehimoreve dhe shërbimeve të tjera – për trajtim efikas, të koordinuar dhe të ndjeshëm gjinor të rasteve të dhunës.

**Progresi i përgjithshëm i zbatimit (2022–2024).**<sup>32</sup> Në periudhën 2022–2024, është vërejtur progres i qëndrueshëm në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, veçanërisht në harmonizimin e legjislacionit, zhvillimin e kornizave nënligjore dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve përgjegjëse. Tendencat tregojnë një konsolidim të qasjes institucionale dhe rritje të koordinimit ndërsektorial. Vlerësimi tregon një rritje graduale të cilësisë së zbatimit, duke reflektuar pjekuri më të madhe institucionale dhe rritje të koordinimit ndër-institucional në periudhën 2023–2024.

Tabela 5: Numri dhe përqindja e zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara nën objektivin strategjik 2

Viti	Nr. aktiviteteve	Të zbatuara plotësisht	Të zbatuara pjesërisht	Të pazbatuara
2022	29	45 %	38 %	17 %
2023	30	73 %	20 %	6 %
2024	31	55 %	35 %	10 %

Burimi: Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë, 2022–2024 (<https://md.rks-qov.net/zkn/>)

Gjatë periudhës 2022–2024, siç theksohet në Profilin Gjinor të Kosovës 2024<sup>33</sup>, korniza ligjore në Kosovë është përmirësuar ndjeshëm, me miratimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (2023), Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (2022) dhe Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare (2024). Këto zhvillime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt përafrimit me kërkesat e Konventës së Stambollit dhe acquis të BE-së për mbrojtjen e të drejtave të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

ABGJ ka luajtur një rol kyç në harmonizimin e kornizës ligjore dhe politike me detyrimet ndërkombëtare përmes procesit të rishikimit dhe përditësimit të PSV për rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Gjatë viteve 2023–2024 janë realizuar punëtori të dedikuara për përditësimin e PSV dhe harmonizimin e tyre me Konventën e Stambollit, duke siguruar një qasje të unifikuar dhe të standardizuar për të gjitha institucionet përgjegjëse. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 ABGJ ka realizuar dy punëtori gjashtëditore me qëllim

<sup>32</sup> Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të strategjisë

<sup>33</sup> Shih: [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/UNWOMEN\\_GEF\\_ENG.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/UNWOMEN_GEF_ENG.pdf)

mbështetjen e procesit të rishikimit dhe harmonizimit të PSV, me një buxhet të dedikuar prej 7,206.60 euro.

Në vitin 2023 shënohet rritja më e dukshme e zbatueshmërisë së aktiviteteve, falë përmirësimit të koordinimit ndërinstytucional, angazhimit të rritur të Ministrisë së Drejtësisë dhe përfshirjes sistematike të partnerëve ndërkombëtarë (UN Women, OSBE, Këshilli i Evropës dhe BE). Në vitin 2024, fokusi zhvendoset drejt cilësisë së zbatimit, përfshirjes së standardeve ndërkombëtare dhe avancimit të reformave strukturore, përfshirë:

- finalizimin dhe përditësimin e akteve nënligjore dhe udhëzimeve,
- përmirësimin e mbledhjes dhe integritit të të dhënave administrative,
- trajnimin e profesionisteve/profesionistëve në nivel qendror dhe lokal,
- përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit ligjor.

Megjithëse në vitin 2024 përqindja e aktiviteteve plotësisht të zbatuara shënon një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2023, kjo lidhet me faktin se një pjesë e aktiviteteve kanë kaluar në faza më të avancuara të harmonizimit dhe përpunimit teknik, të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe koordinim të thelluar ndërinstytucional. Kjo dinamikë është karakteristike për fazat kur proceset kalojnë nga veprimet fillestare drejt harmonizimit të thelluar teknik, të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe koordinim të shtuar ndërmjet institucioneve.

## Analiza e treguesve të Objektivit Strategjik II

Tabela 6: Matja e treguesve të objektivit strategjik II dhe objektivave specifike përkatës

Treguesi në nivel objektivit strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Numri i kallëzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur, të pazgjidhura për çdo vit</b>	13 vepra me kryes të rritur dhe 43 vepra me kryes të mitur, për vitin 2020	Zvogëluar me 50%	Në 2023–2024 <sup>34</sup> , Prokuroria pranoi 2,815 raste dhe zgjidhi 2,889 (krahasuar me 3,169 të pranuar dhe 3,679 të zgjidhura në 2022–2023), duke ruajtur efikasitet të qëndrueshëm mbi 100%. Meqenëse vlera bazë e vitit 2020 nuk specifikon institucionin referues (polici apo prokurori), vlerësimi bazohet në këto trende, të cilat tregojnë progres dhe nevojë për forcim kapacitetesh për qëndrueshmëri në vitet në vijim. Një normë zgjidhjeje mbi 100% reflekton trajtimin e rasteve të mbartura nga vitet e mëparshme dhe nuk nënkupton tejkallim të kapaciteteve reale të sistemit.	Zvogëluar me 90%

<sup>34</sup> Të dhënat janë marrë nga raportet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, për vitet 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024. Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/category/publications/>

Përqindja e grave viktime të dhunës nga partneri intim	4% në vitin 2021 <sup>35</sup>	Zvogëlohet me 10%	Prevalenca e dhunës nga partneri intim rezulton 5% në matjen 2023/24 dhe një vlerësim indikativ prej rreth 11.9%, një rritje e raportuar në ciklin e fundit të vlerësimit (2025/26), e cila duhet interpretuar si tregues indikativ dhe jo si matje e drejtpërdrejtë e prevalencës, për shkak të ndryshimeve në metodologji dhe burime të të dhënave. <sup>36</sup> , duke qenë mbi vlerën bazë 4% dhe nën objektivat e uljes për vitin 2024 dhe 2026. Këto rezultate theksojnë nevojën për ndërhyrje më të fokusuar dhe të qëndrueshme për të arritur drejt një trendi ulës në vitet në vijim.	Zvogëlohet me 20%
Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish-partner intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas formës së dhunës dhe sipas moshës (Treguesi i OZHQ 5.2.1)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Të dhënat e OZHQ janë në përpunim; mungon raport kombëtar; treguesi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave bazë për vitin 2022.	Zvogëlohet me 20%
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik II.1.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
<b>Niveli i reflektimit të kuptimit gjinor të dhunës ndaj grave dhe të të gjitha formave të kësaj dhune, sipas Konventës së Stambollit, në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës</b>	Në kornizën ligjore aktuale mungon kuptimi gjinor i dhunës ndaj grave, veçanërisht jashtë sferës së dhunës në familje <sup>37</sup>	50% përputhshmëri me Konventën e Stambollit	Reformat ligjore të ndërmarra në 2023-2024 kanë realizuar nivelin e synuar të harmonizimit me Konventën e Stambollit për vitin 2024, duke përfaqësuar progres të qenësishëm drejt përputhjes së plotë.	100% përputhshmëri me Konventën e Stambollit
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik II.2.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>

<sup>35</sup> Sipas matjeve të pasqyruara në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/WPS-Index-2021-Summary.pdf>

<sup>36</sup> Të dhënat e marra nga Indekset "Gruaja, Paqja, Siguria", për vitet 2023/24 dhe 2025/26. Shih: <https://giwps.georgetown.edu/the-index/>

<sup>37</sup> Sipas raportit përgatitur nga Rrjeti i Grave Kosovë "Nga ligjet në vepra", Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

<b>Numri i kurrikulave të formimit të profesionisteve e profesionistëve të përgatitura e zhvilluara</b>	4	8	Janë zhvilluar 8 module trajnimi (4 fillestare dhe 4 vazhduese), të harmonizuara me Konventën e Stambollit dhe me standardet ndërkombëtare, duke përbushur synimin për vitin 2024. Meqë paketa aktuale mbulon plotësisht temat prioritare, arritja e synimit prej 12 moduleve në vitin 2026 do të vlerësohet në bazë të nevojave të reja trajnuese që mund të identifikohen gjatë vitit në vijim.	12
<b>Treguesi: Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës, në mënyrë të përvitshme</b>	Do merren të dhënat për 2020-2021	Rritur me 10%	Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar u rrit nga 362 (2022) në 458 (2023) dhe 593 (2024), duke shënuar rritje kumulative prej 63.8% ndaj vitit bazë dhe duke tejkaluar dukshëm synimin prej 10%	Rritur me 20%

*Burimi: Të dhënat e mbledhura në kuadër të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare*

*Të dhënat e vitit bazë dhe të periudhës së raportimit nuk janë plotësisht të krahasueshme për shkak të ndryshimeve në metodologjinë e raportimit dhe institucioneve burimore; për këtë arsye, analiza fokusohet në trendet e efikasitetit procedural.*

Reformat e ndërmarra gjatë viteve 2023–2024 janë pjesërisht të harmonizuara me Direktivën e BE 2024/1385 dhe standardet e BE për mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe procedurat penale. Për të arritur përputhshmërinë e plotë, viti 2026 duhet të fokusohet në standardizimin ndërsektorial të të dhënave, integrimin e dispozitave të reja penale dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies ndërinstitucionale.

**Vlerësimi i treguesve të Objektivit Strategjik II** dëshmon se institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të kuadrit ligjor, konsolidimit të mekanizmave institucionale dhe rritjes së kapaciteteve profesionale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Progresi është i dukshëm, sidomos në harmonizimin me Konventën e Stambollit dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve të zbatimit të ligjit. Megjithatë, mbeten sfida të rëndësishme në fushën e matjes së prevalencës së dhunës dhe harmonizimit të sistemit të të dhënave, të cilat ndikojnë në vlerësimin e plotë të progresit drejt synimeve të Strategjisë.

Treguesit kryesorë të nivelit strategjik sinjalizojnë avancime domethënëse në eficiencën e sistemit të drejtësisë, por njëkohësisht nxjerrin në pah nevojën për konsolidim të metodologjive të matjes dhe harmonizim ndërinstitucional.

**Efikasiteti në trajtimin e kallëzimeve penale.** Treguesi për numrin e kallëzimeve penale të pazgjidhura mat cilësinë e përgjigjes së sistemit të drejtësisë ndaj rasteve penale, përfshirë ato të lidhura me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Ndërsa vlera bazë e vitit 2020 (13 raste me kryerës të rritur dhe 43 me kryerës të mitur) nuk është e harmonizuar me metodologjinë e viteve të mëvonshme, të dhënat e periudhës 2023–2024 tregojnë përmirësim të dukshëm institucional: Prokuroria ka ruajtur një normë zgjidhjeje mbi 100 për qind, duke trajtuar më shumë raste sesa ka pranuar. Norma e zgjidhjes mbi 100 për qind e rasteve në Prokurori për periudhën 2023–2024 është në përputhje me standardet e BE-së për reduktimin e ngarkesës së mbetur dhe rritjen e efikasitetit procedural, por kërkon ruajtje të qëndrueshme për të garantuar konsolidim afatgjatë. Ky trend nënkupton përforcimin e kapaciteteve hetimore dhe procedurale. Megjithatë, mungesa e një metodologjie të unifikuar në raportimin e të dhënave kufizon aftësinë për krahasime të drejtpërdrejta me vitin bazë dhe nënvizon rëndësinë e standardizimit të raportimit për vitin 2026. Në këtë periudhë, harmonizimi i metodologjisë së raportimit ndërmjet Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave do të jetë thelbësor për matje të krahasueshme dhe përputhje me standardet e Eurostat-it.

**Prevalenca e dhunës nga partneri intim.** Treguesi për përqindjen e grave viktime të dhunës nga partneri intim ka shënuar rritje krahasuar me vlerën bazë prej 4 për qind (2021), duke arritur 5 për qind në matjen e vitit 2023/24 dhe një vlerësim indikativ prej rreth 11.9 për qind në ciklin e maturimit 2025/26, bazuar në prirjet krahasuese rajonale dhe përmirësimin e zbulueshmërisë së rasteve. Megjithëse rritja e prevalencës e vendos këtë tregues nën synimin e Strategjisë (zvogëlim me 10 për qind deri në 2024 dhe 20 për qind deri në 2026), ajo duhet interpretuar me kujdes. Në kontekstet kur mekanizmat institucionalë forcohen dhe rritet besimi i viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në sistemin e mbrojtjes, prevalenca e raportuar rritet për shkak të: (a) rritjes së raportimit, (b) përmirësimit të matjes statistikore, (c) zbulimit më të saktë të rasteve të fshehura, (d) ndërgjegjësimit më të madh të publikut për format e dhunës.

Ky është një trend i njohur edhe në vende të tjera që po konsolidojnë mekanizmat e mbrojtjes dhe rritin kapacitetet e zbulimit dhe referimit, prandaj interpretimi i prevalencës duhet bërë në kontekst të forcimit të mekanizmave të zbulimit, rritjes së raportimit dhe përmirësimit të metodologjisë së matjes, një tendencë e njohur në vendet që modernizojnë sistemet e mbrojtjes në mënyrë të kujdesshme dhe të bazuar në analiza të kombinuara administrative dhe statistikore.

Treguesi i dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike (OZHQ 5.2.1) nuk ishte i matshëm për periudhën e vlerësimit, pasi vlera bazë e vitit 2022 nuk është gjeneruar në nivel kombëtar dhe procesi i harmonizimit të të dhënave ndërmjet ASK-së, MD-së dhe partnerëve ndërkombëtarë është ende në zhvillim. Kjo është një sfidë strukturore e njohur edhe në vendet që po konsolidojnë sistemet e mbledhjes së të dhënave në përputhje me standardet e Kombeve të Bashkuara dhe Eurostat dhe nuk lidhet me mungesë angazhimi institucional, por me kompleksitetin metodologjik të treguesve globalë të OZHQ-ve. Situata nënvizon nevojën për krijimin e një mekanizmi të përbashkët statistikor, të harmonizuar me standardet e Kombeve të Bashkuara dhe Eurostat, për të mundësuar matje të rregullt dhe të krahasueshme në ciklin e ardhshëm të Strategjisë.

## **Rezultatet sipas objektivave specifike (OS)**

**Objektivi Specifik II.1: Përmirësimi i kornizës ligjore.** Vlerësimi tregon progres të rëndësishëm në harmonizimin e kornizës ligjore me Konventën e Stambollit. Nga një situatë ku kuptimi gjinor i dhunës mungonte pothuajse tërësisht jashtë sferës së dhunës në familje, Kosova ka arritur nivelin e synuar të harmonizimit 50 për qind për vitin 2024. Ky progres ka kontribuar në rritjen e koherencës së kuadrit ligjor me standardet e Këshillit të Evropës, duke garantuar qasje më të qartë dhe të harmonizuar për institucionet përgjegjëse. Reformat e ndërmarra në vitet 2023–2024, përfshirë analizën ex-post të akteve ligjore, përgatitjen e akteve nënligjore e udhëzimeve përkatëse dhe rishikimin e standardeve për shërbimet mbështetëse, e kanë orientuar kornizën normative drejt standardeve evropiane. Në periudhën 2022–2024 janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përputhjes së legjislacionit kombëtar me Konventën e Stambollit dhe direktivat e BE-së. Në shkurt 2024, Ministria e Drejtësisë themeloi Grupin Punues Ndërinstitucional për hartimin e akteve nënligjore që burojnë nga Ligji nr. 08/L-185 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore”. Procesi ka sjellë një rritje të qartë të koherencës ligjore ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale, duke siguruar harmonizim horizontal dhe vertikal me kornizën ndërkombëtare. Në fund të vitit 2024 ishin finalizuar tre nga pesë aktet nënligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, ndërsa dy të tjera u miratuan në fillim të vitit 2025, duke kontribuar në operacionalizimin e mëtejshëm të kornizës institucionale të zbatimit të ligjit. Ndër dokumentet kyçe të miratuara janë:

- Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar dhe Grupin Koordinues Ndërmintor, e cila përcakton strukturën dhe funksionimin e mekanizmit qendror të koordinimit;
- Rregullorja për Mekanizmin Koordinues Lokal (MKL), e miratuar në shkurt 2025, e cila operacionalizon nenin 25 të ligjit dhe standardizon funksionimin, përgjegjësitë dhe llogaridhënien e mekanizmave lokalë të koordinimit;
- Udhëzimi Administrativ për Linjën Emergjente Telefonike Kombëtare për viktimat e dhunës, i cili standardizon procedurat e reagimit institucional dhe ofrimin e mbështetjes emergjente;
- Projekt-udhëzimi administrativ për menaxhimin dhe përdorimin e sistemit elektronik të informacionit, që synon të rregullojë mirëmbajtjen, sigurinë dhe përdorimin e databazës kombëtare për rastet e dhunës dhe nxjerrjen e raporteve publike, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Miratimi i këtyre akteve nënligjore përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt operacionalizimit të plotë të ligjit dhe konsolidimit të mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, duke krijuar një bazë më të qartë rregullatore për reagimin institucional në nivel qendror dhe lokal.

Gjithashtu, ka nisur procesi i ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale për përfshirjen e dispozitave mbi dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe krimet e bazuara në gjini, në përputhje me Direktivën (BE) 2024/1385. Këto reforma e bëjnë kuadrin ligjor dukshëm më të përputhshëm me standardet e BE-së dhe Këshillit të Evropës, duke rritur qartësinë ligjore dhe nivelin e mbrojtjes për viktimat/të mbijetuarat. Këto nisma përbëjnë bazën e domosdoshme për arritjen e synimit të vitit 2026 (100 për qind përputhshmëri), duke kërkuar vijimësi në konsolidimin e akteve zbatuese dhe harmonizimin horizontal të politikave ndërsektoriale.

Roli i organizatave të shoqërisë civile ka qenë i rëndësishëm në këtë proces, përmes analizave juridike krahasuese, kontributit në grupet punuese dhe ofrimit të rekomandimeve të bazuara në prova, çka ka ndihmuar vendimmarrjen dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet evropiane.

**Objektivi Specifik II.2: Rritja e kapaciteteve profesionale.** Arritja e synimit për vitin 2024 (8 module të zhvilluara) dëshmon konsolidimin e programeve të formimit profesional, të harmonizuara me Konventën e Stambollit dhe standardet ndërkombëtare. Kjo paketë mbulon fushat prioritare të trajtimit të dhunës dhe siguron një bazë të standardizuar për trajnimin e profesionistëve kyç. Përbushja e synimit të vitit 2026 (12 module) varet nga identifikimi i nevojave të reja profesionale dhe integrimi i rekomandimeve të GREVIO-s dhe praktikave të vendeve të BE-së.

Në kuadër të Objektivit Strategjik II, që synon forcimin e reagimit institucional dhe mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, progres i rëndësishëm është arritur në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimeve. Në vitin 2024, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) zhvilloi 12 programe trajnimi me 1,104 pjesëmarrëse/pjesëmarrës (829 burra dhe 275 gra), që trajtonin tema si hetimi i dhunës në familje, barazia gjinore, ngacmimi seksual në vendin e punës dhe qasja shumësektoriale ndaj viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve. Paralelisht, Akademia e Drejtësisë ka integruar kurrikulën për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave si pjesë të Programit të vazhdueshëm të trajnimit për gjyqtaret/gjyqtarët dhe prokuroret/prokuratorët, si dhe të trajnimeve fillestare për gjyqtaret/gjyqtarët dhe prokuroret/prokuratorët e sapoemëruar. Kjo kurrikulë përfshin module trajnuese që trajtojnë aspektet materiale dhe procedurale të trajtimit të rasteve të dhunës, me theks në qasjen e përqendruar të viktimave/e mbijetuara/i mbijetuarit, kuptimin e traumës dhe zbatimin e standardeve të Konventës së Stambollit.

Sipas të dhënave të raportuara nga AD, gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë janë realizuar një numër i konsiderueshëm aktivitetesh trajnuese për gjyqtare/gjyqtarë, prokurore/prokuratorë dhe profesioniste/profesionistë të tjerë ligjorë, përfshirë 11 aktivitete trajnuese në vitin 2022; 30 aktivitete trajnuese në vitin 2023 dhe 14 aktivitete trajnuese në vitin 2024; me pjesëmarrjen e gjyqtareve/gjyqtarëve, prokurore/prokuratorëve, bashkëpunëtorëve/bashkëpunëtorëve profesionalë dhe profesionisteve/profesionistëve të tjerë ligjorë. Në vitin 2024 këto trajnime u ndoqën nga 105 gjyqtare/gjyqtarë, 38 prokurore/prokuratorë dhe 187 pjesëmarrëse/pjesëmarrës nga profesione të tjera ligjore, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale për hetimin dhe gjykimin efektiv të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Në sektorin e shëndetësisë janë ndërmarrë gjithashtu hapa për përditësimin e protokolleve klinike dhe forcimin e rolit të shërbimeve mjeko-ligjore në trajtimin e rasteve të dhunës, megjithatë kapacitetet mbështetëse dhe qasja e standardizuar ndaj viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale mbeten ende në proces konsolidimi. Në tërësi, këto zhvillime kontribuojnë në përbushjen e kërkesave të nenit 15 të Konventës së Stambollit, i cili kërkon që profesionistet/profesionistët që punojnë me viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe kryerësit e dhunës të pajisen me trajnime të specializuara për

identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin efektiv të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në këtë mënyrë, ngritja e kapaciteteve profesionale përgjatë zinxhirit institucional të reagimit – nga policia dhe prokuroria deri te gjykatat dhe shërbimet mbështetëse – kontribuon në përmirësimin e përgjigjes së koordinuar dhe efektive ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Një zhvillim thelbësor në përforcimin e kapaciteteve profesionale për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale ishte miratimi i Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Republikën e Kosovës, më 23 nëntor 2022. Ky protokoll përcakton procedurat standarde për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale dhe forcon qasjen ndërinstitucionale, në përputhje me Konventën e Stambollit. Gjatë vitit 2023, EULEX Kosovë dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) me mbështetjen e UN Women zbatuan një seri trajnimesh praktike për profesioniste/profesionistë të institucioneve ligjore, shëndetësore dhe sociale mbi zbatimin e këtij protokollit. Këto trajnime kontribuuan në harmonizimin e procedurave ndërmjet policisë, prokurorisë, mjekësisë ligjore dhe qendrave për punë sociale, duke rritur aftësinë e sistemit institucional për të siguruar mbështetje të koordinuar dhe të ndjeshme gjinore për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale. Këto zhvillime përfaqësojnë një praktikë të mirë të bashkëpunimit shumësektorial, plotësisht në përputhje me objektivat e OS II.2.

Megjithëse janë ndërmarrë reforma ligjore, Raporti i Komisionit Evropian (2024)<sup>38</sup> vëren se zbatimi i Protokollit Shtetëror për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës Seksuale mbetet i pjesshëm dhe pa monitorim sistematik, ndërsa mungon ende një qendër e specializuar për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale. Ky boshllëk vazhdon të paraqesë sfidë për përputhjen e plotë me standardet e Këshillit të Evropës dhe kërkon investime strukturore në vitin 2026 e më tej.

Është përmirësuar gjithashtu infrastruktura institucionale: deri në fund të vitit 2024, 31 dhoma miqësore ishin funksionale në stacionet policore, duke mundësuar intervistim më të sigurt dhe dinjitoz për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit; ndërkohë është zhvilluar sistemi elektronik për monitorimin e urdhrave të mbrojtjes, edhe pse zbatimi i tij mbetet i pjesshëm për shkak të mungesës së vendimeve të rregullta gjyqësore.

Gjithashtu, rritja nga 362 profesioniste/profesionistë të trajnuar në vitin 2022 në 593 në vitin 2024 përfaqëson një rritje kumulative prej 63.8 për qind dhe tejkalon dukshëm synimin e Strategjisë për rritje me 10 për qind në vitin 2024. Kjo arritje reflekton angazhimin e institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë për forcimin e kapaciteteve të policisë, prokurorisë, gjykatave, qendrave për punë sociale dhe mekanizmave lokalë koordinues. Ky zhvillim krijon një bazë të qëndrueshme për profesionalizimin e mëtejshëm të reagimit institucional dhe për forcimin e zbatimit efektiv të Strategjisë.

Përmes trajnimeve të specializuara për Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë, EULEX ka kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe mekanizmave të mbrojtjes. Këto ndërhyrje kanë rritur efektivitetin e hetimit, raportimit dhe ndjekjes penale të rasteve.

---

<sup>38</sup> Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm)

KiE ka mbështetur përmirësimin e reagimit institucional përmes ngritjes së kapaciteteve të Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, QPS-ve dhe profesionisteve/profesionistëve të arsimit, duke promovuar qasje të orientuara drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit, të ndjeshme ndaj traumës dhe me llogaridhënie të qartë të kryerësve. Trajnimet dhe mentorimet e realizuara kanë forcuar përgjigjen ndërsektoriale në trajtimin e rasteve të dhunës.

Kontributi i BE në OS II është i konsiderueshëm përmes programit EUKOJUST dhe programeve të tjera që fokusohen në profesionalizimin e gjyqtareve/gjyqtarëve, prokuroreve/prokuratorëve dhe oficerëve/oficerëve ligjorë. Mbështetja ka adresuar çështje kyçe si zbatimi i drejtë i ligjit të ri, forcimi i llogaridhënies, rritja e dënimeve proporcionale dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. OSBE ka ndihmuar institucionet në implementimin e ligjit dhe akteve nënligjore të reja përmes trajnimeve të specializuara për policinë, prokuroret/prokuratorët, gjyqtaret/gjyqtarët dhe punonëset/punonjësit socialë. Mbështetja për dhomat e intervistimit dhe kapacitetet e policisë në vlerësimin e rrezikut ka përmirësuar dukshëm cilësinë e reagimit dhe mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

Pavarësisht progresit të rëndësishëm, zbatimi i Objektivit Strategjik II përballet ende me disa sfida strukturore. Zbatimi i sistemit elektronik për monitorimin e urdhrave mbrojtës mbetet i pjesshëm, kryesisht për shkak të mungesës së vendimeve të rregullta gjyqësore dhe përdorimit ende të pjesshëm të mjeteve digjitale nga disa institucione, si përgjigje e kapaciteteve të ndryshme teknike dhe nivelit të adaptimit. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e buxheteve të dedikuara për trajnime të vazhdueshme, mos finalizimi i udhëzimit për taksat gjyqësore dhe burimet e pamjaftueshme financiare në disa shërbime, kufizojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të reformave. Mungesa e mekanizmave të standardizuar për matjen e performancës dhe cilësisë së shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit mbetet një boshllëk kyç, i cili kërkon vëmendje të posaçme në fazën e mbetur gjatë vitit 2026. Këto sfida nuk tregojnë mungesë përkushtimi, por nënvizojnë nevojën për investime të mëtejshme teknike, metodologjike dhe financiare për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të rezultateve të arritura. Ato duhen interpretuar si pjesë e një tranzicioni të natyrshëm drejt standardizimit të plotë statistikor dhe institucional, jo si tregues i mungesës së progresit.

Pra në përfundim, mund të themi se analiza e treguesve të Objektivit Strategjik II sugjeron progres të qëndrueshëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ndërhyrjet e ndërmarra kanë rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë, kanë përmirësuar harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe kanë thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional.

Megjithatë, vlerësimi tregon se harmonizimi i të gjitha akteve ligjore kërkon më shumë kohë sesa parashikuar fillimisht, për shkak të kapaciteteve të kufizuara të grupeve punuese dhe mungesës së akteve nënligjore të përditësuara në disa sektorë. Po ashtu, mungesa e një metodologjie të unifikuar për mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave administrative kufizon aftësinë e institucioneve për të matur trendet reale të dhunës dhe për të vlerësuar ndikimin e reformave ligjore. Harmonizimi me Direktivën e BE 2024/1385 kërkon forcim të mëtejshëm të mekanizmave të mbledhjes së të dhënave, përgjigjes së koordinuar dhe aksesit të barabartë në shërbime. Përparimi i deritanishëm vendos një bazë solide, por implementimi i

standardeve të avancuara evropiane mbetet i varur nga finalizimi i akteve nënligjore dhe funksionalizimi i shërbimeve të specializuara.

Vlerësimi evidenton disa sfida strukturore që ndikojnë në matjen dhe vlerësimin e progresit në kuadër të Objektivit Strategjik II. Para së gjithash, mungesa e vlerave bazë të harmonizuara për treguesit kryesorë, sidomos ata të lidhur me OZHQ, si dhe koordinimi jo i duhur ndërinstitucional në mbledhjen e të dhënave administrative, e bëjnë të vështirë vlerësimin e trendit real të dhunës nga partneri intim. Të dhënat e vitit 2024 tregojnë luhatje të prevalencës, por këto reflektojnë më shumë përmirësim të zbulueshmërisë dhe rritje të raportimit, sesa rritje të fenomenit.

Proceset e harmonizimit ligjor kanë përparuar, por ritmi i rishikimit të legjislacionit vijues mbetet i ngadalshëm, për shkak të kapaciteteve të kufizuara dhe kompleksitetit të akteve që kërkojnë përditësim. Sfidë shtesë mbetet mungesa e monitorimit të standardizuar të zbatimit të moduleve të trajnimit dhe nevoja për integrimin e praktikave evropiane në fazat e ardhshme të formimit profesional.

Përtej këtyre sfidave, përmirësimet në efikasitetin e Prokurorisë (mbi 100 për qind zgjidhje rastesh në periudhën 2023–2024), rritja e personelit të trajnuar dhe zhvillimi i moduleve të standardizuara përbëjnë bazë të fortë për përparim të mëtejshëm. Për të maksimizuar ndikimin në vitin 2026 e në vijim, është i domosdoshëm një investim i vazhdueshëm në mekanizmat e monitorimit, koordinimin ndërinstitucional dhe harmonizimin statistikor, në përputhje me udhëzimet e OECD–DAC dhe standardet evropiane të raportimit.

Në tërësi, ndërhyrjet e OS II kanë qenë efektive dhe koherente në orientimin e reformave strukturore, duke forcuar kapacitetet e institucioneve përgjegjëse dhe duke avancuar përputhshmërinë me standardet e BE-së dhe Këshillit të Evropës. Megjithatë, për të siguruar ndikim të qëndrueshëm deri në vitin 2026 dhe në ciklin e ri strategjik, kërkohet thellim i koordinimit ndërinstitucional, finalizim i akteve nënligjore, si dhe standardizim metodologjik i të dhënave administrative dhe statistikore. Konsolidimi i mekanizmave të mbledhjes së të dhënave dhe i akteve zbatuese do të jetë vendimtar për avancimin e mëtejshëm të reformave dhe rritjen e efektivitetit të politikave kundër dhunës në Kosovë.

### Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik II sipas kritereve të OECD-DAC

Tabela 7: Vlerësimi sipas kritereve të OECD-DAC për Objektivin Strategjik II

KRITERI	VLERËSIMI	ARSYETIMI I BAZUAR NË TË DHËNA
Relevanca	Shumë e lartë	Objekti Strategjik II është plotësisht në linjë me prioritetet shtetërore të Kosovës për forcimin e shtetit të së drejtës, barazinë gjinore dhe përputhjen me Konventën e Stambollit dhe acquis të BE-së. Pesha e madhe që Strategjia i jep harmonizimit ligjor, standardeve të strehimoreve, PSV-ve dhe profesionalizimit të institucioneve përputhet drejtpërdrejt me udhërrëfyesit ndërkombëtarë dhe me nevojat e identifikuar nga institucionet përgjegjëse.

<b>Koherenca</b>	<b>E lartë</b>	Reformat 2023–2024 tregojnë rritje të koherencës horizontale ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, ABGJ-së dhe MD-së. Standardizimi i moduleve të trajnimit (8 module të zhvilluara), analiza ex-post e akteve ligjore dhe përgatitja e udhëzimeve administrative e forcojnë koherencën vertikale midis nivelit qendror-lokal. Bashkëpunimi me OSHC-të e specializuara dhe partnerët ndërkombëtarë (UN Women, OSBE, KiE, BE) kontribuon në harmonizimin e qasjeve.
<b>Efektiviteti</b>	<b>I lartë me trend pozitiv</b>	Zbatimi i aktiviteteve arrin 73% në vitin 2023 dhe 55% në vitin 2024. U përmbush synimi i harmonizimit 50% të legjislacionit (OS II.1) si dhe synimi për 8 module trajnimi dhe 63.8% rritje të numrit të profesionisteve/profesionistëve të trajnuar (OS II.2). Megjithatë, treguesit që lidhen me prevalencën e dhunës nga partneri intim (OZHQ 5.2.1 dhe 5.2.2) nuk janë të matshëm ose shënojnë rritje të prevalencës së raportuar, për shkak të mungesës së të dhënave bazë dhe rritjes së raportimit.
<b>Efiçienca</b>	<b>E mirë</b>	Prokuroria ka ruajtur efikasitet mbi 100% në zgjidhjen e rasteve (2,889 të zgjidhura / 2,815 të pranuar në 2023–2024). Programet e trajnimit u standardizuan me burime relativisht të kufizuara dhe me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë. Megjithatë, proceset e harmonizimit ligjor kërkojnë kohë më të gjatë sesa parashikuar, për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike në disa institucione.
<b>Ndikimi</b>	<b>I moderuar me trend pozitiv</b>	Ka indikacione të qarta të ndikimit institucional: rritje të efikasitetit të Prokurorisë, përmirësim të koordinimit ndër-institucional, integrim të standardeve të Konventës së Stambollit dhe rritje të kapaciteteve profesionale. Ndikimi në prevalencën reale të dhunës nuk mund të matet plotësisht për shkak të mungesës së të dhënave të harmonizuara dhe rritjes së raportimit, që reflekton forcim të sistemit, jo rritje të fenomenit.
<b>Qëndrueshmëria</b>	<b>Mesatare</b>	Reformat ligjore dhe korniza e moduleve të trajnimit janë të qëndrueshme. Por qëndrueshmëria e plotë kërkon: (a) rritjen e kapaciteteve të grupeve punuese ligjore; (b) mekanizma të unifikuar për mbledhjen e të dhënave; (c) buxhet të garantuar për zbatimin e akteve nënligjore; (d) institucionalizim të programeve trajnimit në sistemet e brendshme të Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe QPS-ve.

*Burimi: Vlerësimi bazohet në të dhënat e paraqitura në seksionet e mësipërme, duke përfshirë treguesit, raportet vjetore të zbatimit dhe të dhënat administrative të institucioneve përgjegjëse*

*Në terma të përgjithshëm, Objektivi Strategjik II ka avancuar dukshëm harmonizimin e legjislacionit vendor me Konventën e Stambollit dhe acquis të BE-së, si dhe ka rritur profesionalizimin e institucioneve kyçe të zinxhirit të reagimit. Rritja mbi 63 për qind e numrit të profesionisteve/profesionistëve të trajnuar dhe zhvillimi i moduleve të standardizuara tregojnë një mobilizim të qëndrueshëm institucional, i cili lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e efikasitetit të Prokurorisë (normë zgjidhjeje >100 për qind). Megjithatë, finalizimi i disa akteve nënligjore, standardizimi i raportimit ndërinstytucional dhe sigurimi i burimeve të qëndrueshme mbeten kushte thelbësore për rritjen e ndikimit dhe zbatimin e plotë gjatë periudhës 2026 e në vijim.*

Megjithatë, mungesa e një metodologjie të unifikuar të mbledhjes së të dhënave, vlerat bazë të pa konsoliduara për disa tregues të OZHQ dhe kapacitetet e kufizuara të grupeve punuese kufizojnë vlerësimin e plotë të ndikimit. Rritja e prevalencës së raportuar të dhunës nga partneri intim duhet interpretuar si rezultat i rritjes së raportimit, përmirësimit të zbulueshmërisë dhe ndërgjegjësimit publik, jo si rritje e fenomenit. Në tërësi, ndërhyrjet e OS II janë efektive dhe të qëndrueshme në orientimin e reformave strukturore, por kërkohet investim i mëtejshëm në harmonizimin statistikor, institucionalizimin e programeve të trajnimit dhe finalizimin e akteve nënligjore për të siguruar rezultate të matshme deri në vitin 2026.

*Vlerësimi sipas kriterëve të OECD–DAC konfirmon se Objektivi Strategjik II është në rrugën e duhur për arritjen e rezultateve të planifikuara deri në vitin 2026, por kërkon thellim të koordinimit ndërinstytucional dhe konsolidim të kapaciteteve për të garantuar qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë.*

### **Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik II**

Faza 2027–2030/2032 duhet të ndërtohet mbi përafrimin gradual me acquis të BE-së, rekomandimet e rishikimit të GREVIO-s dhe standardet e Direktivës (BE) 2024/1385. Rekomandimet në vijim synojnë të sigurojnë që përparimi i arritur në periudhën 2022–2024, si dhe më tej gjatë vitit 2025 të konsolidohet, të zgjerohet dhe të institucionalizohet në vitin 2026 dhe të shërbejë si bazë për një cikël të ri të politikave 2027–2030/2032, të ndërtuar mbi standardet e BE-së dhe rekomandimet e GREVIO-s. Forcimi i efektivitetit të Objektivit Strategjik II kërkon fokus të vazhdueshëm në harmonizimin ligjor, standardizimin e procedurave dhe ndërtimin afatgjatë të kapaciteteve profesionale. Duke qenë se progresi i arritur deri më tani është i rëndësishëm, sidomos në drejtim të harmonizimit me Konventën e Stambollit dhe rritjes së efikasitetit të institucioneve të drejtësisë, faza e mbetur e Strategjisë duhet të përqendrohet në konsolidimin e këtyre arritjeve përmes afrimit të akteve nënligjore, unifikimit të të dhënave statistikore dhe institucionalizimit të trajnimeve. Për periudhën e re strategjike (2027–2030/2032), rekomandimet theksojnë nevojën për një qasje më të strukturuar ndërinstytucionale, bazuar në standardet evropiane, vlerësimet e GREVIO-s dhe praktikatat e vendeve të BE-së.

Rekomandimet prioritare synojnë të garantojnë se reformat ligjore përcillen me zbatim të plotë, se kapacitetet profesionale nuk varen nga trajnime të njehershme por institucionalizohen në nivel kombëtar, dhe se mekanizmat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave ndërtohen mbi baza të qëndrueshme teknike dhe metodologjike. Kjo është

thelbësore për të përmbushur objektivat e vitit 2026 dhe për të vendosur themelet e fazës së ardhshme strategjike.

Tabela 8: Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik II sipas periudhës së zbatimit

2026 (FAZA PËRMBYLLËSE E STRATEGJISË AKTUALE)	2027–2030/2032 (STRATEGJIA E RE)
Finalizimi dhe përditësimi i të gjitha akteve nënligjore dhe udhëzimeve në përputhje me Konventën e Stambollit dhe rekomandimet e GREVIO-s.	Hartimi i një kornize të re gjithëpërfshirëse ligjore dhe politike për adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, bazuar në përputhshmërinë me acquis të BE-së. Harmonizimi i plotë i legjislacionit penal dhe procedural me Direktivën (BE) 2024/1385, përfshirë definicionet e veprave penale, masat mbrojtëse dhe standardet për mbështetjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.
Standardizimi i metodologjisë për mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave administrative ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, QPS-ve dhe ABGJ-së.	Ndërtimi i një sistemi kombëtar të integruar të të dhënave mbi dhunën, me platformë të përbashkët digjitale dhe raporte vjetore të harmonizuara me treguesit e OZHQ-ve.
Konsolidimi i moduleve ekzistuese të trajnimit dhe zgjerimi i tyre në mënyrë të synuar (dhuna seksuale, përgjigja ndërsektoriale, menaxhimi i rasteve të ndërlikuara, dhuna e fasiciluar nga teknologjia, etj.).	Institucionalizimi i trajnimeve për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, me programe të detyrueshme për Policinë, Prokurorinë, Gjykatat dhe QPS-të, ku të përfshihen të gjitha format e dhunës ndaj grave.
Forcimi i mekanizmave të monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe procedurave (lista kontrolli, vetëvlerësime, raporte tremujore komunale dhe qendrore).	Krijimi i mekanizmave të përgjegjshmërisë institucionale (rezultate të performancës) të lidhura me buxhetimin e bazuar në performancë për komunat dhe institucionet kryesore.
Rritja e kapaciteteve të grupeve punuese për harmonizimin e legjislacionit dhe koordinimin teknik ndërministror.	Themelimi i qendrave rajonale të ekspertizës për trajtimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, me bashkëpunim ndërkufitar dhe shkëmbim praktikash me vendet e BE-së.
Thellimi i bashkëpunimit me strehimoret, shërbimet mbështetëse dhe mekanizmat lokalë koordinues për standardizimin e protokolleve të referimit.	Zgjerimi i mëtejshëm financimit të qëndrueshëm për shërbimet mbështetëse dhe sigurimi i linjave të dedikuara buxhetore në nivel qendror dhe lokal.

Burimi: Përpunim i të dhënave nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe analiza e vlerësimit afatmesëm (2022–2024).

Në përputhje me gjetjet e Objektivit Strategjik I, sfidat në matjen e treguesve në kuadër të Objektivit Strategjik II konfirmojnë nevojën për një sistem të integruar dhe të standardizuar të të dhënave, që mbulon si perceptimet publike ashtu edhe të dhënat administrative.

### **4.2.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK III: FUQIZIMI INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE DHE TRAJTIM TË VIKTIMAVE**

Objektivi Strategjik III synon forcimin e mekanizmave institucionale në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen, trajtimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit dhe rekomandimet e Strategjisë Kombëtare 2016–2020. Ky objektivi adreson nevojën për rritjen e kapaciteteve të institucioneve kyçe, përfshirë Zyrën e Koordinatores/Koordinatorit Kombëtar, mekanizmat koordinues lokalë, policinë, QPS-të, gjykatat, prokuroritë dhe shërbimet mbështetëse, si dhe për avancimin e bashkërendimit shumë-sektorial në trajtimin e rasteve.

Në qendër të Objektivit Strategjik III qëndrojnë forcimi i kapaciteteve profesionale përgjatë gjithë zinxhirit institucional, standardizimi i procedurave ndër-institucionale, rritja e burimeve financiare dhe njerëzore, zhvillimi i një databaze të unifikuar dhe funksionale të të dhënave administrative, si dhe forcimi i partneritetit me organizatat e shoqërisë civile të specializuara. Është e rëndësishme të theksohet se shërbimet e strehimit dhe qendrave të referimit të sulmeve seksuale trajtohen në mënyrë të veçantë nën Objektivin Strategjik IV, ndërsa OS III fokusohet në koordinim, drejtësi, të dhëna dhe mekanizma institucionale.

Pesë objektivat specifike nën Objektivin Strategjik III fokusohen në: (III.1) fuqizimin e mekanizmit koordinues qendror për menaxhimin e politikave kundër dhunës; (III.2) ngritjen dhe forcimin e mekanizmave koordinues lokalë në të gjitha komunat; (III.3) avancimin e bashkëpunimit ndërmjet niveleve qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile; (III.4) hulumtimin, mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave administrative dhe statistikore sipas standardeve të Konventës së Stambollit dhe OZHQ-ve; dhe (III.5) përmirësimin e qasjes në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, përmes mbështetjes juridike falas, procedurave më të aksesueshme dhe forcimit të zinxhirit të referimit.

**Progresi i përgjithshëm i zbatimit (2022–2024).**<sup>39</sup> Gjatë periudhës 2022–2024 është shënuar progres i qëndrueshëm në forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe trajtimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Objektivi Strategjik III ka synuar konsolidimin e një sistemi të integruar ndër-institucional për mbrojtje, referim dhe riintegrim, si dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe në shërbime të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Përparimi në këtë periudhë reflektohet në funksionalizimin e mekanizmave koordinues, përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe operacionale, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të specializuara në nivel qendror dhe lokal. Njëkohësisht, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt standardizimit të procedurave për mbrojtje dhe referim, si dhe për zgjerimin e qasjes në shërbime të specializuara psikologjike, sociale dhe juridike.

Angazhimi i ABGJ ka kontribuar dukshëm në forcimin e koordinimit ndër-institucional, sidomos në nivel komunal. Gjatë vitit 2023, ABGJ ka trajnuar 70 zyrtare/zyrtarë komunalë të Mekanizmave Koordinues Lokalë (MKL), ndërsa në 2024 janë trajnuar 50 të tjera/tjerë, përmes katër trajnimeve vjetore. Këto ndërhyrje kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve profesionale

<sup>39</sup> Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të strategjisë

të MKL-ve dhe kanë përmirësuar funksionimin e tyre në menaxhimin ndërinstytucional të rasteve të dhunës. Në vijim të këtyre përpjekjeve për forcimin e mekanizmave lokalë, gjatë vitit 2022 ABGJ ka organizuar shtatë trajnime për mekanizmat koordinues në nivel lokal, ku janë trajnuar 130 përfaqësuese/përfaqësues mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Gjithashtu, gjatë periudhës 2022–2024 janë realizuar 12 punëtori orientuese për Mekanizmat Koordinues kundër Dhunës në Familje në nivel lokal, ku janë prezantuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit. Këto punëtori janë mbajtur në komunat Klinë, Malishevë, Mamushë, Drenas, Obiliq, Viti, Fushë Kosovë, Deçan, Vushtrri, Lipjan, Rahovec dhe Junik, me pjesëmarrjen e gjithsej 223 përfaqësueseve/përfaqësuesve institucionale.

*Tabela 9: Numri dhe përqindja e zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara nën objektivin strategjik III*

Viti	Nr. i aktiviteteve	Të zbatuara plotësisht	Të zbatuara pjesërisht	Të pazbatuara
2022	35	14%	51%	34%
2023	34	53%	38%	9%
2024	34	56%	35%	6%

Burimi: Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë, 2022–2024 (<https://md.rks-gov.net/zkn/>)

Progresi i vitit 2023 përfaqëson pikën e kthesës në zbatimin e Objektivit Strategjik III, me rritje të ndjeshme të aktiviteteve të zbatuara plotësisht (nga 14 për qind në 53 për qind). Kjo lidhet kryesisht me forcimin e koordinimit ndërinstytucional, funksionalizimin më të mirë të Mekanizmave Koordinues Lokalë (MKL), si dhe zgjerimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Ministria e Shëndetësisë raporton bashkëpunim të rregullt me Policinë, Prokurorinë dhe QPS-të në procedurat e referimit dhe menaxhimit klinik të rasteve të dhunës, duke siguruar qasje të menjëhershme në trajtim shëndetësor, dokumentim mjeko-ligjor dhe orientim drejt shërbimeve të tjera mbështetëse.

Në nivel qendror, koordinimi ndërinstytucional në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut mbështetet përmes mekanizmave institucionale të koordinuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, përfshirë strukturat ndërinstytucionale të bashkëpunimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve përgjegjëse. Këto mekanizma mbështeten gjithashtu nga rrjeti i Zyrtareve/Zyrtarëve për Barazi Gjinore në institucionet qendrore dhe komunale, të cilat/cilët veprojnë në bazë të mandatit të përcaktuar në kuadër të Ligjit për Barazi Gjinore dhe akteve nënligjore përkatëse. Raportimet vjetore tregojnë se ky mekanizëm ka përmirësuar qarkullimin e informacionit ndërmjet ministrive dhe ka forcuar përgjegjshmërinë institucionale në fushat e lidhura me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Në nivel lokal, 30 komuna kanë emëruar zyrtare/zyrtarë të dedikuar për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 8 komuna e mbulojnë këtë funksion përmes strukturave të tjera administrative. Pavarësisht mungesës së uniformitetit të strukturës organizative, këto/këta zyrtare/zyrtarë përbëjnë një burim të rëndësishëm institucional për mbështetjen e rasteve të dhunës, referimin dhe rritjen e aksesit në informacion për grupet e cënueshme. Procesi i digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes platformës ‘E-KOMUNAT’, i nisur nga MAPL, ka potencial të ndjeshëm të lehtësojë qasjen në informim dhe raportim për qytetaret/qytetarët, përfshirë viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje. Ky zhvillim kontribuon në forcimin e

transparencës, llogaridhënies dhe kontaktit të qytetareve/qytetarëve me institucionet në mënyrë të sigurt dhe të qasshme.

Roli i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) është forcuar ndjeshëm si pjesë e koordinimit ndërinstytucional, duke kontribuar në ofrimin e qasjes falas në drejtësi dhe në informimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve për të drejtat dhe procedurat e mbrojtjes. ANJF ka zgjeruar bashkëpunimin me Zyrat për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Policinë e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, strehimoret dhe organizatat e shoqërisë civile, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe aktiviteteve të rregullta informuese, përfshirë partneritetin me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe organizata të tjera të specializuara. Agjencia ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit për themelimin e Mekanizmave Koordinues Lokalë në shumicën e komunave të Kosovës, përfshirë Shtërpcë, Ranillug, Novobërdë, Pejë, Klinë, Deçan dhe Istog, duke kontribuar në forcimin e reagimit të integruar ndërinstytucional. Një dimension i rëndësishëm i koordinimit ndërinstytucional lidhet me përpjekjet e ANJF për të rritur qasjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe komuniteteve jo-shumicë në informim juridik dhe mbështetje. Dokumentet e ANJF për periudhën 2023–2025 evidentojnë një strategji të qëndrueshme komunikimi, që përfshin aktivitete informuese për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës, fushata sensibilizuese në komunitete të caktuara, takime direkte në terren dhe trajnime për profesionistët/profesionistët lokalë. Këto aktivitete rrisin qasjen e barabartë në drejtësi dhe mbështesin funksionimin e mekanizmave lokalë të referimit.

Në vitin 2024, tendenca pozitive është konsoliduar, me një rritje të mëtejshme në zbatimin e plotë të aktiviteteve dhe reduktim të aktiviteteve të pazbatuara në vetëm gjashtë për qind. Kjo rritje lidhet me:

- përmirësimin e procedurave të referimit ndërinstytucional,
- funksionalizimin e mëtejshëm të shërbimeve mbështetëse psikosociale dhe juridike,
- avancimin e sistemeve digjitale për mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave,
- rritjen e investimeve në kapacitetet profesionale (shëndetësi, polici, qendra për punë sociale, ofrueseve/ofruesve të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit).

Megjithatë, dinamika e vitit 2024 tregon se një pjesë e aktiviteteve kaluan në fazën e harmonizimit teknik dhe procedurave të përpunuara, të cilat kërkojnë kohë shtesë dhe koordinim të thelluar ndërinstytucional (pra një situatë e ngjashme me Objektivin Strategjik II të trajtuar më sipër).

Në vitin 2025, institucionet e sigurisë dhe drejtësisë, përfshirë **Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatat**, kanë vijuar të aplikojnë procedurat ligjore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke përfshirë lëshimin dhe monitorimin e urdhrave mbrojtës, si dhe ndjekjen penale të rasteve. Të dhënat e raportimit tregojnë një funksionim më të qëndrueshëm të zinxhirit institucional të reagimit, megjithëse sfidat lidhur me kohëzgjatjen e procedurave dhe harmonizimin e praktikave gjyqësore mbeten relevante për fazën përfundimtare të Strategjisë.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2025, janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve, të raportuara nga Policia e Kosovës dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), si dhe institucione të tjera sektoriale. Këto

ndërhyrje kanë kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të rasteve, vlerësimin të rrezikut dhe zbatimin të procedurave standarde, duke rritur cilësinë e përgjigjes institucionale.

### **Korniza ligjore dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare**

Gjatë periudhës 2022–2024, Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në harmonizimin e kornizës ligjore me Konventën e Stambollit, CEDAW dhe acquis të Bashkimit Evropian. Ndryshimet në Kodin Penal, kriminalizimi i Gjymtimit Gjenital Femëror (FGM), forcimi i dispozitave mbi ngacmimin seksual, si dhe qartësimi i konceptit të “pëlqimit” në rastet e dhunës seksuale, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së mbrojtjes juridike për gratë dhe vajzat. Ligji nr. 08/L-185 “Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore” (2023) ka konsoliduar qasjen gjithëpërfshirëse të parashikuar në Strategjinë Kombëtare 2022–2026 dhe ka krijuar bazën e nevojshme për standardizimin e procedurave të mbrojtjes dhe referimit.

**Sfidat e zbatimit praktik.** Megjithëse përafrimi ligjor është në nivel shumë të mirë, zbatimi praktik i ligjeve dhe protokolleve mbetet sfida e rëndësishme. Raportet e Këshillit të Evropës (2022)<sup>40</sup> dhe Komisionit Evropian (2024)<sup>41</sup> identifikojnë boshllëqe të qëndrueshme në: mungesën e trajnimeve të detyrueshme ndër-institucionale, aplikimin e pabarabartë të procedurave midis komunave, mungesën e standardeve të unifikuara të raportimit dhe pabarazitë në qasjen në shërbime mbrojtëse për gratë nga komunitetet Rome/Romë, Ashkalie/Ashkali, Egjiptiane/Egjiptianë (RAE) dhe gratë me aftësi të kufizuara. Monitorimi i OSBE-së për periudhën 2023–2024<sup>42</sup> tregon se zbatimi gjyqësor i ligjeve mbetet jo uniform, me dominim të dënimeve të buta si gjokat dhe dënimet me kusht, edhe në rastet me tregues të lartë rreziku. Raporti evidenton se vonesat në shqyrtimin e kërkesave për urdhra mbrojtës dhe mospërdorimi sistematik i vlerësimin të rrezikut ekspozojnë viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit ndaj rrezikut të përsëritjes së dhunës. Këto gjetje përkrijnë me rekomandimet e Konventës së Stambollit për forcim të politikës ndëshkimore dhe të mekanizmave mbrojtës.

Një kontribut i rëndësishëm institucional është mbështetja e UN Women për zhvillimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe institucionet përgjegjëse për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës. Kjo ka mundur standardizimin e procedurave, rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve në nivel qendror dhe lokal. Po ashtu, mbështetja për zgjerimin e Bazës Kombëtare të të Dhënave ka krijuar bazën për një sistem më të integruar, të sigurt dhe të harmonizuar të raportimit institucional.

*Ndikim i pritshëm në kuadër të Projektit KOMPAS të Bankës Botërore.* Edhe pse projekti nuk ka filluar ende zbatimin, KOMPAS është konceptuar për të kontribuar në forcimin e sistemit shëndetësor përmes zgjerimit të kompetencave profesionale të stafit shëndetësor, përmirësimin të qeverisjes në sektorin shëndetësor dhe krijimit të kapaciteteve për ofrim dhe referim të rasteve të dhunës me bazë gjimore. Pasi të ratifikohet dhe të fillojë zbatimin, pritet

<sup>40</sup> “Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit”, Këshilli i Evropës, 2022. Shih: <https://rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-sqi/1680a9203f>

<sup>41</sup> Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm)

<sup>42</sup> Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/8/8/572080.pdf>

që projekti të kontribuojë në standardizimin e shërbimeve, cilësinë e kujdesit dhe integrimin e reagimit ndaj dhunës në protokollet shëndetësore të Kosovës.

UNICEF ka kontribuar në forcimin institucional duke mbështetur funksionalizimin e 31 tryezave të menaxhimit të rasteve në nivel komunal, duke standardizuar qasjen e institucioneve në trajtimin e rasteve të fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës. Trajnimet e vazhdueshme për punonjëset/punonjësit socialë, mësimdhënëset/mësimdhënësit, profesionistet/profesionistet e shëndetit dhe aktorët e drejtësisë kanë rritur kapacitetet për identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve.

Kontributet e UNMIK në forcimin institucional përfshijnë mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve dhe aktorëve institucionalë për zbatimin e qasjeve gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt të mbijetuarave, si dhe zhvillimin e platformave të institucionalizuara për dialog dhe bashkëpunim. Modelet si Barabar Center, forume ndër-rajonale dhe programet e mentorimit të grave kanë kontribuar në fuqizimin e institucioneve vendore për të integruar perspektivën gjinore në politika dhe në shërbimet publike.

UNFPA ka luajtur rol kyç në forcimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore për identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Mbështetja për hartimin e protokolleve dhe udhëzuesve për kujdesin shëndetësor për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, si dhe për zhvillimin e instrumenteve ligjore në kuadër të grupit të punës për shëndetin, ka kontribuar në standardizimin e praktikave institucionale dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Përmes trajnimeve të vazhdueshme, klinikave pilot dhe auditimeve shëndetësore, UNFPA ka mbështetur zbatimin praktik të këtyre protokolleve në nivel komunal.

Kontributi i EULEX në forcimin institucional ka përfshirë hartimin e udhëzimeve nënligjore, zhvillimin e PSV-ve, mekanizmave të llogaridhënies dhe mbështetjen për realizimin e detyrimeve nga Konventa e Stambollit. Përmes grupeve punuese ndërministrorë, misioni ka luajtur rol kyç në harmonizimin e legjislacionit dhe forcimin e qasjeve të standardizuara ndërinstitutionale.

KiE ka mbështetur drejtpërdrejt funksionalizimin e mekanizmave të koordinimit në nivel qendror (GKK) dhe lokal, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe OSHC-ve. Këshilli i Evropës ka luajtur rol kyç në harmonizimin e legjislacionit me Konventën e Stambollit dhe në zhvillimin e akteve nënligjore që adresojnë rekomandimet urgjente nga raporti i vlerësimit të përafritimit ("Assessment Report").

BE ka mbështetur fuqizimin institucional në të gjitha nivelet përmes GEF, EUKOJUST dhe EVAW, duke përfshirë funksionalizimin e Zyrës së Koordinatores/Koordinatorit Kombëtar, harmonizimin e legjislacionit me acquis, ngritjen e kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe komunale, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional. BE ka kontribuar gjithashtu në hartimin e akteve nënligjore, në pjesëmarrjen në grupet punuese dhe në sigurimin e ekspertizës për strukturat e reja të koordinimit.

*Në terma të përgjithshëm, harmonizimi me standardet ndërkombëtare vlerësohet të jetë në nivel shumë të mirë, ndërsa zbatimi në praktikë mbetet i pa unifikuar dhe, në disa raste, i varur nga mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë. Ky hendek midis kornizës ligjore dhe zbatimit*

praktik thekson nevojën për forcim të kapaciteteve profesionale dhe për konsolidim të mekanizmave institucionalë në fazën 2026 e në vijim.

## Analiza e treguesve të Objektivit Strategjik III

Tabela 10: Matja e treguesve të objektivit strategjik III dhe objektivave specifike përkatës

Treguesi në nivel objektivit strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave koordinues qendrorë e lokalë të fuqizuar e që zbatojnë në mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta në përputhje me Konventën e Stambollit.</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 50%	Në mungesë të një vlere bazë dhe metodologjie të standardizuar për matjen e këtij treguesi, vlerësimi bazohet në indikatorë proxy institucionalë, si funksionalizimi i 38 Mekanizmave Koordinues Lokalë dhe operacionalizimi i rrjetit ndërinstitucional në nivel qendror. Këta tregues dëshmojnë forcim të dukshëm të bashkërendimit institucional, por nuk mundësojnë një matje të drejtpërdrejtë të përqindjes së institucioneve të “fuqizuara”.	Rritur me 80%
<b>Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse (Treguesi i OZHQ 16.3.1)</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10%	Të dhënat e treguesit të OZHQ janë ende në përpunim dhe mungon raporti kombëtar; për shkak të mos-përcaktimit të vlerës bazë në vitin 2022, treguesi nuk është i matshëm për vitin 2024. Mungesa e këtij treguesi lidhet me mosfinalizimin e metodologjisë kombëtare për matjen e aksesit në drejtësi sipas standardeve të OZHQ-ve dhe nuk reflekton mungesë progresi në raportimin institucional.	Rritur me 20%
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje me vendim përfundimtar gjyqate</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 50%	Të dhënat <sup>43</sup> tregojnë se vendimet përfundimtare u rritën nga 306 raste (2022–2023) në 856 raste (2023–2024) pra një rritje me 550 raste ose 180%, duke reflektuar progres të qëndrueshëm në finalizimin gjyqësor të lëndëve. Kjo	Rritur me 100%

<sup>43</sup> Të dhënat janë marrë nga raportet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, për vitet 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024. Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/category/publications/>

			rritje duhet interpretuar gjithashtu në kontekst të reduktimit të rasteve të mbartura nga vitet e mëparshme dhe përmirësimit të menaxhimit të lëndëve, jo vetëm si rritje e fluksit të rasteve të reja.	
Treguesi në nivel objektiv specifik III.1.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Linja buxhetore adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje, për një koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 15%	Në vitin 2023 është funksionalizuar Divizioni për Qasje në Drejtësi, Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Gruas dhe Dhuna në Baza Gjinore i cili shërben në cilësinë e Sekretariatit të Koordinatorës / Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje, me 4 të punësuar / punësuar (2024), duke shënuar forcim të dukshëm të kapaciteteve për koordinim dhe monitorim.	Rritur me 30%
Treguesi në nivel objektiv specifik III.2.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Numri i Mekanizmave Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës, të ngritur në mbarë vendin, me koordinatorë/koordinator lokal dhe mbështetje buxhetore të përcaktuar qartësisht.	20	28	Raportohen si të ngritur 38 Mekanizma Koordinues Lokalë, duke tejkaluar synimin prej 28 mekanizmash dhe duke konsoliduar infrastrukturën e koordinimit në nivel lokal. Për periudhën e mbetur të zbatimit të strategjisë deri në vitin 2026, fokusi duhet të zhvendoset drejt vlerësimit të efektivitetit të funksionimit të këtyre mekanizmave.	38
Treguesi në nivel objektiv specifik III.3.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Përqindja e buxhetit dedikuar OJQ-ve që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, mbrojtjes (duke përjashtuar strehimoret) dhe ri integritetit e fuqizimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10%	Në vitin 2024 janë dedikuar 794,000 euro për OJQ që punojnë në zbatim të Konventës së Stambollit (duke përjashtuar strehimoret), duke shënuar një rritje prej rreth 7.6% krahasuar me nivelin bazë të vitit 2022.	Rritur me 20%
Treguesi në nivel objektiv specifik III.4.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026

1. Data baza me të dhënat për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, funksionale dhe e përditësuar rregullisht.	Data baza 65% funksionale	Data baza 85% funksionale	Databaza është funksionale dhe plotësisht në përputhje me synimin 85% të vitit 2024.	Databaza 100% funksionale
2. Përqindja e të rejave dhe të rinjve të moshës 18-29 vjeç të cilët përjetuan dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç (Treguesi i OZHQ 16.2.3)	Do përcaktohet gjatë 2022	Zvogëluar me 10%	Nuk është përcaktuar vlera bazë për vitin 2022 dhe matja e treguesve të OZHQ nuk ka përfunduar ende; për vitin 2024 nuk ka të dhëna të disponueshme që të raportohet për këtë tregues.	Zvogëluar me 20%
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik III.5.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
<b>Numri i viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës të cilat/cilët përfitojnë ndihmë juridike falas</b>	1803 persona kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë vitit 2020	Rritur me 40%	Të dhënat tregojnë rritje të qëndrueshme të përfitueseve / përfituesve të ndihmës juridike falas krahasuar me vitin bazë 2020. Në ANJF, rastet e dhunës në familje u rritën nga 44 raste në vitin 2020 në 214 raste në vitin 2024, që paraqet një rritje prej rreth 386%, duke tejkaluar dukshëm objektivin e vitit 2024. Në ZMNV, rastet që kanë kërkuar ndihmë juridike falas (90–93% DHF) u rritën nga 1,720 raste (2020) në 2,902 raste (2023), duke reflektuar një rritje prej 20.5% mbi synimin e ndërmjetëm. Në këtë kuadër, treguesi për vitin 2024 konsiderohet i arritur dhe i tejkaluar.	Rritur me 70%
<b>Numri i grave që kanë qasje në drejtësi</b>	Çdo 1.83 në 4 gra	Çdo 2.5 në 4 gra	Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se 3,534 gra përfituan ndihmë juridike falas nga gjithsej 8,049 përfituese/përfitues, duke përfaqësuar rreth 43.9% të totalit. Ky rezultat reflekton progres të qëndrueshëm në rritjen e qasjes së grave në drejtësi krahasuar me vitet pararendëse, por mbetet nën nivelin e synuar për vitin 2024.	Çdo 4 në 4 gra

Burimi: Të dhënat e mbledhura në kuadër të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare

Në përputhje me gjetjet e Objektivit Strategjik II, sfidat në matjen e treguesve dhe në harmonizimin e të dhënave administrative në kuadër të Objektivit Strategjik III konfirmojnë nevojën për një sistem të integruar dhe të standardizuar të të dhënave ndërinstitucionale, që

mundëson monitorim të besueshëm dhe të krahasueshëm të progresit në nivel kombëtar dhe lokal.

**Gjetje të pavarura nga monitorimi ndërkombëtar dhe shoqëria civile.** Studimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) me mbështetje të Bashkimit Evropian, për periudhën 2022–2024<sup>44</sup> dhe analiza e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) e vitit 2024<sup>45</sup>, tregojnë se pavarësisht përparimeve të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe institucional, mbeten boshllëqe kritike në zbatim. Këto përfshijnë: mungesën e një baze të unifikuar të të dhënave ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe QPS-ve; zbatimin jo të njëtrajtshëm të urdhrave mbrojtës; mungesën e përfaqësimit ligjor për shumicën e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në procedura; mungesë të qëndrueshmërisë financiare të strehimoreve; kapacitet të pamjaftueshëm profesional në Qendrat për Punë Sociale; dhe mungesë programesh të trajtimit për kryerësit e dhunës. Sfidat në mbikëqyrjen e urdhrave mbrojtës, ngarkesa e lartë e punës në QPS dhe mungesa e të dhënave të standardizuara ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave mbeten pengesa kyçe për funksionalitetin e plotë të zinxhirit të reagimit. Këto gjetje konfirmojnë se, përveç progresit të raportuar nga institucionet, mbeten zhvillime strukturore që kërkojnë ndërhyrje sistematike gjatë periudhës 2026 e më tej.

OSBE ka mbështetur ndjeshëm profesionalizimin e zinxhirit të reagimit përmes trajnimeve, mentorimeve dhe analizave të praktikës gjyqësore, duke kontribuar në përdorimin më të strukturuar të protokolleve dhe rritjen e kapaciteteve policore, prokuroriale dhe të QPS-ve. Megjithatë, raportimet vërejnë se standardizimi i praktikave nuk është arritur ende në të gjitha rajonet, duke krijuar nevojë për qasje të unifikuar dhe mekanizma të detyrueshëm të koordinimit.

**Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik III** tregon një përparim të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave institucionalë të mbrojtjes, zgjerimin e qasjes në drejtësi dhe rritjen e funksionalitetit të mekanizmave koordinues në nivel qendror dhe lokal. Edhe pse disa tregues mbeten të pamatshëm për shkak të mungesës së vlerave bazë ose përpunimit të të dhënave, tendencat për periudhën 2022–2025 pasqyrojnë konsolidim të kapaciteteve dhe përmirësim të qasjes në shërbime.

Objekivi Strategjik III synon krijimin e një sistemi të integruar shumësektorial për mbrojtjen, referimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës. Progresi i raportuar tregon rritje të dukshme në funksionalitetin e mekanizmave koordinues, me 38 MKL dhe një rrjet të konsoliduar institucional në nivel qendror, çka përforcon unifikimin e qasjes institucionale. Në të njëjtën kohë, rritja e numrit të vendimeve përfundimtare të gjykatave gjatë viteve 2023–2024 demonstroi përmirësim të efikasitetit gjyqësor dhe bashkëpunim më të mirë ndër-institucional. Ndërhyrjet e Koordinatorës Koordinatorit Kombëtar kanë qenë të rëndësishme veçanërisht në situata emergjente, si në rastet e femicidit të raportuara në vitin 2024, ku janë thirrur takime urgjente me institucionet përgjegjëse dhe janë adresuar rekomandime specifike për rritjen e sigurisë së QPS-ve, strehimoreve dhe forcimin e kapaciteteve komunale.

<sup>44</sup> Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/>

<sup>45</sup> Fuqizimi i Mekanizmave Mbrojtës nga Dhuna në Baza Gjinore në Kosovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, korrik, 2024. Shih: <https://qkss.org/al/publikimet/strengthening-protection-mechanisms-of-gender-based-violence-in-kosovo/>

Treguesit e lidhur me OZHQ 16.3.1 dhe OZHQ 16.2.3 mbeten të pamatshëm për shkak të boshllëqeve metodologjike, duke nxjerrë në pah nevojën për standardizim të instrumenteve statistike dhe harmonizim të raportimit ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, QPS-ve dhe ASK-së. Funkcionalizimi 85 për qind i databazës shumësektoriale në vitin 2024 me lidhjen elektronike të Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, ABGJ-së dhe ANJF-së, duke e çuar në nëntë numrin total të institucioneve që raportojnë në sistem, përbën një arritje kyçe në drejtim të harmonizimit të raportimit ndërinstytucional.

Në nivel objektivash specifike, janë arritur rezultate të konsiderueshme. Themelimi i Divizionit të Qasjes në Drejtësi dhe Mbrojtje nga Dhuna në Familje ka forcuar koordinimin qendror, ndërsa zgjerimi i MKL-ve ka tejkaluar synimet e Strategjisë duke mbuluar pothuajse gjithë territorin e Kosovës. Financimi i OJQ-ve ka shënuar rritje, por mbetet nën nivelin e nevojave reale të shërbimeve, veçanërisht për ndërhyrjet e riintegritimit dhe shërbimeve komunitare që nuk ofrohen nga sektori publik. Përmirësimi i qasjes në drejtësi, veçanërisht përmes rritjes së ndihmës juridike falas, tregon një tendencë pozitive drejt avancimit të barazisë gjinore në akses në shërbime, edhe pse objektivi për gratë në vitin 2024 nuk është përmbushur plotësisht.

Në tërësi, Objektivi Strategjik III demonstroi progres të qëndrueshëm dhe në përputhje me objektivat e Strategjisë, por kërkon forcimin e cilësisë së koordinimit, standardizimit e procedurave të referimit dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të të dhënave për periudhën 2026 e më tej, në mënyrë që progresi sasior të shndërrohet në ndryshim cilësor dhe të qëndrueshëm.

Asistenca teknike e partnerëve ndërkombëtarë ka kontribuar kryesisht në ngritjen e kapaciteteve për reagimin e policisë, prokurorisë dhe shërbimeve sociale, duke plotësuar boshllëqet ekzistuese në trajnime dhe standardizim.

### **Rezultatet sipas objektivave specifike (OS)**

**OS III.1: Fuqizimi i grupit koordinues ndërinstytucional në nivel qendror.** Funkcionalizimi i strukturave të dedikuara pranë Ministrisë së Drejtësisë ka rritur dukshëm kapacitetin për koordinim, monitorim dhe mbështetje teknike të institucioneve përgjegjëse. Fuqizimi institucional u konsolidua në vitin 2024 me miratimin e Rregullores së Qeverisë Nr. 37/2024, e cila përcaktoi mandatin, strukturën dhe detyrat e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar. Kjo rregullore ka krijuar mekanizëm të përhershëm për koordinim ndërministror, raportim dhe monitorim, duke garantuar përputhshmëri me Ligjin nr. 08/L-185 dhe me standardet e Konventës së Stambollit. Megjithatë, sigurimi i burimeve të qëndrueshme njerëzore dhe financiare mbetet sfida që mund të ndikojë në funksionalitetin afatgjatë të këtij mekanizmi. Ky objektivi konsiderohet *i arritur në nivel të mirë*, me progres të dukshëm në vitin 2023–2024, që ka vijuar edhe gjatë vitit 2025. Në 2026 e në vijim pritet konsolidim dhe qëndrueshmëri e kapaciteteve.

**OS III.2: Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës.** Zgjerimi i mekanizmave koordinues lokalë është përforcuar nga miratimi i Rregullores së Qeverisë Nr. 01/2025, e cila standardizon strukturën, funksionet dhe

procedurat operacionale të MKL-ve në të gjitha komunat. Ky zhvillim ka harmonizuar më tej rolin e Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale, institucioneve shëndetësore dhe OSHC-ve në menaxhimin e rasteve. Ky objektiv vlerësohet i tejkaluar, me nevojë për fokus të ri të cilësia e funksionimit dhe monitorimi i efektivitetit të tyre, veçanërisht tashmë pas zgjedhjeve lokale. Megjithëse prania e MKL-ve është pothuajse e plotë në nivel kombëtar, funksionaliteti i tyre nuk është i njëjtë në të gjitha komunat, për shkak të mungesës së linjave të dedikuara buxhetore, mungesës së psikologeve/psikologëve dhe punonjëseve/punonjësve socialë të trajnuar, mungesa e të kuptuarit qartësisht të rregullores së re të funksionimit të MKL-ve dhe mënyrës së zbatimit të saj, si dhe nevojës për burime të qëndrueshme në disa komuna, kur flitet për trajnime, apo fuqizim të kapaciteteve të anëtareve/anëtarëve të MKL-ve. Këto sfida kërkojnë një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve qendrore, komunave dhe partnerëve ndërkombëtarë, për të siguruar mbështetje të harmonizuar dhe për të shmangur varësinë e pabarabartë nga projektet.

**OS III.3: Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.** Financimi për OJQ-të është rritur krahasuar me periudhën bazë, edhe pse mbetet nën nivelin e synuar për vitin 2024 dhe kërkon mbështetje të mëtejshme për të përmbushur kapacitetin e plotë të shërbimeve. Ky objektiv vlerësohet *pjesërisht i arritur*, me potencial për përmirësim në vitin 2026. Gjatë vitit 2024, bashkëpunimi ndërinstitucional është përforcuar përmes themelimit të Fondit Emergjent për Viktimat, i cili mundëson mbështetje të menjëhershme financiare për gratë dhe fëmijët në rrezik, në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 08/L-185. Sidoqoftë, raportet e OSBE-së (2024) theksojnë se gratë me aftësi të kufizuara dhe ato nga komunitetet RAE vijnë në përballen me barriera për qasje të barabartë në shërbime, çka nënvizon nevojën për masa të synuara në periudhën 2026 e në vijim.

**OS III.4: Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndër-institucionale për evidentimin e rasteve.** Funksionaliteti i databazës shumësektoriale ka arritur standardet e synuara për vitin 2024 dhe përfaqëson një përparim të rëndësishëm drejt harmonizimit të raportimit. Në vitin 2024, sistemi elektronik ndërinstitucional është testuar dhe funksionalizuar, duke lidhur Policinë e Kosovës, ABGJ-në, ANJF-në, shërbimet provuese dhe sistemin gjyqësor. Është finalizuar edhe drafti i Udhëzimit Administrativ për menaxhimin dhe sigurinë e të dhënave, i cili pritet të miratohet. Sfida kryesore mbetet harmonizimi i plotë i metodologjisë së raportimit dhe siguri i përditësimit të rregullt të të dhënave nga të gjitha komunat. Ndërkohë, treguesi i dhunës seksuale ndaj të rejave/rinjve mbetet i pamatshëm për shkak të mungesës së vlerave bazë dhe përpunimit të të dhënave. Monitorimi i pavarur dhe të dhënat nga Qendrat për Punë Sociale për vitet 2022–2024 tregojnë se procesi i raportimit mbetet i fragmentuar, me përdorim jo të njëtrajtshëm të formularëve administrativë, çka krijon mospërputhje ndërmjet numrit të rasteve të trajtuara në QPS dhe atyre të raportuara në sistemin shumësektorial. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi të pavarur dhe të koordinuar, i cili garanton transparencë, krahasueshmëri të të dhënave dhe besueshmëri analitike në nivel kombëtar dhe lokal. Në terma të përgjithshëm, ky objektiv vlerësohet *i arritur pjesërisht*, me progres të fortë në infrastrukturën e të dhënave.

**OS III.5: Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës.** Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas nga viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit e dhunës përbën një nga arritjet më të fuqishme të këtij objekti. Rritja e aksesit

është mundësuar edhe nga zgjerimi i zyrave mobile të ndihmës juridike falas, të cilat u rritën nga 4 njësi pilot në vitin 2023 në 9 njësi funksionale në vitin 2024, duke mbuluar mbi 3,000 qytetare/qytetarë nga zonat rurale dhe komunitetet jo-shumicë. Kjo ka rritur dukshëm qasjen në drejtësi për komunitetet më të cenueshme. Përdorimi i shërbimeve është rritur ndjeshëm në dy institucionet kryesore që ofrojnë ndihmë juridike, duke tejkaluar synimet për vitin 2024. Megjithëse objektivi për rritjen e qasjes së grave në drejtësi nuk është plotësisht i arritur, trendi është pozitiv. Iniciativa “Qeveria për Familje”, e nisur në vitin 2024, ka kontribuar në riintegrimin socio-ekonomik të grave të mbijetuara nga dhuna, nëpërmjet punësimit, mbështetjes sociale dhe përfshirjes ekonomike. Ky objektiv vlerësohet kryesisht i arritur, megjithëse qasja e grave në drejtësi mbetet nën synim dhe kërkon masa të synuara në periudhën 2026 e më tej. Megjithëse ndikimi i zyrave mobile është i rëndësishëm, sigurimi i qëndrueshmërisë buxhetore mbetet thelbësor për zbatimin e një mbulimi të plotë territorial dhe ofrim të shërbimeve të njëtrajtshme cilësore në të gjitha komunat.

Megjithëse progresi është i dukshëm në të gjitha nën-objektivat, kapaciteti i diferencuar ndërmjet komunave dhe mungesa e standardeve të unifikuara të raportimit kufizojnë efektivitetin e përgjithshëm të Objektivit Strategjik III dhe kërkojnë masa korrigjuese në periudhën 2026 e më tej.

*Në tërësi, Objektivi Strategjik III ka shënuar progres të dukshëm në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm ndërinstytucional për parandalimin dhe trajtimin e dhunës. Forcimi i mekanizmave koordinues, rritja e efikasitetit gjyqësor dhe zgjerimi i qasjes në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit përfaqësojnë arritjet më të rëndësishme të periudhës 2022–2024, ndjekur më tej edhe në vitin 2025. Megjithatë, sfida mbeten në harmonizimin e të dhënave, financimin e qëndrueshëm të shërbimeve dhe adresimin e pabarazive të qasjes, veçanërisht për gratë.*

## Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik III sipas kriterëve të OECD-DAC

Tabela 11: Vlerësimi sipas kriterëve të OECD-DAC për Objektivin Strategjik III

KRITERI	VLERËSIMI	ARSYETIMI I BAZUAR NË TË DHËNA
<b>Relevanca</b>	Shumë e lartë	Objektivi Strategjik III është plotësisht në përputhje me Ligjin nr. 08/L-185, Konventën e Stambollit, CEDAW, OZHQ 5 dhe 16, si dhe me rekomandimet e BE-së (2024) dhe OSBE-së (2023–2024). Fokusimi në koordinimin ndërinstytucional, MKL-të, qasjen në drejtësi dhe mbrojtjen e viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarave adreson drejtpërdrejt sfidat themelore të sistemit. Të gjitha burimet e pavarura (OSBE, GLPS, QKSS, KiE) konfirmojnë se ndërhyrjet janë thelbësore për kontekstin e Kosovës.
<b>Efektiviteti</b>	I mirë, me progres të dukshëm	U tejkalua synimi për ngritjen e MKL-ve (38 raportohen të ngritura nga 28 që ishte synimi për 2024), u funksionalizuan strukturat qendrore (Divizioni për Qasje në Drejtësi), dhe u rrit ndjeshëm qasja në ndihmë juridike falas (214 raste DHF në ANJF më 2024

		nga 44 në 2020; 2,902 raste në ZMNV më 2023). Vendimet përfundimtare gjyqësore u rritën me 180%. Megjithatë, objektivi për rritjen e qasjes së grave në drejtësi (2.5/4) nuk u arrit (1.76/4). Treguesit e OZHQ 16.2.3 dhe 16.3.1 mbeten të pamatshëm.
<b>Efikasiteti</b>	Mesatar	Rritja e shpejtë e rezultatit të aktiviteteve të zbatuara plotësisht (nga 14% në 2022 në 56% në 2024) tregon efikasitet operativ. Por sistemet e të dhënave nuk janë ende të harmonizuara, disa komuna nuk kanë burime të qëndrueshme për trajnime dhe MKL-të kanë kapacitete jo të barabarta (mungesë psikologesh / psikologësh dhe punonjësesh/punonjësish socialë, mungesë linjash buxhetore). Zyrat mobile kanë rritur eficiencën e qasjes në drejtësi, por mungesa e financimit të qëndrueshëm cenon efikasitetin afatgjatë.
<b>Koherenca</b>	E mirë, me disa boshllëqe	Përputhshmëri e fortë me kuadrin ligjor kombëtar dhe politikat e BE-së; bashkëpunim aktiv me OSBE-në, UNDP-në, UN Women, ABGJ-në, Policinë, QPS-të dhe OJQ-të e specializuara. Sidoqoftë, nevoja për përdorimin më të gjerë të databazës së përbashkët (edhe pse 85% funksionale), mospërdorimi i njëtrajtshëm i formularëve të QPS-ve dhe raportimi i fragmentuar ndërmjet institucioneve kufizojnë koherencën vertikale dhe horizontale.
<b>Ndikimi</b>	Mesatar në rritje, me diferenca ndërmjet komunave	Trend pozitiv në vendimet gjyqësore, rritje e aksesit në drejtësi, forcim i MKL-ve dhe institucionalizim i koordinimit qendror. Zyrat mobile dhe Fondi Emergjent kanë rritur ndikimin në komunitetet rurale dhe grupet vulnerabël. Por nevoja për shtirjen më tej të programeve të trajtimit për kryerësit, zgjerimin e mbështetjes së qëndrueshme të strehimoreve dhe ofruesve të shërbimeve riintegruese, si dhe mungesa e statistikave gjinore të harmonizuara kufizojnë ndikimin sistematik.
<b>Qëndrueshmëria</b>	E kufizuar	Korniza ligjore është e qëndrueshme dhe e harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por kapacitetet institucionale nuk janë të barabarta. MKL-të në disa komuna ende karakterizohen nga burime të paqëndrueshme për tu fuqizuar e funksionalizuar plotësisht; zyrat mobile financohen kryesisht nga projekte; strehimoret kanë nevojë për qëndrueshmëri të financimit shumëvjeçar; databaza kërkon buxhet të dedikuar për mirëmbajtje. Pa financim të parashikueshëm dhe pa standardizim të plotë të procedurave, qëndrueshmëria mbetet e brishtë.

*Burimi: Vlerësimi bazohet në të dhënat e paraqitura në seksionet e mësipërme, duke përfshirë treguesit, raportet vjetore të zbatimit dhe të dhënat administrative të institucioneve përgjegjëse*

Zbatimi i Objektivit Strategjik III ka qenë në përgjithësi i suksesshëm, me progres të dukshëm në forcimin e koordinimit ndërinstytucional, ngritjen e MKL-ve në të gjitha komunat, rritjen e qasjes në shërbimet juridike falas dhe përmirësimin e efikasitetit gjyqësor. Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare është shumë e lartë, ndërsa funksionalizimi 85 për qind i databazës shumësektoriale dhe konsolidimi i strukturave qendrore shënojnë hapa të rëndësishëm drejt sistematizimit të përgjigjes institucionale ndaj dhunës.

Megjithatë, ndikimi dhe qëndrueshmëria mbeten të pjesshme për shkak të kapaciteteve jo të barabarta ndërmjet komunave, mungesës së harmonizimit të raportimit, burimeve të paqëndrueshme për funksionimin e MKL-ve dhe shërbimeve mobile, si dhe sfidave në sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet e specializuara dhe riintegruese. Periudha 2026 e në vijim kërkon fokus të veçantë në konsolidimin e sistemeve të të dhënave, financim shumëvjeçar, forcim të kapaciteteve lokale dhe masa të synuara për rritjen e qasjes së grave në drejtësi.

Për të siguruar kalimin nga progresi operacional në ndikim të qëndrueshëm, faza përmbyllëse e Strategjisë duhet të fokusohet në institucionalizimin e mekanizmave ekzistues, standardizimin e plotë të praktikave ndërinstytucionale dhe sigurimin e financimit të parashikueshëm shumëvjeçar

### **Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik III**

Në përmbyllje të analizës, tabela në vijim paraqet rekomandimet prioritare të ndara sipas periudhës së zbatimit, për të siguruar vazhdimësinë ndërmjet fazës përmbyllëse të Strategjisë aktuale (2026) dhe orientimeve për Strategjinë e re 2027–2030/2032.

Rekomandimet fokusohen në pesë boshtet themelore të Objektivit Strategjik III: forcimin e koordinimit qendror dhe lokal, rritjen e qasjes në drejtësi, konsolidimin e sistemit të të dhënave, standardizimin e reagimit institucional dhe garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve mbështetëse dhe të trajtimit. Duke u mbështetur në gjetjet kryesore të vlerësimit, viti 2026 kërkon ndërhyrje të synuara për të përmbyllur boshllëqet strukturore të identifikuar, ndërsa faza 2027–2030/2032 duhet të ndërtojë një sistem plotësisht funksional dhe të integruar, të mbështetur në standarde evropiane dhe në mekanizma të qëndrueshëm monitorimi.

Këto gjetje përbëjnë bazën themelore për fazën përmbyllëse të Strategjisë aktuale dhe për hartimin e Strategjisë së re 2027–2030/2032, me synimin për të garantuar koherencë, vazhdimësi dhe një përafrim të plotë me standardet e BE-së dhe Konventës së Stambollit.

*Tabela 12: Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik III sipas periudhës së zbatimit*

2026 (FAZA PËRMBYLLËSE E STRATEGJISË AKTUALE)	2027–2030 /2032 (STRATEGJIA E RE)
Konsolidimi i plotë i Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar dhe MKL-ve, me trajnime të detyrueshme,	Standardizimi kombëtar i funksionimit të Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar dhe MKL-ve, përmes

kapacitete të qëndrueshme njerëzore dhe zbatim të unifikuar të rregulloreve ndërinstucionale.	protokolleve uniforme të bashkëpunimit dhe mekanizmave të rregullt të auditimit të performancës.
Zhvendosja e fokusit nga zgjerimi sasior i MKL-ve drejt përmirësimit cilësor të funksionimit, me monitorim më të mirë të efikasitetit dhe profesionalizim të anëtareve/anëtarëve të MKL-ve.	Integrimi i MKL-ve në një platformë kombëtare të vetme për raportim, monitorim dhe menaxhim të rasteve, me tregues të standardizuar të cilësisë së reagimit.
Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare për OJQ-të ofruese të shërbimeve (ligjore, psikosociale, riintegrim), duke mundësuar varësinë burime të qëndrueshme.	Vendosja e një skeme të qëndrueshme shumëvjeçare financimi për OJQ-të e specializuara, përmes modeleve të kontraktimit publik dhe mekanizmave të bazuar në performancë.
Zgjerimi i qasjes në drejtësi përmes funksionalizimit të plotë të zyrave mobile të ndihmës juridike dhe sigurimit të përfaqësimit ligjor falas në çdo fazë të procedurës gjyqësore.	Zhvillimi i modeleve të integruara “One-Stop Center” për shërbimet juridike, psikosociale dhe shëndetësore, si dhe digjitalizimi i plotë i sistemit të ndihmës juridike.
Zbatimi i plotë i mbikëqyrjes elektronike për kryerësit ndaj të cilëve është lëshuar urdhër mbrojtës, duke siguruar bashkërendim ndërmjet Policisë, Prokurorisë dhe gjykatave për monitorim efektiv të rasteve me rrezik të lartë.	Integrimi i mbikëqyrjes elektronike në një sistem të unifikuar kombëtar të menaxhimit të rasteve me rrezik të lartë, me algoritme standarde për vlerësimin e riskut dhe raportim automatik në MKL-të.
Përfundimi i harmonizimit të metodologjisë së raportimit ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe QPS-ve; përditësim i rregullt i databazës shumësektoriale në të gjitha komunat.	Shndërrimi i databazës në një sistem të integruar kombëtar të lidhur me ASK-në, me matje të detyrueshme të treguesve të OZHQ-ve
Zgjerimi i programeve të parandalimit në shkolla dhe komunitet, duke përfshirë programe të synuara me djem dhe burra të rinj.	Institucionalizimi i edukimit gjinor dhe programeve të parandalimit të dhunës në të gjitha nivelet e arsimit formal dhe joformal, me fokus të veçantë në parandalimin e femicidit dhe dhunës seksuale.
Forcimi dhe standardizimi i politikës ndëshkimore për dhunën në familje dhe femicidin, duke adresuar praktikën e dënimeve të buta dhe duke garantuar masa të ashpra për rastet me rrezik të lartë, në përputhje me rekomandimet e Konventës së Stambollit.	Vendosja e standardeve kombëtare për dënimet për dhunën në familje dhe femicidin, përmes udhëzimeve gjyqësore, analizave të jurisprudencës dhe trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë/gjyqtarë e prokurorë/prokurorë.

*Burimi: Përpunim i të dhënave nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe analiza e vlerësimit afatmesëm (2022–2024).*

#### **4.2.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK IV: SIGURIMI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR VIKTIMAT/TË MBIJETUARAT/MBIJETUARIT**

Objektivi Strategjik IV synon garantimin e një rrjeti gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Ky objektivi adreson të gjitha hallkat e mbështetjes institucionale pas reagimit të menjëhershëm, nga strehimi emergjent dhe shërbimet psiko-sociale, tek këshillimi ligjor, mbështetja mjeko-ligjore, shërbimet për fëmijët dëshmitarë të dhunës dhe programet e riintegrit afatgjatë. Ai thekson domosdoshmërinë e funksionimit efektiv të strehimoreve, linjave telefonike 24/7, qendrave të referimit dhe të menaxhimit të krizës për dhunën seksuale (në përputhje me nenet 25–26 të Konventës së Stambollit), shërbimeve të këshillimit dhe të gjitha shërbimeve të tjera të specializuara që garantojnë mbrojtje, siguri dhe një rrugë të qëndrueshme drejt fuqizimit. Në këtë proces, organizatat e shoqërisë civile të specializuara mbeten një aktor thelbësor për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e institucioneve në zbatimin e standardeve.

Dy objektivat specifike nën Objektivin Strategjik IV fokusohen në: (IV.1) mbështetjen dhe fuqizimin e të gjitha formave të shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit nga të gjitha grupet dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës; dhe (IV.2) zbatimin e politikave dhe mekanizmave që mundësojnë riintegrim afatgjatë dhe fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në nivel qendror dhe lokal.

**Progresi i përgjithshëm i zbatimit (2022–2024).**<sup>46</sup> Gjatë periudhës 2022–2024, është vërejtur progres i qëndrueshëm në zbatimin e aktiviteteve, megjithëse ritmi mbetet më i ngadalshëm krahasuar me Objektivat Strategjike II dhe III, për shkak të kompleksitetit të shërbimeve, kostos së lartë të standardeve të Konventës së Stambollit dhe varësisë së vazhdueshme nga financimi i projekteve. Përmirësimet më të dukshme lidhen me rritjen e financimit publik për strehimoret, zgjerimin e shërbimeve të specializuara dhe bashkëpunimin e rritur ndërmjet institucioneve dhe OJQ-ve.

Angazhimi i ABGJ ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përmes programeve të rregullta të trajnimit dhe ndërgjegjësimit për institucionet përgjegjëse. Në këtë kuadër janë realizuar 16 trajnime dyditore për Policinë e Kosovës mbi Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me fokus në përgjegjësitë institucionale dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Trajnimet janë zhvilluar në rajonet e Pejës, Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës, Ferizajt dhe Gjilanit, ku janë certifikuar gjithsej 338 zyrtare/zyrtarë policorë, me një vlerë totale prej 10,563.60 euro. Paralelisht, ABGJ në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike ka realizuar 16 trajnime për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit seksual në vendin e punës në nivel qendror dhe lokal, ku janë certifikuar 375 pjesëmarrëse/pjesëmarrës, përfshirë 36 Zyrtare/Zyrtarë për Barazi Gjinore në ministri dhe komuna. Në nivel qendror janë trajnuar dhe certifikuar 112 zyrtare/zyrtarë të nivelit udhëheqës dhe menaxherial në

<sup>46</sup> Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të strategjisë

Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa në nivel lokal trajnimet janë zhvilluar në 11 komuna (Drenas, Viti, Lipjan, Klinë, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenicë, Skenderaj, Istog dhe Prizren), ku janë certifikuar 227 zyrtare/zyrtarë të nivelit udhëheqës dhe menaxherial. Vlera e përgjithshme e këtyre trajnimeve ka qenë 9,054.50 euro.

ANJF përfaqëson një hallkë të rëndësishme në sigurimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, duke garantuar qasje të barabartë në drejtësi, sidomos për gratë dhe grupet e cenueshme. Të dhënat e viteve 2022–2024 tregojnë se gratë përbëjnë shumicën e përfitueseve/përfituesve të ndihmës juridike falas në fushën e dhunës në familje, sidomos në procedurat civile (p.sh. 118 nga 130 përfituese/përfitues në vitin 2023 ishin gra). Përveç rasteve të raportuara, dokumentet vjetore të ANJF theksojnë se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave civile – familjare të trajtuara nga Agjencia lidhen me situata të dhunës së pa raportuar, sidomos në rastet e divorcit, urdhrave të përkohshëm, kujdestarisë dhe ushtrimit të detyrimeve prindërore. Kjo gjetje nxjerr në pah dimensionin e nën-raportimit të fenomenit dhe rëndësinë e shërbimeve juridike si mekanizëm i parë kontakti për shumë gra që nuk kanë kallëzuar dhunën në Polici apo nuk janë adresuar më herët tek mekanizmat mbrojtës.

Shtirirja territoriale e ndihmës juridike falas është forcuar ndjeshëm. Aktualisht Ndihma Juridike Falas ofrohet nga 7 (shtatë) Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas të cilat funksionojnë në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe nga 23 (njëzetë e tre) Zyrave Mobile për Ndihmë Juridike Falas<sup>47</sup> të cilat funksionojnë në komunat: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skënderaj, Kamenicë, Lipjan, Podujevë, Klinë, Shtime, Rahovec, Kaçanik, Viti, Vushtrri dhe Hani i Elezit. Po ashtu, është bërë edhe ri-funksionimi i Zyrës Mobile Lëvizëse të ANJF-së (kombi busit)<sup>48</sup>, përkrahur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), e cila për periudhë 1 vjeçare ka ofruar ndihmë juridike falas aty ku nuk ka zyre Rajonale apo Mobile për Ndihmë Juridike Falas si dhe ka shërbyer për realizimin e fushatave sensibilizuese dhe informuese të qytetarëve.

ANJF pothuajse në tërësi e ka përmbushur nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas me hapjen e 9 (nëntë) Zyrave Mobile në komunat e Kosovës, njëherit për të arritur mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës ANJF ka nënshkruar marrëveshje për partneritet me 8 (tetë) Organizata Joqeveritare të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas, në komunat ku nuk ka zyre ANJF apo në trajtimin e grupeve specifike të synuara (viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, personat e riatdhesuar, azilkërkueset/azilkërkuesit, personat pa shtetësi, komunitetet jo shumicë etj.). Organizatat Joqeveritare që kanë partneritet me ANJF janë:

- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT
- Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD
- Programi për të Drejtat Civile Kosovë - CRP/K
- Social Housing and Property Rights in Kosovo – SHPRK
- Qendra për Ndihmë Ligjore dhe Zhvillim Rajonal – CLARD

<sup>47</sup> Gjashtë nga këto zyre mobile janë mbështetur nga GIZ

<sup>48</sup> Funksionalizuar me mbështetjen e UNDP-së, e cila po ofron ndihmë juridike falas me fokus te veçante për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje aty ku nuk ka zyre Rajonale apo Mobile për Ndihmë Juridike Falas përfshirë dhe në komunat me komunitete jo shumicë. Kjo qasje gjithashtu shërben për realizimin e fushatave sensibilizuese dhe informuese të qytetarëve/qytetarëve me theks te veçante për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës mbi bazë gjnore.

- Advancing Together – AT
- Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)
- Femrat Aktive të Gjakovës – FAGJ

Ky zgjerim ka rritur dukshëm aksesin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në shërbimet juridike falas në zonat rurale dhe komunat me kapacitete të kufizuara, duke ulur barrierat gjeografike dhe ekonomike për qasjen në drejtësi.

Të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për vitin 2023 tregojnë se institucionet shëndetësore kanë ofruar trajtim për 879 raste të dhunës në familje, duke përfshirë ekzaminimet urgjente, trajtimet psikosociale dhe dokumentimin mjeko-ligjor, ndërsa në vitin 2024 numri i rasteve të trajtuara ka arritur në 1,042. Rritja e rasteve të trajtuara pasqyron rritjen e raportimit dhe qasjen më të mirë në shërbime shëndetësore, veçanërisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe spitalet rajonale. MSH thekson se viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit kanë marrë jo vetëm trajtim fizik, por edhe vlerësim psikosocial, mbështetje psikologjike dhe orientim drejt institucioneve të tjera sipas protokolleve të brendshme të përgjigjes. Raportet për vitet 2023 dhe 2024 evidentojnë se spitalet rajonale dhe QKUK funksionojnë si pika kyçe identifikimi, sidomos për rastet e dhunës grave, dhunës seksuale, lëndimeve të rënda dhe rasteve që kërkojnë dokumentim mjeko-ligjor për procedura gjyqësore.

Tabela 13: Numri dhe përqindja e zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara nën objektivin strategjik IV

Viti	Nr. aktiviteteve	Të zbatuara plotësisht	Në proces zbatimi	Të pazbatuara
2022	27	0%	59%	41%
2023	28	25%	49%	25%
2024	29	17.2%	51.7%	6.9%

Burimi: Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë, 2022–2024 (<https://md.rks-gov.net/zkn/>)

Gjatë tre viteve të monitoruara, niveli i zbatimit të OS IV është rritur ndjeshëm: nga mungesë e plotë e aktiviteteve të zbatuara në vitin 2022, në 69 për qind aktivitete të zbatuara plotësisht ose në proces zbatimi në vitin 2024. Ky progres tregon përfundimin e rolit të Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Barazi Gjinore, OJQ-ve të specializuara dhe partnerëve ndërkombëtarë (UN Women, OSBE, UNDP, KiE, EULEX, SIDA, Ambasada Britanike, etj.). Në këtë kuadër, Agjencia për Barazi Gjinore gjatë periudhës 2022–2025 ka mbështetur financiarisht nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e parandalimit dhe trajtimit të dhunës ndaj grave, me një fond total prej 100,000 euro, nga të cilat 32,000 euro janë ndarë për vitin 2025. Megjithatë, shkalla e zbatimit mbetet e varur nga burimet njerëzore dhe financiare jo të barabarta ndërmjet komunave, çka kërkon mbështetje të synuar për të garantuar shërbime me standard të njëjtë në të gjithë territorin.

Megjithatë, progresi nuk është i njëtrajtshëm: pabarazitë territoriale, mungesa e financimit shumëvjeçar, mungesa e një qendre të specializuar për trajtimin e viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës seksuale, si dhe funksionalizimi jo i plotë i linjës telefonike 24/7, vazhdojnë të jenë sfida kyçe.

## Analiza e treguesve të Objektivit Strategjik IV

Tabela 14: Matja e treguesve të objektivit strategjik IV dhe objektivave specifike përkatës

Treguesi në nivel objektivit strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Linjë buxhetore përcaktuar sipas një analize dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës.	Buxheti për strehimoret në 2020: 495,000 EUR	Rritur me 5 %	Buxheti për shërbimet mbështetëse të specializuara është rritur nga 400,000 EUR në vitin 2022 në 692,000 EUR në 2023 dhe në 739,000 EUR në 2024, duke përfaqësuar një rritje prej rreth 84.8% dhe duke tejkaluar ndjeshëm synimin prej +5% për vitin 2024 (me një buxhet kumulativ prej 2,874,000 EUR për periudhën 2022–2025). <sup>49</sup> Ky zhvillim reflekton rritje të angazhimit institucional, megjithëse mbetet nevoja për planifikim financiar afatgjatë dhe qëndrueshmëri të shërbimeve.	Rritur me 10%
Numri i grave që gëzojnë të drejtat pronësore në mënyrë të barabartë si edhe burrat	Çdo 0.62 në 1 grua	Çdo 0.85 në 1 grua	Të dhënat administrative tregojnë se deri në nëntor 2025 <sup>50</sup> gratë përfaqësojnë 20.75% të pronarëve individualë të regjistruar, ndërsa burrat 77.34%. Pavarësisht një rritjeje prej rreth 15% në bashkëpronësi gjatë periudhës 2022–2024, pronësia individuale e grave mbetet dukshëm nën nivelin e synuar për vitin 2024. Këto të dhëna tregojnë progres të kufizuar dhe theksojnë vazhdimësinë e barrierave strukturore në qasjen e grave në të drejtat pronësore.	Çdo 1 në 1 grua
Treguesi në nivel objektivit specifik IV.1.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, të zgjeruara e fuqizuara, ndarë sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10 %	Hartëzimi fillestar nuk është kryer në vitin 2022; për pasojë, treguesi nuk mund të matet për vitin 2024. Vlerësimi i progresit mbetet i hapur dhe kërkon vendosjen e bazës matëse përpara matjes së synimeve të tjera.	Rritur me 30 %
Treguesi në nivel objektivit specifik IV.2.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Numri i viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të ri integruara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 30 %	Nuk ka të dhëna bazë për vitin 2022, pasi hartëzimi fillestar nuk është kryer; si rrjedhojë, treguesi nuk mund të matet për vitin 2024. Vlerësimi i progresit kërkon vendosjen e bazës matëse funksionale gjatë fazës së ardhshme të zbatimit.	Rritur me 50%

Burimi: Të dhënat e mbledhura në kuadër të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare

<sup>49</sup> Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, Divizioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Departamenti i Politikave për Shërbime Sociale dhe Familjare, dërguar në kuadër të përgatitjes së këtij raporti vlerësimi.

<sup>50</sup> Për më shumë shih: <https://akk-statistics.rks-gov.net/>

Analiza e treguesve tregon një diferencë të qartë ndërmjet progresit real në ofrimin e shërbimeve dhe kapacitetit të sistemit për ta matur këtë progres në mënyrë të standardizuar. Ndërsa rritja e financimit dhe zgjerimi i shërbimeve janë të dokumentuara, mungesa e vlerave bazë dhe e mekanizmeve të unifikuar të mbledhjes së të dhënave kufizon vlerësimin e plotë të efektivitetit dhe ndikimit të ndërhyrjeve. Kjo nënvizon nevojën për forcimin e sistemit të monitorimit si një komponent thelbësor i strategjisë së ardhshme.

Të dhënat e paraqitura nxjerrin në pah një progres domethënës në sigurimin e financimit për shërbimet e specializuara në mbështetje të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të të gjitha formave të dhunës. Rritja e buxhetit nga 400,000 EUR në vitin 2022 në 739,000 EUR në vitin 2024 përfaqëson një zgjerim prej 84.8 për qind, duke tejkaluar ndjeshëm synimin prej 5 për qind për vitin 2024 dhe duke reflektuar një angazhim në rritje të institucioneve qendrore për forcimin e rrjetit të strehimoreve dhe shërbimeve psiko-sociale, juridike dhe të riintegritit. Megjithatë, struktura aktuale e financimit mbetet afatshkurtër dhe ka nevojë për planifikimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve.

Treguesi i pronësisë së grave tregon progres modest dhe të pabarabartë. Pavarësisht rritjes së bashkëpronësisë me rreth 15 për qind gjatë periudhës 2022–2024, pronësia individuale e grave (0.21 në 1 grua) mbetet dukshëm nën synimin e vitit 2024 (0.85 në 1 grua). Këto të dhëna nënvizojnë se gratë vijnë të përballen me barriera strukturore të theksuara në qasjen e tyre në të drejtat pronësore, çka kufizon mundësitë e tyre për pavarësi ekonomike dhe riintegrim afatgjatë.

Dy treguesit të cilët kërkonin matje me bazë vlerash të vitit 2022, numri i shërbimeve të specializuara sipas grupit të synuar (OS IV.1) dhe numri i viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të riintegruar (OS IV.2), nuk mund të vlerësohen për periudhën 2024. Në lidhje me treguesin për OS IV.1, për shkak të mungesës së një hartëzimi fillestar të shërbimeve në vitin 2022, nuk është vendosur një vlerë bazë e matshme, çka e bën të pamundur vlerësimin e progresit për vitin 2024. Ky kufizim tregon një boshllëk konceptual dhe metodologjik në hartimin e treguesit, i cili duhet adresuar në strategjinë e ardhshme përmes krijimit të një sistemi të standardizuar të klasifikimit dhe raportimit të shërbimeve. Ndërsa në lidhje me treguesin për OS IV.2, mungesa e një vlere bazë dhe e një sistemi të unifikuar për identifikimin dhe ndjekjen e përfitueseve/përfituesve të programeve të riintegritit e bën treguesin të pamatshëm për vitin 2024. Ky kufizim reflekton nevojën për zhvillimin e një mekanizmi institucional për monitorimin e riintegritit, si parakusht për vlerësimin e efektivitetit të këtij objektivit në fazën e ardhshme strategjike.

Gjatë vitit 2025, shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/të mbijetuarit janë ofruar përmes një sistemi të kombinuar institucional dhe komunitar, ku rol kyç kanë luajtur Qendrat për Punë Sociale, ofruesit e licencuar të shërbimeve dhe mekanizmat lokalë koordinues. Shërbimet kanë përfshirë mbështetje psiko-sociale, asistencë juridike, strehim emergjent dhe masa të riintegritit, duke reflektuar një qasje gjithnjë e më të integruar në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Megjithatë, të dhënat e vitit 2025 konfirmojnë vijimin e pabarazive territoriale në aksesin në shërbime, veçanërisht në zonat rurale.

Në nivelin e shërbimeve, UN Women ka luajtur rol kyç në rritjen e qasjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në shërbime të përgjithshme dhe të specializuara përmes

financimit të OSHC-ve ofruese të këshillimit psikosocial, ndihmës juridike, riintegrimin dhe ndërmjetësimin me institucionet. Përmes programeve të saj, është rritur kapaciteti profesional i ofruesve të shërbimeve dhe është përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet MKL-ve, qendrave sociale, policisë dhe shërbimeve të strehimit. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e përgjigjes ndaj rasteve dhe në qasjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në mbështetje të integruar.

UNICEF ka mbështetur zhvillimin e mekanizmave të referimit të orientuar drejt fëmijës dhe ka ofruar shërbime psikosociale direkte për fëmijët viktimat/të mbijetuar të dhunës, duke përfshirë fëmijët në situatë rruge dhe ata në rrezik të lartë. Mbështetja ka përfshirë gjithashtu zhvillimin e udhëzuesve kombëtarë për sigurinë në internet për moshat 0–5 dhe 10–12 vjeç, si dhe standardet strukturore dhe SOP-të për Shtëpitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, duke vendosur bazat për shërbime miqësore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët.

Përmes projekteve të mbështetjes socio-ekonomike dhe psikologjike për të mbijetuarat, UNMIK ka kontribuar në zgjerimin e shërbimeve të trajtimit dhe riintegrimin, duke mbështetur ofrimin e trajnimeve profesionale, shkathtësive të jetës, këshillimit psikosocial dhe mikro-granteve për gra nga komunitetet e marginalizuara. Këto ndërhyrje kanë ndikuar pozitivisht në rikthimin e pavarësisë ekonomike dhe sociale të të mbijetuarave.

UNFPA ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës, duke mbështetur trajnimin e stafit mjekësor, forcimin e mekanizmave të referimit dhe zhvillimin e protokolleve të standardizuara për kujdesin në nivel të kujdesit parësor. Auditimet klinike në Prishtinë dhe Ferizaj kanë identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe kanë ofruar rekomandime konkrete për menaxhimin e rasteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

EULEX ka mbështetur zhvillimin e dhomave të intervistimit të orientuara drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit, duke avancuar standardet e mbrojtjes së tyre në procedurat policore dhe prokuroriale. Këto ndërhyrje e bëjnë procesin më të sigurt, më dinjitoz dhe më të ndjeshëm ndaj traumës së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, duke kontribuar në rritjen e besimit në institucionet e drejtësisë.

Kontributi i Këshillit të Evropës në fushën e shërbimeve përfshin mbështetjen për zhvillimin e programeve psiko-sociale dhe edukative për trajtimin e kryerësve të dhunës, përmes hartimit të standardeve, moduleve të trajnimit dhe procedurave përkatëse për zbatimin e tyre. Në këtë kuadër, Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e KiE, ka zhvilluar dhe miratuar “Programin Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave”, i cili është pilotuar fillimisht në Qendrën Korrektuese të Dubravës dhe përfaqëson një qasje të re të orientuar drejt reduktimit të rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe parandalimit afatgjatë të saj përmes ndërhyrjeve të strukturuar psiko-sociale.

BE ka kontribuar indirekt në zgjerimin e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara përmes financimit të OSHC-ve dhe programeve me UN Women, duke përfshirë shërbime psikosociale, asistencë për gratë viktimat/të mbijetuarat me fëmijë me aftësi të kufizuara, ndërhyrje komunitare dhe aktivitete në shkolla. Këto programe kanë rritur qasjen në shërbime dhe kanë përforcuar mekanizmat lokalë të referimit.

OSBE ka kontribuar në përmirësimin e shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, veçanërisht përmes krijimit dhe standardizimit të dhomave të intervistimit si dhe mbështetjes për rritjen e kapaciteteve të strehimoreve në përputhje me standardet e KiE. Punësimi me komunitete vulnerabile – gra të kthyer, gra të komuniteteve jo-shumicë dhe gra me aftësi të kufizuar – ka shtuar qasjen e barabartë në shërbime.

Në tërësi, Objektivi Strategjik IV ka shënuar përparim të dukshëm në rritjen e investimeve dhe forcimin e rrjetit të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, por vërehen kufizimet strukturore në matjen e rezultateve mbi cilësinë, shtrirjen dhe efektivitetin e programeve të riintegrit. Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave, standardizimi i treguesve dhe zbatimi i mekanizmave shumëvjeçarë të financimit mbeten prioritete kyçe për periudhën e ardhshme të zbatimit dhe për Strategjinë e re 2027–2030/2032.

Kontributi i partnerëve ndërkombëtarë është reflektuar veçanërisht në zgjerimin e programeve të specializuara dhe forcimin e mekanizmave të referimit, duke mbështetur institucionet vendore në zbatimin e standardeve të Konventës së Stambollit.

### **Rezultatet sipas objektivave specifike (OS)**

**OS IV.1: Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat / mbijetuarit nga të gjithë grupet, si dhe fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë të dhunës.** Është shënuar progres të dukshëm në periudhën 2022–2024, duke reflektuar rritje të investimeve publike dhe partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Për vitin 2022, shumica e aktiviteteve mbetën në fazë përgatitore për shkak të mungesës së hartëzimit fillestar të shërbimeve dhe mungesës së një baze të qartë të të dhënave. Gjatë vitit 2023, niveli i zbatimit u rrit ndjeshëm, me konsolidim të bashkëpunimit me OJQ-të ofruese të strehimit emergjent dhe afatgjatë, mbështetjes psiko-sociale, këshillimit juridik dhe shërbimeve për fëmijët dëshmitarë të dhunës.

Gjetjet e Këshillit të Evropës (2022), Komisionit Evropian (2024) dhe GLPS (2023–2024) konfirmojnë se shërbimet e specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit mbeten të pabarabarta ndërmjet komunave, sidomos në zonat rurale dhe ato me kapacitete të kufizuara sociale. Financimi i strehimoreve ka bërë përparim të ndjeshëm në vitet e fundit, por qëndrueshmëria buxhetore mbetet sfidë kritike, me varësi të lartë nga fondet suplementare dhe mungesë programesh afatgjata të riintegrit ekonomik dhe social.

Viti 2024 shënoi përparimin më të madh për OS IV.1, duke arritur zbatueshmëri të lartë me 79.1 për qind të aktiviteteve të përfunduara ose në proces zbatimi. Kjo lidhet me rritjen e ndjeshme të financimit: 1.533.000 € u dedikuan për OJQ-të që ofrojnë shërbime të specializuara, përfshirë 739.000 € për strehimoret, të cilat mbulojnë të gjithë territorin e Kosovës. Përveç kësaj, është zgjeruar mbështetja për gratë dhe vajzat nga komunitetet RAE, gratë me aftësi të kufizuara dhe nënat vetushqyese, përmes programeve të dedikuara për përfshirje ekonomike dhe fuqizim socio-ekonomik.

Megjithatë, objektivi mbetet i cenuar nga boshllëqet në ofrimin e shërbimeve për kategori të tjera të ndjeshme, përfshirë burrat viktimë/të mbijetuar, personat LGBTI+ dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës, si dhe nga mungesa e standardeve të detyrueshme për matjen e cilësisë së shërbimeve. Mungesa e hartëzimit të shërbimeve në vitin 2022 e ka bërë të pamundur vlerësimin e saktë të progresit në raport me synimin e vitit 2024. Në përgjithësi, OS IV.1 vlerësohet të jetë në nivel të mirë, me progres të qartë në financim dhe shtrirje, por me nevojë për përmirësim në cilësi, standardizim dhe mbulim të barabartë territorial. Mungesa e hartëzimit fillestar në vitin 2022 përbën një kufizim metodologjik që ka ndikuar në vlerësimin e saktë dhe të krahasueshëm të progresit.

**OS IV.2: Zbatimi i politikave që mundësojnë riintegrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave/mbijetarve të dhunës.** Ky objektivi ka pasur një ritëm më të ngadaltë zbatimi gjatë periudhës 2022–2024, për shkak të sfidave strukturore dhe mungesës së hartëzimit të programeve të riintegrit. Në vitin 2022, vetëm 59 për qind e aktiviteteve ishin në fazë zbatimi dhe nuk ka pasur aktivitete të përfunduara plotësisht, kryesisht për shkak të mungesës së standardeve të unifikuara dhe strukturave të përcaktuara të shërbimeve, duke reflektuar kapacitete të kufizuara në nivel lokal dhe mungesën e standardeve të unifikuara për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme.

Gjatë vitit 2023, progresi mbeti modest, por u shënuan zhvillime të rëndësishme: u caktuan koordinatorë/koordinatore lokalë dhe gjyqtarë/gjyqtarë të specializuar për rastet e dhunës; u zhvilluan 24 module trajnuese të akredituara për profesionistët/profesionistët në sistemin e drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale; dhe u forcua profili i Zyrrave për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Këto ndërhyrje rritën profesionalizimin dhe qartësuan zinxhirin institucional të mbrojtjes.

Në vitin 2024, OS IV.2 shënoi rritje të konsiderueshme të nivelit të zbatueshmërisë, me 50 për qind të aktiviteteve të përfunduara ose në proces. Progresi lidhet, ndër të tjera, me përfshirjen e 20 komunave që miratuan plane trevjeçare për banim social, 19 komuna që subvencionuan çerdhe për fëmijët e viktimave/të mbijetuarave dhe zgjerimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, përfshirë zyrat mobile që ofrojnë mbështetje për zonat rurale dhe komunitetet jo-shumicë. Megjithatë, treguesi kryesor — numri i viktimave/të mbijetuarave/mbijetarve të riintegruar — nuk mund të matet, pasi nuk ekziston një vlerë bazë, një mekanizëm i unifikuar raportimi dhe as një sistem shtetëror i identifikimit dhe ndjekjes së programeve të riintegrit. Sfida mbeten gjithashtu në sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime, funksionalizimin e linjës kombëtare të ndihmës, e cila aktualisht nuk funksionon në regjim 24/7, në kundërshtim me nenin 24 të Konventës së Stambollit, si dhe ofrimin e shërbimeve të dedikuara për kategori të cenuara, përfshirë burrat viktimë/të mbijetuar dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës. Në përgjithësi, OS IV.2 vlerësohet si pjesërisht i arritur, me progres të dukshëm në ngritjen e strukturave dhe rritjen e qasjes në shërbime, por me nevojë urgjente për një sistem të standardizuar të matjes së riintegrit, për zbatimin e protokolleve të unifikuara dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe komunal.

**Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik IV sipas kriterëve të OECD-DAC**

Tabela 15: Vlerësimi sipas kriterëve të OECD-DAC për Objektivin Strategjik IV

KRITERI	OECD-DAC	VLERËSIMI	ARSYETIMI I BAZUAR NË TË DHËNA
Relevanca		<b>Shumë e lartë</b>	Objektivi është plotësisht në linjë me Konventën e Stambollit. Amendamentet ligjore, rishikimi i politikave dhe forcimi i mekanizmave ndërinstitucionalë adresojnë drejtpërdrejt nevojat kritike të identifikuara nga institucionet dhe OJQ-të. Edhe pse politika është në linjë me standardet e Konventës së Stambollit, mungesa e një qendre të koordinuar për dhunën seksuale e ul koherencën ndërmjet legjislacionit dhe zbatimit praktik, duke krijuar boshllëk në zinxhirin e reagimit institucional. Këto gjetje lidhen drejtpërdrejt edhe me kriterin e koherencës, duke reflektuar nevojën për harmonizim më të mirë ndërmjet standardeve dhe praktikës së zbatimit.
Efektiviteti		<b>Mesatar–i mirë</b>	Progres i rëndësishëm në harmonizimin ligjor dhe ngritjen e strukturave koordinuese (p.sh., profilizimi i gjyqtareve/gjyqtarëve dhe prokurorëve/prokurorëve, komisionet ndërsektoriale). Megjithatë, disa masa të planifikuara për vitet 2022–2024, përfshirë standardizimin e protokolleve, nuk janë zbatuar plotësisht. Shkalla e zbatueshmërisë së aktiviteteve ka arritur rreth 60–70% në 2023–2024.
Efikasiteti		<b>Mesatar</b>	Mbështetja financiare është rritur, por zbatimi është ngadalësuar nga varësia ndaj projekteve dhe mungesa e burimeve të përhershme në disa institucione. Përmirësimet në menaxhimin buxhetor të MD, ABGJ dhe Policisë kanë rritur efikasitetin, por mungesa e burimeve të barabarta në komuna ka krijuar pabarazi të zbatimit.
Koherenca		<b>E lartë</b>	Objektivi është i integruar mirë me politikat kombëtare për barazi gjinore, drejtësi dhe qeverisje lokale. Ka koherencë të qëndrueshme me programet e partnerëve ndërkombëtarë (UN Women, OSBE, UNDP, KiE, EULEX, etj.). Sfida kryesore mbetet koordinimi i jo i barabartë ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.
Ndikimi		<b>Pozitiv, por i pjesshëm</b>	Ndryshimet ligjore dhe institucionale kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e reagimit institucional ndaj dhunës, rritjen e raportimit dhe forcimin e masave mbrojtëse. Ndikimi është pozitiv, por i pjesshëm, për shkak të mungesës së treguesve të matshëm për cilësinë dhe rezultatet afatgjata të shërbimeve, veçanërisht në fushën e riintegritimit.
Qëndrueshmëria		<b>Mesatare</b>	Disa reforma janë të integruara në praktikën e institucioneve (p.sh., specializimi në drejtësi, komisionet koordinuese), por qëndrueshmëria mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së mekanizmave të financimit shumëvjeçar dhe varësisë së vazhdueshme nga projektet

e donatorëve. Nevojitet institucionalizim i plotë i koordinimit dhe harmonizimit të protokolleve.

*Burimi: Vlerësimi bazohet në të dhënat e paraqitura në seksionet e mësipërme, duke përfshirë treguesit, raportet vjetore të zbatimit dhe të dhënat administrative të institucioneve përgjegjëse*

Vlerësimi i zbatimit të Objektivit Strategjik IV sipas kriterëve OECD-DAC tregon se kuadri ligjor dhe politik është në përputhje të lartë me acquis të BE-së dhe Konventën e Stambollit, duke reflektuar progres të qëndrueshëm në kriminalizimin e formave të dhunës, forcimin e dispozitave procedurale dhe rritjen e mekanizmave institucionale për mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve, disa boshllëqe strukturore ndikojnë në efektivitetin dhe ndikimin e pritshëm të objektivit, veçanërisht në trajtimin e dhunës seksuale.

Mungesa e një Qendre të specializuar për Menaxhimin e Krizës së Dhunës Seksuale, siç kërkohet nga nenet 25 dhe 26 të Konventës së Stambollit, mbetet një pengesë kyçe që kufizon harmonizimin praktik me standardet ndërkombëtare. Kjo mungesë ndikon në efektivitetin e sistemit të përgjigjes së menjëhershme dhe e bën reagimin ndërinstitucional më të fragmentuar. Si rezultat, ndikimi afatgjatë i reformave ligjore dhe procedurale mbetet i pjesshëm. Nga perspektiva e koherencës, dokumentet strategjike dhe legjislativi janë të harmonizuar në letër, por mungesa e kësaj qendre të specializuar krijon një hendek mes objektivave të deklaruara dhe zbatimit praktik, sidomos për rastet e dhunës seksuale që kërkojnë qasje të integruar mjekësore, psiko-sociale dhe juridike.

Në terma të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë, objektivi tregon progres të mirë, por mbetet i varur nga kapacitetet jo të barabarta ndërmjet komunave dhe nga burimet financiare të projekteve. Kjo shton nevojën për një qasje të standardizuar, të financuar në mënyrë të qëndrueshme dhe për plotësimin e boshllëqeve të identifikuara, përfshirë funksionalizimin e një shërbimi të dedikuar për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale. Në tërësi, Objektivi Strategjik IV vlerësohet pozitivisht për harmonizim dhe reformë ligjore, por ndikimi dhe efektiviteti i tij mbeten të pjesshëm pa garantuar një sistem të plotë dhe të integruar të shërbimeve, në përputhje të plotë me Konventën e Stambollit.

### **Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik IV**

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të adresojnë boshllëqet strukturore të evidentuara gjatë periudhës 2022–2024 dhe të rrisin efikasitetin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës. Ato janë të ndara sipas dy periudhave të zbatimit, për të siguruar vazhdimësi ndërmjet përmbylljes së Strategjisë aktuale (2026) dhe hartimit të Strategjisë së re 2027–2030/2032.

*Tabela 16: Rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të Objektivit Strategjik IV sipas periudhës së zbatimit*

<b>2026 (FAZA PËRMBYLLËSE E STRATEGJISË AKTUALE)</b>	<b>2027–2030 /2032 (STRATEGJIA E RE)</b>
Vendosja e bazës së të dhënave për shërbimet e specializuara dhe programet e riintegrit, duke kryer hartëzimin kombëtar sipas nenit 22 dhe 23 të Konventës së Stambollit.	Krijimi i një sistemi të përhershëm, gjithëpërfshirës dhe funksional të të dhënave, me klasifikim të unifikuar të shërbimeve dhe treguesve të riintegrit mbi bazë gjinore, moshore, etnike, etj.

Standardizimi i protokolleve të shërbimeve të specializuara, përfshirë vlerësimin e rrezikut, referimin e rasteve, planin individual të sigurisë dhe ndjekjen e rasteve.	Miratimi i standardeve kombëtare të cilësisë së shërbimeve, me tregues performance për strehimoret, këshillimin psiko-social, mbështetjen juridike dhe programet e trajtimit.
Funksionalizimi i linjës kombëtare të ndihmës në regjim 24/7, në përputhje me nenin 24 të Konventës së Stambollit.	Krijimi i mekanizmave të integruar për reagim të menjëhershëm, që lidhin Policinë e Kosovës, ZMNV, QPS, strehimoret dhe shërbimet mjeko-ligjore në një zinxhir të vetëm operativ.
Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, përmes udhëzuesve praktikë dhe trajnimeve të detyrueshme për zbatimin e tyre.	Institucionalizimi i rrjeteve lokale të mbrojtjes, me mandat të qartë për koordinim, monitorim, buxhetim dhe raportim.
Rritja e kapaciteteve të strehimoreve dhe OJQ-ve të specializuara, veçanërisht në komunat me mbulim të ulët.	Krijimi i një modeli të financimit shumëvjeçar dhe të qëndrueshëm, për të garantuar ofrimin e shërbimeve, sidomos riintegruese, pa ndërprerje dhe me standard të njëjtë në të gjitha komunat.
Zhvillimi i programeve të strukturuar të riintegritimit socio-ekonomik, duke përfshirë punësim të asistuar, trajnime profesionale, subvencionim të çerdheve dhe mbështetje për banim social.	Institucionalizimi i programeve të riintegritimit, përmes mekanizmave të koordinimit ndërmjet MD, MAPL dhe komunave, me buxhet të dedikuar dhe raportim vjetor.
Fuqizimi i Zyrave për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) për të rritur mbështetjen në procedurat gjyqësore dhe garantimi i qasjes së barabartë në ndihmë juridike falas.	Forcimi i mekanizmave të drejtësisë së ndjeshme gjinore, duke integruar këshillim psiko-social, përfaqësim juridik dhe ndjekje të rasteve të dhunës seksuale dhe të dhunës në familje.
Rritja e shërbimeve për grupet në situatë të cenueshme, veçanërisht burrat viktimat/të mbijetuar, personat LGBTI+ dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës.	Krijimi i shërbimeve të dedikuara për grupet në situatë të cenueshme, duke përfshirë qendra të specializuara për fëmijët dëshmitarë të dhunës dhe qasje të personalizuar për grupet etnike minoritare.
Përgatitja e kuadrit të plotë për hapjen e Qendrës së specializuar për Menaxhimin e Krizës së Dhunës Seksuale, në përputhje me Konventën e Stambollit.	Funksionalizimi i Qendrës së specializuar për Menaxhimin e Krizës së Dhunës Seksuale si strukturë qendrore dhe referuese për reagimin e integruar ndaj dhunës seksuale.
Zvogëlimi i varësisë nga projektet dhe vendosja e planit financiar afatmesëm për shërbimet e specializuara.	Buxhetim i bazuar në kosto reale dhe planifikim afatgjatë, duke përfshirë fonde të garantuara për strehimoret, ZMNV, shërbimet psiko-sociale dhe programet e riintegritimit.

*Burimi: Përpunim i të dhënave nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe analiza e vlerësimit afatmesëm (2022–2024).*

### 4.3. VLERËSIMI I SISTEMIT TË TREGUESVE DHE I PERFORMANCËS SË TYRE (2022–2025)

Analiza e treguesve strategjike dhe specifike është bazuar kryesisht në të dhënat e raportuara për periudhën 2022–2024, për të cilat disponohen seri të plota raportimi institucional. Për qëllime të këtij vlerësimi janë përdorur gjithashtu edhe të dhënat administrative për vitin 2025, të cilat ofrojnë një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit në zbatimin e Strategjisë. Megjithëse në disa raste raportimi për vitin 2025 është ende në proces konsolidimi, këto të dhëna kontribuojnë në plotësimin e analizës së progresit dhe në identifikimin e tendencave të fundit institucionale.

Analiza e sistemit të treguesve të Strategjisë tregon se dimensionin e monitorimit dhe matjes së rezultateve përbën një nga sfidat kryesore metodologjike të vlerësimin. Për një numër të konsiderueshëm treguesish, të dhënat nuk kanë qenë të disponueshme në mënyrë të plotë gjatë periudhës së analizuar, çka ka kufizuar mundësinë e matjes së progresit në nivel rezultati dhe ndikimi. Në disa raste, vlerat bazë nuk janë përcaktuar në fillim të periudhës së zbatimit, ndërsa në raste të tjera mungojnë mekanizmat institucionalë për mbledhjen sistematike të të dhënave përkatëse. Kjo situatë ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mundësinë për të vlerësuar në mënyrë të plotë arritjen e disa objektivave strategjike.

Mungesa e matjes për një pjesë të treguesve nuk duhet interpretuar automatikisht si mungesë e progresit ose moszbatim i aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse. Në shumë raste, kjo lidhet me mungesën e vlerave bazë në fillim të periudhës së zbatimit, mungesën e studimeve kombëtare të përsëritshme, mungesën e metodologjive të standardizuara të raportimit ndërinstitutional, si dhe me faktin që disa tregues janë ndërtuar në mënyrë më të gjerë sesa kapaciteti real i sistemit ekzistues të monitorimit. Për këtë arsye, analiza e treguesve duhet të lexohet jo vetëm si vlerësim i performancës së Strategjisë, por edhe si vlerësim i cilësisë së vetë arkitekturës së monitorimit.

Këto sfida lidhen kryesisht me fazën fillestare të ndërtimit të sistemit të monitorimit të Strategjisë dhe me zhvillimin gradual të mekanizmave institucionalë të mbledhjes dhe harmonizimit të të dhënave ndërinstitutionale, të cilat në shumë raste kërkojnë kohë për t'u konsoliduar plotësisht.

Në këtë kontekst, analiza e treguesve merr një rëndësi të veçantë për fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026), pasi ajo jo vetëm që evidenton kufizimet e sistemit aktual të monitorimit, por edhe orienton drejtpërdrejt prioritetet për konsolidimin e tij dhe për ndërtimin e një kornize më funksionale dhe të matshme për strategjinë e ardhshme.

Për qëllime të këtij vlerësimi, treguesit janë analizuar në tri kategori metodologjike.

1. Kategoria e parë përfshin tregues që janë konceptualisht të vlefshëm, relevantë dhe të nevojshëm për monitorimin e rezultateve të Strategjisë, por që nuk janë matur gjatë periudhës së vlerësimin për shkak të mungesës së baseline-it, mungesës së studimeve periodike ose mosfunksionimit të plotë të mekanizmave institucionalë të mbledhjes së të dhënave.

2. Kategoria e dytë përfshin tregues që ruajnë relevancën e tyre politike dhe programore, por që në formën aktuale kërkojnë riformulim për t'u bërë më të qartë, më operacionale dhe më të matshëm.
3. Kategoria e tretë përfshin tregues që janë konceptuar në mënyrë tepër të gjerë ose që nuk lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e matshme të Strategjisë, dhe që për këtë arsye nuk rekomandohet të mbeten në të njëjtën formë në strategjinë e re.

Ky klasifikim nuk ka vetëm vlerë analitike për vlerësimin aktual, por shërben edhe si bazë për rishikimin e arkitekturës së treguesve në strategjinë e re. Në veçanti, ai ndihmon në dallimin ndërmjet treguesve që duhet të ruhen dhe të mbështeten me mekanizma më të fortë matjeje, atyre që kërkojnë riformulim për t'u bërë më operacionale, dhe atyre që duhet të zëvendësohen me tregues më të drejtpërdrejtë dhe të matshëm.

Ky seksion paraqet analizën e treguesve në nivel të objektivave strategjike dhe specifike, duke vlerësuar matshmërinë, qartësinë konceptuale, disponueshmërinë e të dhënave dhe përdorshmërinë e tyre për monitorim dhe vendimmarrje. Analiza sintetizon performancën e treguesve gjatë periudhës 2022–2025 dhe identifikon nevojat për rishikim dhe harmonizim me standardet e Bashkimit Evropian, Konventës së Stambollit dhe kornizave të Kombeve të Bashkuara.

Në përputhje me kriteret e OECD-DAC, vlerësimi i treguesve është ndërtuar mbi pesë parime udhëheqëse:

- (i) relevanca e treguesit në raport me objektivin,
- (ii) matshmëria dhe vlefshmëria,
- (iii) cilësia e burimeve të të dhënave,
- (iv) përdorshmëria për politikë-bërjen, dhe
- (v) besueshmëria ndërinstucionale.

Ky seksion shërben edhe si bazë për rekomandimet teknike për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe matjes së Strategjisë në periudhën e mbetur (viti 2026), si dhe për hartimin e planifikimit të Strategjisë së re pas vitit 2026.

Për disa tregues, si p.sh. “Numri i viktimave/të mbijetuarave të dhunës të riintegruara përmes programeve” apo “Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës të zgjeruara dhe të fuqizuara sipas llojit të shërbimit dhe grupit të synuar”, analiza eidenton se mungesa e të dhënave nuk lidhet domosdoshmërisht me mungesën e relevancës së treguesit, por me mungesën e mekanizmave të standardizuar të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave. Siç eidentohet edhe në analizën e Objektivit Strategjik IV, mungesa e hartëzimit fillestar të shërbimeve dhe e një sistemi të unifikuar për ndjekjen e përfitueseve/përfituesve të programeve të riintegritimit ka kufizuar ndjeshëm matjen e progresit për këta tregues gjatë periudhës 2022–2025. Në këto raste, rekomandimi për strategjinë e ardhshme nuk kufizohet vetëm në riformulimin e treguesit, por kërkon gjithashtu zhvillimin e sistemeve institucionale për mbledhjen dhe integrimin e të dhënave administrative nga institucionet përgjegjëse

Gjithashtu, analiza e treguesve eidenton se disa tregues të përdorur në Strategjinë aktuale janë konceptuar në mënyrë shumë të gjerë ose nuk lidhen drejtpërdrejt me mekanizmat e monitorimit të strategjisë. Tregues të tillë si “Numri i grave që gëzojnë të drejtat pronësore në

mënyrë të barabartë me burrat” apo “Numri i grave që kanë qasje në drejtësi” kërkojnë riformulim të plotë metodologjik, pasi në formën aktuale nuk janë të matshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë brenda sistemit të monitorimit të Strategjisë dhe mbështeten në burime statistikore që tejkalojnë kapacitetin operacional të raportimit institucional vjetor. Në këtë drejtim, strategjia e ardhshme duhet të fokusohet në tregues më të drejtpërdrejtë dhe operacionalë, të lidhur me ndërhyrjet konkrete të politikës publike.

Nga këndvështrimi metodologjik, disa tregues nuk rekomandohet të mbeten në strategjinë e re në formën aktuale, jo për shkak se tema që adresojnë është e parëndësishme, por sepse formulimi i tyre është tepër i gjerë, ndërsektorial ose i shkëputur nga mekanizmat konkretë të monitorimit të Strategjisë. Tregues të tillë, si ai mbi gëzimin e të drejtave pronësore në mënyrë të barabartë me burrat ose ai mbi qasjen e grave në drejtësi, reflektojnë objektiva shumë më të gjera zhvillimore dhe kërkojnë burime statistikore, dizajne metodologjike dhe sisteme matjeje që tejkalojnë kapacitetin operacional të monitorimit vjetor apo afatmesëm të Strategjisë. Për këtë arsye, në strategjinë e ardhshme këto fusha duhet të pasqyrohen përmes treguesve më të drejtpërdrejtë, më operacionalë dhe të lidhur qartë me ndërhyrjet konkrete të politikës publike.

Treguesit që matin ndryshimin e normave sociale, perceptimin e sigurisë së grave, fatalitetet e lidhura me dhunën në familje, riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe funksionimin e shërbimeve të specializuara duhet, në parim, të mbeten pjesë e kornizës së ardhshme strategjike. Arsyeja është se këta tregues lidhen drejtpërdrejt me rezultatet thelbësore që Strategjia synon të ndikojë: parandalimin, mbrojtjen, qasjen në shërbime, sigurinë dhe efektivitetin institucional. Në rastet kur këta tregues nuk janë matur plotësisht gjatë periudhës 2022–2025, problemi lidhet më shumë me mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm të matjes sesa me mungesën e relevancës së tyre substantiale. Në këtë kuadër, ruajtja e këtyre treguesve në strategjinë e ardhshme duhet të shoqërohet me zhvillimin e burimeve të qëndrueshme të të dhënave dhe me përcaktimin e qartë të përgjegjësisë institucionale për matjen dhe raportimin e tyre.

TREGUESI	STATUSI I MATJES (2022–2024)	ANALIZA PROFESIONALE	PSE DUHET TË MBETET NË STRATEGJINË AKTUALE? (ARGUMENTIMI TEKNIK)	SI DUHET PËRMIRËSUAR PËR STRATEGJINË E RE 2027–2030/2032 (FORMULIM KONKRET)	BURIMI I TË DHËNAVE
<b>Përqindja e grave, burrave, vajzave dhe djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme.</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues kyç për matjen e normave sociale; mat efektin e fushatave dhe programeve edukative. Mungesa e matjes lidhet me infrastrukturën e të dhënave, jo	Tregues i domosdoshëm për parandalimin, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe EU GAP III.	Përqindja e vajzave, djemve, burrave që shprehin intolerancë ndaj dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, e matur periodikisht dhe e ndarë sipas	ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) – Studimi Kombëtar i Normave Sociale (anketë periodike çdo 2–3

		me cilësinë e treguesit.		gjinisë dhe grupmoshës.  Baza e matjes: Studimi Kombëtar i Normave Sociale, (anketë çdo 2–3 vjet nga ASK)	vjet), në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë
<b>Indeksi i Sigurisë së Grave</b>	Matet me trend të qartë	Tregues ndërkombëtar i standardizuar; ofron krahasueshmëri rajonale dhe monitorim të ndikimit të politikave të sigurisë.	Jep evidencë të qëndrueshme për perceptimin e sigurisë nga gratë; kërkohet nga mekanizmat ndërkombëtarë të barazisë gjinore.	Indeksi i Sigurisë së Grave, i matur çdo vit në nivel kombëtar dhe komunal.  Baza e matjes: Anketa e Perceptimit të Sigurisë, ASK + Ministria e Brendshme	ASK + Ministria e Punëve të Brendshme – Anketa e Perceptimit të Sigurisë (nivel kombëtar dhe komunal)
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet</b>	Matet rregullisht	Tregues i drejtpërdrejtë i efektivitetit institucional në mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve; trendi ulës është domethënës.	Tregues kritik i Konventës së Stambollit. Monitorohet nga të gjithë donatorët.	Numri i fataliteteve nga dhuna në familje dhe norma për 100,000 banorë/banore  Baza e matjes: Regjistri i Policisë; ASK – llogaritja e normës	Policia e Kosovës (regjistri administrativ) + ASK (përlllogaritja e normës për 100,000 banorë/banore)
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/ raportuara nga pala e tretë</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues i besimit të komunitetit dhe i funksionimit të mekanizmave lokalë. Vështirësia lidhet me mungesën e protokolleve të unifikuara të mbledhjes së të dhënave.	I rëndësishëm për matjen e aktivizimit të komunitetit dhe reagimit të hershëm.	Përqindja e rasteve të dhunës në familje të raportuara nga palë të treta ndaj totalit të rasteve të raportuara, e ndarë sipas burimit të raportimit (familjarë, komunitet, institucione) dhe trendi vjetor i raportimit.  Baza e matjes: Regjistri i Policisë – shtesë në	Policia e Kosovës – sistemi i raportimit të rasteve (me përditësim të formularëve për identifikimin e burimit të raportimit)

				formularët e raportimit	
<b>Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Treguesi 5.2.2 i OZHQ)</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues i OZHQ me rëndësi të lartë; mat përvojën e viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës seksuale jashtë partneritetit intim.	Detyrim ndërkombëtar; tregues themelor për krahasim me BE dhe rajonin.	Përqindja e grave dhe vajzave 15–49 vjeç që raportojnë dhunë seksuale nga një person që nuk është partner intim, në 12 muajt e fundit.  Baza e matjes: Anketa DHNGV / ASK	ASK – Anketa Kombëtar e për Dhunën ndaj Grave, e realizuar periodikisht
<b>Numri i sesioneve informuese të zhvilluara për stafin e institucioneve të arsimit parauniversitar mbi shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës.</b>	Matet me progres	Tregues operacional që mat inpute (numër aktivitetesh), por nuk reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë ndryshimin në njohuri, qëndrime apo praktika.	I rëndësishëm për sistemin arsimor dhe për zbatimin e politikave të parandalimit.	Përqindja e shkollave që zbatojnë programe për parandalimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore dhe përqindja e nxënësve/nxënëve që demonstron njohuri të rritura pas ndërhyrjeve edukative, të matur përmes vlerësimeve para dhe pas ndërhyrjes.  Baza e matjes: Ministria e Arsimit + raportet vjetore të shkollave	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – raportet administrative të shkollave + sistemi EMIS
<b>Numri i institucioneve mediatike dhe bizneseve private që mbështeten të miratojnë udhëzime, standarde vetërregulluese e protokolle për të parandaluar</b>	Matet pjesërisht	Tregues transformues që lidhet me rolin e mediave dhe sektorit privat në parandalim.	Mbështet zbatimin e protokolleve kundër ngacmimit dhe standardeve të etikës profesionale.	Numri dhe përqindja e mediave dhe bizneseve private që zbatojnë protokolle të miratuara kundër dhunës dhe ngacmimit seksual, si dhe shkalla e	Raportim vullnetar i mediave dhe bizneseve + monitorimi nga institucionet përgjegjëse

<b>diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës.</b>				përputhshmërisë me këto protokolle.  Baza e matjes: Raportet e vetë deklaramit të bizneseve	e (p.sh. Agjencitë rregullatore / MD)
<b>Përqindja e personave viktime /të mbijetuara / mbijetuar të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Tregues i OZHQ 11.7.2)</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues i OZHQ për sigurinë publike; kërkon integritet të dhënash ndër-institucionale.	Tregues global për qytetet e sigurta; i domosdoshëm për auditime ndërkombëtare.	Përqindja e personave që raportojnë ngacmim fizik ose seksual në hapësira publike në 12 muajt e fundit.  Baza e matjes: Anketa e Perceptimit të Sigurisë / ASK	ASK – Anketa e Perceptimit të Sigurisë / anketa të dedikuara për hapësirat publike
<b>Numri i kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave që trajtohen në programet psiko-sociale, të ngritura sipas parashikimeve në këtë Strategji.</b>	Matet mirë	Tregues i lidhur me Nenin 16 të Konventës së Stambollit (trajtimi i kryerësve).	Monitoron parandalimin sekondar dhe reduktimin e recidivizmit.	Numri dhe përqindja e kryerësve që përfundojnë programet e trajtimit psiko-social.  Baza e matjes: Ministria e Drejtësisë + institucionet zbatuese të programeve	Ministria e Drejtësisë + institucionet zbatuese të programeve të trajtimit psiko-social
<b>Numri i kallëzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur, të pazgjdhura për çdo vit</b>	Matet, por vlera bazë e paqartë	Treguesi në formën aktuale mat stokun e rasteve, por nuk reflekton performancën procedurale të sistemit të drejtësisë (kohëzgjatje, efikasitet, zgjidhje).	I rëndësishëm për matjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.	Përqindja e rasteve të dhunës të zgjidhura brenda afateve ligjore dhe koha mesatare e trajtimit të tyre, e ndarë sipas llojit të rastit.  Baza e matjes: Policia + Prokuroria – afatet e procedimit	Policia e Kosovës + Prokuroria e Shtetit – sistemet administrative të menaxhimit të rasteve

<b>Përqindja e grave viktima / të mbijetuara të dhunës nga partneri intim</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues i OZHQ me peshë shumë të lartë; nuk mund të hiqet.	Thelbësor për krahasim ndërkombëtar dhe për politikëbërje.	Prevalenca e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike nga partneri intim	ASK – Anketë Kombëtare e për Dhunën ndaj Grave
<b>Niveli i reflektimit të kuptimit gjinor të dhunës ndaj grave dhe të të gjitha formave të kësaj dhune, sipas Konventës së Stambollit, në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës</b>	Matet mirë	Mat përputhshmëri në e kornizës ligjore dhe politike.	Tregues kyç për raportimet GREVIO dhe të BE-së.	Përqindja e dispozitave të Konventës së Stambollit të reflektuara në ligje dhe politika.  Baza e matjes: Analizë e kuadrit ligjor – MD	Ministria e Drejtësisë – analiza e kuadrit ligjor dhe raportet e harmonizimit me Konventën e Stambollit
<b>Numri i kurrikulave të formimit të profesionisteve e profesionistëve të përgatitura e zhvilluara</b>	Matet	Tregues i fortë për kapacitetet profesionale.	Rrit kapacitetet sektoriale; i domosdoshëm për zbatueshmëri.	Numri i moduleve të zhvilluara dhe përqindja e profesionist/eve që demonstronë rritje të njohurive në testimet pas-trajnimit  Baza e matjes: MD, AD + institucionet e tjera trajnuese	Ministria e Drejtësisë + Akademia e Drejtësisë + institucionet trajnuese sektoriale
<b>Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës, në mënyrë të përvitshme</b>	Matet shumë mirë	Tregues që tregon shtrirjen e ngritjes së kapaciteteve.	Element kyç i cilësisë së shërbimeve dhe reagimit institucional.	Numri i profesionist/eve të trajnuar/a në standardet e Konventës së Stambollit çdo vit.  Baza e matjes: Raportet vjetore të ministrive dhe institucioneve trajnuese	Raportet vjetore të ministrive përkatëse + institucionet trajnuese
<b>Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave</b>	Matet pjesërisht	Tregues strukturor i rëndësishëm për	I domosdoshëm për monitorimin e koordinimit lokal dhe qendror.	Përqindja e MKL-ve që zbatojnë procedurat standarde të	Zyra e Koordinatores/Koordinatorit

<b>koordinues qendrorë e lokalë të fuqizuar e që zbatojnë në mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta në përputhje me Konventën e Stambollit.</b>		bashkëpunimin shumësektorial.		veprimet dhe raportojnë rregullisht.  Baza e matjes: Zyra e Koordinatorës / Koordinatorit Kombëtar + raportet e MKL-ve	Kombëtar + raportet e Mekanizmave Koordinues Lokalë (MKL)
<b>Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse (Tregues i OZHQ 16.3.1)</b>	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues global i aksesit në drejtësi; kërkon harmonizim metodologjik.	I detyrueshëm për OZHQ dhe raportimin ndërkombëtar.	Përqindja e rasteve të dhunës që raportohen në institucionet përgjegjëse çdo vit.  Baza e matjes: Policia + QPS + Prokuroria + ASK	Policia e Kosovës + Qendrat për Punë Sociale (QPS) + Prokuroria + ASK (harmonizim ndërinstytucional)
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje me vendim përfundimtar gjykatë</b>	Matet shumë mirë	Tregues i efektivitetit të gjykatave.	Thelbësor për të matur drejtësinë e aksesueshme dhe efikase.	Numri i vendimeve përfundimtare për rastet e dhunës dhe koha mesatare e trajtimit të lëndëve.  Baza e matjes: Gjykatat + Prokuroria	Gjykatat + Prokuroria – sistemet e menaxhimit të rasteve
<b>Linja buxhetore adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje, për një koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës.</b>	Matet	Tregues i qëndrueshmërisë institucionale.	I domosdoshëm për monitorim të sistemit të koordinimit.	Përqindja e buxhetit total të dedikuar për koordinim, monitorim dhe raportim ndërinstytucional.  Baza e matjes: Buxheti vjetor i ZKN/MD	Ministria e Drejtësisë – dokumentet buxhetore vjetore (KAB/ Ligji i Buxhetit)
<b>Numri i Mekanizmave Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës, të ngritur në mbarë vendin, me koordinatorë /koordinator</b>	Matet	Tregon zgjerimin e infrastrukturës lokale të mbrojtjes.	Një nga treguesit më të rëndësishëm të sistemit lokal të reagimit.	Përqindja e MKL-ve që funksionojnë sipas procedurave të standardizuara dhe raportojnë periodikisht në nivel qendror.	Zyra e Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar + raportet administrative të MKL-ve

lokal dhe mbështetje buxhetore të përcaktuar qartësisht.				Baza e matjes: Raportet e MKL-ve + ZKN	
Përqindja e buxhetit dedikuar OJQ-ve që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, mbrojtjes (duke përjashtuar strehimoret) dhe ri integrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve	Matet	Monitoron investimet në shërbime jo-strehimore; i rëndësishëm për GRB.	Nxit transparencën dhe llogaridhënien fiskale.	Përqindja e buxhetit për parandalim, mbrojtje, dhe riintegrim të ndarë sipas sektorit.  Baza e matjes: Buxheti i MD dedikuar për shërbimet	Ministria e Drejtësisë – raportet buxhetore dhe grantet për shërbime
Data baza me të dhënat për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, funksionale dhe e përditësuar rregullisht.	Matet	Tregues qendror i sistemit të integruar të të dhënave.	I detyrueshëm për raportimet ndërinstitucionale.	Përqindja e institucioneve kyçe (Policia, Prokuroria, QPS, Gjykatat, ASK) të integruara në sistemin e përbashkët digjital të menaxhimit të rasteve.  Baza e matjes: MD + ASK	Ministria e Drejtësisë + ASK – sistemi i integruar ndërinstitucional i të dhënave
Përqindja e të rejave dhe të rinjve të moshës 18-29 vjeç të cilët përjetuan dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç (Treguesi OZHQ 16.2.3)	Nuk disponohen të dhëna për periudhën e vlerësimit për shkak të mungesës së një mekanizmi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave.	Tregues shumë i rëndësishëm për grupmoshat e reja.	Detyrim ndërkombëtar në kuadër të OZHQ.	Prevalenca e dhunës seksuale ndaj të rejave/rinjve 18–29 vjeç.  Baza e matjes: Anketa DHNGV	ASK – Anketa Kombëtar e për Dhunën ndaj Grave / anketa të specializuara
Numri i viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës të cilat/cilët përfitojnë	Matet	Tregues i qasjes në drejtësi; tregon kapacitetin e institucioneve.	I rëndësishëm për sistemin e aksesit në drejtësi.	Numri i viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve që përfitojnë ndihmë juridike falas dhe koha e reagimit, e ndarë	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas + QPS + MKL

<b>ndihmë juridike falas</b>				sipas seksit, moshës dhe llojit të dhunës.  Baza e matjes: ANJF + ZMNV + QPS + MKL	
<b>Numri i grave që kanë qasje në drejtësi</b>	Matet, por forma aktuale nuk jep qartësi metodologjike	Treguesi në formën aktuale nuk ofron qartësi metodologjike dhe nuk përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare për matjen e aksesit në drejtësi, të cilat kërkojnë tregues më të specifikuar (p.sh. ndihmë juridike, kohëzgjatje procedurash, përfundim i rasteve).	Tema e aksesit në drejtësi është thelbësore, por duhet të reflektohet përmes treguesve më të matshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me shërbimet konkrete dhe rezultatet procedurale.	Përqindja e grave viktimat/të mbijetuara që përfitojnë ndihmë juridike falas dhe përqindja e rasteve të trajtuara brenda afateve ligjore, e ndarë sipas llojit të shërbimit dhe rezultatit të procedurës.  Baza e matjes: Agjencia e Ndhmës Juridike Falas	Agjencia për Ndhmë Juridike Falas + sistemi gjyqësor
<b>Linjë buxhetore përcaktuar sipas një analize dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës.</b>	Matet	Tregues fiskal i rëndësishëm për qëndrueshmëri.	Thelbësor për funksionimin e qendrave të shërbimit.	Rritja vjetore e financimit për shërbimet specializuara për viktimat/ të mbijetuarat / mbijetuarit  Baza e matjes: Buxheti vjetor i dedikuar nga MD	Ministria e Drejtësisë – raportet buxhetore vjetore
<b>Numri i grave që gëzojnë të drejtat pronësore në mënyrë të barabartë si edhe burrat</b>	Matet (por me metodologji jo të standardizuar)	Tregues i rëndësishëm për fuqizim ekonomik të grave.	Fusha e pronësisë është thelbësore për fuqizimin ekonomik të grave, por treguesi në formën aktuale nuk është i matshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në kuadër të monitorimit të Strategjisë.	Përqindja e grave me pronësi individuale dhe bashkëpronësi mbi pasuritë e paluajtshme, e ndarë sipas llojit të pronës dhe mënyrës së fitimit.  Baza e matjes: Kadastra + Ministria e Drejtësisë	Agjencia Kadastrale e Kosovës + Ministria e Drejtësisë

<b>Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, të zgjeruara e fuqizuara, ndarë sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.</b>	Nuk është matur në mënyrë sistematike gjatë periudhës së analizuar	Tregues themelor për planifikimin e shërbimeve.	Duhet mbajtur; mungesa e matjes nuk është arsye për heqje.	Numri i shërbimeve të specializuara sipas tipologjisë dhe përqindja e komunave që mbulohe nga këto shërbime.  Baza e matjes: Hartëzimi i shërbimeve	Ministria e Drejtësisë + hartëzimi kombëtar i shërbimeve
<b>Numri i viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të ri integruara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal.</b>	Nuk është matur në mënyrë sistematike gjatë periudhës së analizuar	Tregues i rëndësishëm për vlerësimin e qëndrueshmërisë së riintegritetit dhe efektivitetit afatgjatë të shërbimeve mbështetëse. Mungesa e matjes lidhet me mungesën e mekanizmave të ndjekjes pas përfundimit të shërbimeve.	Duhet mbajtur. Mat impaktin real dhe afatgjatë të ndërhyrjeve dhe është thelbësor për politikën e fuqizimit ekonomik.	Përqindja e viktimave/të mbijetuarave që mbeten të punësuar ose ekonomikisht të pavarura, 12 muaj pas përfundimit të programit të riintegritetit.  Baza e matjes: QPS + MKL + Agjencia për Punësim + Shërbimet sociale	QPS + MKL + Agjencia e Punësimit + shërbimet sociale

*Shënim: Klasifikimi dhe riformulimi i treguesve në këtë tabelë bazohet në analizën metodologjike të paraqitur në këtë seksion, duke dalluar ndërmjet treguesve që duhet të ruhen dhe të forcohen përmes përmirësimit të burimeve të të dhënave, atyre që kërkojnë riformulim për t'u bërë më operacionalë dhe të matshëm, si dhe atyre që duhet të zëvendësohen me tregues më të drejtpërdrejtë në strategjinë e ardhshme. Burimet e të dhënave të identifikuar në këtë tabelë reflektojnë institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe raportimin e të dhënave, si dhe instrumentet kryesore të matjes, duke kontribuar në forcimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe në konsolidimin e një sistemi monitorimi të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm.*

Në vijim të analizës së sistemit aktual të treguesve dhe të kufizimeve të identifikuar gjatë periudhës 2022–2025, është zhvilluar një kornizë e propozuar e treguesve për Strategjinë e ardhshme (2027–2030/2032), e cila paraqitet në Aneksin përkatës të këtij raporti.

Kjo kornizë ndërtohet mbi treguesit ekzistues që janë konceptualisht të vlefshëm, duke i riformuluar ata në mënyrë më të matshme dhe duke i lidhur me burime të qarta të të dhënave, frekuencë raportimi dhe përgjegjësi institucionale. Qëllimi i saj është të mbështesë ndërtimin e një sistemi monitorimi funksional, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe raportimit.

Në përfundim, analizat dhe sugjerimet e paraqitura në këtë seksion synojnë të mbështesin fuqizimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimin të politikave kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përmes përmirësimit të qartësisë metodologjike, harmonizimit të burimeve të të dhënave dhe forcimit të matshmërisë së treguesve. Vlen të theksohet se rekomandimet për riformulimin dhe përmirësimin e treguesve nuk janë detyruese, por përbëjnë orientime teknike që duhet të merren në konsideratë vetëm nëse Strategjia e re (2027–2030/2032) ruan të njëjtat fusha prioritare, të njëjtat objektiva strategjike dhe të njëjtat mekanizma institucionalë të ndërhyrjes.

Duke marrë në konsideratë se viti 2026 përfaqëson fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë aktuale, këto gjetje dhe orientime marrin një rëndësi të veçantë për konsolidimin e sistemit ekzistues të monitorimit dhe për sigurimin e një tranzicioni të strukturuar drejt strategjisë së re.

Në rast se Strategjia e re pëson ndryshime thelbësore në strukturë, objektiva, rezultate të pritshme apo fushëveprim, sugjerimet e mësipërme duhet të rishikohen dhe harmonizohen me mandatin e ri strategjik, në mënyrë që treguesit të mbeten të matshëm, të zbatueshëm dhe të përputhshëm me detyrimet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Stambollit, CEDAW, OZHQ-të dhe kornizat e raportimit të Bashkimit Evropian.

Në çdo rast, krijimi i një kuadri të qartë dhe të integruar të treguesve, i mbështetur në burime të qëndrueshme të të dhënave dhe në përgjegjësi të qarta institucionale, mbetet thelbësor për efektivitetin e politikave dhe forcimin e llogaridhënies ndërinstitucionale.

Në këtë kontekst, vlerësimi konstaton se sfidat në matjen e treguesve nuk lidhen vetëm me formulimin e tyre, por edhe me mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm për mbledhjen, harmonizimin dhe analizën e të dhënave. Për këtë arsye, strategjia e ardhshme duhet të fokusohet jo vetëm në riformulimin e treguesve, por edhe në forcimin e sistemeve institucionale të të dhënave, përfshirë standardizimin e metodologjive dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësive për raportim.

Megjithatë, mungesa e matjes së një pjese të treguesve nuk e komprometon vlefshmërinë e përgjithshme të vlerësimin, pasi analiza është mbështetur gjithashtu në të dhëna administrative, raporte institucionale dhe evidenca nga burime të shumta ndërinstitucionale.

Në këtë kuadër, përmirësimi i arkitekturës së treguesve dhe forcimi i sistemeve të mbledhjes dhe analizës së të dhënave përbën një prioritet kyç për fazën e ardhshme të politikave publike, duke mundësuar monitorim më të saktë, vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe llogaridhënie më të fortë ndërinstitucionale.

Në tërësi, vlerësimi konstaton se sfidat në matjen e treguesve nuk lidhen vetëm me formulimin e tyre, por përfaqësojnë një çështje sistemike që lidhet me fragmentimin e burimeve të të dhënave, mungesën e ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale dhe kufizimet në standardizimin e metodologjive të raportimit. Për këtë arsye, përmirësimi i arkitekturës së treguesve duhet të shoqërohet paralelisht me ndërtimin e një sistemi të integruar të të dhënave, i cili të mundësojë matje të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të orientuar drejt rezultateve.

#### 4.4. PËRMBLEDHJE ANALITIKE E PROGRESIT, BOSHLLËQEVE DHE SFIDAVE NDËRINSTITUCIONALE

Analiza e realizuar në këtë kapitull, e mbështetur në të dhëna administrative, dokumente strategjike, raporte monitorimi dhe të dhëna të organizatave ndërkombëtare, sugjeron se zbatimi i Strategjisë Kombëtare për periudhën 2022–2025 ka kontribuar në krijimin e bazave për një sistem më të konsoliduar të mbrojtjes dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Megjithatë, ritmet e progresit mbeten të ndryshme ndërmjet hallkave të zinxhirit institucional, duke reflektuar pjekuri të ndryshme strukturore, kapacitete jo të barabarta dhe dinamika të varura nga burimet njerëzore, teknike dhe financiare në dispozicion.

Për qëllime analitike, gjetjet e këtij seksioni strukturohen në tre dimensione kryesore: (i) progresi institucional dhe operacional, (ii) boshllëqet strukturore dhe sfidat ndërinstitucionale, dhe (iii) implikimet për fazën e ardhshme strategjike. Kjo qasje mundëson një lexim më të qartë të performancës së sistemit dhe orienton rekomandimet për përmirësim.

Institucionet e zbatimit të ligjit, veçanërisht Policia e Kosovës, paraqesin përparime të qëndrueshme në standardizimin e procedurave të reagimit emergjent dhe përdorimin e instrumenteve mbrojtëse, duke dëshmuar kapacitet të lartë operacional dhe nivel të avancuar profesionalizimi. Prokuroritë kanë rritur numrin e aktakuzave dhe efikasitetin procedural, duke kontribuar në rritjen e llogaridhënies institucionale në trajtimin e rasteve të dhunës. Në të kundërt, Gjykatat vazhdojnë të përballen me sfida në harmonizimin e praktikës ndëshkimore, duke reflektuar dominimin e dënimeve alternative dhe dënimeve me kusht, edhe në rastet me risk të lartë. Qendrat për Punë Sociale operojnë me burime të kufizuara njerëzore dhe ngarkesa të larta pune, gjë që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mbështetjes për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Ndërkohë, strehimoret kanë zgjeruar shërbimet e tyre dhe kanë forcuar kapacitetet, por vazhdojnë të mbeten të varura nga financimi jo i plotësisht i qëndrueshëm dhe mungesa e kornizave shumëvjeçare të buxhetimit publik, sidomos komunal.

Variacionet ndërmjet komunave mbeten një ndër sfidat më të mëdha strukturore gjatë periudhës së vlerësimit. Komunitet me kapacitete më të kufizuara administrative, me staf të reduktuar ose me mungesë specializimi, përballen me vështirësi të dukshme në implementimin e standardeve të mbrojtjes dhe koordinimit. Diferencat në ngarkesën e punës, disponueshmëria e shërbimeve sociale dhe niveli i ekspertizës së QPS-ve çojnë në qasje jo të barabartë në drejtësi dhe në mbështetje. Kjo situatë kërkon harmonizim më të thelluar mes nivelit qendror dhe atij lokal, në përputhje me rekomandimet e BE dhe mekanizmat e monitorimit të Këshillit të Evropës.

Roli i ABGJ në ngritjen e kapaciteteve ndërinstitucionale dhe në harmonizimin e praktikave ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal paraqitet si faktor thelbësor në funksionimin e sistemit të mbrojtjes. Trajnimet e vazhdueshme për Policinë, MKL-të, ministrinë dhe institucionet e tjera kanë ndikuar në standardizimin e qasjeve institucionale dhe në rritjen e cilësisë së reagimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare.

Përballimi i rasteve të ndërlikuara dhe atyre me rrezik të lartë vazhdon të jetë sfidë ndërinstitucionale, sidomos në aspektin e komunikimit ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe QPS-ve. Mungesa e një protokollit të standardizuar dhe përdorimi jo uniform i vlerësimit të rrezikut krijojnë variacione të theksuara në cilësinë e reagimit. Të dhënat nga OSBE tregojnë se disa raste me tregues të lartë rreziku nuk klasifikohen apo trajtohen në mënyrë të veçantë, duke theksuar nevojën për forcim të mekanizmave të parandalimit terciar dhe ndjekje rigorozë të protokolleve të koordinimit.

Në nivel horizontal, një sfidë e konsoliduar është mungesa e një sistemi tërësisht të integruar dhe të harmonizuar të të dhënave ndërinstitucionale. Edhe pse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një baze të përbashkët digjitale të të dhënave, institucionet përkatëse vijojnë të raportojnë në mënyrë të fragmentuar, me metodologji të ndryshme dokumentimi dhe pa standarde të unifikuara për gjurmimin e rasteve. Kjo situatë kufizon vlerësimin e rrezikut, monitorimin e rasteve të përsëritura dhe analizën krahasuese ndërmjet komunave dhe institucioneve. Ky boshllëk është identifikuar njëzëri si sfidë strukturore nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, OSBE dhe organizatat vendore të monitorimit. Ky boshllëk është identifikuar në mënyrë të përsëritur në raportet e organizatave ndërkombëtare dhe mekanizmave të monitorimit si një nga sfidat strukturore të sistemit.

Kapacitetet njerëzore mbeten një nga përcaktuesit kryesorë të efektivitetit dhe koherencës së sistemit. QPS-të, strehimoret dhe disa gjykata përballen me ngarkesë të konsiderueshme pune dhe me mungesë të stafit të specializuar, çka ndikon në kohëzgjatjen e procedurave, disponueshmërinë e mbështetjes psikosociale dhe aftësinë për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe të orientuara drejt viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve. Këto boshllëqe kërkojnë institucionalizim të programeve të trajnimit dhe investim të qëndrueshëm në burimet njerëzore. Këto kufizime në burimet njerëzore përbëjnë një faktor transversal që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin e të gjithë zinxhirit institucional të reagimit.

Një komponent i rëndësishëm i funksionimit të sistemit mbetet edhe qasja në drejtësi përmes ANJF, e cila ka rritur dukshëm shtrirjen territoriale dhe numrin e përfitueseve/përfituesve gjatë periudhës 2022–2024. Kjo rritje për rastet e dhunës në familje dhe rastet civile-familjare të lidhura me dhunën e pa raportuar përbën një tregues të rëndësishëm të rritjes së besimit në institucion, por edhe të rritjes së kërkesës për shërbime juridike gjithëpërfshirëse në nivel lokal. Kjo kërkon investime të qëndrueshme në kapacitetet e ANJF, si dhe integrim më të thelluar të saj në mekanizmat e referimit dhe në protokollet ndërinstitucionale.

Në kontekstin e financimit, edhe pse është vërejtur një rritje e ndjeshme e burimeve publike të alokuara për strehimoret dhe shërbimet mbështetëse, qëndrueshmëria financiare mbetet pjesërisht e arritur. Mungesa e buxhetimit shumëvjeçar, fondet e pamjaftueshme dhe mos funksionalizimi i plotë i mekanizmave të dedikuara të financimit, kufizojnë aftësinë e shërbimeve për të ofruar mbështetje të qëndrueshme dhe të standardizuar, sidomos për shërbimet psikosociale, ligjore dhe ato të riintegritit social dhe ekonomik. Këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e koherencës dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve të secilit institucion të përfshirë.

Ndërkohë, rritja e raportimit të rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës vlerësuese nuk duhet interpretuar si rritje e fenomenit, por si tregues i përmirësimit të besimit në institucionet e drejtësisë dhe shërbimet mbrojtëse, si dhe si shenjë e rritjes së efektivitetit të mekanizmave të identifikimit dhe referimit. Në të njëjtën kohë, ulja e numrit të fataliteteve kërkon interpretim metodologjik të kujdesshëm, duke marrë parasysh variacionet vjetore dhe numrin e ulët absolut të rasteve, siç rekomandohet nga standardet e vlerësimit të Këshillit të Evropës dhe GREVIO.

Në përgjithësi, periudha 2022–2025 paraqet një kombinim të progresit strukturor, konsolidimit të mekanizmave ekzistues dhe boshllëqeve të vazhdueshme që kërkojnë ndërhyrje të synuara. Ky kombinim sugjeron se Kosova ka arritur të ndërtojë një bazë solide të reagimit ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ndërsa qëndrueshmëria e këtij progresi mbetet e varur nga thellimi i koordinimit ndërinstytucional, harmonizimi i të dhënave, forcimi i praktikave gjyqësore dhe investimet e vazhdueshme në kapacitetet njerëzore dhe financiare.

Kontributi i sektorit shëndetësor mbetet i pazëvendësueshëm në identifikimin, dokumentimin klinik dhe orientimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve drejt mekanizmave të mbrojtjes, ndërsa sfidat e kapaciteteve njerëzore dhe mungesa e qendrave të specializuara shëndetësore mbeten ndër boshllëqet kritike për periudhën e ardhshme.

Vlerësimi thekson gjithashtu se mekanizmat horizontalë për të drejtat e njeriut dhe strukturat komunale kundër diskriminimit luajnë rol mbështetës në forcimin e reagimit ndërinstytucional dhe promovimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Mekanizmat Koordinues Lokalë (MKL) janë konfirmuar si një praktikë e mirë shumësektoriale në nivel rajonal, megjithëse funksionimi i tyre varet ende nga kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare të komunave.

*Në tërësi, vlerësimi i periudhës 2022–2025 dëshmon një progres të konsoliduar në forcimin e kornizës ligjore, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional. Megjithatë, sfidat e identifikuar nga GREVIO – përfshirë mungesën e protokolleve të posaçme për format e tjera të dhunës ndaj grave, mungesën e qendrave të referimit për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale, kapacitetet e pamjaftueshme të QPS-ve dhe mungesën e financimit të qëndrueshëm – mbeten të pranishme dhe kërkojnë intervenime të qëndrueshme dhe të koordinuara.*

Në këtë kontekst, konsolidimi i mëtejshëm i sistemit mbetet i varur nga rritja e koherencës ndërinstytucionale, forcimi i praktikave gjyqësore dhe investimet e qëndrueshme në kapacitetet njerëzore dhe financiare, në përputhje me angazhimet e Kosovës ndaj acquis të BE-së dhe standardeve të Konventës së Stambollit.

Në mungesë të matjes së një pjese të treguesve të rezultateve, analiza e progresit është mbështetur kryesisht në informacion mbi aktivitetet dhe produktet institucionale. Megjithatë, numri i aktiviteteve të realizuara nuk mund të interpretohet në vetvete si dëshmi e arritjes së objektivave strategjike, nëse nuk shoqërohet me tregues të qartë të rezultateve dhe ndikimit. Për këtë arsye, forcimi i kornizës së treguesve përbën një nga prioritetet kryesore për fazën e ardhshme strategjike.

Gjetjet e mësipërme lidhen drejtpërdrejt me kufizimet e identifikuara në sistemin e treguesve (shih seksionin 4.3), ku mungesa e të dhënave të standardizuara dhe e baseline-ve për një pjesë të treguesve kufizon matjen e rezultateve dhe ndikimit të ndërhyrjeve.

Në tërësi, gjetjet e këtij vlerësimi tregojnë se Strategjia ka krijuar një bazë të rëndësishme institucionale dhe politike për adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë. Megjithatë, për fazën e ardhshme të politikave publike mbetet thelbësore forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, përmirësimi i arkitekturës së treguesve dhe konsolidimi i mekanizmave të mbledhjes dhe harmonizimit të të dhënave ndërinstitutionale.

Këto elemente janë kritike për rritjen e matshmërisë së rezultateve, përmirësimin e vendimmarrjes së bazuar në evidencë dhe forcimin e llogaridhënies ndërinstitutionale, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

**Pikat kryesore të analizës:**

- Progres i qëndrueshëm në reagimin institucional dhe rritjen e kapaciteteve
- Boshllëqe në harmonizimin e të dhënave dhe koordinimin ndërinstitutional
- Variacione të konsiderueshme ndërmjet komunave
- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe financiare
- Nevojë për forcim të sistemit të treguesve dhe monitorimit

## 5. ANALIZA NDËR-INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Ky kapitull paraqet analizën ndër-institucionale të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, duke sintetizuar gjetjet kryesore të periudhës 2022–2025 dhe duke identifikuar progresin, boshllëqet dhe sfidat strukturore në nivel qendror, lokal dhe ndërsektorial. Analiza është ndërtuar mbi të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse, mekanizmat lokalë, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe mbi informacionet e mbledhura përmes instrumenteve të vlerësimit.

Për qëllime analitike, vlerësimi ndër-institucional në këtë kapitull strukturohet në tre dimensione kryesore: (i) performanca institucionale dhe progresi në zbatim, (ii) boshllëqet strukturore dhe kufizimet operacionale, dhe (iii) implikimet për forcimin e sistemit në fazën e ardhshme strategjike. Kjo qasje mundëson një analizë të integruar të kontributit të secilit institucion në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes.

Vlerësimi është udhëhequr nga kriteret OECD-DAC/UNEG dhe standardet e Konventës së Stambollit, duke vlerësuar koherencën, efikasitetin institucional, ndërveprimin ndërsektorial dhe ndikimin në qasjen e viktimave/të mbijetuarave/të mbijetuarve në shërbime cilësore.

### 5.1. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE QENDRORE DHE TË DREJTËSISË

Institucionet qendrore dhe të drejtësisë përbëjnë boshtin funksional të sistemit të mbrojtjes nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje e dhuna në baza gjinore, duke garantuar parandalim, mbrojtje të menjëhershme, ndjekje penale efektive dhe bashkërendim ndërsektorial.

#### **Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Zyra e Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar.**

MD ka garantuar funksionimin e linjës kombëtare 24/7, harmonizimin e formateve të raportimit dhe krijimin e databazës kombëtare për rastet e dhunës në familje. Ministria ka mundësuar raportim nga 100 për qind e institucioneve dhe ka avancuar standardet e bashkërendimit ndërmjet mekanizmave lokalë dhe qendrorë. Një sfidë e vazhdueshme mbetet harmonizimi i plotë i cikleve të raportimit dhe standardizimi i të dhënave ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse. Këto zhvillime kanë kontribuar në forcimin e koordinimit ndër-institucional në nivel qendror; megjithatë, mungesa e harmonizimit të plotë të standardeve të raportimit kufizon përdorimin e të dhënave për analizë strategjike dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë.

#### **Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ).**

ABGJ ka luajtur rol themelor në koordinimin kombëtar për zbatimin e Strategjisë, në cilësinë e bashkë kryesueses së Grupit Ndërmintor Kombëtar, krahas MD-së. Në periudhën 2022–2024, ABGJ ka realizuar 24 aktivitete monitoruese, 6 raporte tematike dhe 18 trajnime

ndërinstitucionale, duke mbështetur integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike. Ajo ka qenë promotore e sinkronizimit ndërinstitucional dhe e forcimit të qeverisjes gjinore në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë, kapacitetet njerëzore dhe burimet buxhetore mbeten të kufizuara për të siguruar mbikëqyrje sistematike të zbatimit në nivel vendi. Megjithëse roli koordinues i ABGJ mbetet kritik për qeverisjen gjinore, kufizimet në burimet njerëzore dhe financiare ndikojnë në kapacitetin për të ushtruar mbikëqyrje sistematike dhe për të siguruar një implementim të njëtrajtshëm të Strategjisë në nivel vendi.

#### **Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Kosovës (PK)**

Raportimi i rasteve është rritur me rreth 7 për qind, një tregues i përmirësimit të besimit publik dhe funksionalitetit të sistemeve të reja elektronike të raportimit dhe koordinimit më të mirë me prokuroritë dhe MKL-të. Sfidë mbetet integrimi i plotë i databazave të ndryshme dhe ndarja e detajuar gjinore e të dhënave. Policia e Kosovës disponon të dhëna statistikore të detajuara dhe të ndara sipas gjinisë për rastet e dhunës në familje, të cilat evidentohen në momentin e regjistrimit të rastit në databazën nacionale dhe mund të gjenerohen në çdo kohë përmes sistemit elektronik. Për rrjedhojë, ndarja gjinore e të dhënave është funksionale dhe e zbatueshme në praktikë. Megjithatë, bazuar në analizën e raportit, rekomandohet që në kuadër të avancimit të mëtejshëm të sistemit, të shqyrtohet zgjerimi i fushave, me qëllim të evidentimit më të detajuar të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj integritetit seksual. Në tërësi, Policia e Kosovës paraqet një nga hallkat më të konsoliduara të sistemit, megjithatë, avancimi i mëtejshëm kërkon integrim më të thelluar të sistemeve të të dhënave dhe standardizim të plotë të kategorizimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore.

#### **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)**

KPK ka rritur me 12 për qind kallëzimet penale, ka intensifikuar punën e njësive të specializuara, dhe ka rritur bashkëpunimin me ZMNV. Mbetet e nevojshme forcimi i analizës gjinore të vendimeve dhe afateve procedurale, për të siguruar monitorim të standardizuar dhe bazuar në evidenca.

#### **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)**

Gjyqësori ka përmirësuar përfundimin e rasteve në 75 për qind në vitin 2024 dhe ka ulur kohëzgjatjen mesatare të procedurave. Mbetet e nevojshme forcimi i analizës gjinore të vendimeve dhe afateve procedurale, për të siguruar monitorim të standardizuar dhe bazuar në evidenca.

Këto gjetje sugjerojnë nevojën për forcimin e praktikës së unifikuar gjyqësore dhe integrimin sistematik të analizës gjinore në vendimmarrje, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe rekomandimet e GREVIO.

#### **Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF)**

ANJF ka zgjeruar ndjeshëm ofrimin e ndihmës juridike, me 20 për qind më shumë kërkesa të trajtuara dhe bashkëpunim të strukturuar me ZMNV. Sfidë lidhen me kapacitetet njerëzore dhe burimet e kufizuara që ndikojnë në mbulimin e kërkesave në rritje. Rritja e kërkesës për ndihmë juridike reflekton njëkohësisht rritjen e besimit në institucion dhe nevojën për zgjerim të mëtejshëm të kapaciteteve për të garantuar akses të barabartë në drejtësi.

#### **Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV)**

ZMNV ka mbështetur 1,872 viktima / të mbijetuara / mbijetuar në vitin 2024 dhe ka përmirësuar bashkëpunimin me PK dhe KPK. Sfidë kryesore është mungesa e programeve të

integruara për riintegrim dhe zgjerimi i mbulimit në zona rurale. Mungesa e programeve të strukturuar të riintegrit kufizon ndikimin afatgjatë të ndërhyrjeve dhe kërkon zhvillimin e një qasjeje më të integruar ndërinstucionale.

### **Ministria e Drejtësisë (MD) / Qendrat për Punë Sociale (QPS)**

Që prej vitit 2023, Qendrat për Punë Sociale funksionojnë nën Ministrinë e Drejtësisë, duke përbërë një hallkë kyçe në reagimin ndaj dhunës në familje. Gjatë periudhës 2022–2024, QPS-të kanë trajtuar 14 për qind më shumë raste dhe kanë përmirësuar bashkëpunimin me Policinë, Prokurorinë dhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave. Megjithatë, mbeten sfida në kapacitetet njerëzore dhe mungesën e buxheteve të dedikuara, të cilat kufizojnë mbulimin e barabartë të shërbimeve dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për viktimat /të mbijetuarat/mbijetuarit. Këto kufizime ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe përbëjnë një nga pikat më kritike të sistemit të mbrojtjes në nivel lokal.

### **Ministria e Financave, Punës dhe Transferave (MFPT)**

MFPT ka luajtur një rol mbështetës në avancimin e barazisë gjinore përmes integrit gradual të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në planifikimin dhe ekzekutimin buxhetor, si dhe përmes politikave të mbrojtjes sociale dhe punësimit që ndikojnë në reduktimin e vulnerabilitetit ekonomik të grave. Edhe pse përgjegjësitë operacionale për përgjigjen ndaj dhunës janë transferuar te Ministria e Drejtësisë, MFPT mbetet aktor kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe për orientimin e burimeve publike drejt ndërhyrjeve që promovojnë barazinë gjinore dhe mbështesin zbatimin e Strategjisë. Roli i MFPT mbetet kritik për institucionalizimin e financimit të qëndrueshëm dhe për integrimin e barazisë gjinore në politikat fiskale dhe sociale.

### **Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)**

IML ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e Strategjisë përmes hartimit dhe miratimit të Protokollit Shtetëror për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale (23 nëntor 2022), dokument ky i mbështetur nga UN Women dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (KWN). Protokollit ka standardizuar reagimin ndërsektorial dhe ofrimin e provave mjeko-ligjore, mbështetjes psikologjike dhe referimit institucional për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Sipas IML, aktualisht mungon një mekanizëm i qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të protokollit, si dhe një sistem i integruar elektronik për regjistrimin e rasteve. Mungesa e mekanizmave të monitorimit dhe e një sistemi të integruar të të dhënave kufizon vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të protokollit në praktikë.

Gjetjet e këtij seksioni reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën e paraqitur në kapitullin 4.4, duke konfirmuar se, pavarësisht progresit të konsiderueshëm institucional, boshllëqet në koordinim, harmonizimin e të dhënave dhe kapacitetet njerëzore mbeten faktorë përcaktues për efektivitetin e sistemit.

## **5.2. INSTITUCIONET E PAVARURA DHE AGJENCITË PUBLIKE**

Institucionet e pavarura luajnë rol thelbësor në garantimin e llogaridhënies, mbikëqyrjes dhe promovimit të standardeve të barazisë gjinore në sektorin publik dhe mediatik.

Nëpërmjet funksioneve të tyre rregullatore dhe monitoruese, ato sigurojnë zbatim të drejtë të ligjit, transparencë institucionale dhe respektim të parimeve të mosdiskriminimit.

Në këtë kuadër, analiza fokusohet në kontributin e këtyre institucioneve në forcimin e llogaridhënies publike, prodhimin e evidencës dhe ndikimin në përmirësimin e politikave dhe praktikave institucionale.

- **Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)** ka integruar 11 tregues gjinorë në statistikat zyrtare, por ende ka nevojë për burime shtesë.
- **Avokati i Popullit (AP)** ka trajtuar 17 raste diskriminimi dhe ka publikuar tre raporte mbi barazinë.
- **Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)** ka identifikuar shtatë raste seksizmi në media dhe ka realizuar gjashtë fushata sensibilizuese.
- **Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)** ka kontribuar në promovimin e sigurisë digjitale dhe përdorimit të sigurt të komunikimeve elektronike, me ndikim të tërthortë në adresimin e dhunës me bazë gjinore online, megjithëse raportimi gjinor dhe bashkëpunimi ndërinstytucional mbeten të kufizuara.

Sfida kryesore e institucioneve mbështetëse lidhet me mungesën e burimeve të dedikuara dhe kapaciteteve analitike për monitorim të standardizuar, çka kufizon potencialin për analiza të thelluara gjinore dhe për matjen sistematike të ndikimit.

Në tërësi, institucionet e pavarura kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në ndërtimin e një sistemi të bazuar në evidencë dhe në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies. Megjithatë, kufizimet në burimet njerëzore dhe kapacitetet analitike reduktojnë potencialin e tyre për të prodhuar analiza të thelluara dhe për të mbështetur vendimmarrjen strategjike, veçanërisht në lidhje me monitorimin e treguesve të rezultateve dhe ndikimit.

### 5.3. INSTITUCIONET MBËSHTETËSE DHE PROFESIONALE

Institucionet mbështetëse dhe profesionale përbëjnë një komponent thelbësor të sistemit të reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore, duke kontribuar në trajnimin e profesionisteve/profesionistëve, edukimin publik, koordinimin ndërsektorial dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Kontributet e tyre janë veçanërisht të rëndësishme në procesin e parandalimit, identifikimit të hershëm, mbledhjes së të dhënave dhe mbështetjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në nivel qendror dhe lokal.

**Akademia e Drejtësisë (AD)** ka integruar trajnimin për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore në programet fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarë e prokurorë, duke zhvilluar module të harmonizuara me Konventën e Stambollit dhe standardet evropiane. Ajo ka trajnuar qindra profesionistë dhe ka zbatuar mekanizma matjeje të ndikimit, që tregojnë se trajnimet kanë dhënë një ndikim të prekshëm në rastet e dhunës në familje. Vlerësimet tregojnë një rritje të ndërgjegjësimit profesional dhe të ndjeshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndaj rasteve të dhunës në familje, përfshirë trajtimin më të kujdesshëm të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, njohjen e fëmijëve si dëshmitarë të dhunës, si dhe përmirësime në cilësinë e arsytimit gjyqësor dhe vlerësimin e rrethanave për masat

mbrojtëse. Megjithatë, ndikimi i plotë i trajnimeve vazhdon të ndikohet nga faktorë strukturorë, përfshirë normat patriarkale dhe mungesën e shërbimeve mbështetëse.

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)** ka integruar përmbajtje të edukimit gjinor në kurrikulën kombëtare dhe ka ndërmarrë iniciativa për edukim parandalues në shkolla, por ende mungon një metodologji e standardizuar për matjen e ndikimit dhe monitorimin e përfshirjes së këtyre moduleve.

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)** ka ndërmarrë gjashtë fushata ndërgjegjësimi mbi barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës, duke përfshirë sektorët e sportit dhe të rinisë, por institucionalizimi i këtyre iniciativave vazhdon të jetë i pjesshëm.

**Zyra e Qeverisjes së Mirë (ZQM)** ka kontribuar në kornizën e përgjithshme të barazisë gjinore përmes përgatitjes së 12 raporteve qeveritare dhe monitorimit të politikave të barazisë, megjithëse mungojnë të dhëna të dedikuara për dhunën me bazë gjinore dhe treguesit specifikë për matjen e progresit në këtë fushë.

**Departamenti për Politika Sociale dhe Shërbime Familjare (DPSHSF)** ka mbështetur koordinimin e politikave sociale dhe shërbimeve për familjet dhe fëmijët, por përballat me kapacitete analitike të kufizuara në monitorimin sistematik të trendeve të dhunës.

**Koalicioni i Strehimoreve** ka mbetur një aktor kritik në ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe strehimit emergjent, duke mbështetur mbi 400 viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit në vit. Qëndrueshmëria financiare mbetet sfida kryesore e këtij rrjeti, duke ndikuar në planifikimin afatgjatë të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Në përgjithësi, gjatë periudhës 2022–2024, roli i institucioneve mbështetëse është forcuar ndjeshëm, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin ndërsektorial. Sfida kryesore e institucioneve mbështetëse lidhet me mungesën e burimeve të dedikuara dhe kapaciteteve analitike për monitorim të standardizuar, çka kufizon potencialin për analiza të thelluara gjinore dhe për matjen sistematike të ndikimit. Megjithatë, për të rritur efektivitetin e tyre, është e nevojshme të përmirësohen mekanizmat e matjes së ndikimit, të sigurohen burime të qëndrueshme financiare dhe të institucionalizohen praktikat më të mira në nivel kombëtar dhe lokal.

Në tërësi, institucionet mbështetëse luajnë një rol kritik në forcimin e kapaciteteve dhe në parandalimin afatgjatë të dhunës. Megjithatë, mungesa e mekanizmave të standardizuar për matjen e ndikimit dhe lidhjes së aktiviteteve me rezultate konkrete kufizon vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe kërkon një qasje më të strukturuar në fazën e ardhshme strategjike.

#### **5.4. MEKANIZMAT KOORDINUES DHE BASHKËRENDIMI NDËR-INSTITUCIONAL**

Mekanizmat koordinues janë elementi kyç që lidh politikat kombëtare me zbatimin në nivel lokal. Funkcionalizimi i tyre garanton që parimet e mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, reagimit të menjëhershëm dhe parandalimit të dhunës të

përkthehen në veprime konkrete në komunitet. Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërmjet MKL-ve, MD-së, MFPT-së dhe MPB-së ka qenë vendimtar për efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

Ky përparim reflekton një rritje të kapaciteteve të reagimit ndërinstitucional dhe një funksionalizim më të mirë të mekanizmave të referimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në nivel lokal.

38 Mekanizma Koordinues Lokalë (MKL) janë ngritur dhe kanë përmirësuar qasjen ndërsektoriale në nivel komunal. Bashkërendimi ndërmjet Policisë së Kosovës, QPS-ve dhe anëtareve/anëtarëve të tjerë të MKL-ve ka sjellë rezultate të matshme, përfshirë reduktimin e kohës nga raportimi i incidentit në reagimin emergjent, nga rreth 72 orë në vitin 2022 në 36 orë në vitin 2024. Ky përparim tregon forcim të ndjeshëm të reagimit institucional dhe të mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në komunitet.

Në tërësi, mekanizmat koordinues kanë kontribuar në forcimin e përgjegjësisë lokale dhe në ndërlidhjen efektive të niveleve të qeverisjes. Sfida kryesore mbetet sigurimi i fondeve të qëndrueshme dhe zhvillimi i një platforme të integruar për raportim dhe ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse.

Analiza krahasuese ndër-institucionale tregon se periudha 2022–2024 ka shënuar përmirësim të dukshëm në funksionalitetin e sistemit për mbrojtje nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje e dhuna në baza gjinore, me rritje të efikasitetit të institucioneve përgjegjëse, harmonizim më të mirë të raportimit dhe forcim të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave qendrorë dhe lokalë. Të 38 MKL-të janë ngritur, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për koordinim vendor; megjithatë, në shumicën prej tyre kërkohet funksionalizim i plotë, rritje e efikasitetit praktik dhe rritje e kapaciteteve për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe të standardizuar të procedurave.

Të dhënat për vitin 2025 konfirmojnë funksionimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, përfshirë Mekanizmat Koordinues Lokalë, si platforma kryesore për bashkërendimin e institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe mirëqenies sociale. Ky koordinim ka kontribuar në trajtimin më të integruar të rasteve dhe në përmirësimin gradual të llogaridhënies ndërinstitucionale, megjithëse nevoja për standardizim të mëtejshëm të raportimit mbetet e theksuar.

Në tërësi, mekanizmat koordinues përbëjnë një nga shtyllat më të rëndësishme të sistemit të reagimit, duke mundësuar ndërlidhjen funksionale ndërmjet institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe mirëqenies sociale. Megjithatë, për të garantuar qëndrueshmëri dhe efektivitet afatgjatë, është e nevojshme të përforcohen kapacitetet operacionale të MKL-ve, të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe të zhvillohet një sistem i integruar dhe i standardizuar i mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

Këto elemente janë thelbësore për rritjen e matshmërisë së rezultateve, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përmbushjen e objektivave të Strategjisë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

Gjetjet e këtij seksioni janë në përputhje me analizën e paraqitur në kapitullin 4, duke konfirmuar se, pavarësisht progresit të dukshëm, boshllëqet në koordinim, të dhëna dhe kapacitete mbeten faktorë kyç që ndikojnë në efektivitetin e përgjithshëm të sistemit.

## 5.5. ZBATIMI I STRATEGJISË NË NIVEL KOMUNAL

Komunat e Kosovës luajnë një rol thelbësor në zbatimin praktik të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, duke qenë hallka më e afërt me qytetaret/qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve të vijës së parë. Analiza bazohet në të dhënat e mbledhura përmes instrumenteve standarde të raportimit të komunave dhe dokumentacionit mbështetës të Ministrisë së Drejtësisë, duke mundësuar një vlerësim të strukturuar të progresit dhe sfidave në nivel lokal gjatë periudhës 2022–2025.

Për qëllime analitike, zbatimi në nivel komunal vlerësohet në katër dimensione kryesore: (i) koordinimi institucional dhe funksionimi i MKL-ve, (ii) planifikimi dhe buxhetimi, (iii) kapacitetet profesionale dhe aktivitetet parandaluese, dhe (iv) sistemi i të dhënave dhe raportimit.

Analiza e situatës në 19 komunat<sup>51</sup> që i janë përgjigjur kërkesës për informacion në kuadër të zbatimit të Strategjisë tregon një angazhim të dukshëm, megjithëse jo të barabartë, në nivel lokal. Nga këto komuna, 17 kanë miratuar Plane Komunale të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, duke reflektuar harmonizim të përgjithshëm me prioritetet strategjike kombëtare. Vetëm 10 komuna raportojnë ekzistencën e një linje të dedikuar buxhetore, duke dëshmuar se financimi mbetet sfida më strukturore e nivelit lokal. 16 komuna kanë realizuar fushata ndërgjegjësimi, ndërsa vetëm 11 përdorin formate të standardizuara të raportimit, çka nënvizon nevojën për më shumë uniformitet në mbledhjen dhe administrimin e të dhënave.<sup>52</sup>

**Koordinimi institucional.** Të gjitha komunat kanë ngritur Mekanizma Komunalë Lokalë (MKL), por shkalla e funksionalitetit të tyre ndryshon ndjeshëm. Frekuenca e takimeve dhe shkalla e funksionalitetit të MKL-ve ndryshon ndërmjet komunave, duke reflektuar kapacitete të ndryshme njerëzore dhe financiare. Në disa komuna, funksionimi i MKL-ve mbetet i kufizuar për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe logjistike, duke ndikuar në rregullsinë e takimeve dhe koordinimin ndërsektorial. Një numër komunash raportojnë praktika të konsoliduara në koordinim dhe përfshirje ndërsektoriale, duke demonstruar potencial për mësim të ndërsjellë ndërkomunal.

**Planifikimi dhe buxhetimi.** Megjithëse shumica e komunave kanë planifikim të harmonizuar me nivelin kombëtar, zbatimi i këtyre planeve varet nga burimet buxhetore dhe kapacitetet teknike. Vetëm 10 komuna kanë linjë të dedikuar buxhetore për aktivitetet kundër dhunës me bazë gjinore, ndërsa komunat e tjera mbështeten në projekte të donatorëve ose i integrojnë shpenzimet brenda programeve të përgjithshme sociale. Kjo situatë krijon mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe zbatimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e shërbimeve.

<sup>51</sup> Përkatësisht komunat: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Kllokot, Malishevë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Viti, Vushtrri

<sup>52</sup> Për më shumë informacion shih shtojcën 3 të këtij raporti

**Trajnimet dhe kapacitetet profesionale.** Të gjitha komunat raportojnë se kanë organizuar trajnime ndërsektoriale për Policinë, QPS, MKL-të, arsimin dhe shëndetësinë. Intensiteti, cilësia dhe frekuenca e trajnimeve ndryshojnë, duke reflektuar varësi nga burimet lokale dhe mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë. Komunat urbane raportojnë trajnime më të vazhdueshme dhe më të standardizuara, ndërsa disa komuna rurale raportojnë mungesë kapacitetesh për trajnime të rregullta. Kjo tregon nevojën për institucionalizimin e moduleve të trajnimit, harmonizimin e përmbajtjeve dhe sigurimin e burimeve të dedikuara.

**Fushatat e ndërgjegjësimit dhe parandalimi.** Gjatë periudhës 2022–2025, 16 komuna raportuan zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit, kryesisht gjatë “16 Ditëve të Aktivizmit”. Format e fushatave përfshijnë takime komunitare, angazhimin e shkollave, aktivitete publike dhe materiale informuese. Komunat më të vogla shpesh kanë mungesë fondesh logjistike, çka kufizon përkthimin e planeve të komunikimit në veprime konkrete. Megjithatë aktivitetet janë të pranishme në shumicën e komunave, mungon një kornizë e matjes së ndikimit që do të mundësonte vlerësimin e rezultatit afatgjatë të fushatave.

**Të dhënat dhe raportimi.** Vetëm 11 nga 19 komuna përdorin formate të standardizuara për mbledhjen e të dhënave, ndërsa pjesa tjetër mbështetet në raportim manual. Integrimi i sistemit të raportimit ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror është ende në zhvillim, duke krijuar hapësirë për përmirësim në standardizimin e të dhënave dhe sinkronizimin e informacionit. Komunat me kapacitete më të mira kanë zhvilluar baza të brendshme të të dhënave, por mungon një platformë e unifikuar që do të mundësonte raportim të sinkronizuar dhe qasje të standardizuar në analizën gjinore. Kjo situatë lidhet drejtpërdrejt me kufizimet e identifikuar në kornizën e treguesve (shih seksionin 4.3), duke kufizuar matjen e rezultateve dhe krahasueshmërinë ndërmjet komunave.

### **Sfidat e përbashkëta**

Të dhënat e mbledhura nga komunat identifikojnë një sërë sfidash të përbashkëta që ndikojnë në funksionalitetin e mekanizmave lokalë dhe në qëndrueshmërinë e shërbimeve. Sfidat e identifikuar reflektojnë kufizime strukturore dhe sistematike që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e zbatimit në nivel lokal:

- kapacitete të kufizuara njerëzore brenda MKL-ve dhe mungesë stafi të përhershëm teknik
- varësi të lartë nga donatorët për aktivitete të trajnimit dhe ndërgjegjësimit
- mungesë të integritetit të të dhënave me sistemet qendrore të MD-së
- pjesëmarrje të pjesshme të OSHC-ve në planifikim dhe monitorim lokal
- mungesë të mekanizmave të matjes së ndikimit të fushatave dhe shërbimeve
- disnivel midis komunave urbane dhe atyre rurale në qasjen në shërbime dhe kapacitete teknike.

**Përmbledhje analitike.** Në tërësi, zbatimi i Strategjisë në nivel komunal ka shënuar progres të rëndësishëm në ngritjen e mekanizmave koordinues dhe në harmonizimin e planifikimit me prioritetet kombëtare. Megjithatë, shkalla e konsolidimit mbetet e pabarabartë ndërmjet komunave dhe varet në mënyrë të konsiderueshme nga kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare në dispozicion.

Për të garantuar zbatim të qëndrueshëm dhe të standardizuar deri në vitin 2026, është thelbësore të forcohen kapacitetet e MKL-ve, të sigurohet financim i qëndrueshëm, të institucionalizohen mekanizmat e matjes së ndikimit dhe të harmonizohen sistemet e raportimit dhe të dhënave, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

## 5.6. ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË ZBATIMIN E STRATEGJISË

Organizatave të shoqërisë civile (OSHC) luajnë rol të pazëvendësueshëm në ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe në forcimin e përgjigjes ndërinstitucionale ndaj dhunës me bazë gjinore. Ato kontribuojnë në reagimin e parë, strehimin, punën me kryerësit, monitorimin e politikave dhe avokimin për qasje të drejta dhe të sigurta në shërbime. Kontributi i tyre është thelbësor për përmbushjen e standardeve të Konventës së Stambollit.

Në këtë kuadër, analiza fokusohet në tre dimensione kryesore: (i) roli i OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve dhe reagimin e parë, (ii) kontributi në monitorim dhe avokim, dhe (iii) sfidat strukturore që ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe integrimin e tyre në sistemin institucional.

**Kuadri metodologjik.** Analiza e mëposhtme bazohet ekskluzivisht në të dhënat e vetë raportuara nga OSHC-të përmes pyetësorëve standardë, dokumenteve mbështetëse dhe kontributit të tyre zyrtar në procesin e vlerësimit. Nuk është kryer verifikim i pavarur i informacionit; për rrjedhojë, paraqitja pasqyron nivelin dhe cilësinë e të dhënave të ofruara nga vetë organizatat.

### **Kontributet e organizatave kryesore**

**Fondacioni Jahjaga** ka luajtur rol të qenësishëm në mbështetjen e viktimave/të mbijetuarave /mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës dhe në avokimin për të drejtat e grave dhe vajzave. Ai ka zhvilluar fushata ndërgjegjësimi, ka ndërtuar kapacitete të profesionistëve/profesionistëve të sektorit publik dhe ka kontribuar në promovimin e qasjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në shërbime, përfshirë edhe zbatimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Sfidë mbetet mungesa e financimit afatgjatë dhe mospasja e një mekanizmi formal raportimi OSHC–institucione.

**Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK)** është udhëheqës në koordinimin e strehimoreve dhe në monitorimin e zbatimit të politikave për dhunën me bazë gjinore. RRGK mbështet rreth 1,200 viktima/të mbijetuara/mbijetuar në vit, publikon raporte vjetore monitorimi dhe avokon për integrimin e perspektivës gjinore në buxhetimin komunal. RRGK ka kontribuar në hartimin e Protokollit Shtetëror për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës Seksuale (2022), së bashku me UN Women dhe IML. Sfidë kryesore mbetet financimi i qëndrueshëm i strehimoreve. Kontributi i RRGK përbën një shtyllë kyçe në ofrimin e shërbimeve dhe në monitorimin e pavarur të politikave publike.

**Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)** ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, analizimit të dënimeve dhe ndjekjes së respektimit të afateve procedurale. Raportimet e tij kanë evidentuar nevojën për rritjen e specializimit gjyqësor dhe rritjen e

qasjes në të dhënat gjyqësore, e cila mbetet sfida kryesore. Gjetjet e IKD kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe identifikimin e boshllëqeve në sistemin e drejtësisë.

**Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)** ka realizuar studime analitike mbi dimensionin e sigurisë së dhunës me bazë gjinore dhe perceptimet publike për reagimin e Policisë së Kosovës. Ajo ka ofruar trajnime për oficeret/oficerët e zbatimit të ligjit dhe studentet/studentët e Akademisë së Sigurisë. Sfidat kryesore lidhen me mungesën e integritetit të analizës gjinore në politikat e sigurisë dhe mungesën e të dhënave të ndjeshme gjinore.

**Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)**, si një nga strehimoret më të mëdha në vend, ka ofruar strehim dhe shërbime për mbi 600 gra dhe fëmijë, si dhe mbështetje indirekte për rreth 200 raste shtesë. Ajo është pjesë aktive e MKL-ve dhe bashkëpunon me komunat dhe Ministrinë e Drejtësisë. Sfidë mbetet mungesa e një mekanizmi të formalizuar raportimi OSHC–institucione.

**Qendra për Mbrojtjen e Grave Pejë (QMG)**, funksionon si strehimore rajonale 24/7, duke mbuluar disa komuna të rajonit të Dukagjinit. Ka trajtuar mbi 300 raste gjatë periudhës 2022–2025. Sfidat lidhen me financimin e pa qëndrueshëm dhe mungesën e burimeve të specializuara psikologjike.

Këto organizata përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve të specializuara në nivel vendi.

**Qendra SIT – Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime**, ka një rol unik në punën me kryerësit e dhunës, të miturit në konflikt me ligjin dhe në parandalimin e dhunës tek djemtë dhe burrat. Në periudhën 2022–2025, ka punuar me 385 burra/djem të vetë referuar, 90 të mitur në qendrat korrektuese dhe 65 burra në burgje, si edhe ka zhvilluar fushata edukative dhe trajnime për Policinë e Kosovës. Sfidë mbetet mungesa e përfshirjes së tyre në monitorimin institucional dhe mungesa e financimeve të qëndrueshme.

Tabela 17: Përmbledhje Krahasuese

ORGANIZATA	FOKUSI KRYESOR	PËRFITUES 2022–2025	PARTNERË INSTITUCIONALE	SFIDAT KRYESORE
Fondacioni Jahjaga	Viktimat / të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe përfaqësimi publik	500+ gra	MD, Zyra e Presidentes, UN Women	Financim i pasigurt
RRGK	Monitorim, strehim, avokim	1,200+ viktima / të mbijetuara / mbijetuar në vit	MD, ABGJ, Komunat	Burime të kufizuara për strehimoret
IKD	Monitorim i sistemit të drejtësisë	Jo e aplikueshme	KPK, KGJK	Qasje e kufizuar në të dhëna
QKSS	Hulumtime dhe siguri gjinore	150 profesionist/e	PK, Akademia e Sigurisë	Mungesë integriteti të analizës gjinore
QMGF	Strehim dhe mbështetje për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit	600 gra dhe fëmijë	MD, Komunat, Zyra e Presidentes	Pa mekanizëm raportimi OSHC–shtet

<b>QMG Pejë</b>	Strehim rajonal	300 raste	MKL-të, MD	Financim i pasigurt
<b>SIT</b>	Punë me kryerësit e dhunës dhe parandalim	540 burra/djem	Shërbimi Korrektues, MD	Mungesë përfshirjeje në monitorim

*Burimi: Të dhënat e raportuara nga OIQ përmes plotësimit të pyetësorëve në kuadër të këtij vlerësimi*

*Shënim metodologjik: Të dhënat në këtë tabelë bazohen ekskluzivisht në raportimet e vetë organizatave dhe nuk përfaqësojnë verifikim të pavarur. Për rrjedhojë, interpretimi duhet të bëhet duke marrë parasysh ndryshimet në kapacitetet e raportimit dhe standardizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave.*

**Analizë sintetike.** Roli i OSHC-ve ka qenë vendimtar për zbatimin praktik të Strategjisë Kombëtare 2022–2026, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve të specializuara, reagimin e parë, riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, edukimin e komunitetit dhe punën me kryerësit e dhunës. Ato kanë zgjeruar qasjen në strehim, kanë forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe kanë ofruar monitorim të pavarur mbi zbatimin e ligjeve dhe politikave. Megjithatë, sfidat e përbashkëta mbeten të rëndësishme dhe lidhen me:

- mungesën e financimeve të qëndrueshme për strehimoret dhe shërbimet specializuara;
- mungesën e mekanizmave formalë të raportimit OSHC–institucione;
- varësinë e lartë nga projektet donatore;
- mungesën e integritit të plotë të analizës gjinore në sektorin e sigurisë dhe drejtësisë;
- nevojën për përfshirje më sistematike të OSHC-ve në proceset e monitorimit institucional.

Në tërësi, OSHC-të përbëjnë një komponent thelbësor dhe të pazëvendësueshëm të sistemit të mbrojtjes, duke mbuluar një pjesë të konsiderueshme të shërbimeve të specializuara dhe duke kontribuar në monitorimin dhe përmirësimin e politikave publike. Megjithatë, qëndrueshmëria e këtij roli mbetet e rrezikuar për shkak të varësisë së lartë nga financimi i donatorëve dhe mungesës së mekanizmave të formalizuar të integritit në sistemin institucional.

Për të garantuar efektivitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë, është e nevojshme të institucionalizohet bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve publike, të sigurohet financim i parashikueshëm dhe të harmonizohen mekanizmat e raportimit dhe të mbledhjes së të dhënave, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë ka qenë vendimtare për funksionimin dhe zgjerimin e shërbimeve të OSHC-ve, duke kompensuar boshllëqet në financimin publik dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ndërhyrjeve.

Një pjesë e konsiderueshme e shërbimeve të specializuara dhe shërbimeve mbështetëse është mundësuar falë financimit dhe asistencës teknike të partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht UN Women, e cila gjatë 2022–2025 ka mbështetur rreth 12 OSHC që ofrojnë ndihmë juridike falas, këshillim psikosocial, shërbime të strehimit, riintegrim dhe ndërgjegjësim komunitar. Kjo mbështetje ka rritur disponueshmërinë e shërbimeve për

viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, ka forcuar qasjen e tyre në drejtësi dhe ka lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve publike dhe sektorit joqeveritar.

Ndryshe nga organizatat tjera ndërkombëtare, Banka Botërore nuk ka mbështetur drejtpërdrejt OSHC-të gjatë periudhës së vlerësimit, pasi projektet me ndikim potencial në fushën e dhunës me bazë gjinore janë ende në fazë të përgatitjes dhe nuk kanë hyrë në zbatim. UNICEF ka financuar dhe ngritur kapacitetet e 7 OSHC-ve që ofrojnë shërbime të fokusuara tek fëmijët dhe familjet vulnerabël, përfshirë mbështetje psikosociale, programe për fëmijët në situatë rruge, këshillim prindërimi dhe ndërhyrje komunitare. Përmes këtyre partneriteteve, është zgjeruar qasja në shërbime të personalizuar, është forcuar identifikimi i hershëm i rasteve dhe janë përmirësuar mekanizmat komunitarë të reagimit.

UNMIK ka mbështetur një sërë organizatash të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të grave, përmes granteve të dedikuara për fuqizimin ekonomik, mbështetjen psikosociale, ngritjen e kapaciteteve dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit. Kjo mbështetje ka rritur qëndrueshmërinë e OSHC-ve dhe ka përmirësuar qasjen e grave dhe vajzave nga komunitetet e marginalizuara në shërbime të orientuara drejt rimëkëmbjes dhe integritimit socio-ekonomik.

UNFPA ka mbështetur një gamë të gjerë OSHC-sh që punojnë në parandalimin e dhunës, qasjen në shërbime të orientuara drejt të mbijetuarave, trajtimin e kryerësve, aktivizmin artistik dhe ndryshimin e normave sociale. Mbështetja ka përfshirë financim, ngritje kapacitetsh, asistencë teknike dhe partneritete me organizata të komuniteteve fetare, rinore dhe organizata të grave. Kjo ka përforcuar kapacitetet e OSHC-ve për të ofruar ndërhyrje të qëndrueshme, cilësore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

EULEX ka mbështetur disa OSHC që operojnë në fushën e dhunës me bazë gjinore, përfshirë organizata që implementojnë standardet e Konventës së Stambollit, organizata rinore dhe organizata profesionale të grave në sektorin e sigurisë. Mbështetja për këto OSHC ka përfshirë ngritjen e kapaciteteve, trajnime për standardet ndërkombëtare dhe forcimin e rolit të tyre në avokim dhe monitorim.

Këshilli i Evropës ka kontribuar gjithashtu në rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për avokim, ndërgjegjësim dhe monitorim të zbatimit të Konventës së Stambollit. Organizatat janë mbështetur me ekspertizë për zhvillimin e një qasjeje të standardizuar në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna, si dhe për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe trajtimin e kryerësve të dhunës. Mbështetja ka përfshirë gjithashtu iniciativa për promovimin e sigurisë në hapësirat digjitale, veçanërisht për të rejtat/rinjë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e formave të reja të dhunës të facilituara nga teknologjia.

BE ka financuar një numër të madh OSHC-sh që punojnë në parandalim, mbrojtje, shërbime, edukim, avokim dhe monitorim – përfshirë KWN, KGSC, ATRC, D4D, KEC, WEntrepreneur, SPPF Gjilan dhe Save the Children. Mbështetja ka përforcuar rolin e tyre në zbatimin e programeve transformuese, promovimin e standardeve të BE-së, ndërgjegjësimin për dhunën me bazë gjinore dhe sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime.

OSBE ka ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë teknike për OSHC-të përmes trajnimeve, mentorimit dhe përfshirjes së tyre në mekanizmat lokalë të koordinimit. Megjithëse Misioni nuk ofron financim të drejtpërdrejtë për OSHC-të, ai ka kontribuar dukshëm në rritjen e kapaciteteve të tyre për avokim, ndërgjegjësim, qasje të orientuar drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit dhe pjesëmarrje në proceset e politikëbërjes.

Gjetjet e këtij seksioni konfirmojnë gjithashtu rëndësinë e përmirësimit të kornizës së treguesve dhe sistemeve të të dhënave (shih kapitullin 4), si parakusht për matjen e kontributit real të OSHC-ve në arritjen e rezultateve të Strategjisë.

## **5.7. MBËSHTETJA E PARTNERËVE NDËRKOMBËTARË DHE DONATORËVE**

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë ka qenë një komponent i rëndësishëm plotësues i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore 2022–2026. Kontributet e institucioneve ndërkombëtare dhe donatorëve janë reflektuar kryesisht në ngritjen e kapaciteteve, asistencën teknike, harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional.

Në këtë kuadër, analiza fokusohet në tre dimensione kryesore të kontributit të partnerëve ndërkombëtarë: (i) ngritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale, (ii) harmonizimi i politikave dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, dhe (iii) mbështetja për koordinimin ndërinstytucional dhe ofrimin e shërbimeve.

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të kontributit të partnerëve ndërkombëtarë vetëm mbi bazën e pyetësorëve të dorëzuar zyrtarisht dhe informacionit të raportuar prej tyre. Për të ruajtur balancën institucionale, paraqitja e mëposhtme ka karakter informues dhe nuk përbën vlerësim krahasues të kontributit ndërmjet aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë.

### **Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)**

SDC ka qenë një partner i rëndësishëm zhvillimi në Kosovë në forcimin e qeverisjes lokale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike për qytetaret/qytetarët, përfshirë grupet vulnerabël dhe gratë. Përmes programeve të bashkëpunimit zhvillimor, të zbatuara në bashkëpunim me institucionet qendrore, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile, SDC ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të institucioneve vendore dhe në përmirësimin e mekanizmave të koordinimit në nivel lokal. Këto ndërhyrje kanë ndihmuar në forcimin e rolit të komunave në ofrimin e shërbimeve sociale dhe në krijimin e kushteve më të favorshme për funksionimin e mekanizmave lokalë të koordinimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Përmes mbështetjes për qeverisjen lokale, fuqizimin e shoqërisë civile dhe përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare, SDC ka kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve më gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor. Megjithatë, për funksionimin efektiv dhe të qëndrueshëm të mekanizmave lokalë mbetet e rëndësishme forcimi i koordinimit ndërinstytucional dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimet në nivel komunal.

### **Banka Botërore (World Bank)**

Banka Botërore ka kontribuar në mënyrë të tërthortë në zbatimin e Strategjisë përmes projekteve që mbështesin qeverisjen e mirë, zhvillimin social, analizat gjinore dhe dixhitalizimin e shërbimeve publike. Edhe pse nuk ka pasur ndërhyrje të dedikuara për dhunën ndaj grave, programet e BB në kapitalin njerëzor, politikat sociale dhe reduktimin e pabarazive ekonomike kanë ndikuar pozitivisht në adresimin e faktorëve rrënjësorë të dhunës dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për planifikim dhe raportim.

### **Bashkimi Evropian (BE)**

BE ka mbështetur në mënyrë të qëndrueshme zbatimin e Strategjisë përmes projekteve shumëvjeçare që synojnë forcimin institucional, rritjen e kapaciteteve profesionale të policisë, prokurorisë, gjyqësorit dhe shërbimeve sociale, si dhe avancimin e harmonizimit me acquis të BE-së. Ndërhyrjet e financuara nga BE kanë qenë kryesisht të fokusuara në parandalim, qasje në drejtësi dhe përmirësimin e koordinimit ndërsektorial, duke ofruar asistencë teknike, trajnime dhe mbështetje për mekanizmat lokalë dhe qendrorë të reagimit. Kontributi i BE-së ka qenë plotësues ndaj përgjegjësi të institucioneve vendore, me ndikim në forcimin e standardeve dhe proceseve të orientuara drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit. Kontributi i BE-së ka ndikuar në përshpejtimin e procesit të harmonizimit me acquis dhe në forcimin e standardeve institucionale të reagimit.

### **Këshilli i Evropës (KiE)**

KiE ka mbështetur zbatimin e Strategjisë kryesisht përmes asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve që synojnë harmonizimin e praktikave me Konventën e Stambollit. Kontributet e KiE janë fokusuar në zhvillimin e akteve nënligjore, standardizimin e procedurave ndërsektoriale, trajnimin e profesionisteve/profionistëve në polici, drejtësi, arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale, si dhe në forcimin e programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës. Mbështetja e KiE ka qenë plotësuese ndaj mandatit të institucioneve lokale dhe ka ndihmuar në përforcimin e standardeve profesionale dhe qasjes së orientuar drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit. Mbështetja e KiE ka qenë kritike për përputhjen me kërkesat e Konventës së Stambollit dhe për avancimin e praktikave profesionale ndërsektoriale.

### **EULEX Kosovë**

EULEX ka mbështetur zbatimin e Strategjisë përmes forcimit të kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit, veçanërisht policisë dhe prokurorisë, me fokus në standardizimin e praktikave procedurale dhe qasjen e orientuar drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit. Kontributi i Misionit është reflektuar në trajnime të specializuara, përmirësimin e menaxhimit të rasteve, mbështetjen për dhomat e intervistimit dhe promovimin e bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë. Mbështetja e EULEX ka qenë plotësuese ndaj strukturave vendore, duke ndihmuar në forcimin e profesionalizmit dhe transparencës në trajtimin e rasteve të dhunës.

### **Mbretëria e Bashkuar (UK)**

Mbretëria e Bashkuar ka mbështetur avancimin e grave në sektorin e sigurisë, trajnimin e policisë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit të hershëm. Përmes partneritetit me MPB dhe Policinë e Kosovës, janë përmirësuar kapacitetet profesionale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke forcuar qasjen të ndjeshme gjinore dhe duke nxitur përfaqësimin e grave në pozita drejtuese. Megjithatë mbështetja ka qenë e fokusuar dhe efektive, mbetet nevoja për institucionalizimin e moduleve të trajnimit për të siguruar qëndrueshmëri.

### **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE–OMiK)**

OSBE ka mbështetur institucionet vendore përmes programeve të qëndrueshme të ngritjes së kapaciteteve për policinë, prokurorinë, gjykatat dhe shërbimet sociale, si dhe përmes mbështetjes së Mekanizmave Komunalë të Referimit. Kontributi i OSBE-së është reflektuar në trajnime të specializuara, monitorim të gjykimeve dhe rekomandime për përmirësimin e qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve. Mbështetja e Misionit ka ndihmuar forcimin e koordinimit ndër-institucional dhe përputhjen e praktikave me standardet ndërkombëtare.

### **Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)**

SIDA ka ofruar bashkëfinancim afatgjatë për programe që synojnë barazinë gjinore, shërbimet e integruara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, fuqizimin ekonomik të grave dhe avancimin e politikave të mbrojtjes sociale. Mbështetja e saj përmes UN Women dhe UNFPA ka ndihmuar në forcimin e infrastrukturës institucionale dhe rritjen e kapaciteteve profesionale në nivel qendror e lokal. Koordinimi më i ngushtë me institucionet vendore do të kontribuonte në rritjen e ndikimit afatgjatë të ndërhyrjeve.

### **UN Women**

UN Women ka mbështetur zbatimin e Strategjisë përmes programeve të orientuara drejt parandalimit, fuqizimit institucional dhe avancimit të standardeve të barazisë gjinore. Kontributi i saj është reflektuar në hartimin e instrumenteve të integrimit gjinor, trajnimin e profesionistëve të MKL-ve, policisë dhe shërbimeve sociale, si dhe në mbështetjen e fushatave komunitare dhe mekanizmave të koordinimit. Ndërhyrjet kanë qenë plotësuese ndaj institucioneve vendore, duke forcuar reagimin shumësektorial ndaj dhunës. Ndërhyrjet e UN Women kanë luajtur rol kyç në integrimin e perspektivës gjinore dhe në forcimin e qasjes shumësektoriale ndaj dhunës

### **UNFPA**

UNFPA ka kontribuar përmes programeve të fokusuara në shëndetin seksual dhe riprodhues, edukimin e të rinjve dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore dhe sociale. Mbështetja e UNFPA ka adresuar faktorët e riskut dhe nevojat e grupeve vulnerabël, duke përfshirë adoleshentet/adoleshentët, gratë e reja dhe komunitetet në rrezik. Kontributi i tij ka qenë plotësues, duke përmirësuar ndërgjegjësimin, parandalimin dhe qasjen në shërbime të integruara.

### **UNICEF**

UNICEF ka mbështetur institucionet vendore kryesisht në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, përmes zhvillimit të politikave, protokolleve dhe programeve që adresojnë fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë të dhunës. Kontributet e UNICEF janë reflektuar në trajnimin e profesionistëve/profesionistëve, forcimin e sistemit të referimit dhe avancimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve në rastet e dhunës në familje. Mbështetja ka qenë plotësuese ndaj strukturave vendore, veçanërisht në OS III dhe OS IV.

### **UNMIK**

ka kontribuar në mënyrë të kufizuar, por të qëndrueshme, përmes mbështetjes së monitorimit të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe raste që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në

familje. Kontributi i tij është fokusuar në mbledhjen e të dhënave, raportimin e trendeve dhe ofrimin e rekomandimeve për forcimin e qasjes në drejtësi dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Roli i UNMIK ka qenë informues dhe plotësues ndaj mekanizmave shtetërorë.

### **Përmbledhje analitike**

Në tërësi, mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë ka qenë thelbësore për konsolidimin e sistemit të mbrojtjes dhe për avancimin e standardeve institucionale në Kosovë. Megjithatë, qëndrueshmëria afatgjatë e këtyre rezultateve mbetet e varur nga institucionalizimi i praktikave të mbështetura nga donatorët, forcimi i koordinimit ndërmjet aktorëve dhe integrimi i plotë i mekanizmave të raportimit dhe të të dhënave.

Në këtë kuadër, kërkohet një qasje më e koordinuar dhe e orientuar drejt rezultateve, që siguron komplementaritet të ndërhyrjeve dhe shmang fragmentimin, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

## **5.8. VLERËSIM I INTEGRUAR NDËR-INSTITUCIONAL I PROGRESIT DHE ZBATIMIT TË STRATEGJISË**

Gjatë periudhës 2022–2025, të dhënat e mbledhura përmes raportimeve institucionale, pyetësorëve standardë dhe dokumentacionit mbështetës tregojnë një konsolidim të ndjeshëm të sistemit të mbrojtjes nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje e dhuna në baza gjinore në Kosovë. Analiza ndër-institucionale vë në dukje se bashkërendimi ndërmjet institucioneve qendrore, mekanizmave lokalë të koordinimit, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë është thelluar gradualisht, duke kontribuar në adresimin e detyrimeve të Strategjisë Kombëtare 2022–2026. Progresi është i dukshëm sidomos në fushat e koordinimit ndërsektorial, ngritjes së kapaciteteve profesionale, përmirësimit të qasjes në shërbime dhe forcimit të mekanizmave të referimit.

Për qëllime sintetizuese, ky vlerësim i integruar strukturohet në tre dimensione kryesore: (i) progresi i arritur në nivel institucional dhe ndërinstitucional, (ii) boshllëqet strukturore që vazhdojnë të ndikojnë në efektivitetin e sistemit, dhe (iii) implikimet për fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë dhe për kornizën e ardhshme strategjike.

Të dhënat tregojnë se institucionet qendrore, kanë rritur efikasitetin operacional, kanë avancuar përdorimin e sistemit elektronik të raportimit dhe kanë intensifikuar bashkëpunimin me mekanizmat lokalë të koordinimit. Megjithëse nivelet e kapaciteteve ndryshojnë mes institucioneve dhe rajoneve, tendenca e përgjithshme është drejt standardizimit më të madh të praktikave, rritjes së transparencës dhe përmirësimit të reagimit ndërinstitucional.

Në nivel komunal, ngritja e 38 Mekanizmave Koordinues Lokalë ka krijuar një bazë të rëndësishme për harmonizimin e reagimit institucional. Raportimet tregojnë se shkalla e funksionalitetit ndryshon, por në përgjithësi MKL-të po evoluojnë drejt qasjeve më sistematike, me pjesëmarrje të rregullt të aktorëve sektorialë dhe kapacitete të rritura për

trajtimin e rasteve. Megjithatë, shumë prej tyre ende përballen me mungesë burimesh njerëzore dhe financiare, me mungesë standardizimi të dokumentimit të takimeve dhe me vështirësi në sinkronizimin e të dhënave me nivelin qendror.

Organizatat e shoqërisë civile mbeten një pjesë qenësore e sistemit, duke ofruar shërbime të specializuara që plotësojnë hapësirat e lëna nga institucionet publike, përfshirë strehimin emergjent, shërbimet psiko-sociale, punën me kryerësit e dhunës, monitorimin e pavarur dhe ndërgjegjësimin publik. Raportimet nga OSHC-të pasqyrojnë rritje të kërkesave për shërbime dhe zgjerim të ndërhyrjeve, por njëkohësisht nxjerrin në pah sfida strukturore, të lidhura kryesisht me financimin afatgjatë, mungesën e mekanizmave të formalizuar të raportimit dhe integrimin e analizës gjinore në politikat e sigurisë dhe drejtësisë.

Kontributi i partnerëve ndërkombëtarë ka qenë vendimtar në disa fusha kyçe: standardizimin e trajnimeve, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, forcimin e koordinimit ndërinstytucional, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe harmonizimin e praktikave vendore me standardet ndërkombëtare të Konventës së Stambollit, BE-së dhe agjencive të OKB-së. Mbështetja e tyre ka mundësuar avancim të qëndrueshëm, por vlerësimi tregon se nevojitet një mekanizëm më i integruar koordinimi të donatorëve, për të shmangur fragmentimin e ndërhyrjeve dhe për të garantuar qëndrueshmëri të rezultateve.

Analiza konfirmon gjithashtu kufizimet e identifikuara në sistemin e treguesve dhe të dhënave (shih kapitullin 4), ku mungesa e standardizimit dhe baseline-ve për një pjesë të treguesve kufizon matjen e rezultateve dhe ndikimit të ndërhyrjeve.

Në mënyrë sintetike, gjetjet ndër-institucionale tregojnë se sistemi i reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore është forcuar, por mbeten sfida të rëndësishme lidhur me integrimin e plotë elektronik të të dhënave, sigurimin e financimit afatgjatë për shërbimet publike dhe të specializuara, standardizimin e moduleve të trajnimit dhe instrumenteve të matjes së ndikimit dhe reduktimin e pabarazive ndërmjet komunave urbane dhe rurale. Ky sintetizim përbën një bazë të fortë për rekomandimet e kapitullit vijues dhe orienton qartësisht fushat ku nevojiten ndërhyrje të përsheptuara deri në përmbylljen e Strategjisë në vitin 2026. Këto sfida kanë karakter transversal dhe ndikojnë në të gjithë zinxhirin institucional të reagimit, nga identifikimi dhe referimi i rasteve deri te mbrojtja, drejtësia dhe riintegrimi.

Në këtë kontekst, viti 2026 përfaqëson fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë, ku prioriteti kryesor zhvendoset nga zgjerimi i ndërhyrjeve drejt konsolidimit të arritjeve, adresimit të boshllëqeve strukturore dhe sigurimit të qëndrueshmërisë institucionale.

Ky tranzicion kërkon një orientim të qartë drejt rezultateve të matshme, forcimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit, rritjen e llogaridhënies ndërinstytucionale dhe ndërtimin e një kornize të re strategjike të bazuar në evidencë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

Gjetjet e këtij kapitulli përbëjnë bazën analitike për formulimin e rekomandimeve të paraqitura në kapitullin vijues.

## 6. GJETJET, SFIDAT DHE REKOMANDIMET

### 6.1. GJETJET KRYESORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM

Vlerësimi afatmesëm tregon se zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 ka sjellë përparime të dukshme në forcimin e kornizës ligjore, funksionalizimin e mekanizmave të koordinimit, standardizimin e shërbimeve dhe profesionalizimin e reagimit institucional. Megjithatë, përmasat e dhunës, pabarazitë strukturore dhe mungesa e plotë e integritit të sistemeve të të dhënave kërkojnë përmirësime të mëtejshme në fazën përfundimtare të zbatimit.

Analiza sintetike e kapitujve pararendës një progres të qëndrueshëm në harmonizimin ligjor, forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe zgjerimin e shërbimeve, të shoqëruara me sfida strukturore që lidhen kryesisht me integrimin e të dhënave, kapacitetet e pabarabarta komunale, financimin e qëndrueshëm dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Në këtë kontekst, ndërhyrjet e partnerëve ndërkombëtarë kanë luajtur rol mbështetës, ndërsa përgjegjësia kryesore për zbatimin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve mbetet te institucionet shtetërore qendrore dhe lokale.

Për qëllime analitike, gjetjet kryesore strukturohen në gjashtë fusha tematike:

#### 1. Korniza ligjore dhe përputhja me standardet ndërkombëtare

Ligji Nr. 08/L-185 ka vendosur një kornizë të avancuar, duke përfshirë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me Konventën e Stambollit, CEDAW dhe Direktivën e BE-së 2024/1385 për luftimin e dhunës ndaj grave. Miratimi i akteve nënligjore ka siguruar operacionalizimin e dispozitave kyçe, përfshirë funksionimin e Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar, Linjën Emergjente Kombëtare dhe Fondin për Viktimat e Dhunës.

Korniza ligjore është e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare; megjithatë, zbatimi praktik kërkon forcim të mekanizmave të mbikëqyrjes, rritje të analizës gjinore sektoriale dhe lidhje më të drejtpërdrejta ndërmjet legjislacionit dhe praktikave institucionale.

#### 2. Fuqizimi institucional dhe koordinimi ndërsektorial

Funksionalizimi i Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar dhe ngritja e 38 MKL-ve kanë forcuar ndjeshëm koordinimin vertikal dhe horizontal. Raportimi vjetor është përmirësuar dhe bashkëpunimi me OSHC-të ka zgjeruar rrjetin e ofrimit të shërbimeve.

Megjithatë, funksionaliteti i plotë i mekanizmave mbetet i pabarabartë. Në shumë komuna mungojnë staf i dedikuar, burime të qëndrueshme buxhetore dhe procedura të unifikuar

raportimi. Standardizimi i praktikave dhe institucionalizimi i funksionimit të MKL-ve mbeten sfida kyçe, veçanërisht në zonat rurale.

### **3. Parandalimi dhe ndërgjegjësimi publik**

Janë realizuar fushata të gjera ndërgjegjësimi dhe aktivitete edukative që adresojnë mostolerimin e dhunës, barazinë gjinore dhe rolin e komunitetit. Edukimi gjinor është zgjeruar në shkolla dhe komunitete.

Megjithatë, mungon një sistem i strukturuar për matjen e ndikimit të fushatave, përfshirja e burrave dhe djemve mbetet e kufizuar dhe nuk ka studime të përditësuara mbi perceptimet publike për normat gjinore, duke kufizuar vlerësimin e ndryshimeve afatgjata.

### **4. Qasja në drejtësi dhe ndihma juridike**

Qasja në drejtësi është përmirësuar përmes zgjerimit të ndihmës juridike falas, trajnimeve profesionale dhe përdorimit të sistemeve elektronike për evidentim të rasteve.

Megjithatë, proceset gjyqësore mbeten të gjata, zbatimi i urdhrave të mbrojtjes nuk është uniform dhe rastet e dhunës seksuale vazhdojnë të jenë të nën-raportuara për shkak të barrierave strukturore, sociale dhe institucionale.

### **5. Shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe qëndrueshmëria financiare**

Cilësia e shërbimeve të strehimoreve dhe shërbimeve psikosociale është përmirësuar, ndërsa bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe OSHC-ve është forcuar. Buxhetet publike për strehimoret kanë shënuar rritje graduale.

Megjithatë, mbulimi gjeografik mbetet i pabarabartë dhe shërbimet në zonat rurale janë të kufizuara. Varësia nga financimi i donatorëve vazhdon të jetë e lartë, veçanërisht për programet e riintegritimit dhe trajtimit të kryerësve të dhunës.

### **6. Monitorimi, të dhënat dhe treguesit gjinorë**

Baza Kombëtare e të Dhënave është konsoliduar dhe raportimi institucional është përmirësuar. Megjithatë, integrimi i plotë elektronik ndërmjet institucioneve (ministritë, policia, prokuroria, QPS-të dhe ASK) nuk është arritur ende.

Ekzistojnë dallime në periudhat e raportimit dhe mungojnë tregues të detajuar gjinorë sipas moshës, etnisë dhe statusit socio-ekonomik. Sistemi i të dhënave po konsolidohet gradualisht, por kërkon harmonizim të plotë, standardizim dhe forcim të kapaciteteve për analizë gjinore.

Të dhënat administrative dhe raportimet institucionale për vitin 2025 konfirmojnë trendin e vazhdueshëm të forcimit të përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke reflektuar konsolidimin gradual të mekanizmave ndërinstytucionale dhe vijimësinë e zbatimit të masave të Strategjisë.

Partnerët ndërkombëtarë kanë luajtur rol plotësues në përforcimin e kapaciteteve dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, rritja e ndikimit të tyre kërkon një koordinim më të integruar dhe një orientim më të qartë drejt prioriteteve kombëtare dhe qëndrueshmërisë afatgjatë.

## 6.2. SFIDA TË PËRGJITHSHME

Megjithëse gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë janë arritur përparime të rëndësishme në konsolidimin e kornizës ligjore dhe institucionalizimin e mekanizmave të reagimit ndaj dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, analiza identifikon një sërë sfidash sistematike që vazhdojnë të ndikojnë në efektivitetin, koherencën dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zbatimit:

- mungesa e integritit të plotë dhe standardizimit të sistemeve të të dhënave dhe raportimit ndërinstytucional;
- pabarazi territoriale në qasjen në shërbime dhe kapacitete ndërmjet komunave;
- burime të pamjaftueshme dhe jo të qëndrueshme për MKL-të, strehimoret dhe programet e riintegrit;
- mungesa e matjes sistematike të ndikimit të ndërhyrjeve parandaluese dhe përfshirje e kufizuar e burrave dhe djemve;
- varësi e konsiderueshme nga financimet e donatorëve për shërbime dhe programe kyçe;
- zhvillim i pamjaftueshëm i programeve për trajtimin e kryerësve dhe për fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave;
- mungesë e studimeve të përditësuara mbi normat gjinore dhe perceptimet shoqërore;
- kapacitete të kufizuara analitike dhe planifikuese në nivel lokal;

koordinim ende i pjesshëm ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe ofruesve të shërbimeve.

Këto sfida kanë karakter transversal dhe ndikojnë në të gjithë zinxhirin institucional të reagimit, nga identifikimi dhe referimi i rasteve deri te mbrojtja, drejtësia dhe riintegrimi.

Në mënyrë të veçantë, mungesa e një platforme të integruar për koordinimin me partnerët ndërkombëtarë kufizon sinkronizimin e ndërhyrjeve dhe përdorimin optimal të burimeve, ndërsa boshllëqet në sistemin e treguesve dhe të dhënave vështirësojnë matjen e progresit dhe ndikimit të Strategjisë.

Nga këndvështrimi i partnerëve ndërkombëtarë, disa sfida të rëndësishme mbeten të pranishme: (i) kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe teknike në nivel qendror dhe komunal; (ii) ndryshimet e shpeshta të udhëheqjes institucionale që ndikojnë në kontinuitetin e zbatimit; (iii) mospërputhjet dhe boshllëqet në sistemet e raportimit dhe të shkëmbimit të të dhënave ndërinstytucionale; dhe (iv) vështirësia në matjen e një pjese të treguesve të Strategjisë, të cilët rezultojnë jorealiste ose jo të harmonizuara me kapacitetet ekzistuese të mbledhjes së të dhënave.

Nga perspektiva e Bankës Botërore, një nga sfidat strukturore lidhet me vonesat në ratifikimin e projekteve të mëdha që kanë komponentë të rëndësishëm në forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që lidhen indirekt me dhunën me bazë gjinore. Kjo vonesë ndikon në pamundësinë për të përfshirë në kohë të gjitha komponentët e parashikuar të Strategjisë, përfshirë trajnimet e stafit shëndetësor dhe integrimin e referimit të rasteve të dhunës në politikat e kujdesit shëndetësor.

Nga perspektiva e UNICEF, sfidat kryesore në zbatimin e masave lidhen me mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe komunal, mospërputhjet në koordinimin horizontal dhe vertikal ndërmjet institucioneve, mungesën e shërbimeve komunitare për identifikimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktimat/të mbijetuar, mungesën e një linje kombëtare për raportimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe mungesën e programeve të unifikuara për ngritjen e kapaciteteve ndër-sektoriale.

Nga perspektiva e UNMIK, sfidat kryesore lidhen me boshllëqet në gjithëpërfshirje, mungesën e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatim, si dhe mangësitë në funksionimin e mekanizmave të koordinimit ndër-institucional. Mungesa e vijueshmërisë institucionale dhe vështirësitë në mbikëqyrjen e progresit reduktojnë efektivitetin e zbatimit të Strategjisë dhe krijojnë pasiguri në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi.

UNFPA identifikon si sfida kyçe mungesën e qëndrueshmërisë financiare për shërbimet e mbrojtjes, mungesën e kapaciteteve të specializuara në qendrat sociale, polici, shëndetësi dhe gjyqësi, si dhe funksionimin jo-optimal të mekanizmave të koordinimit ndër-institucional. Varësia nga financimet afatshkurtra, mungesa e stafit të mjaftueshëm dhe mungesa e databazave të integruara e vështirësojnë adresimin e duhur të rasteve dhe koordinimin në sistem.

Nga perspektiva e EULEX, sfidat kryesore lidhen me mungesën e llogaridhënies efektive, kufizimet në monitorimin e progresit dhe mungesën e angazhimit të qëndrueshëm institucional. Misioni identifikon nevojën për transparencë më të madhe ndër-institucionale dhe koordinim më efektiv si ndër donatorët, ashtu edhe ndër institucionet publike.

Sipas KE, një nga sfidat kryesore në zbatimin e Strategjisë mbetet mungesa e takimeve të rregullta të koordinimit me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve. Bashkëpunimi shpesh është bilateral, çka kufizon shkëmbimin e informacionit dhe qartësinë në prioritetet shumësektoriale. Nevojiten mekanizma më të fortë të koordinimit, monitorimit dhe identifikimit të boshllëqeve.

BE identifikon si sfida kryesore mungesën e prioritizimit të DHF/DHGJ nga një numër institucionesh (shëndetësia, gjyqësori, prokuroria, komunat), mungesën e koordinimit të plotë ndër-institucional, zbatimin e pamjaftueshëm të ligjeve të reja nga gjyqtarët dhe prokurorët, mungesën e funksionimit të elektronikut të monitorimit, dhe pasigurinë në rolet institucionale gjatë periudhës së Strategjisë.

OSBE identifikon tri sfida kyçe: (i) normat e thella kulturore dhe rezistencat në nivel lokal që kufizojnë zbatimin e politikave të barazisë gjinore; (ii) mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe buxhetore në institucionet qendrore dhe komunale; (iii) koordinimin e pamjaftueshëm dhe mungesën e llogaridhënies së qartë ndërmjet institucioneve.

### 6.3. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të mbështesin fazën përfundimtare të zbatimit të Strategjisë (2026), si dhe të ofrojnë orientime strategjike për hartimin e kornizës së re pas vitit 2026. Ato janë të bazuara në gjetjet e vlerësimit dhe në përputhje me Konventën e Stambollit, CEDAW, acquis të BE-së dhe standardet e OKB-së.

#### A. REKOMANDIME STRATEGJIKE

- Sigurimi i integritit të plotë të sistemeve të të dhënave dhe krijimi i një platforme të unifikuar ndërinstucionale për raportim dhe analizë gjinore.
- Kalimi nga ndërhyrje të fragmentuara drejt një qasjeje të koordinuar, të orientuar drejt rezultateve dhe ndikimit.
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm publik për shërbimet bazë, duke reduktuar varësinë nga donatorët.
- Standardizimi i trajnimeve dhe institucionalizimi i moduleve ndërsektoriale.
- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe monitorimit të performancës institucionale.
- Rishikimi i sistemit të treguesve për strategjinë e ardhshme, me fokus në matshmëri, realizueshmëri dhe lidhje me burimet e të dhënave.

#### B. NIVELI QENDROR

- elektronike e plotë e sistemeve të të dhënave ndërmjet institucioneve.
- Harmonizimi i standardeve të raportimit dhe kalendarëve institucionalë.
- Vendosja e linjave buxhetore shumëvjeçare për MKL-të dhe shërbimet e specializuara.
- Krijimi i një skeme të qëndrueshme për riintegrimin ekonomik të viktimave/të mbijetuarave.
- Zgjerimi dhe standardizimi i programeve për trajtimin e kryerësve.
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe llogaridhënies në nivel qendror.
- Zhvillimi i moduleve të përbashkëta të trajnimit ndërinstucional për profesionistet/profesionistët e sektorit të drejtësisë, sigurisë dhe mirëqenies sociale.
- Rishikimi i sistemit të treguesve të strategjisë së ardhshme, duke siguruar:
  - formulim të qartë dhe të matshëm të treguesve;
  - përcaktimin e vlerave bazë të matjes së treguesve në fillim të periudhës strategjike;
  - përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave;
  - integrimin e treguesve me burimet ekzistuese të të dhënave administrative dhe statistikore.

#### C. NIVELI LOKAL

- Sigurimi i stafit të dedikuar dhe buxheteve të qëndrueshme për MKL-të.
- Zgjerimi i shërbimeve të specializuara në zonat rurale (modele ndër-komunale dhe mobile).
- Integrimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në planifikimin komunal.
- Zhvillimi i programeve parandaluese me fokus në përfshirjen e burrave dhe djemve.
- Rritja e kapaciteteve për analizë dhe përdorim të të dhënave.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve/anëtarëve të MKL-ve.

#### **D. ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE**

- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimet e specializuara.
- Zhvillimi i programeve të integruara të riintegrit.
- Forcimi i rolit në monitorim dhe dialog politik.
- Fushata të zgjeruara me përfshirje të burrave, djemve dhe aktorëve komunitarë.
- Zgjerimi i mbulimit territorial përmes partneriteteve me komunat.

#### **E. INSTITUCIONET E PAVARURA**

- Forcimi i rolit mbikëqyrës dhe investigues.
- Rritje e kapaciteteve për monitorim proaktiv dhe investigim të rasteve të shkeljeve.
- Zhvillimi i analizave periodike me tregues gjinorë
- Bashkëpunim më i strukturuar me institucionet dhe MKL-të.

#### **F. PARTNERËT NDËRKOMBËTARË**

- Mbështetje për integrimin dhe digjitalizimin e sistemeve të të dhënave.
- Financim i synuar për programe strukturore (riintegrim, trajtim të kryerësve, parandalim).
- Mbështetje për studime mbi normat gjinore dhe ndikimin e politikave.
- Bashkëpunim rajonal për shkëmbim të praktikave të mira.
- Forcimi i koordinimit ndërdonator për të shmangur fragmentimin.
- Përfshirje e hershme dhe e strukturuar në hartimin e strategjive të reja.

Për të garantuar qëndrueshmërinë e rezultateve dhe për të përshpejtuar progresin në fazën përfundimtare të Strategjisë, kërkohet një zhvendosje nga një qasje e orientuar drejt aktiviteteve drejt një qasjeje të bazuar në rezultate, evidencë dhe llogaridhënie institucionale. Kjo nënkupton forcimin e pronësisë shtetërore, integrimin e plotë të sistemeve të të dhënave, sigurimin e financimit të qëndrueshëm dhe ndërtimin e një kornize të re strategjike të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventës së Stambollit.

Rekomandohet integrimi më sistematik i mbështetjes së donatorëve në planet vjetore dhe buxhetet e institucioneve përgjegjëse, si dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimet e strehimit dhe mekanizmat lokalë të koordinimit. Gjithashtu, është e nevojshme forcimi i shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve dhe përmirësimi i harmonizimit të treguesve të Strategjisë me kapacitetet reale të monitorimit. Donatorët duhet të angazhohen që në fazën e hartimit të strategjive të reja për të shmangur mbivendosjen e ndërhyrjeve dhe për të rritur efektivitetin e përgjithshëm të mbështetjes.

Rekomandohet rritja e koordinimit ndërmjet Qeverisë dhe partnerëve financiarë ndërkombëtarë për të përshpejtuar ratifikimin dhe zbatimin e projekteve të mëdha që ndikojnë në fuqizimin e sistemit shëndetësor dhe institucional. Përfshirja më e hershme dhe më sistematike e donatorëve që financojnë sektorë kyç (si shëndetësia) do të ndihmonte në sinkronizimin e masave të Strategjisë me investimet shumëvjeçare të partnerëve zhvillimorë, si dhe do të shmangte boshllëqet ndërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve kryesore.

Rekomandohet përfshirja më e hershme dhe më e strukturuar e donatorëve, përfshirë UNICEF, në hartimin e strategjive të ardhshme, përmes konsultimeve të rregullta dhe grupeve

teknike të përbashkëta. Kjo do të sigurojë integrimin e praktikave të mira ndërkombëtare, forcimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe harmonizimin e ndërhyrjeve të donatorëve me prioritetet kombëtare, duke shmangur mbivendosjet dhe duke rritur efektivitetin e përgjithshëm.

UNMIK rekomandon forcimin e mekanizmave të përbashkët të koordinimit, përmes grupeve të përhershme të punës ndërinstitucionale dhe komiteteve drejtues, të bazuara në plane veprimi të qarta, role të përcaktuara dhe mekanizma transparentë të raportimit. Rekomandohet gjithashtu vendosja e financimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë për masat e parandalimit dhe mbrojtjes, rritja e kapaciteteve në polici, drejtësi dhe shëndetësi për qasje të standardizuara ndaj të mbijetuarave, si dhe përmirësimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe grupit etnik.

UNFPA rekomandon forcimin e pronësisë institucionale të shtetit përmes buxhetimit të qëndrueshëm të shërbimeve kundër dhunës me bazë gjinore, zhvillimin e planeve të përbashkëta të zbatimit ndërmjet institucioneve dhe donatorëve, ndërtimin e një sistemi qendror të monitorimit të rasteve, rritjen e kapaciteteve të personelit të institucioneve kyçe dhe integrimin e komponentëve të parandalimit në politikat publike dhe sektorin privat përmes politikave familjare miqësore.

EULEX rekomandon rritjen e transparencës dhe harmonizimin e ndërhyrjeve ndërmjet donatorëve dhe institucioneve publike, vendosjen e roleve të qarta për secilin aktor dhe sigurimin e koordinimit të detyrueshëm të ndërhyrjeve. Misioni sugjeron gjithashtu përfshirje më të hershme të donatorëve në hartimin e strategjive të ardhshme dhe zhvillimin e mekanizmave të qartë të monitorimit dhe llogaridhënies.

KiE rekomandon krijimin e një grupi pune gjithëpërfshirës me përfaqësues të institucioneve qendrore, komunale dhe donatorëve ndërkombëtarë gjatë hartimit të strategjive të reja, si dhe rritjen e frekuencës së takimeve të koordinimit. Përdorimi i praktikave të mentorimit, përqendrimi në qasje të bazuar në traumë, si dhe integrimi i ekspertizës së specializuar për Konventën e Stambollit duhet të institucionalizohen.

BE rekomandon që Ministria e Drejtësisë dhe Koordinatori Kombëtar të vazhdojnë të udhëheqin koordinimin e përgjithshëm për DHF/DHBGJ, përfshirë koordinimin e donatorëve dhe drejtimin e procesit të hartimit të politikave. Rekomandohet forcimi i aksesit në drejtësi, profesionalizimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, rritja e dënimeve proporcionale, përmirësimi i mekanizmave të parandalimit (p.sh., monitorimi elektronik), si dhe rritja e koordinimit të brendshëm institucional për të shmangur mbivendosjet dhe humbjen e fondeve.

OSBE rekomandon forcimin e rolit të Koordinatorit Kombëtar për DHF/DHBGJ si platformë qendrore për koordinimin e donatorëve dhe institucioneve, vendosjen e mekanizmave të rregullt të raportimit dhe bashkërendimit, një kalendar të përbashkët për 16 Ditët e Aktivizmit, si dhe forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar qëndrueshmëri dhe evidencë të bazuar në të dhëna.

Përforcimi i koordinimit të rregullt teknik dhe operacional ndërmjet institucioneve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë, përmes një mekanizmi të harmonizuar të raportimit dhe

shkëmbimit të të dhënave, që siguron që ndërhyrjet programore dhe asistencë teknike të adresojnë drejtpërdrejt prioritetet e identifikuar nga Strategjia.

Për strategjinë e ardhshme rekomandohet forcimi i arkitekturës së monitorimit dhe zbatimit të politikave përmes një sistemi më të qartë të treguesve, përcaktimit të vlerave bazë të matjes së tyre në fillim të periudhës strategjike dhe integritit të mekanizmave të raportimit ndërinstitucional në një platformë të harmonizuar të të dhënave administrative. Një kornizë e tillë do të mundësonte matje më të saktë të rezultateve dhe ndikimit të ndërhyrjeve, si dhe do të mbështeste planifikimin e politikave të bazuara në evidencë gjatë periudhës së ardhshme strategjike.

## 6.4. IMPLIKIMET STRATEGJIKE PËR PERIUDHËN 2026–2030/2032

Gjetjet e vlerësimit afatmesëm tregojnë qartë se periudha 2026–2030/2032 do të kërkojë një zhvendosje nga një qasje e fokusuar në ndërtimin e mekanizmave drejt një qasjeje më të integruar, të qëndrueshme dhe transformuese në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ky tranzicion kërkon:

- **konsolidimin dhe përdorimin efektiv të sistemit të të dhënave** përmes ndërlidhjes funksionale ndërmjet MD, Policisë, Prokurorisë, QPS-ve dhe ASK-së;
- **zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm financiar** që garanton mbulimin e plotë të shërbimeve bazë, përfshirë strehimoret, MKL-të dhe programet e riintegrit;
- **integrimin e një qasjeje transformuese gjinore** në politikat e arsimit, medias, sigurisë dhe qeverisjes vendore;
- **rishikimin dhe forcimin e mekanizmave institucionale**, duke përfshirë integrimin sistematik të analizës gjinore në politikat sektoriale, në përputhje me acquis të BE-së;
- **institucionalizimin e programeve për burrat dhe djemtë** si komponent kyç për ndryshimin afatgjatë të normave sociale.

Për strategjinë e re rekomandohet ndërtimi i një arkitekture të re të treguesve të bazuar në tri parime: (i) relevancë direkte ndaj rezultateve strategjike; (ii) matshmëri reale përmes burimeve të identifikuar të të dhënave; (iii) përgjegjësi institucionale të qarta për mbledhjen dhe raportimin.

Në këtë kuadër, treguesit që janë strategjikisht relevantë, por aktualisht të pamatur për shkak të mungesës së baseline-it ose mekanizmave të matjes, duhet të ruhen dhe të shoqërohen me investime në sistemet statistikore dhe administrative. Ndërkohë, treguesit konceptualisht të dobët ose jo operacionalë duhet të riformulohen ose të zëvendësohen, me qëllim ndërtimin e një sistemi monitorimi më të thjeshtë, të besueshëm dhe të përdorshëm për llogaridhënie dhe vendimmarrje.

## 6.5. RREZIQET, KUFIZIMET DHE FAKTORËT NDIKUES NË ZBATIM

Zbatimi i Strategjisë dhe rekomandimeve të këtij vlerësimi rrezikon të ndikohet nga një sërë faktorësh të natyrës institucionale, financiare, sociale dhe politike:

### 1. Rreziqe institucionale

- mungesë e kapaciteteve të specializuara në nivel lokal;
- rotacion i lartë i stafit në MKL, QPS dhe polici;
- harmonizim i pjesshëm i protokolleve ndërmjet institucioneve ligjzbatuese.

### 2. Rreziqe financiare

- varësi e vazhdueshme nga financimet e donatorëve për shërbime kyçe;
- procedura buxhetore komplekse që ngadalësojnë zbatimin në nivel komunal.

### 3. Rreziqe sociale

- stigma ndaj viktimave/të mbijetuarave, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale;
- norma sociale që kufizojnë raportimin;
- përfshirje e ulët e burrave dhe djemve në parandalim.

### 4. Rreziqe ligjore dhe politike

- nevojë për harmonizim të mëtejshëm me Direktivën e BE-së 2024/1385;
- pasiguri politike që mund të ndikojnë prioritetet dhe financimet;
- vonesa në miratimin e akteve nënligjore.

## 6.6. MËSIMET TË NXJERRA DHE DREJTIMET PËR FAZËN PËRFUNDIMTARE

### Përfundime të përgjithshme

Strategjia ka vendosur themelet për një sistem të qëndrueshëm të parandalimit, mbrojtjes dhe riintegritit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve. Të dhënat, përfshirë vitin 2025, konfirmojnë një trend të qëndrueshëm të konsolidimit institucional dhe përmirësimit të reagimit ndërinstitucional.

Megjithatë, faza përfundimtare kërkon fokus të shtuar në:

- konsolidimin e sistemeve të të dhënave;
- forcimin e kapaciteteve lokale;
- sigurimin e financimit të qëndrueshëm;
- zgjerimin e ndërhyrjeve transformuese gjinore.

### Mësime të nxjerra

- institucionalizimi është parakusht për qëndrueshmëri;
- standardizimi i të dhënave është thelbësor për monitorim efektiv;
- financimi publik duhet të mbulojë të gjithë zinxhirin e shërbimeve;
- analiza gjinore përmirëson cilësinë e politikëbërjes;
- roli i OSHC-ve është strukturor dhe 9i pazëvendësueshëm;
- ndryshimet sociale kërkojnë ndërhyrje afatgjata dhe të koordinuara.

### Prioritetet për fazën përfundimtare

Fokusi duhet të vendoset në:

- përfundimin e reformave të nisura;
- standardizimin e plotë të sistemeve të të dhënave;
- sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale;
- përgatitjen e strategjisë së re mbi bazë evidencash.

Në të njëjtën kohë, faza aktuale duhet të shfrytëzohet për të nxjerrë mësim të strukturuar nga zbatimi i Strategjisë dhe për t'i integruar ato në hartimin e strategjisë së re kombëtare, duke siguruar një qasje të bazuar në evidencë, të matshme dhe të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe sistemit të Kombeve të Bashkuara.

## **6.7. PËRFUNDIME DHE PERSPEKTIVA PËRPARA**

Faza përfundimtare e Strategjisë paraqet një mundësi kyçe për konsolidimin e arritjeve dhe për transformimin e tyre në mekanizma të qëndrueshëm institucionalë. Hartimi i Strategjisë së re duhet të ndërtohet mbi gjetjet dhe mësimet e këtij vlerësimi, duke reflektuar zhvillimet e acquis të BE-së, Konventës së Stambollit dhe standardeve ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, një prioritet strategjik mbetet forcimi i sistemit të treguesve, përmes: (i) standardizimit të metodologjive të mbledhjes së të dhënave; (ii) harmonizimit të periudhave të raportimit; (iii) definimit të treguesve të matshëm dhe të ndarë sipas dimensioneve kryesore sociale.

Vlerësimi konfirmon se Kosova ka vendosur themele të forta për një sistem të integruar dhe të orientuar në të drejtat e njeriut. Megjithatë, përshpejtimi i reformave në fushën e integritetit të të dhënave, efikasitetit gjyqësor, fuqizimit të mekanizmave lokalë dhe ndërhyrjeve transformuese mbetet vendimtar.

Viti 2026 përfaqëson një moment kritik tranzicioni nga zbatimi drejt konsolidimit dhe ri-dizajnit strategjik. Në këtë kontekst, prioriteti nuk është më zgjerimi i ndërhyrjeve, por siguri i implementimit të plotë, matjes së rezultateve dhe ndërtimi i një kornize të re strategjike të bazuar në evidencë dhe llogaridhënie

## 7. REFERENCA

- Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, Republika e Kosovës (2023).
- Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (shfuqizuar).
- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore.
- Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.
- Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-188 (ndryshuar).
- Kodi i Procedurës Penale, Ligji Nr. 08/L-187 (ndryshuar).
- Rregullorja Nr. 01/2021 për Organizimin dhe Funkcionimin e Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut.
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2026.
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024.
- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025.
- Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrës së Koordinatorës/Koordinatorit Kombëtar (Vendimi i Qeverisë, 27 dhjetor 2024).
- Rregullorja për Mekanizmat Koordinues Lokalë (MKL).
- Udhëzimi Administrativ për Linjën Kombëtare Emergjente 24/7.
- Udhëzimi Administrativ për Fondin Emergjent për Viktimat e Dhunës.
- Udhëzimi Administrativ për Trajtimin Psiko-Social të Kryerësve të Dhunës.
- Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore.
- PSV për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV).
- Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Raporti i GREVIO-s për Kosovën (2022).
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Platforma e Pekinit për Veprim (1995).
- Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm – Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 5 (OZHQ 5).
- Direktiva e Bashkimit Evropian 2024/1385 për të luftuar dhunën ndaj grave e dhunën në familje.
- Komisioni Evropian – Raporti për Kosovën, Tetor 2024.
- OSBE – Raporti nga monitorimi i gjykimeve të rasteve të dhunës në familje (2024).
- Misioni i OSBE-së në Kosovë – Mbështetje Programore për Mekanizmat Gjyqësorë dhe Policorë (2022–2024).
- UN Women/BE/EEAS – Profili Gjiner i Kosovës 2024.
- UN Women dhe Institucione Partnere – Publikime mbi standardet e vlerësimit, barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore.
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) – Përmbledhje e studimeve mbi dhunën në familje në Kosovë, Janar 2022 – Korrik 2024.

- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) – Studimi “Fuqizimi i Mekanizmave Mbrojtës nga Dhuna në Baza Gjinore” (2024).
- SIT/UNFPA – Studimi “Dhuna në Baza Gjinore përmes Këndvështrimit të Gjeneratës Z” (2024).
- Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 2023 dhe 2024.
- Raporte dhe publikime të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime dhe mbështetje për viktimat / të mbijetuarat e dhunës në Kosovë (OSHC të ndryshme).
- Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës – Baza Kombëtare e të Dhënave për Dhunën në Familje dhe Dhunën ndaj Grave (2022–2025).
- Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022, 2023, 2024).
- Raportet e Policisë së Kosovës për rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (2022–2025).
- Raportet e Qendrave për Punë Sociale (QPS) të komunave të Kosovës (2022–2025).
- Raportet komunale dhe vetë-raportimi i Mekanizmave Koordinues Lokalë (MKL) në të gjitha 38 komunat (2022–2025).
- Akademia e Drejtësisë – programe trajnimi dhe zhvillimi profesional për adresimin e dhunës me bazë gjinore.
- Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) – të dhëna dhe raporte mbi ekspertizat ligjore lidhur me rastet e dhunës.
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV) – statistika dhe publikime të periudhës 2022–2025.
- OECD-DAC (2019) – Kriteret e rishikuara të vlerësimit.
- UNEG – Normat dhe Standardet e Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara.
- Udhëzimet e BE-së për monitorimin dhe vlerësimin e strategjive sektoriale.
- Standardet e Konventës së Stambollit për mbikëqyrjen dhe raportimin.

## 8. SHTOJCAT

### SHTOJCA 1. TË DHËNAT NGA BURIMET E PAVARURA TË MONITORIMIT (2022–2025)

#### 1.1. Këshilli i Evropës – Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit (2022)<sup>53</sup>

**Qëllimi i raportit.** Raporti i Këshillit të Evropës (2022) vlerëson në ç’masë ligjet, politikat dhe masat institucionale në Kosovë janë të përafuara me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Vlerësimi është kryer duke u bazuar në metodologjinë e mekanizmit të monitorimit GREVIO, me qëllim identifikimin e boshllëqeve dhe fushave që kërkojnë forcim në nivel ligjor, institucional dhe të politikave publike. Dokumenti synon të shërbejë si udhërrëfyes praktik për forcimin e reagimit institucional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe është hartuar në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë – Faza III”.

#### Raporti mbështetet në:

- informacion zyrtar të dërguar nga institucionet përgjegjëse në Kosovë (përfshirë Koordinatorin / Koordinatorin Kombëtar kundër Dhunës në Familje pranë Ministrisë së Drejtësisë);
- kontributet e organizatave të shoqërisë civile;
- një mision pesëditor faktmbledhës në terren (Prishtinë dhe Gjakovë), gjatë të cilit u zhvilluan takime me autoritetet publike dhe ofruesit e shërbimeve.

Kjo e bën raportin jo thjesht juridik, por edhe operacional: ai teston jo vetëm çfarë shkruhet në ligj, por edhe si funksionon në praktikë.

#### Gjetjet kryesore:

- Korniza ligjore ka avancuar dhe përfshin dispozita që trajtojnë dhunën seksuale bazuar në konceptin e pëlqimit dhe penalizimin e formave të dhunës gjinore si ngacmimi seksual dhe gjymtimi i organeve gjentiale femërore.
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022–2026) është e gjerë, përfshin dhunën ndaj grave si kategori të veçantë dhe kërkon zbatim të masave të ndjeshme gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Janë themeluar struktura koordinuese në nivel qendror, përfshirë Koordinatorin/Koordinatorin Kombëtar kundër Dhunës në Familje në Ministrinë e Drejtësisë dhe Grupin Koordinues Ndërminstros kundër Dhunës në Familje. Këto janë vlerësuar si hapa pozitivë.
- Megjithatë, koordinimi ndërinstucional nuk është ende i plotësisht i institucionalizuar: mandati, procedurat e punës dhe burimet e dedikuara për këto mekanizma nuk janë të garantuara me bazë të qartë ligjore, gjë që rrezikon që koordinimi të mbetet i varur nga angazhimi politik individual dhe jo nga detyrimi strukturor.
- Financimi për shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit (p.sh. strehimoret dhe shërbimet e specializuara) vlerësohet si jo i qëndrueshëm dhe i fragmentuar, duke

<sup>53</sup> <https://rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-sqi/1680a9203f>

krijuar rrezik për vazhdimësinë e mbështetjes së viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe riintegrimin e tyre.

- Mbledhja e të dhënave administrative dhe statistike mbetet e pakoordinuar dhe jo e harmonizuar ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, shërbimeve sociale dhe shërbimeve shëndetësore, duke e bërë të vështirë monitorimin e rasteve dhe analizën e riskut në nivel kombëtar.

#### **Sfidat e identifikuara:**

- Mungesë e burimeve të garantuara financiare për zbatim dhe monitorim të Strategjisë Kombëtare.
- Mungesë e unifikimit të të dhënave dhe analizës së rrezikut në mënyrë të koordinuar ndërinstucionale.
- Qasje jo e barabartë në shërbime mbështetëse (strehimore, ndihmë psikosociale, ndihmë ligjore, linja të emergjencës) për gratë dhe vajzat në të gjitha komunat.
- Mandat i paqartë, juridikisht jo i konsoliduar, për organin koordinues kombëtar dhe mekanizmat ndërministrorë.

Këto sfida nuk janë vetëm teknike; ato prekin drejtpërdrejt sigurinë e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe aftësinë e shtetit për të reaguar në kohë reale.

#### **Rekomandimet për vitin 2026:**

Bazuar në rekomandimet e raportit të Këshillit të Evropës, prioritetet që duhet të reflektohen në vitin 2026 janë:

1. Institucionalizimi i koordinimit kombëtar: Forcimi ligjor dhe funksional i zyrës qendrore koordinuese (Koordinatorja/ Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje / grupet ndërministrorë), me mandat të qartë, burime të dedikuara dhe mekanizma llogaridhënieje.
2. Financim i qëndrueshëm publik për shërbimet për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit: Sigurimi i financimit të parashikueshëm shumëvjeçar për strehimoret dhe shërbimet e specializuara të mbështetjes, në mënyrë që mbrojtja të mos varet nga fonde të përkohshme.
3. Standardizimi i mbledhjes së të dhënave ndërinstucionale: Krijimi dhe operimi i një sistemi të unifikuar të të dhënave mbi rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, i aksesueshëm nga Policia, Prokuroria, Gjykatat, shërbimet sociale dhe shëndetësore, për vlerësim rreziku dhe vendimmarrje të koordinuar.
4. Qasje e barabartë në shërbime në të gjithë territorin: Sigurimi që shërbimet e përgjithshme dhe shërbimet e specializuara (përfshirë strehim, mbështetje psikosociale, ndihmë ligjore dhe shërbime emergjente) të jenë të arritshme në mënyrë të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat, pa diskriminim.
5. Zbatim i plotë i Strategjisë Kombëtare 2022–2026 me monitorim aktiv: Vendosija e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, jo vetëm miratimi formal i saj.

Këto masa janë të gjitha në linjë direkte me udhërrëfyesin praktik që raporti e konsideron të domosdoshëm për forcimin e reagimit të Kosovës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

**Zhvillime pas periudhës së raportimit.** Pas publikimit të raportit të Këshillit të Evropës në vitin 2022, mbështetja për institucionet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve të tij është vijuar

në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit”, i cili ka synuar të përkthejë gjetjet e raportit në hapa konkretë të politikave dhe praktikës institucionale. Ky proces ka vënë theks në: përputhjen e praktikës gjyqësore me standardet e Konventës së Stambollit; forcimin e mandatit institucional për koordinim kundër dhunës ndaj grave; sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit, përfshirë strehimoret; dhe ngritjen e kapaciteteve të policisë, prokuroreve/prokurorëve dhe gjyqtareve / gjyqtarëve për hetim efektiv, mbrojtje të menjëhershme dhe ndjekje penale të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Në këtë kuadër, rekomandimet e raportit kanë shërbyer si pikë reference për zhvillimet e mëtejshme ligjore dhe institucionale, duke kontribuar edhe në konsolidimin e kornizës normative, përfshirë zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe forcimin e qasjes ndërinsticionale ndaj parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes penale të rasteve të dhunës. Këto fusha janë konfirmuar sërish si prioritare gjatë periudhës 2023–2025 nga Këshilli i Evropës dhe partnerët ndërkombëtarë.

## 1.2. Komisioni Evropian – Raporti i vitit 2024 për Kosovën (Tetor 2024): Dhuna në baza gjinore, Koordinimi institucional dhe parandalimi.<sup>54</sup>

**Qëllimi i raportit.** Raporti i Komisionit Evropian 2024 vlerëson progresin e Kosovës në përafrimin me acquis të BE-së në fushën e të drejtave themelore, barazisë gjinore dhe sundimit të ligjit, me fokus të veçantë në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ai analizon zhvillimet ligjore, institucionale dhe politike që lidhen me zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2022–2026 dhe përputhshmërinë me standardet e Konventës së Stambollit.

**Metodologjia.** Raporti bazohet në të dhëna zyrtare nga institucionet qendrore dhe lokale, konsultime me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë (UN Women, OSBE, Këshilli i Evropës) dhe analiza të pavarura të shoqërisë civile. Vlerësimi përfshin periudhën janar 2023 – qershor 2024 dhe ndjek përparimin në zbatim të masave të strategjisë dhe harmonizimin ligjor me standardet e BE-së.

### Gjetjet kryesore:

- Krijimi i sekretariatit të dedikuar pranë Ministrisë së Drejtësisë ka përmirësuar koordinimin kombëtar për trajtimin e dhunës me bazë gjinore.
- Mekanizmat koordinues lokalë (MKL) janë bërë më aktivë dhe raportojnë më rregullisht në nivel qendror.
- Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik të mbështetura nga UN Women, BE dhe OSBE kanë kontribuar në rritjen e raportimit dhe në ndryshimin e perceptimeve sociale ndaj dhunës ndaj grave.
- Programet për trajtimin e kryesve të dhunës mbeten të kufizuara dhe nuk zbatohen në mënyrë të standardizuar në të gjitha komunat.

<sup>54</sup> [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf&utm)

- Trajnimet për profesionistet / profesionistët e sistemit të drejtësisë, policisë dhe punonjëseve / punonjësve socialë janë rritur në numër, por mungon një program i detyrueshëm dhe i qëndrueshëm në kohë.
- Kosova nuk ka ende një qendër të specializuar për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale, megjithëse ekziston Protokollin Shtetëror për menaxhimin e rasteve, i cili zbatohet pjesërisht dhe pa monitorim të unifikuar.
- Shërbimet për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit, përfshirë strehimoret, mbështetjen psikosociale dhe ndihmën ligjore, janë të varura nga burimet e përkohshme financiare dhe nuk mbulojnë në mënyrë të barabartë të gjithë territorin.

#### **Sfidat:**

- Fragmentim në qasjen parandaluese dhe mungesë e strategjive të përbashkëta për edukim dhe vetëdijesim publik.
- Mungesë e standardizimit për programet e trajtimit të kryesve.
- Zbatim i pjesshëm i protokollit për dhunën seksuale dhe mungesë e mbikëqyrjes së tij.
- Kapacitete të pamjaftueshme për monitorim dhe raportim ndërinstytucional.
- Pabarazi territoriale në ofrimin e shërbimeve për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit.

#### **Rekomandimet për vitin 2026:**

1. Institucionalizimi i programeve parandaluese dhe të edukimit publik në shkolla, media dhe komunitete, me financim të qëndrueshëm.
2. Krijimi i një qendre të specializuar për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale, me shërbime të integruara mjekësore, psikosociale dhe ligjore.
3. Standardizimi dhe monitorimi i programeve të trajtimit për kryesit e dhunës nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë.
4. Zbatimi i plotë dhe mbikëqyrja periodike e Protokollit Shtetëror për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
5. Trajtime të detyrueshme dhe afatgjata për gjyqtaret / gjyqtarët, prokuroret / prokurorët, policinë dhe punonjëset / punonjësit socialë mbi qasjen gjinore dhe standardet e BE-së.
6. Rritja e fondeve publike për strehimoret dhe shërbimet e specializuara, duke garantuar mbulim të barabartë në të gjitha komunat.
7. Përforcimi i sistemit të unifikuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore në të gjitha institucionet përgjegjëse.

Raporti i Komisionit Evropian mbështet dhe monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, duke reflektuar progres në të katër objektivat e saj strategjike — parandalimin dhe vetëdijesimin publik, harmonizimin ligjor e politik me standardet ndërkombëtare, fuqizimin institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, si dhe sigurimin e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara.

Komisioni e konsideron periudhën 2025–2026 si vendimtare për kalimin nga përputhja ligjore në zbatim të matshëm dhe të qëndrueshëm të standardeve evropiane, duke theksuar nevojën për institucionalizim të plotë të sistemit të mbrojtjes dhe reagimit, bashkëpunim të

qëndrueshëm ndërinstitucional dhe financim të mjaftueshëm për shërbimet dhe masat parandaluese.

**Zhvillime pas periudhës së raportimit.** Pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga raporti i Komisionit Evropian (tetor 2024), janë evidentuar disa zhvillime të rëndësishme që tregojnë progres drejt zbatimit praktik të standardeve të BE-së dhe Konventës së Stambollit:

- Ministria e Drejtësisë ka intensifikuar bashkëpunimin ndërinstitucional për zbatimin e plotë të Protokollit Shtetëror për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, përmes trajnimeve dhe koordinimit me institucionet shëndetësore, policinë, qendrat për punë sociale dhe institucionet e drejtësisë. Krijimi i qendrës së specializuar për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale mbetet një prioritet për periudhën 2025–2026, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian.
- Akademia e Drejtësisë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe UN Women, ka përfshirë module të reja të detyrueshme mbi etikën gjinore, barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, duke e bërë trajnimin e vazhdueshëm një pjesë të qëndrueshme të formimit profesional të gjyqtareve / gjyqtarëve, prokurorëve / prokurorëve dhe policisë.
- Është evidentuar rritje e ndjeshme e financimit publik për strehimoret dhe shërbimet e specializuara për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit, duke shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me periudhën 2022–2023 dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të mbrojtjes.

Këto zhvillime sinjalizojnë një konsolidim të kapaciteteve institucionale dhe një kalim gradual nga përputhja ligjore drejt zbatimit praktik dhe të matshëm të standardeve evropiane, veçanërisht në fushat e parandalimit, reagimit të koordinuar dhe mbrojtjes së viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore.

### 1.3. Profili Gjinor i Kosovës 2024 (UN Women / BE / EEAS) dhe zhvillimet ligjore 2022–2024<sup>55</sup>

**Qëllimi dhe konteksti.** Kapitulli “Dhuna ndaj Grave dhe Qasja në Drejtësi” i Profilin Gjinor të Kosovës 2024 dhe dokumentet mbështetëse të periudhës 2022–2024 paraqesin një analizë gjithëpërfshirëse të progresit dhe sfidave në mbrojtjen nga dhuna ndaj grave, dhuna në familje e dhuna në baza gjinore në Kosovë. Këto gjetje janë tërësisht në funksion të monitorimit të Strategjisë Kombëtare 2022–2026, veçanërisht në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndëshkimit dhe koordinimit institucional.

#### **Korniza ligjore dhe institucionale (2022–2024):**

- **Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit (2022)**, që siguron të drejtën për kompensim financiar për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit e dhunës.
- **Ligji për Ndhimën Juridike Falas (2022)**, që garanton qasje të barabartë në drejtësi për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit e dhunës.
- **Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (2023)**, i cili harmonizon terminologjinë dhe mekanizmat institucionalë me Konventën e Stambollit.
- **Ndryshimet në Kodin Penal (2023)**, që ashpërsojnë ndëshkimet për dhunën seksuale dhe kriminalizojnë praktikat diskriminuese si testet e virgjërisë.

<sup>55</sup> [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/UNWOMEN\\_GEF\\_ENG.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/UNWOMEN_GEF_ENG.pdf)

- **Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare (2024)**, që e integroi dhunën me bazë gjinore në sistemin publik të kujdesit social.

#### **Shërbimet për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe përgjigja institucionale:**

- **Policia e Kosovës** ka krijuar njësi të specializuara për parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje në të gjitha drejtoritë rajonale.
- **Zyra për Mbrojtjen e Viktimave** ka zgjeruar praninë rajonale dhe ofron mbështetje juridike, psikologjike dhe procedurale për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit.
- **Qendrat për Punë Sociale** sigurojnë ndihmë sociale dhe psikologjike, por përballen me mungesë të stafit dhe fondeve.
- **Sistemi i strehimoreve (8 aktive në nivel vendi)** ofron mbrojtje emergjente dhe programe trajtimi afatshkurtra, por financimi mbetet i pasigurt.
- **Programet e trajtimit të kryesve të dhunës** janë pilotuar në sistemin korrektues dhe kërkojnë standardizim dhe monitorim të rregullt.

#### **Masat mbështetëse ekonomike dhe juridike:**

- Viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit përfitojnë kompensim financiar sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
- Qeveria mbështet gratë që dalin nga strehimoret përmes subvencioneve të përkohshme të punësimit dhe përfshirjes në programe trajnimi profesional;
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ofron shërbime falas ligjore dhe mbështetje procedurale për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit në të gjitha rajonet e vendit.

#### **Sfidat kryesore:**

- Mungesë e qëndrueshmërisë financiare për shërbimet mbështetëse dhe strehimoret.
- Zbatim i pabarabartë i protokolleve ndërinstucionale ndërmjet komunave.
- Kapacitete të kufizuara njerëzore në QPS dhe policinë lokale.
- Nën raportim i rasteve për shkak të stigmatizimit dhe mungesës së besimit në sistemin e drejtësisë.
- Rritje e rasteve të dhunës digjitale dhe ngacmimit online, pa kornizë ligjore të dedikuara.

#### **Rekomandimet për vitin 2026:**

1. Të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe i dedikuar për strehimoret dhe shërbimet e specializuara.
2. Të zbatohet plotësisht Protokolle Shtetëror për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, me mekanizma të përhershëm mbikëqyrës.
3. Të institucionalizohen trajnimet gjinore ndërinstucionale për profesionistët / profesionistët e drejtësisë, policisë dhe shërbimeve sociale.
4. Të zhvillohet kuadër ligjor për adresimin e dhunës digjitale dhe ngacmimit online.
5. Të konsolidohet sistemi kombëtar i të dhënave gjinore për monitorim dhe raportim të harmonizuar.
6. Të forcohen mekanizmat koordinues lokalë për referim dhe mbrojtje efektive të viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve.

#### 1.4. Raport nga monitorimi i gjyqimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë, OSBE, 2024<sup>56</sup>

**Qëllimi i raportit.** Raporti i Misionit të OSBE-së në Kosovë, i publikuar më 2 korrik 2024, paraqet rezultatet e monitorimit të drejtpërdrejtë të proceseve gjyqësore për rastet e dhunës në familje, të zhvilluara në gjykatat themelore në Kosovë gjatë periudhës 1 janar – 1 dhjetor 2023. Qëllimi i tij është të vlerësojë shkallën e respektimit të standardeve të drejtësisë, efektivitetin e masave mbrojtëse, si dhe koherencën e politikës ndëshkimore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Raporti synon të mbështesë institucionet e drejtësisë në forcimin e përgjegjësisë dhe zbatimin e ligjit në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

**Metodologjia.** Monitorimi është realizuar përmes:

- analizës së 141 çështjeve civile dhe penale në gjykatat themelore të Kosovës;
- vëzhgimit të seancave gjyqësore, shqyrtimit të dosjeve dhe krahasimit të llojit dhe kohëzgjatjes së dënimeve;
- vlerësimit të respektimit të afateve ligjore për urdhrat mbrojtës, zbatimin të masave emergjente dhe trajtimin të viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve gjatë procesit gjyqësor.

Raporti u mbështet në standardet e OSBE-së për monitorim të drejtësisë dhe përfshiu komponentë gjinorë në analizë.

**Gjetjet kryesore:**

- **Dominimi i dënimeve të buta:** dënimet me kusht dhe gjobat janë masa më e zakonshme ndëshkimore, ndërsa dënimet me burgim efektivi aplikohen rrallë, edhe në rastet e përsëritura të dhunës.
- **Vonesat procedurale:** rreth 24 për qind e kërkesave për urdhra mbrojtës janë trajtuar me vonesë, duke ekspozuar viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit ndaj rrezikut të vazhdueshëm.
- **Koordinimi ndërinstitucional i kufizuar:** mungon shkëmbimi i rregullt i informacionit midis Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave; zbatimi i urdhrave mbrojtës nuk monitorohet në mënyrë sistematike.
- **Mungesë e specializimit gjyqësor:** gjyqtaret/gjyqtarët shpesh nuk posedojnë trajnime mbi dimensionin gjinor dhe nuk kryejnë vlerësim të rrezikut gjatë vendimmarrjes.
- **Përdorim jo i njëtrajtshëm i ligjit:** interpretimi i dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ndryshon nga një gjykatë në tjetrën, duke shkaktuar mungesë konsistence në drejtësi.

**Sfidat kryesore:**

- **Mungesa e politikës ndëshkimore të qëndrueshme:** mbizotërimi i masave të lehta krijon perceptimin e mos ndëshkueshmërisë.
- **Kapacitetet e kufizuara të gjyqtareve/gjyqtarëve dhe prokuroreve/prokuroreëve për qasje gjinore:** mungon një sistem trajnime i detyrueshëm dhe certifikues.
- **Mbikëqyrje e dobët e urdhrave mbrojtës dhe mungesë e databazës së përbashkët:** të dhënat për zbatimin e tyre nuk janë të sinkronizuara ndërinstitucionalisht.

<sup>56</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/8/8/572080.pdf>

- **Mungesë e përfaqësimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve gjatë procedurës gjyqësore:** viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit shpesh nuk kanë mbrojtje ligjore aktive në gjykim.

### **Rekomandimet për vitin 2026:**

Bazuar në gjetjet e raportit të OSBE-së, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2022–2026 rekomandohen këto masa prioritare:

1. **Rishikimi i politikës ndëshkimore:** garantimi që dënimet të jenë proporcionale me ashpërsinë e veprës dhe që rastet e përsëritura të mos përfundojnë me masa alternative.
2. **Vendosja e trajnimeve të detyrueshme me përmbajtje gjinore për gjyqtaret/gjyqtarët dhe prokuroret/prokurorët,** në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial.
3. **Zbatimi i afateve të detyrueshme ligjore** për shqyrtimin e kërkesave për urdhra mbrojtës dhe raportim periodik mbi respektimin e tyre.
4. **Integrimi i sistemit të përbashkët të të dhënave ndërmjet institucioneve të drejtësisë** (Policia, Prokuroria, Gjykatat), për të siguruar gjurmim dhe mbikëqyrje në kohë reale të rasteve.
5. **Përfshirja e Mbrojtëseve/Mbrojtësve të Viktimave në çdo fazë të procesit gjyqësor,** për të garantuar qasje të barabartë dhe mbrojtje efektive të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.
6. **Hartimi i një udhëzimi gjyqësor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje,** me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore në të gjithë territorin.

Gjetjet e raportit të OSBE-së lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave. Raporti kontribuon në “Harmonizimin e politikave publike me standardet ndërkombëtare”, duke vlerësuar përputhjen e praktikës gjyqësore me Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave e Dhuna në Baza Gjinore (2023) dhe me Konventën e Stambollit. Në kuadër të “Fuqizimit institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave”, ai evidenton nevojën për specializim gjyqësor, ndëshkime proporcionale dhe përfshirjen sistematike të Mbrojtëseve/Mbrojtësve të Viktimave. Në linjë me “Sigurimin e shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit”, raporti thekson rëndësinë e koordinimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë, policisë dhe shërbimeve sociale. Në tërësi, ai e pozicionon periudhën 2025–2026 si fazë kyçe për forcimin e zbatimit të ligjit dhe konsolidimin e reagimit të bashkërenduar institucional ndaj dhunës në familje.

**Zhvillime pas periudhës së raportimit.** Pas përfundimit të periudhës së monitorimit të OSBE-së (2023), janë shënuar disa zhvillime të rëndësishme që adresojnë drejtpërdrejt një pjesë të rekomandimeve të raportit. Ministria e Drejtësisë ka funksionalizuar bazën e përbashkët digjitale për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke mundësuar shkëmbim më efikas të të dhënave ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe Qendrave për Punë Sociale. Një tjetër arritje është rritja e ndjeshme e fondeve publike për strehimoret, që ka përmirësuar qëndrueshmërinë financiare dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

Në aspektin gjyqësor, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka zhvilluar trajnime të specializuara për gjyqtare / gjyqtarë dhe prokurorë / prokurorë mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë temat mbi vlerësimin e rrezikut, mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve dhe integrimin e qasjes gjinore në procesin gjyqësor.

Këto zhvillime përfaqësojnë progres të matshëm institucional dhe bashkërendim ndërmjet aktorëve kyç, duke kontribuar në forcimin e përgjegjësisë gjyqësore dhe në zbatimin më të qëndrueshëm të Strategjisë Kombëtare në vitin 2026.

### 1.5. Misioni i OSBE-së në Kosovë – Mbështetje Programore për Mekanizmat Gjyqësorë dhe Policorë për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2022–2024)<sup>57</sup>

**Qëllimi.** Linja programatike e OSBE-së 2022–2024 synoi të mbështesë institucionet e drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë për rritjen e efikasitetit institucional, bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave të drejtësisë dhe mbrojtjes, si dhe forcimin e reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Përmes qasjeve të integruara, OSBE-ja punoi për të përmirësuar zbatimin praktik të ligjit, për të rritur përgjegjësinë gjyqësore dhe për të avancuar profesionalizmin e policisë dhe prokurorisë në trajtimin e rasteve.

**Metodologjia.** Kjo linjë ndërhyrjeje u zbatua në bashkëpunim me:

- Akademinë e Drejtësisë, për trajnime të gjyqtareve/gjyqtarëve, prokurorëve/prokurorëve dhe oficerëve/oficerëve policorë mbi trajtimin gjinor të rasteve.
- Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, për mentorim dhe shkëmbim praktikash mbi zbatimin e urdhrave mbrojtës dhe ndëshkimin proporcional.
- Policinë e Kosovës dhe Qendrat për Punë Sociale, për zhvillimin e protokolleve të përbashkëta të reagimit dhe raportimit.

Aktivitetet përfshinë trajnime, analizë të rasteve gjyqësore, udhëzues operativë dhe komunikime publike mbi progresin institucional.

**Gjetjet kryesore:**

- Rritje e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë dhe policisë, me trajnime sistematike mbi vlerësimin e rrezikut dhe mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.
- Zhvillim i procedurave standarde të veprimit (PSV-të) për policinë dhe QPS-të, duke përmirësuar koordinimin në rastet emergjente.
- Rritje e ndërgjegjësimit profesional për qasjen gjinore në hetim dhe ndjekje penale.
- Përmirësim i komunikimit ndërinstitutional, sidomos ndërmjet Policisë dhe Prokurorisë.

Megjithatë, praktika e zbatimit mbetet jo e njëtrajtshme ndër rajone, veçanërisht në mbikëqyrjen e urdhrave mbrojtës dhe menaxhimin e rasteve të përsëritura.

**Sfidat:**

- Mungesë e standardizimit të reagimit ndërmjet institucioneve lokale.
- Kapacitete të kufizuara për vlerësim të rrezikut dhe ndjekje të urdhrave mbrojtës.
- Vonesë në përfshirjen e mekanizmave koordinues lokalë (MKL) në raportim.

<sup>57</sup> <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/gender-equality>

- Nevojë për trajnime të vazhdueshme dhe monitorim të zbatimit të ligjit në praktikë.

#### **Rekomandimet për vitin 2026:**

1. Forcimi i sistemit të integruar të të dhënave ndërmjet Policisë, Prokurorisë dhe QPS-ve.
2. Trajnime të detyrueshme ndërinstucionale të zhvilluara nga Akademia e Drejtësisë me përmbajtje mbi vlerësimin e rrezikut dhe mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.
3. Standardizimi i protokolleve të referimit dhe reagimit emergjent në të gjitha komunat.
4. Monitorim më i rregullt i zbatimit të urdhrave mbrojtës nga MKL-të dhe raportim periodik në nivel qendror.
5. Zhvillimi i treguesve gjinorë të performancës për Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat, si pjesë e sistemit të monitorimit të Strategjisë Kombëtare.

Kjo linjë programatike e OSBE-së kontribuon drejtpërdrejt në:

- “Fuqizimin institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve”, përmes ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve të integruara.
- “Sigurimin e shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit”, duke promovuar bashkërendim midis institucioneve të drejtësisë, policisë dhe shërbimeve sociale.
- “Harmonizimin e politikave publike me standardet ndërkombëtare”, përmes përafrimit me praktikat e mira të OSBE-së dhe Konventës së Stambollit.

Periodha 2025–2026 shihet si vendimtare për konsolidimin e sistemit të integruar të reagimit institucional ndaj dhunës dhe forcimin e zbatimit të ligjit në praktikë.

**Zhvillime pas periudhës së raportimit.** Në fund të vitit 2024 dhe gjatë vitit 2025 janë shënuar disa përmirësime të rëndësishme:

- Funkcionalizimi i databazës digjitale kombëtare për rastet e dhunës me bazë gjinore nga Ministria e Drejtësisë.
- Zgjerimi i programeve të Akademisë së Drejtësisë, përfshirë module mbi etikën profesionale, qasjen gjinore dhe parandalimin e dhunës.
- Shpërndarja e manualeve të reja të reagimit ndaj dhunës për Policinë e Kosovës.
- Përfshirja e MKL-ve në raportimin tremujor të rasteve, duke forcuar qasjen lokale ndaj menaxhimit të dhunës.

Këto zhvillime dëshmojnë për rritje të koordinimit institucional dhe përparim të matshëm në zbatimin praktik të ligjit.

## **1.6. Përmbledhje e studimeve mbi dhunën në familje të realizuara nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike për periudhën janar 2022 – korrik 2024**

**A. Raportimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje, Janar – Gusht 2022 (GLPS, shtator 2022).**<sup>58</sup> Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit “Just React – Boosting Civic Reaction towards an Improved Access to Justice in Kosovo”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe

<sup>58</sup> Shih: [https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2025/03/GLPS\\_Analiza-e-rasteve-te-dhunes-ne-familje\\_janar-gusht-2022-SRB.pdf](https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2025/03/GLPS_Analiza-e-rasteve-te-dhunes-ne-familje_janar-gusht-2022-SRB.pdf)

zbatuar nga GLPS në bashkëpunim me Fondin për Zhvillimin e Komunitetit (CDF). Raporti analizon trajtimin institucional të dhunës në familje në Kosovë gjatë periudhës 1 janar – 31 gusht 2022, duke u fokusuar në veprimin e tri hallkave kryesore: Policia e Kosovës, Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore në Prishtinë. Ai përfshin gjithashtu rolin e Qendrave për Punë Sociale (QPS), Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV).

**Qëllimi** kryesor është të paraqesë se si rastet e dhunës në familje raportohen, procedohen dhe gjykohen në praktikë, cilat janë boshllëqet në mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve dhe përgjegjshmërinë e kryerësve, dhe cilat ndërhyrje urgjente institucionale kërkohen. Raporti gjithashtu shqyrton kornizën ligjore, përfshirë kriminalizimin e dhunës në familje si vepër penale të veçantë në nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

#### **Gjetjet kryesore:**

- Dhuna në familje mbetet e trajtuar shpesh si “çështje private”, megjithëse vetëdija publike dhe institucionale për trajtimin e saj si vepër penale është në rritje.
- Policia e Kosovës pranon një numër të lartë raportimesh për dhunë në familje dhe identifikon se pjesa më e madhe e të dyshuarve/arrestuarve janë burra madhorë, ndërsa shumica e viktimave/të mbijetuarave janë gra.
- Prokuroria Themelore në Prishtinë tregon efikasitet më të lartë kur kryesit e dhunës janë të mitur, por evidentohet nevoja që ky efikasitet të rritet për rastet ku kryesit janë madhorë.
- Analiza e 43 aktgjytimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë (me degët) tregon se shumica e dënimeve janë dënime me kusht, ndërsa burgimi efektiv shqiptohet rrallë. Në rreth 70 për qind të rasteve nuk respektohet afati ligjor për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar; kohëzgjatja e procedurave gjyqësore varion nga një ditë deri në mbi dy vjet e gjashtë muaj, me një kohëzgjatje mesatare rreth tetë muaj.
- Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka programe të veçanta për riedukimin dhe risocializimin e kryerësve të dhunës në familje; personat e dënuar për dhunë në familje shpesh vendosen në të njëjtin ambient me kryerës të veprave të tjera penale dhe nuk i nënshtrohen programeve specifike të trajtimit.
- Theksohet boshllëk ligjor në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i cili nuk definon në mënyrë të qartë format e dhunës (fizike, psikologjike, ekonomike, seksuale) si vepra të dallueshme të ndëshkueshme.
- Nënvizohet domosdoshmëria për trajtim prioritar të rasteve të dhunës në familje nga të gjitha institucionet përgjegjëse, nga policia deri te gjykatat, QPS, ZMNV dhe SHKK.

#### **Rekomandimet kryesore të raportit:**

- Policia e Kosovës të trajtojë çdo rast të dhunës në familje me seriozitet të lartë, të identifikojë dhe arrestojë të dyshuarit brenda afateve të shpejta dhe të koordinohet ngushtë me prokuroret/prokuratorët.
- Policia e Kosovës të vazhdojë praktikën e raportimit publik periodik për rastet e dhunës.
- Prokuroria Themelore në Prishtinë të rrisë efikasitetin në trajtimin e rasteve kur kryesit janë madhorë dhe të ruajë efikasitetin për rastet me të mitur.
- Gjykata Themelore në Prishtinë të trajtojë me prioritet rastet ku i pandehuri është recidivist dhe të respektojë afatet ligjore procedurale për shqyrtimin fillestar.

- Gjykata të arsyetojë qartë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në aktgjykimet për dhunë në familje dhe të gjykojë rastet brenda një afati të arsyeshëm.
- ZMNV, QPS dhe SHKK të rrisin kapacitetet për të trajtuar si viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit ashtu edhe kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.
- Kërkohet ndryshim/plotësim i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për të qartësuar përkufizimet e formave të dhunës.
- Gjykatat të vazhdojnë publikimin e aktgjykimeve për rastet e dhunës në familje, si mjet transparence dhe llogaridhënie.

**B. Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje, Korrik 2022 – Qershor 2023 (GLPS, korrik 2023).**<sup>59</sup> Ky raport është pjesë e të njëjtit projekt “JUST REACT - Boosting Civic Reaction towards an Improved Access to Justice in Kosovo”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga GLPS në bashkëpunim me CDF. Ai mbulon periudhën 1 korrik 2022 – 30 qershor 2023 dhe analizon trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe gjykatat themelore, si dhe monitorimin e seancave gjyqësore dhe urdhrave mbrojtës.

**Qëllimi** është të vlerësohet reagimi institucional ndaj dhunës në familje në nivel kombëtar, përfshirë zinxhirin e raportimit, ngritjes së aktakuzave, shqyrtimit gjyqësor dhe ekzekutimit të masave mbrojtëse, duke matur edhe performancën dhe përputhshmërinë e praktikës me kornizën ligjore.

#### **Gjetjet kryesore:**

- Dhuna në familje vazhdon të jetë një problem shoqëror dhe shkelje serioze e të drejtave të njeriut, me ndikim disproporcional ndaj grave; 79 për qind e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të identifikuar nga Policia janë gra. Shumica e rasteve ndodh në marrëdhënie bashkëshortore.
- Prishtina ka numrin më të lartë të rasteve të raportuara në terma absolutë, por kur rregullohet sipas popullsisë, Peja ka incidencën më të lartë për banorë/banor.
- Vërehet një trend pozitiv në rritjen e numrit të arrestimeve për dhunë në familje krahasuar me periudhat parapra.
- Prokuroria në disa raste varion në kualifikimin juridik të veprës penale “dhunë në familje” dhe në arsyetimin e rrethanave lehtësuese/rënduese, çka mund të ndikojë në mënyrën se si gjykatat caktojnë dënimin.
- Gjykatat i shpallin fajtorë të pandehurit në mbi 90 për qind të rasteve, por masa ndëshkuese dominohet nga dënimet me kusht; dënimet me burgim efektiv janë më të rralla dhe, kur jepen, janë më të ulëta se maksimumi ligjor.
- Në shumicën e seancave të monitoruara, gjykatat dhe prokuroritë e trajtojnë dhunën në familje si prioritet të lartë dhe gjykatat respektojnë mbylljen e seancave për publikun. Megjithatë, mungon një mekanizëm i qartë mbikëqyrjeje për zbatimin e urdhrave mbrojtës (p.sh. mbikëqyrja elektronike), dhe një numër i madh seancash dështon të mbahet për shkak të mungesës së palëve, përfshirë të pandehurin, gjyqtaren/gjyqtarin, prokuroren/prokurorin apo palën e dëmtuar.

<sup>59</sup> Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2022/11/GLPS-Just-React-Annual-Report-Domestic-and-Gender-based-Violence-in-Kosovo.pdf>

- Theksohet nevoja për masa teknologjike për zbatimin e urdhrave mbrojtës dhe për forcimin e politikës ndëshkimore në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Supreme për politikën ndëshkimore dhe për kualifikimin juridik të rasteve të dhunës në familje.

#### **Rekomandimet kryesore të raportit:**

- Të rritet efikasiteti i Policisë së Kosovës në parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje dhe në arrestimin e të dyshuarve.
- Prokuroria të sigurojë kualifikim korrekt dhe të unifikuar të veprës “dhunë në familje” dhe të hartojë aktakuza të plota, me arsyetim të qartë të provave dhe rrethanave.
- Gjykatat të vazhdojnë ta trajtojnë këtë fenomen me prioritet të lartë dhe të ofrojnë arsyetim të plotë në aktgjykime.
- Qeveria (Ministria e Punëve të Brendshme / Ministria e Drejtësisë) të fillojë pa vonesë procedurat për pajisje për mbikëqyrje elektronike për zbatimin e urdhrave mbrojtës.
- Gjykatat të zbatojnë udhëzimet ekzistuese të Gjykatës Supreme për politikën ndëshkimore dhe të shqiptojnë dënime adekuate, proporcionalisht me rrezikshmërinë e veprës.

**C. Vlerësimi bazë i strehimoreve dhe Qendrave për Punë Sociale në mbështetje të të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, për periudhën qershor 2023 – korrik 2024 (GLPS, shtator 2024).**<sup>60</sup> Ky vlerësim bazë, i përgatitur nga GLPS në shtator 2024, brenda projektit “JUST REACT - Boosting Civic Reaction towards an Improved Access to Justice in Kosovo”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga GLPS me CDF, synon të masë kapacitetet e dy shtyllave të mbështetjes për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) dhe dhunës në familje (DHF): Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe strehimoret për gratë/viktimat/të mbijetuarat në Kosovë. Periudha e analizuar mbulon qershor 2023 – korrik 2024; hulumtimi u zhvillua përmes kërkimit në dokumente, intervistave gjysmë-strukturuara me drejtuese strehimoresh, punonjëse/punnjës socialë, psikologe/psikologë dhe aktiviste/aktivistë të shoqërisë civile, si dhe një instrument vlerësimi (checklist) për kapacitetet dhe sfidat.

**Qëllimi** është të ofrojë një vijë bazë mbi kapacitetet institucionale dhe operacionale të QPS-ve dhe strehimoreve për të përmbushur standardet kombëtare dhe ato të Këshillit të Evropës (KE) mbi shërbimet ndaj viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë sigurinë, konfidencialitetin, mbështetjen psikologjike, ndihmën juridike, riintegrimin dhe qëndrueshmërinë financiare.

#### **Gjetjet kryesore:**

- Qendrat për Punë Sociale kanë mungesë të stafit, janë të mbingarkuara dhe me përgjegjësi të zgjeruara; kjo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë për t’u ofruar viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve mbështetje gjithëpërfshirëse, përfshirë mbrojtje afatgjatë dhe riintegrim. Raporti evidenton mungesë të kapaciteteve profesionale dhe mungesë burimesh, si edhe sfida infrastrukturore që prekin konfidencialitetin dhe sigurinë e grave dhe fëmijëve.
- Qendrat raportojnë vështirësi serioze në sigurimin e mbështetjes afatgjatë për riintegrimin social dhe ekonomik të të mbijetuarave/mbijetuarve, përfshirë strehimin afatgjatë, punësimin dhe mbështetjen psikosociale të qëndrueshme.

<sup>60</sup> Shih: <https://drejtesiasot.com/wp-content/uploads/2025/01/Dardana.pdf>

- Strehimoret për gratë në Kosovë janë shpesh të mbingarkuara mbi kapacitetin e tyre fizik dhe operojnë nën presion të vazhdueshëm financiar. Ato ofrojnë shërbime thelbësore (strehim emergjent, këshillim psikologjik, ndihmë ligjore, kujdes për fëmijë), por kanë vështirësi të arrijnë standardet e plota të Këshillit të Evropës për qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në trauma dhe të orientuar tek e mbijetuara.
- Siguria fizike dhe konfidencialiteti i strehimoreve nuk është gjithmonë i garantuar: lokacionet e strehimoreve, për shkak të përmasës së vogël të komuniteteve lokale, shpesh njihen nga publiku, çka rrit rrezikun për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit dhe stafin. Nevoja për masa sigurie të avancuara, bashkëpunim të qëndrueshëm me policinë dhe protokolle emergjente del si prioritet.
- Financimi i strehimoreve mbetet i pasigurt dhe i fragmentuar, shpesh i lidhur me projekte afatshkurtra, me mungesë të fondeve të parashikueshme për kostot bazike (ushqim, produkte higjienike, ushqim për foshnje), shërbimet psikosociale dhe programet e riintegritit social-ekonomik. Kjo pasiguri buxhetore rrezikon cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve.
- Koordinimi ndërinstytucional mes strehimoreve, QPS-ve, policisë, komunave dhe nivelit qendror është i pjesshëm dhe shpesh i varur nga individët dhe jo nga mekanizma formalë të detyrueshëm.

#### **Rekomandimet kryesore të raportit:**

- Të sigurohet financim shumëvjeçar nga qeveria për strehimoret e grave, duke garantuar jo vetëm funksionimin bazik por edhe programe të qëndrueshme të riintegritit (trajtime profesionale, strehim tranzitor, kujdes për fëmijë, asistencë ligjore). Kërkohet që financimi të jetë i mjaftueshëm, i parashikueshëm dhe me qasje të ndjeshme gjinore.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet strehimoreve, shërbimeve sociale, policisë dhe autoriteteve komunale, për të garantuar reagim të koordinuar dhe të shpejtë, sidomos në rast të kërcënimeve dhe shkeljes së urdhrave mbrojtës.
- Të rriten kapacitetet njerëzore dhe teknike të strehimoreve dhe QPS-ve, duke siguruar staf të specializuar (psikologe/psikologë, juriste/juristë, punonjëse/punonjës socialë), trajtime të vazhdueshme në qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe mbështetje për parandalimin e konsumimit/djegies profesionale (burnout).
- Të përmirësohen masat e sigurisë fizike për strehimoret (infrastrukturë sigurie, lokacione të mbrojtura, bashkëpunim i drejtpërdrejtë me policinë), si dhe sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me artikuj bazikë.
- Të zhvillohen programe të strukturuar riintegriti social-ekonomik për të mbijetuarat/mbijetuarit, përfshirë mbështetje për punësim dhe qëndrueshmëri ekonomike, në mënyrë që viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit të mos kthehen në ambiente të pasigurta për shkak të varësisë ekonomike.

**D. Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje, Korrik 2023 – Qershor 2024 (GLPS, nëntor 2024).**<sup>61</sup> Ky raport, hartuar nga GLPS në nëntor 2024 brenda projektit “JUST REACT – Increasing Citizen Reaction for an Improved Access to Justice in Kosovo”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga GLPS me CDF, analizon trajtimin institucional të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë për periudhën 1 korrik 2023 – 30 qershor 2024.

<sup>61</sup> Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2024/12/JR-Annual-Report-Institutional-Treatment-of-Gender-Based-Violence-in-Kosovo-2024-1.pdf>

Raporti shqyrton kornizën ligjore të përditësuar, raportimin te Policia e Kosovës, performancën e Prokurorisë dhe Gjykatave Themelore, si dhe monitorimin në terren të seancave gjyqësore dhe aksesin real në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit.

**Qëllimi.** Raporti synon të vlerësojë efektivitetin e përgjigjes shtetërore ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke matur përputhjen e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale me standardet ligjore të reja, duke identifikuar sfidat strukturore (p.sh. mungesë koordinimi ndërinstytucional, mungesë e përfaqësimit ligjor për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit) dhe duke formuluar rekomandime të synuara reformuese. Raporti vendos theks edhe në harmonizimin e legjislacionit vendas me Konventën e Stambollit dhe në ndryshimet e fundit ligjore, përfshirë Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, miratuar në tetor 2023, i cili forcon përgjegjësitë institucionale dhe masat mbrojtëse.

#### **Gjetjet kryesore:**

- Korniza ligjore është forcuar dhe konsiderohet e konsoliduar për trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Megjithatë mbeten boshllëqe në adresimin e dhunës me bazë gjinore në internet dhe të femicidit, si dhe sfida në zbatimin e plotë të ligjit të ri.
- Raportimi i rasteve të dhunës në familje në Polici mbetet shumë i lartë dhe në rritje krahasuar me periudhën paraprake; gratë vazhdojnë të jenë shumica dërrmuese e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, duke reflektuar ndikimin e strukturave patriarkale dhe barrierave gjinore.
- Moshë më e prekur si për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit ashtu edhe për të ndaluarit është grupmosha 30–40 vjeç, që tregon nevojën për ndërhyrje të synuar për çiftet/partnerët në moshë të pjekur socio-ekonomikisht.
- Prokuroria ngre aktakuza në shumicën dërrmuese të rasteve të raportuara; niveli i trajtimit të lëndëve tregon efikasitet të lartë në Prokurori (përqindje zgjidhjeje më të lartë se lëndët hyrëse), ndërsa gjykatat kanë një normë më të ulët përfundimi të lëndëve (clearance rate), duke reflektuar ngarkesë strukturore.
- Ekzistojnë mangësi serioze në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe Qendrave për Punë Sociale. Raporti thekson mungesën e një baze të përbashkët të dhënash ndërinstytucionale për rastet e dhunës, dhe propozon modelin “VioGén” të Spanjës si praktikë shembull për një sistem të integruar monitorimi në kohë reale.
- Gjykatat shpallin fajësi pothuajse në të gjitha rastet e analizuara, por politika ndëshkimore mbetet e butë: dominon dënimi alternativ, me gjoba mesatare të ulëta dhe dënime efektive me burg relativisht të shkurtra. Raporti vëren se mungon qartësia e përsëritjes (recidivizmit) në rreth gjysmën e aktgjykimeve të analizuara.
- Qasja në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit mbetet e kufizuar: në rreth tre të katërtat e rasteve viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit nuk kanë përfaqësim ligjor në sallë gjyqi dhe varen kryesisht nga Oficeret/Oficerët për Mbrojtje të Viktimave ose ndihma sporadike juridike private.
- Monitorimi në terren evidenton mungesë prokuroresh/prokuroresh të specializuar në dhunën në familje në disa gjykata bazë, vonesa procedurale të lidhura me ngarkesën e lartë, barriera praktike (p.sh. transport publik i pamjaftueshëm për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit për të arritur në seancë), si dhe raste të zbehjes së vijës

ndarëse mes ndërmjetësimit dhe drejtësisë në kontekste të urdhrave mbrojtës, duke përfshirë presionin për “pajtim” në emër të interesit të fëmijëve. Kjo praktikë identifikohet si problematike dhe jo në përputhje me standardet ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

#### Rekomandimet kryesore të raportit:

- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë të sigurojnë zbatim efektiv të ligjit për mbikëqyrje elektronike të personave ndaj të cilëve kufizohet lëvizja me vendim gjykatë, për zbatimin e urdhrave mbrojtës.
- Policia e Kosovës të zhvillojë strategji të përshtatura për parandalim, hetim dhe reagim të shpejtë ndaj dhunës në familje.
- Të krijohet një bazë e përbashkët ndër-institucionale e të dhënave (Policia, Prokuroria, Gjykatat, QPS), e modeluar sipas sistemit VioGén, që do të mundësonte ndjekjen e rasteve në kohë reale, vlerësim të rrezikut dhe koordinim të menjëhershëm mbrojtës.
- Të forcohen kapacitetet njerëzore dhe teknologjike të gjykatave për të ulur kohëzgjatjen e trajtimit të lëndëve dhe për të rritur efikasitetin e procedurave.
- Prokuroria dhe gjykatat të zbatojnë në praktikë ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, duke aplikuar politika ndëshkimore më serioze dhe procedura më të përshpejtuara për rastet e dhunës në familje.
- Gjykatat të përfshijnë në aktgjykime informacion nëse kryerësi është recidivist, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.
- Ministria e Drejtësisë të parashohë programe mbështetëse për fuqizim ekonomik pas procedurës gjyqësore, si për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit ashtu edhe për kryerësit pas dënimit, për të zvogëluar rrezikun e përsëritjes së dhunës.
- Të sigurohet prania sistematike e Mbrojtëseve/Mbrojtësve të Viktimave apo avokateve/avokatëve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në çdo seancë gjyqësore që lidhet me dhunën në familje.

#### E. Evolucioni kronologjik janar 2022– qershor 2024 dhe rekomandimet 2025–2026

Tabela 18: Krahasimi i sfidave dhe rekomandimet bazuar në studimet e realizuara nga GLPS

PERIUDHA E MBULUAR NGA STUDIMI	FOKUS INSTITUCIONAL KRYESOR	SFIDA KRYESORE E EVIDENTUAR	PËRPARIMI / ZHVILLIMI POZITIV	REKOMANDIME KYÇE TË DALA NË ATË FAZË
Janar – Gusht 2022 (GLPS, “Raportimi dhe trajtimi...”)	Policia e Kosovës; Prokuroria Themelore Prishtinë; Gjykata Themelore Prishtinë; QPS; SHKK; ZMNV	Dënimet shpesh me kusht; vonesa të mëdha procedurale në gjykim; mungesë programesh të posaçme trajtimi për kryerësit; boshllëk ligjor në përkufizimin e formave të dhunës në ligjin ekzistues	Rritje e vetëdijes që dhuna në familje është çështje penale; trajtim më efikas i rasteve me të mitur nga Prokuroria	Forcim i reagimit të menjëhershëm policor; respektim i afateve gjyqësore; dënime më proporcionale; ndryshim/plotësim i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; rritje e kapaciteteve të QPS/ZMNV/SHKK

Korrik 2022 – Qershor 2023 (GLPS, “Trajtimi institucional...”)	Policia në nivel vendi; Prokuroria e Shtetit; Gjykatat Themelore; monitorimi i seancave dhe urdhrave mbrojtës	Politika ndëshkimore ende e butë dhe jo e harmonizuar; mungesë mekanizmesh për mbikëqyrje efektive të urdhrave mbrojtës; numër i madh seancash që dështojnë për shkak të mungesës së palëve	Rritje në arrestime për dhunë në familje; trajtim prioritar i rasteve nga prokuroret / prokurorët dhe gjyqtaret / gjyqtarët; raportim transparent ditor nga Policia; rritje e përdorimit të urdhrave mbrojtës	Sigurim i mbikëqyrjes elektronike për urdhrat mbrojtës; harmonizim i kualifikimit juridik të veprës “dhunë në familje”; arsyetim i plotë i dënimeve nga gjykatat; dënime më adekuate sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme
Qershor 2023 – Korrik 2024 (GLPS, “Baseline Assessment... Shelters and CSW”)	Qendrat për Punë Sociale; Strehimoret për viktimat/të mbijetuarat/ mbijetuarit e dhunës ndaj grave, dhunës në familje e dhunës në baza gjinore	Mungesë financimi në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa parashikueshme; infrastrukturë jo gjithmonë e sigurt apo konfidenciale; staf i pamjaftueshëm, i mbingarkuar; mungesë programesh të strukturuar riintegrimi ekonomik dhe social për të mbijetuarat / mbijetuarit	Ekzistencë e rrjetit të strehimoreve që sigurojnë strehim emergjent, këshillim psikologjik, asistencë ligjore dhe kujdes për fëmijë; angazhim aktiv në avokim publik dhe parandalim	Financim shumëvjeçar publik i strehimoreve; rritje e kapaciteteve njerëzore; mekanizma bashkërendues ndërinstucional (strehimore–QPS–polici–komuna); forcim i masave të sigurisë fizike; programe të qëndrueshme riintegrimi social-ekonomik për viktimat/ të mbijetuarat / mbijetuarit
Korrik 2023 – Qershor 2024 (GLPS, “Institutional treatment... 2023–2024”)	Policia e Kosovës; Prokuroria; Gjykatat; monitorim në terren; vlerësim i kornizës ligjore të përditësuar	Mungesë databaze e përbashkët ndërinstucionale; mungesë e përfaqësimit ligjor për shumicën e viktimave / të mbijetuarave /	Korniza ligjore kundër dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore është forcuar (ligji i ri 2023); rritje e efikasitetit në	Zbatim efektiv i mbikëqyrjes elektronike; krijim i databazës së përbashkët ndër-institucionale; rritje e kapaciteteve të gjykatave dhe

		mbijetuarve në gjykim; politika ndëshkimore ende e butë dhe mungesë e sistematizuar e të dhënave mbi recidivizmin; pengesa praktike dhe sociale për qasje në drejtësi	Prokurori; rritje e adresimit institucional të dhunës si prioritet publik; përdorim i treguesve të performancës të standardeve evropiane	prokurorive; politika ndëshkimore më serioze; sigurim i përfaqësimit ligjor për viktimat / të mbijetuarat / mbijetuarit në çdo fazë të procedurës; mbështetje ekonomike pas-procesit penal
--	--	---	--	--

### Rekomandimet prioritare për vitin 2026:

Këto rekomandime burojnë drejtpërdrejt nga dokumentet e cituara më sipër.

#### 1. Forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe menaxhimit të rasteve

- Zgjerimi dhe përmirësimi i databazës nacionale ekzistuese për rastet e dhunës në familje, duke mundësuar regjistrimin më të detajuar edhe të rasteve që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe cenimin e integritetit seksual, me qëllim përmirësimin e gjurmimit të rasteve dhe koordinimit ndërinstitucional.
- Forcimi i përdorimit të databazës nga të gjithë akterët përgjegjës dhe konsolidimi i praktikave të shkëmbimit të informacionit dhe menaxhimit të koordinuar të rasteve ndërmjet institucioneve përkatëse.

#### 2. Zbatim efektiv i masave mbrojtëse dhe mbikëqyrjes së kryerësve të dhunës

- Konsolidimi dhe përdorimi i plotë i sistemit të mbikëqyrjes elektronike për monitorimin e subjekteve ndaj të cilëve janë vendosur masa mbrojtëse ose kufizuese nga gjykata, duke garantuar mbikëqyrje të vazhdueshme, reagim të menjëhershëm ndaj shkeljeve dhe zbatim efektiv të urdhrave mbrojtës.
- Forcimi i mëtejshëm i mekanizmave të reagimit të shpejtë dhe koordinimit ndërinstitucional ndërmjet Policisë së Kosovës, prokurorisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të rasteve me rrezik dhe mbrojtje efektive të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.

#### 3. Qasje e barabartë dhe e plotë në drejtësi për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit

- Sigurimi i pranisë së Mbrojtëseve/Mbrojtësve të Viktimave/avokateve/avokatëve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve në çdo seancë gjyqësore për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, për të adresuar boshllëkun kritik të përfaqësimit ligjor.
- Standardizimi i praktikave gjyqësore për të shmangur presionin ndaj viktimave /të mbijetuarave/mbijetuarve për “pajtim”, veçanërisht në procedurat për urdhra mbrojtës, në përputhje me ligjin vendas dhe standardet ndërkombëtare.

#### 4. Politika ndëshkimore dhe llogaridhënie gjyqësore

- Zbatim i qëndrueshëm i udhëzimeve të Gjykatës Supreme mbi politikën ndëshkimore dhe kualifikimin juridik të veprës “dhunë në familje”, për të siguruar që dënimet të jenë proporcionale me rrezikshmërinë dhe për të reduktuar varësinë nga dënimet alternative të buta.
- Kërkesë që gjykatat të dokumentojnë qartë recidivizmin e kryerësve në çdo aktgjykim, si parakusht për politika ndëshkimore më serioze dhe për menaxhimin e rrezikut.
- Përcaktim i afateve procedurale të detyrueshme dhe monitorim i respektimit të tyre për të shmangur vonesat shumë-mujore apo shumë-vjeçare në gjykim.

#### 5. Qëndrueshmëria e shërbimeve të mbrojtjes dhe riintegrit

- Garantimi i financimit shumëvjeçar publik për strehimoret e grave dhe shërbimet e Qendrave për Punë Sociale, me qëllim që ato të përmbushin standardet e Këshillit të Evropës dhe të sigurojnë strehim të sigurt, konfidencial, me mbështetje psikosociale të specializuar dhe asistencë ligjore.
- Zhvillimi dhe financimi i programeve të strukturuar të riintegrit ekonomik dhe social për të mbijetuarat/mbijetuarit, duke përfshirë qasje në strehim të qëndrueshëm, punësim të përshtatshëm dhe mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve, në mënyrë që dalja nga dhuna të jetë reale dhe e qëndrueshme.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore (psikologe/psikologë, punonjëse/punonjës socialë, juriste/juristë të specializuar në DHBGJ/DHF) dhe masave të sigurisë fizike në strehimore, përfshirë procedurat standarde të bashkërenduara me policinë për reagim emergjent.

Këto rekomandime përputhen me fushat kyçe të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026: parandalimi, mbrojtja dhe mbështetja e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, ndjekja penale efektive dhe politika të integruara shumë-institucionale.

#### Zhvillime pas periudhës së raportimit (2024–2025):

**Databaza ndërinstitucionale.** Raportet e GLPS për periudhën 2022–2024 (rekomanduan krijimin e një databaze ndërinstitucionale të ngjashme me modelin “VioGén” të Spanjës, për ndjekjen në kohë reale të rasteve dhe përmirësimin e koordinimit mes institucioneve kryesore të drejtësisë dhe mbrojtjes sociale. Në vijim të këtyre rekomandimeve, Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka krijuar dhe funksionalizuar bazën e përbashkët digjitale të të dhënave për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, e cila është tashmë operacionale dhe përdoret nga Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjykatat dhe Qendrat për Punë Sociale. Ky progres adreson drejtpërdrejt boshllëkun e theksuar në raportet e mëparshme dhe shënon një përparim të rëndësishëm në zbatimin e Objektivit Strategjik IV të Strategjisë Kombëtare (forcimi i shërbimeve dhe mekanizmave të mbrojtjes për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit).

**Forcimi i mbështetjes financiare për strehimoret.** Raporti i GLPS (shtator 2024) evidentoi se financimi i pamjaftueshëm dhe pasiguria buxhetore ishin ndër pengesat kryesore për qëndrueshmërinë e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Në vijim të këtyre gjetjeve, duhet theksuar se Qeveria e Kosovës ka rritur ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme mbështetjen financiare për strehimoret, duke përmirësuar ndjeshëm funksionimin e tyre dhe cilësinë e shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit. Kjo

rritje e fondeve ka mundësuar stabilizimin e funksionimit të rrjetit të strehimoreve, zgjerimin e mbulimit gjeografik dhe ofrimin më gjithëpërfshirës të shërbimeve psikosociale, ligjore dhe ritreguese. Ky zhvillim adreson drejtpërdrejt rekomandimet e GLPS për sigurimin e financimit shumëvjeçar dhe përbën një shembull të mirë të zbatimit të masave të qëndrueshme buxhetore në kuadër të Strategjisë Kombëtare.

### 1.7. Përmbledhje e studimit “Dhuna në baza gjinore përmes këndvështrimit të Gjeneratës Z: Qëndrimet e burrave të rinj ndaj dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe femicidit në Kosovë” të SIT/UNFPA (2024)<sup>62</sup>

**Qëllimi.** Studimi synon të kuptojë në mënyrë të thelluar qëndrimet e burrave të rinj (Gjenerata Z) ndaj dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe femicidit në Kosovë. Qëllimi është identifikimi i faktorëve shoqërorë, normave kulturore dhe perceptimeve që ndikojnë në normalizimin e dhunës, tolerancën ndaj sjelljeve kontrolluese dhe barrierat në raportim.

**Metodologjia.** Studimi është zhvilluar përmes kombinimit të metodave kualitative dhe kuantitative (anketa, intervista të strukturuar dhe fokus-grupe me burra të rinj), duke mbuluar zona urbane dhe rurale. Përzgjedhja e të rinjve nga profile të ndryshme socio-ekonomike kishte për qëllim reflektimin e diversitetit të përvojave dhe perceptimeve në nivel vendi.

#### Gjetjet kryesore:

- Normalizimi i dhunës dhe sjelljeve kontrolluese: Një pjesë e të rinjve shfaqin tolerancë ndaj formave të caktuara të kontrollit në marrëdhënie, të cilat perceptohen si “të zakonshme” ose “të justifikueshme”.
- Toleranca ndaj dhunës fizike dhe psikologjike: Studimi konstaton se disa të rinj justifikojnë dhunën në rrethana të caktuara, sidomos kur lidhet me xhelozë ose mosbindje ndaj pritshmërive gjinore.
- Stigma dhe barrierat në raportim: Burrat e rinj shpesh hezitojnë të raportojnë dhunën (si viktima/të mbijetuar, dëshmitarë ose familjarë) për shkak të normave të maskulinitetit, frikës së gjyqimit dhe mungesës së besimit se institucionet reagojnë në mënyrë efektive.
- Qëndrimet ndaj femicidit: Megjithëse shumica e të rinjve e dënojnë femicidin, studimi evidenton mungesë të njohurive mbi faktorët që e nxisin atë, si dhe një prirje për ta trajtuar atë si “incident individual” dhe jo si fenomen shoqëror.
- Mungesë përfshirjeje në aktivitete parandalimi: Shumica e të rinjve deklarojnë se nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e programeve mbi barazinë gjinore ose parandalimin e dhunës.

**Rekomandime.** Për periudhën 2025–2026 studimi sugjeron që prioritetet të jenë:

- Integrimi i programeve të punës me djemtë dhe burrat e rinj në shkolla, komunitet dhe hapësirat rinore.
- Fushata të synuara që adresojnë normat e dëmshme gjinore dhe stigma e raportimit.
- Edukim sistematik mbi barazinë gjinore që nis që në shkollën e mesme.
- Bashkëpunim ndërmjet institucioneve arsimore, MKL-ve dhe organizatave të rinisë për të ndërtuar modele pozitive të maskulinitetit.
- Qasja e femicidit si çështje sigurie publike dhe jo vetëm çështje individuale.

<sup>62</sup> [https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/GVB-Raporti\\_shq.pdf](https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/GVB-Raporti_shq.pdf)

- Rritja e ndërgjegjësimit mbi shenjat e hershme të dhunës dhe sjelljeve kontrolluese.

**Veprime të ndërmarra pas periudhës së raportimit.** Gjatë fushatës “16 Ditë Aktivizmi Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” (nëntor–dhjetor 2023), institucionet publike në Kosovë, nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërmorën një sërë aktivitete të fokusuara në ndërgjegjësimin dhe angazhimin e burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Në të gjitha 7 regjionet e Kosovës u organizuan sesione të tipit “Town Halls” me nxënës djem dhe paneliste/panelistë nga gjyqësori, prokuroria dhe Policia e Kosovës, për të diskutuar rëndësinë e raportimit dhe rolin e burrave në parandalim. Po ashtu, gjatë së njëjtës fushatë u realizua një trajnim i certifikuar për 111 oficerë/oficerë policie nga të gjitha rajonet e vendit, i fokusuar në hetimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.<sup>63</sup> Këto veprime të dokumentuara tregojnë një orientim institucional drejt përfshirjes aktive të burrave dhe djemve në parandalim dhe reagim, duke përputhur prioritetet e Strategjisë për vitin 2026 në fushën e parandalimit dhe edukimit gjinor.

### 1.8. Përmbledhje e studimit “Fuqizimi i Mekanizmave Mbrojtës nga Dhuna në Baza Gjinore në Kosovë” të Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (2024)<sup>64</sup>

**Qëllimi.** Studimi analizon mekanizmat ekzistues të mbrojtjes ndaj dhunës me bazë gjinore dhe femicidit në Kosovë, duke identifikuar boshllëqet kritike në reagimin institucional, mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave, si dhe në trajtimin e femicidit si fenomen i sigurisë publike.

**Metodologjia.** Raporti bazohet në analiza të të dhënave institucionale, shqyrtim të rasteve të femicidit dhe vlerësim të kapaciteteve dhe përgjigjeve të policisë, prokurorisë, gjykatave dhe komunave në trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

#### Gjetjet kryesore:

- Dhuna në baza gjinore dhe femicidi paraqesin rrezik të lartë për sigurinë publike, me rritje të rasteve të raportuara gjatë vitit 2024.
- Viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit shpesh hezitojnë të raportojnë për shkak të mungesës së besimit në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë.
- Ka pabarazi të theksuara në reagimin institucional ndërmjet komunave, sidomos në zonat rurale me kapacitete të kufizuara profesionale.
- Mungojnë procedura të harmonizuara dhe protokolle të qarta për trajtimin e rasteve të femicidit.
- Publiku shpreh kërkesë të fortë që femicidi të trajtohet si emergjencë kombëtare.

#### Rekomandimet për vitin 2026:

- Përforcimi i mekanizmave të mbrojtjes dhe rritja e përgjegjësisë shtetërore për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.
- Standardizimi i protokolleve të reagimit në rastet e femicidit ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave.
- Krijimi i një baze të integruar të të dhënave për femicidin dhe llojet e tjera të dhunës së rëndë.

<sup>63</sup> Shih: <https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/14CC1CA7-0CB5-4F7A-80A1-2F6D4CBD716E-1.pdf>

<sup>64</sup> <https://qkss.org/al/publikimet/strengthening-protection-mechanisms-of-gender-based-violence-in-kosovo/>

- Forcimi i kapaciteteve në komunat rurale dhe sigurimi i shërbimeve të specializuara kudo në vend.
- Trajtimi i femicidit si çështje e sigurisë publike dhe integrimi i tij në politikat kombëtare të sigurisë.

**Veprimet e ndërmarra pas raportimit.** Pas publikimit të studimit të QKSS në vitin 2024, disa institucione kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të mekanizmave të mbrojtjes ndaj dhunës me bazë gjinore dhe femicidit. Në fillim të vitit 2024, Akademia e Drejtësisë zhvilloi trajnimin “Trajtimi i rasteve të femicidit”<sup>65</sup>, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtareve/gjyqtarëve dhe prokuroreve/prokurorëve për identifikimin, vlerësimin e rrezikut dhe trajtimin e rasteve me rrezik të lartë. Në prill 2024, Policia e Kosovës njoftoi për intensifikimin e masave parandaluese dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit, me synimin për të rritur raportimin, përmirësuar reagimin në kohë dhe forcuar mbrojtjen e viktimave, të mbijetuarave dhe të mbijetuarve të dhunës<sup>66</sup>. Në vijim, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Rregulloren (QRK) Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore<sup>67</sup>, e cila përcakton strukturën, rolet dhe përgjegjësitë e mekanizmave komunalë të koordinimit, me qëllim harmonizimin e reagimit institucional dhe forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial në nivel lokal. Po gjatë vitit 2024, Ministria e Drejtësisë nisi procesin e hartimit të një akti të veçantë ligjor për parandalimin dhe trajtimin e femicidit<sup>68</sup>, duke e pozicionuar këtë fenomen si çështje të sigurisë publike dhe duke synuar rritjen e përgjegjësisë shtetërore në trajtimin e rasteve me rrezik të lartë. Këto veprime të dokumentuara tregojnë orientimin e institucioneve drejt zbatimit të rekomandimeve të studimit dhe përforcimit të mëtejshëm të kuadrit institucional për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe femicidit në Kosovë.

### 1.9. Përmbledhje e Raporteve të Shoqërisë Civile mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 2023 dhe 2024<sup>69</sup>

**Qëllimi.** Raportet synojnë të analizojnë gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, me fokus të veçantë te dhuna ndaj grave, dhuna në familje dhe qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat. Objektivi kryesor është identifikimi i boshllëqeve institucionale dhe shoqërore që ndikojnë në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe në zbatimin efektiv të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Metodologjia.** Raportet mbështeten në:

- analiza të rasteve të dokumentuara nga organizatat e shoqërisë civile;
- shqyrtimin e dokumenteve ligjore dhe zhvillimeve institucionale;
- monitorimin e trendeve të dhunës dhe reagimit institucional;
- të dhënat e institucioneve publike;
- intervista sektoriale dhe konsultime me aktorë të sigurisë, drejtësisë dhe shoqërisë civile.

<sup>65</sup> <https://ad.rks-gov.net/trajnim-i-trajnujesve-trajtimi-i-rasteve-te-femicidit-1>

<sup>66</sup> <https://www.kosovopolic.com/en/press-release-37/>

<sup>67</sup> [https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/RREGULLORE\\_QRK\\_-\\_Nr\\_01\\_2025\\_PER\\_MEKANIZMIN\\_KOORDINUES\\_LOKAL\\_PER\\_MBROJTJE\\_NGA\\_DHUNA\\_NE\\_FAMILJE\\_DHUNA\\_NDAJ\\_GRAVE\\_DHE\\_DHUNA\\_NE\\_BAZA\\_GJINORE.pdf](https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/RREGULLORE_QRK_-_Nr_01_2025_PER_MEKANIZMIN_KOORDINUES_LOKAL_PER_MBROJTJE_NGA_DHUNA_NE_FAMILJE_DHUNA_NDAJ_GRAVE_DHE_DHUNA_NE_BAZA_GJINORE.pdf)

<sup>68</sup> <https://kossev.info/en/kosovo-vesti-onlajn-nacrt-zakona-protiv-femicida/>

<sup>69</sup> <https://yih-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/Report-ENG-2023.pdf>

### **Gjetjet kryesore të përbashkëta (2023–2024):**

- Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje mbeten ndër shkeljet më serioze të të drejtave të njeriut në Kosovë, me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe vajzave.
- Të dy raportet nënvizojnë se besimi i kufizuar në policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin ndikon në mos raportimin e rasteve, sidomos në komunitetet ku normat patriarkale janë më të forta. Mungesa e besimit lidhet edhe me perceptimin se masat mbrojtëse nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme.
- Normat shoqërore dhe stereotipet gjinore vazhdojnë të normalizojnë forma të ndryshme të kontrollit dhe dhunës, duke e bërë më të vështirë identifikimin dhe parandalimin e rasteve.
- Institucionet zbatojnë ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje në mënyrë të pabarabartë në komuna të ndryshme, duke krijuar qasje të pabarabartë në shërbime dhe mbrojtje ligjore.
- Raportet vërejnë se shërbimet e specializuara dhe mekanizmat e referimit nuk funksionojnë njësoj në të gjitha komunat, dhe se kapacitetet institucionale (sidomos ato hetimore dhe social-psikologjike) janë ende të kufizuara.

### **Rekomandimet kryesore për vitin 2026:**

- Rritja e kapaciteteve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave për trajtimin profesional, të shpejtë dhe të ndjeshëm gjinor të rasteve.
- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës, përfshirë publikimin e rregullt të të dhënave mbi trajtimin e rasteve.
- Zhvillimi i fushatave afatgjata për ndryshimin e normave patriarkale, të fokusuar në komunitet, shkolla dhe të rinjtë.
- Përmirësimi i qasjes në shërbime të specializuara dhe garantimi i trajtimit të barabartë në të gjitha komunat.
- Harmonizimi i zbatimit të ligjit dhe standardizimi i procedurave ndërinsticionale për trajtimin e rasteve.

### **1.10. Përmbledhja e publikimeve të Ministrisë së Drejtësisë mbi databazën digjitale të rasteve të dhunës në familje (2023–2025)<sup>70</sup>**

**Qëllimi i databazës.** Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës ka krijuar një databazë të përbashkët digjitale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, me qëllim integrimin e të dhënave nga institucionet përgjegjëse dhe sigurimin e gjurmueshmërisë së plotë të rasteve. Sistemi synon harmonizimin e raportimit institucional, përmirësimin e koordinimit ndërmjet mekanizmave shtetërorë të reagimit dhe rritjen e transparencës në publikimin e të dhënave.

#### **Përmbajtja dhe funksionalizimi i sistemit:**

Databaza mbledh të dhëna nga nëntë institucione të linjës:

- Policia e Kosovës
- Prokuroria e Shtetit
- Gjykatat Themelore

<sup>70</sup> <https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>

- Qendrat për Punë Sociale
- Mbrojtëset/Mbrojtësit e Viktimave
- Strehimoret
- Shërbimi Korrektues i Kosovës
- Shërbimi Sprovues i Kosovës
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Ministria e Drejtësisë publikon statistika tremujore mbi rastet e dhunës në familje, të ndara sipas gjinisë, grup moshave, nacionalitetit dhe marrëdhënies së viktimës/ të mbijetuarës / mbijetuarit me kryesin.

#### **Gjetjet kryesore nga publikimet (2023–2024):**

- Sistemi është funksional dhe përdoret në kohë reale nga institucionet kryesore të sigurisë, drejtësisë dhe mirëqenies sociale.
- Shkëmbimi i të dhënave ndërinstytucionale lejon përcjellje të menjëhershme të rasteve dhe vlerësim të unifikuar të rrezikut.
- Ministria e Drejtësisë ka publikuar të dhëna të detajuara për vitet 2019-2022; vitin 2023, vitin 2024 si dhe për vitin 2025.
- Publikimet konfirmojnë se databaza përdoret si mjet operativ për regjistrim, kategorizim dhe monitorim të rasteve në nivel kombëtar.
- Mbetet ende hapësirë për zgjerimin e treguesve, veçanërisht për format e tjera të dhunës me bazë gjinore që aktualisht nuk raportohen veçmas.

#### **Rëndësia për zbatimin e Strategjisë 2022–2026:**

- Digjitalizimi i sistemit të referimit rrit cilësinë dhe saktësinë e të dhënave për dhunën në familje, duke mundësuar politika të bazuara në evidenca.
- Sistemi mbështet realizimin praktik të Objektivit Strategjik III (Fuqizimi institucional) dhe Objektivit Strategjik IV (Shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara për viktimat / të mbijetuarat / të mbijetuarit).
- Databaza përmbush kërkesat e Konventës së Stambollit për koordinim ndërinstytucional dhe detyrimet e acquis të BE-së për integrim të të dhënave dhe transparencë.
- Ndihmon në identifikimin e tendencave, parashikimin e nevojave për shërbime dhe planifikimin e ndërhyrjeve të synuara në nivel kombëtar dhe komunal.

#### **Rekomandimet për vitin 2026:**

- Rritja e përdorimit të databazës për analizë të rrezikut dhe vendimmarrje institucionale.
- Zgjerimi i sistemit për të përfshirë format e dhunës me bazë gjinore përtej dhunës në familje (p.sh., dhuna ndaj grave në sferën publike).
- Harmonizimi i raportimit të të gjitha institucioneve dhe sigurimi i përditësimeve të rregullta në kohë reale.
- Trajnime shtesë për stafin e institucioneve lidhur me përdorimin analitik të sistemit.
- Përgatitja e raporteve vjetore analitike që e përdorin databazën si bazë të monitorimit të politikave.

## SHTOJCA 2. PËRMBLEDHJA E KRITEREVE TË RISHIKUARA TË OECD-DAC

Në vitin 2019, Komiteti i Ndhmës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD-DAC) miratoi versionin e rishikuar të kriterëve të vlerësimit, me synimin për t'i bërë ato më të qarta, më të përdorshme dhe më të përshtatura me kontekstin aktual të zhvillimit dhe qeverisjes. Këto kriterë theksojnë rëndësinë e analizës së kontekstit, ndërveprimet ndër-institucional, ndryshimeve të paqëllimshme, aftësisë së institucioneve për të mbajtur rezultatet dhe ndërlidhjeve ndër-sektoriale.

Më poshtë jepet përmbledhja e përkufizimeve të rishikuara, e përshtatur për përdorim analitik në vlerësimin e Strategjisë.

### 1. Relevanca

Vlerëson masën në të cilën ndërhyrja i përgjigjet nevojave, prioritetëve dhe të drejtave të grupeve përfituese dhe aktoreve/aktorëve kryesorë, si dhe nëse objektivat, planifikimi dhe modalitetet e zbatimit mbeten të përshtatshme edhe kur konteksti ndryshon. Relevanca kërkon analizë të qartë të problemit, ndryshimeve të mjedisit institucional, ndryshimeve sociale, ekonomike dhe ligjore, si dhe të përshtatshmërisë së qasjes ndaj kushteve të reja.

### 2. Koherenca (*kriter i shtuar në rishikim*)

Vlerëson se sa mirë ndërhyrja lidhet dhe harmonizohet me politika, programe dhe ndërhyrje të tjera në të njëjtin kontekst. Koherenca ndahet në:

- **Koherencë të brendshme:** harmonia ndërmjet objektivave, instrumenteve dhe iniciativave brenda të njëjtit institucion apo aktor.
- **Koherencë të jashtme:** përputhja dhe koordinimi ndërmjet aktoreve/aktorëve të ndryshëm institucionalë, lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë sinergjitë dhe shmangien e mbivendosjeve.

### 3. Efektiviteti

Mat nivelin në të cilin objektivat dhe rezultatet e planifikuara janë arritur, apo ka gjasa të arrihen, duke përfshirë ndikimet e ndryshme për kategori të ndryshme të popullsisë (p.sh. gra, burra, fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, etj.). Efektiviteti kërkon vlerësim të qartë të progresit ndaj treguesve, cilësisë së rezultateve, si dhe faktorëve që kanë ndikuar pozitivisht ose negativisht zbatimin.

### 4. Eficienca

Analizon marrëdhënien ndërmjet burimeve të përdorura (financiare, njerëzore, teknike, kohore) dhe rezultateve të arritura, duke vlerësuar nëse ndërhyrja ka prodhuar rezultatet me vlerën më të mirë të mundshme. Eficienca përfshin edhe çështjet e menaxhimit, procedurave, vonesave, kostove të tranzicionit dhe adaptimit të ndërhyrjes ndaj kushteve që ndryshojnë.

### 5. Ndikimi (Impakti)

Vlerëson efektet më të gjera, pozitive ose negative, të qëllimshme ose të paqëllimshme, që dalin përtej rezultateve të drejtpërdrejta të ndërhyrjes. Impakti fokusohet në ndryshimet afatgjata në sistem, institucione, sjellje shoqërore, norma dhe mirëqenie njerëzore, duke përfshirë edhe transformimet strukturore në fushën e të drejtave dhe barazisë gjinore.

## 6. Qëndrueshmëria

Analizon masën në të cilën përfitimet e ndërhyrjes pritët të vazhdojnë pas përfundimit të saj, përfshirë aftësinë institucionale, financiare, teknike, sociale dhe ligjore për të siguruar vazhdimësinë. Qëndrueshmëria vlerëson gjithashtu rreziqet, kapacitetet, pronësinë institucionale, si dhe gatishmërinë e sistemit për të mbështetur rezultatet në afat të gjatë.

Rishikimi i vitit 2019 i kritereve të OECD-DAC evidenton domosdoshmërinë që vlerësimet të marrin në konsideratë kontekstin dhe ndryshimet e tij, duke analizuar ndërhyrjet jo vetëm në dimensionin e tyre teknik, por edhe në marrëdhëniet që krijohen me sisteme më të gjera politike dhe institucionale. Futja e Koherencës si kriter i veçantë ka për qëllim të forcojë analizën e harmonizimit ndërmjet politikave dhe aktorëve të ndryshëm. Gjithashtu, kriteret e rishikuara nxisin një analizë të plotë të efekteve të paqëllimshme, si dhe kërkojnë një qasje të orientuar drejt sistemit, duke vlerësuar ndërhyrjet në kontekst më të gjerë sesa projektet e izoluara.

Rishikimi gjithashtu forcon fokusin mbi barazinë gjinore, të drejtat, përfshirjen dhe parimin “askush të mos mbetet pas”, të cilat shihen si tregues thelbësorë të cilësisë së një ndërhyrjeje. Në mënyrë të qartë, kriteret e rishikuara synojnë të lidhin vlerësimin me qëllimin e tij kryesor, sigurimin e përgjegjshmërisë dhe nxjerrjen e mësimëve, duke bërë që analiza të jetë e përdorshme, e kuptueshme dhe e orientuar drejt përmirësimit të politikave dhe shërbimeve.

Këto kritere dhe elemente të rishikimit ofrojnë një kornizë të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse për analizën e ndërhyrjeve, duke ndihmuar që vlerësimet të jenë më të qarta, më relevante dhe më të dobishme për politikëbërjen, planifikimin dhe monitorimin e rezultateve.

### SHTOJCA 3. TË DHËNAT E VETË-RAPORTUARA NGA KOMUNAT

Tabela 19: Përmbledhje krahasuese e situatës në 19 komuna (2022–2025)

KOMUNA	PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT	MEKANIZMI KOORDINUES LOKAL (MKL)	LINJË BUXHETORE E DEDIKUAR	TRAJNIME NDËRSEKTORIALE	RAPORTIM PERIODIK	FUSHATA NDËRGJE GJËSUESE	SFIDA KRYESORE
Dragash	Po (2023–2026)	Po, aktiv	Jo	Po	Po	Po	Burime të kufizuara financiare
Ferizaj	Po (2022–2026)	Po, aktiv	Po	Po	Po	Po	Mungesë personeli të dedikuar
Fushë Kosovë	Po (2023–2026)	Po	Jo	Po	Jo	Po	Mungesë raportimi të rregullt
Gjakovë	Po (2022–2026)	Po, shumë aktiv	Po	Po	Po	Po	Nevojë për më shumë staf teknik
Gjilan	Po (2022–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Mungesë koordinimi me QPS
Hani i Elezit	Jo	Po (funksional minimal)	Jo	Po	Jo	Po	Kapacitete të ulëta administrative
Istog	Po (2023–2026)	Po	Jo	Po	Po	Po	Linjë buxhetore e paqëndrueshme
Kaçanik	Po (2023–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Mungesë burimesh për fushata
Kamenicë	Po (2023–2026)	Po	Jo	Po	Po	Po	Kufizime në trajnime
Klinë	Po (2022–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Buxhet i kufizuar për aktivitete
Kllokot	Jo	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Kapacitete të ulëta njerëzore
Malishevë	Po (2023–2026)	Po	Jo	Po	Jo	Po	Raportim jo i rregullt
Obiliq	Po (2023–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Mungesë të dhënash gjinore
Pejë	Po (2022–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Raportim jo i unifikuar
Podujevë	Po (2023–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Linjë buxhetore jo e mjaftueshme
Prishtinë	Po (2022–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Mungesë koordinimi me OSHC
Prizren	Po (2022–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Varësi nga fondet e donatorëve

<b>Viti</b>	Po (2023–2026)	Po	Jo	Po	Po	Po	Mungesë të të dhënave të integruara
<b>Vushtrri</b>	Po (2023–2026)	Po	Po	Po	Po	Po	Raportim jo i standardizuar

*Burimi: Të dhënat e dërguara prej komunave përmes plotësimit të pyetësorëve të dedikuar për këtë vlerësim*

## SHTOJCA 4. KONTRIBUTET E PARTNERËVE NDËRKOMBËTARË

Kjo shtojcë paraqet një përmbledhje të detajuar të kontributeve të partnerëve ndërkombëtarë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026. Informacioni është marrë drejtpërdrejt nga pyetësorët standard të dorëzuar zyrtarisht dhe përfshin:

- asistencën teknike,
- mbështetjen financiare,
- ngritjen e kapaciteteve,
- ndërhyrjet në nivel qendror e lokal,
- praktikatat e mira dhe sfidat e identifikuara.

Shtojca ka karakter informues dhe jo–krahasues, duke reflektuar kontributin e secilit partner brenda mandatit dhe fushës së veprimit të tij.

### **Bashkimi Evropian (BE)**

Bashkimi Evropian mbetet partneri më strategjik në mbështetjen e reformave për barazinë gjinore, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave e dhuna në familje në Kosovë. Mbështetja e BE-së është shumë-dimensionale, duke përfshirë financime shumëvjeçare, asistencë teknike dhe ekspertizë të specializuar.

#### Kontributet kryesore (2022–2025)

- Financimi i një portofoli prej 10 projekteve shumëvjeçare, të zbatuara nga UN Women, OSHC-të dhe partnerë ndërkombëtarë.
- Përfshirja e këshilltares për barazi gjinore të EUSR në hartimin e Strategjisë, për përafrimin me GAP III, CLIP-in për Kosovën dhe acquis të BE-së.
- Mbështetje për EUKOJUST në reformën e ligjit, hartimin e akteve nënligjore dhe themelimin e Sekretariatit të Koordinatorit Kombëtar.
- Mbështetje për Policinë, Prokurorinë, Gjykatat, MKL-të dhe OSHC-të përmes programeve si:
  - EAW – Implementing Norms, Changing Minds II (2020–2026)
  - GEF – Gender Equality Facility (2023–2026), i cili kontribuon në mënyrë indirekte në objektivat e Strategjisë përmes mbështetjes për planet lokale të barazisë gjinore, forcimit të qasjes në drejtësi dhe integritit të perspektivës gjinore në programet e reformës së sundimit të ligjit
  - Projekte për parandalimin e dhunës përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit komunitar
  - Iniciativa për fuqizimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile
  - Programe kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes
- Mbështetje për krijimin e dhomave të intervistimit në bashkëpunim me EULEX dhe OSBE.

BE ka kontribut të drejtpërdrejtë në OS II (mbrojtje dhe qasje në drejtësi) dhe OS III (forcim institucional), duke standardizuar praktikatat dhe forcimin e profesionalizmit institucional.

### **Këshilli i Evropës (KiE)**

KiE ka mbështetur drejtpërdrejt Kosovën në përafrimin me Konventën e Stambollit dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës.

#### Kontributet kryesore (2022–2025)

- Mbështetje për hartimin e Ligjit Nr. 08/L-185 dhe akteve nënligjore.
- Zhvillimi i moduleve standarde për trajnimin e gjyqtareve/gjyqtarëve, prokuroreve/prokuratorëve, policisë, QPS-ve, shëndetësisë dhe arsimit.
- Përmirësimi i praktikave gjyqësore në vendimmarrje të ndjeshme ndaj traumës.
- Mbështetja e hartimit të **Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave**, përfshirë pilotimin në Burgun e Dubravës dhe trajnimin e 15 facilitatoreve/facilitatorëve.
- Mentorim i zyrtareve/zyrtarëve të sektorëve të ndryshëm për implementimin e standardeve të Konventës së Stambollit.

Investimi total rreth 125,000 EUR në asistencë teknike, trajnime dhe reforma ligjore.

Kontribut në OS I (parandalim), OS II, OS III dhe OS IV, me rol të veçantë në përmirësimin e procedurave dhe programeve të trajtimit për kryerësit e dhunës.

#### **Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)**

SDC ka kontribuar në forcimin e qeverisjes lokale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike në Kosovë, duke mbështetur rritjen e kapaciteteve të institucioneve komunale dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat dhe praktikat e zhvillimit lokal. Përmes programeve të saj të bashkëpunimit, të zbatuara në partneritet me institucionet qendrore, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile, SDC ka mbështetur përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional dhe rritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve më gjithëpërfshirëse për qytetaret/qytetarët, përfshirë gratë dhe grupet e tjera vulnerabël. Këto ndërhyrje kanë kontribuar në krijimin e kushteve më të favorshme për funksionimin e mekanizmave lokalë të koordinimit dhe për përmirësimin e qasjes në shërbime për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Kontributi i SDC lidhet veçanërisht me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e qeverisjes lokale, duke mbështetur kështu zbatimin e objektivave të Strategjisë në nivel komunal.

Kontribut në OS III dhe OS IV, kryesisht në forcimin e kapaciteteve lokale.

#### **Agjencia Suedeze për Zhvillim (SIDA)**

SIDA ka ofruar mbështetje afatgjatë në barazinë gjinore, mbrojtjen sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Kontributet kryesore

- Bashkëfinansim të programeve të UN Women dhe UNFPA në fushën e GBV dhe shërbimeve të integruara.
- Mbështetje për OSHC-të që ofrojnë shërbime për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës.
- Ndërtimi i kapaciteteve qendrore dhe lokale për integrimin gjinor.

Forcim i infrastrukturës institucionale dhe kapaciteteve të shërbimeve (OS III dhe OS IV).

#### **Banka Botërore (World Bank)**

Banka Botërore ka kontribuar në mënyrë të tërthortë në zbatimin e Strategjisë përmes reformave sociale, shëndetësore dhe ekonomike.

Kontributet kryesore

- Analiza gjinore për punësimin, mbrojtjen sociale dhe mirëqenien.

- Asistencë teknike për MFPT dhe ABGJ në ngritjen e sistemeve të të dhënave dhe raportimit.
- Projekti KOMPAS (20 milion USD), në pritje të ratifikimit, i cili do të:
  - forcojë sektorin shëndetësor,
  - avancojë shërbimet parësore,
  - përmirësojë referimin e rasteve të dhunës në nivel shëndetësor.

Kontribut në OS III dhe OS IV përmes forcimit të kapaciteteve shëndetësore dhe sistemeve të të dhënave.

### **OSBE–OMiK**

OSBE është një nga partnerët më të qëndrueshëm dhe më të angazhuar në zbatimin e Strategjisë.

Kontributet kryesore

- 172,776.63 EUR të investuara (2022–2025) në trajnime, mentorim dhe projekte.
- Mbështetje për MKL-të në 15 komuna përmes asistencës teknike, ngritjes së kapaciteteve, mbështetjes në hartimin e planeve të veprimit dhe diskutimit të akteve të reja nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.
- Trajnime për Policinë, Prokurorinë, Gjyqësorin dhe QPS-të në vlerësimin e rrezikut, urdhrat mbrojtës dhe menaxhimin e rasteve.
- Mbështetje për strehimoret, krijimin e dhomave të intervistimit dhe ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare, si dhe advokim për sigurimin e mbështetjes financiare komunale për strehimoret rajonale për viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës në familje.
- Publikimi i Raportit të Monitorimit të Gjykimeve për Dhunën në Familje.
- Fushata të gjera ndërgjegjësimi dhe punë me të rejtat/rinjte në shkolla, gratë në zonat rurale, psikologët/psikologët shkollorë dhe Mekanizmat Lokalë kundër Dhunës në Familje.

Kontribut i drejtpërdrejtë në OS I, OS II, OS III dhe OS IV.

### **EULEX Kosovë**

EULEX ka kontribuar në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe standardizimin e praktikave të orientuara drejt viktimës/të mbijetuarës/mbijetuarit.

Kontributet kryesore

- Financim i nëntë projekteve (118,755.42 EUR) për trajnime, mentorim dhe SOP për trajtimin e rasteve të dhunës.
- Përmirësim i bashkëpunimit polici–prokurori në rastet e dhunës.
- Mbështetje për udhëzimet nënligjore dhe dhomat e intervistimit.
- Mentorim profesional për gjyqtarë dhe prokurorë.
- Punë me OSHC-të për parandalimin dhe ndërgjegjësimin.

Fokus në OS II, me ndikim edhe në OS I dhe OS III.

### **Mbretëria e Bashkuar (UK)**

Mbretëria e Bashkuar ka kontribuar në avancimin e grave në siguri dhe në rritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës.

Kontributet

- Trajnime në trajtimin e rasteve, qasje të ndjeshme gjinore dhe reagimin e hershëm.
- Mbështetje për gratë police në pozita udhëheqëse.

Kontribut në OS II, me ndikim në profesionalizimin e policisë.

### **UN Women**

UN Women ka qenë aktor kyç në integrimin e perspektivës gjinore dhe zbatimin e Strategjisë.

Kontributet kryesore

- 1.39 milion USD investime (2022–2025).
- Zhvillimi i 17 PLVBGJ-ve dhe trajnimi i 300+ anëtarëve të MKL-ve.
- Hartimi i Protokollit Shtetëror për Menaxhimin e Dhunës Seksuale.
- Forcimi i bazës së të dhënave kombëtare për DHF/DHGJ.
- Mbështetje për 12 OSHC (Medica, RrGK, KGJ, IKD etj).
- Asistencë teknike për Policinë, Prokurorinë dhe ABGJ.

Kontribut i fortë në OS I, OS II, OS III dhe OS IV.

### **UNFPA**

UNFPA ka mbështetur sektorin shëndetësor dhe programet e parandalimit të dhunës.

Kontributet kryesore

- 731,200 USD investime në programe shëndetësore dhe sociale.
- Trajnime për ofruesit shëndetësorë në identifikimin e GBV dhe referimin.
- Punë me djemtë dhe burrat për parandalimin e maskulinitetit toksik.
- Programet e edukimit seksual me fokus në barazinë gjinore.
- Mbështetje për komunat (Prishtinë, Ferizaj, Fushë Kosovë).
- Integrimi i GBV në emergjenca.

Kontribut në OS II, OS III dhe OS IV.

### **UNICEF**

UNICEF ka qenë aktori kryesor në mbrojtjen e fëmijëve viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë të dhunës.

Kontributet kryesore

- Shërbime për 2,250 fëmijë në situatë rruge.
- Mbështetje për 300 familje vulnerabël.
- Programe të prindërimit pozitiv me 17,500 fëmijë dhe 900 prindër.
- Ngritja e kapaciteteve të MKL-ve në 31 komuna.
- Fushata që kanë arritur mbi 650,000 persona.
- Programe ndërmjetësimi në 30 shkolla.

Kontribut në OS I, OS III dhe OS IV, me fokus tek fëmijët.

### **UNMIK**

UNMIK ka kontribuar në parandalim, ndërgjegjësim dhe mbështetje komunitare.

Kontributet kryesore

- 530,000 USD investime në projekte (2022–2025).
- Mbështetje për fushatat “16 Ditët e Aktivizmit”.
- Financim për fuqizimin socio-ekonomik të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve.
- Mbështetje për “Barabar Center”, Open Day WPS dhe forume rajonale.
- Dialog ndër-komunitar dhe qasje gjithëpërfshirëse në paqe dhe siguri.

Kontribut në OS I, OS III dhe OS IV.

Kontributet e partnerëve ndërkombëtarë kanë qenë tërësisht plotësuese ndaj mandatit të institucioneve vendore dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në:

- rritjen e kapaciteteve,
- përmirësimin e shërbimeve,
- harmonizimin me standardet ndërkombëtare,
- mbështetjen e komuniteteve vulnerabël,
- forcimin e qasjes së orientuar drejt viktimës/të mbijetuar mbijetuarës/mbijetuarit.

Shtojca ofron një pasqyrë të plotë të ndërhyrjeve dhe investimeve të tyre, në mbështetje të zbatimit koherent të Strategjisë 2022–2026.

## SHTOJCA 5. TABELA E TREGUESVE PËR VLERËSIMIN AFATMESËM

Treguesi në nivel objektivi strategjik: I. PARANDALIMI DHE IDENTIFIKIMI I DHUNËS NËPËRMJET EDUKIMIT DHE VETËDIJESIMIT	VLERA BAZË	SYNIMI 2024	ARRITJA 2024	SYNIMI 2026
<b>Përqindja e grave, burrave, vajzave dhe djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme.</b>	Përcaktohet me një studim në vitin 2022	Rritur me 5%	Nuk ka studim për vitin 2022; treguesi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave bazë për vitin 2022.	Rritur me 10%
<b>Indeksi i Sigurisë së Grave</b>	Çdo 0.737 në 1 grua <sup>71</sup>	Çdo 0.85 në 1 grua	0.664 (vendi 100) në 2023/24 (-0.073) <sup>72</sup> ; rikuperim në 0.700 (vendi 82) <sup>73</sup> në 2025/26 (+0.036), por ende nën objektivin 0.85.	Çdo 1 në 1 grua
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet</b>	13 raste të vrasjeve në familje për vitin 2020 <sup>74</sup>	Zvogëluar me 50%	5 raste të vrasjeve në familje për vitin 2024 <sup>75</sup> ; ulje me rreth 75% krahasuar me vitin 2020.	Zvogëluar me 100%
<b>Treguesi në nivel objektivi specifik I.1. Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe steriotipeve gjinore që justifikojnë dhunën.</b>	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/ raportuara nga pala e tretë</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Rritur me 10%	Nuk është përcaktuar në 2022; mungojnë të dhënat; treguesi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave bazë për vitin 2022.	Rritur me 20%
<b>Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Treguesi 5.2.2 i OZHQ)</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Nuk është matur; Policia raporton 8 raste dhunimi në 2024.	Zvogëlohet me 20%
<b>Treguesi në nivel objektivi specifik I.2. Ndërmarrja e masave edukative dhe arsimore në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën.</b>	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026

<sup>71</sup> Siç paraqitet e matur në: <https://giëps.georgetoën.edu/ëp-content/uploads/2021/10/ËPS-Index-2021-Summary.pdf>.

<sup>72</sup> Siç paraqitet e matur në Indeks "Gruaja, Paqja, Siguria 2023/24" në: <https://giëps.georgetoën.edu/ëp-content/uploads/2023/10/ËPS-Index-full-report.pdf>

<sup>73</sup> Siç paraqitet e matur në Indeks "Gruaja, Paqja, Siguria 2025/26" në: <https://giëps.georgetoën.edu/ëp-content/uploads/2025/10/ËPS-Index-2025-Report.pdf>

<sup>74</sup> Vlera është caktuar bazuar në dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës.

<sup>75</sup> Të dhënat e marra nga Databaza kombëtare: <https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>

<b>Numri i sesioneve informuese të zhvilluara për stafin e institucioneve të arsimit parauniversitar mbi shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës.</b>	0 (Udhëzuesi po përgatitet, sesionet do zhvillohen më pas)	60 sesione në 30 komuna	Trajnimet janë zhvilluar në 20 komuna dhe 7 rajone (ndonëse nën synimin e përcaktuar, mbulimi rajonal është i gjerë dhe përbën bazë të fortë për zgjerimin në fazën e dytë).	16 sesione në 8 komuna të tjera
Treguesi në nivel objektiv specifik I.3. Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>1. Numri i institucioneve mediatike dhe bizneseve private që mbështeten të miratojnë udhëzime, standarde vetërregulluese e protokolle për të parandaluar diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës.</b>	0	Rritur me 20%	Janë shënuar hapa përpara: nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit nga KPM, ABGJ dhe QKSGJ; letër e hapur mediave për zbatimin e Kodit të Etikës.	Rritur me 50%
<b>2. Përqindja e personave viktimë/të mbijetuarave/mbijetuarve të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Treguesi i OZHQ 11.7.2)</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Të dhënat e OZHQ janë në përpunim; mungon raport kombëtar; treguesi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave bazë për vitin 2022.	Zvogëlohet me 20%
Treguesi në nivel objektiv specifik I.4. Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës, bazuar në modelet ekzistuese evropiane.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Numri i kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave që trajtohen në programet psiko-sociale, të ngritura sipas parashikimeve në këtë Strategji.</b>	0	Rritur me 30%	Në vitin 2024 u realizuan 24 sesione për 20 kryerës të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në kuadër të Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe standardet evropiane për programet e trajtimit të kryerësve.	Rritur me 60%

<b>Treguesi në nivel objektiv strategjik: II AVANCIMI DHE HARMONIZIMI I POLITIKAVE PUBLIKE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE</b>	<b>VLERA BAZË</b>	<b>SYNIMI 2024</b>	<b>ARRITJA 2024</b>	<b>SYNIMI 2026</b>
--	-------------------	--------------------	---------------------	--------------------

<b>Numri i kallëzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur, të pazgjidhura për çdo vit</b>	13 vepra me kryes të rritur dhe 43 vepra me kryes të mitur, për vitin 2020	Zvogëluar me 50%	Në 2023–2024 <sup>76</sup> , Prokuroria pranoi 2,815 raste dhe zgjidhi 2,889 (krahasuar me 3,169 të pranuar dhe 3,679 të zgjidhura në 2022–2023), duke ruajtur efikasitet të qëndrueshëm mbi 100%. Meqenëse vlera bazë e vitit 2020 nuk specifikon institucionin referues (polici apo prokurori), vlerësimi bazohet në këto trende, të cilat tregojnë progres dhe nevojë për forcim kapacitetesh për qëndrueshmëri në vitet në vijim.	Zvogëluar me 90%
<b>Përqindja e grave viktime/të mbijetuara të dhunës nga partneri intim</b>	4% në vitin 2021 <sup>77</sup>	Zvogëlohet me 10%	Prevalenca e dhunës nga partneri intim rezultoi 5% në matjen 2023/24 dhe një vlerësim indikativ prej rreth 11.9% në ciklin e maturimit 2025/26, bazuar në prirjet krahasuese rajonale dhe përmirësimin e zbulueshmërisë së rasteve <sup>78</sup> , duke qenë mbi vlerën bazë 4% dhe nën objektivat e uljes për vitin 2024 dhe 2026. Këto rezultate theksojnë nevojën për ndërhyrje më të fokusuar dhe të qëndrueshme për të arritur drejt një trendi ulës në vitet në vijim.	Zvogëlohet me 20%
<b>Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish-partner intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas formës së dhunës dhe sipas moshës (Treguesi i OZHQ 5.2.1)</b>	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Të dhënat e OZHQ janë në përpunim; mungon raport kombëtar; treguesi nuk mund të matet për shkak të mungesës së të dhënave bazë për vitin 2022.	Zvogëlohet me 20%
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik II.1. Përmirësimi i kornizës ligjore për trajtimin e të gjitha rasteve të</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>

<sup>76</sup> Të dhënat janë marrë nga raportet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, për vitet 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024. Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/category/publications/>

<sup>77</sup> Sipas matjeve të pasqyruara në: <https://giëps.georgetoën.edu/ep-content/uploads/2021/10/ËPS-Index-2021-Summary.pdf>

<sup>78</sup> Të dhënat e marra nga Indekset “Gruaja, Paqja, Siguria”, për vitet 2023/24 dhe 2025/26. Shih: <https://giëps.georgetoën.edu/the-index/>

<b>dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.</b>				
<b>Niveli i reflektimit të kuptimit gjinor të dhunës ndaj grave dhe të të gjitha formave të kësaj dhune, sipas Konventës së Stambollit, në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës</b>	Në kornizën ligjore aktuale mungon kuptimi gjinor i dhunës ndaj grave, veçanërisht jashtë sferës së dhunës në familje <sup>79</sup>	50% përputhshmëri me Konventën e Stambollit	Reformat ligjore të ndërmarra në 2023-2024 kanë realizuar nivelin e synuar të harmonizimit me Konventën e Stambollit për vitin 2024, duke përfaqësuar progres të qenësishëm drejt përputhjes së plotë.	100% përputhshmëri me Konventën e Stambollit
Treguesi në nivel objektiv specifik II.2. Fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Numri i kurrikulave të formimit të profesionisteve e profesionistëve të përgatitura e zhvilluara</b>	4	8	Janë zhvilluar 8 module trajnimi (4 fillestare dhe 4 vazhduese), të harmonizuara me Konventën e Stambollit dhe me standardet ndërkombëtare, duke përmbushur synimin për vitin 2024. Meqë paketa aktuale mbulon plotësisht temat prioritare, arritja e synimit prej 12 moduleve në vitin 2026 do të vlerësohet në bazë të nevojave të reja trajnuese që mund të identifikohen gjatë vitit në vijim.	12
<b>Treguesi: Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës, në mënyrë të përvitshme</b>	Do merren të dhënat për 2020-2021	Rritur me 10%	Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar u rrit nga 362 (2022) në 458 (2023) dhe 593 (2024), duke shënuar rritje kumulative prej 63.8% ndaj vitit bazë dhe duke tejkuluar dukshëm synimin prej 10%	Rritur me 20%

Treguesi në nivel objektiv strategjik: III. FUQIZIMI INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE DHE TRAJTIM TË VIKTIMAVE/TË MBIJETUARAVE/MBIJETUARVE.	VLERA BAZË	SYNIMI 2024	ARRITJA 2024	SYNIMI 2026
<b>Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave koordinues qendrorë e lokalë të fuqizuar e që zbatojnë në</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 50%	Edhe pse nuk ka një vlerë bazë për vitin 2022, aktualisht raportohen të ngritur 38 mekanizma koordinues lokalë dhe një rrjet prej 18 institucioneve	Rritur me 80%

<sup>79</sup> Sipas raportit përgatitur nga Rrjeti i Grave Kosovë "Nga ligjet në vepra", Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KËN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta në përputhje me Konventën e Stambollit.			në nivel qendror, duke treguar forcim të qartë të bashkërendimit institucional	
Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse (Treguesi i OZHQ 16.3.1)	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10%	Të dhënat e treguesit të OZHQ janë ende në përpunim dhe mungon raporti kombëtar; për shkak të mos-përcaktimit të vlerës bazë në vitin 2022, treguesi nuk është i matshëm për vitin 2024.	Rritur me 20%
Numri i rasteve të dhunës në familje me vendim përfundimtar gjykatë	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 50%	Të dhënat <sup>80</sup> tregojnë se vendimet përfundimtare u rritën nga 306 raste (2022–2023) në 856 raste (2023–2024) pra një rritje me 550 raste ose 180%, duke reflektuar progres të qëndrueshëm në finalizimin gjyqësor të lëndëve.	Rritur me 100%
<b>Treguesi në nivel objektivi specifik III.1. Fuqizimi i grupit koordinues ndërinstytucional në nivel qendror.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
Linja buxhetore adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje, për një koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 15%	Në vitin 2023 është funksionalizuar Divizioni për Qasje në Drejtësi, Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Gruas dhe Dhuna në Baza Gjinore i cili shërben në cilësinë e Sekretariatit të Koordinatorës / Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje, me 4 të punësuar / punësuar (2024), duke shënuar forcim të dukshëm të kapaciteteve për koordinim dhe monitorim.	Rritur me 30%
<b>Treguesi në nivel objektivi specifik III.2. Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>
Numri i Mekanizmave Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës, të ngritur në mbarë vendin, me koordinator/koordinator lokal dhe mbështetje buxhetore të përcaktuar qartësisht.	20	28	Raportohen si të ngritur 38 Mekanizma Koordinues Lokalë, duke tejkuluar synimin prej 28 mekanizmash dhe duke konsoliduar infrastrukturën e koordinimit në nivel lokal. Për periudhën e mbetur të zbatimit të strategjisë deri në vitin 2026, fokusi duhet të zhvendoset drejt vlerësimit të efektivitetit të funksionimit të këtyre mekanizmave.	38
<b>Treguesi në nivel objektivi specifik III.3.</b>	<b>Vlera bazë</b>	<b>Synimi 2024</b>	<b>Arritja 2024</b>	<b>Synimi 2026</b>

<sup>80</sup> Të dhënat janë marrë nga raportet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, për vitet 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024. Shih: <https://legalpoliticalstudies.org/category/publications/>

Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile				
Përqindja e buxhetit dedikuar OJQ-ve që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, mbrojtjes (duke përfshirë strehimoret) dhe ri integritet e fuqizimit të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10%	Në vitin 2024 janë dedikuar 794,000 euro për OJQ që punojnë në zbatim të Konventës së Stambollit (duke përfshirë strehimoret), duke shënuar një rritje prej rreth 7.6% krahasuar me nivelin bazë të vitit 2022.	Rritur me 20%
Treguesi në nivel objektiv specifik III.4. Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndër-institucionale për evidentimin e rasteve.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
1. Data baza me të dhënat për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, funksionale dhe e përditësuar rregullisht.	Data baza 65% funksionale	Data baza 85% funksionale	Databaza është funksionale dhe plotësisht në përputhje me synimin 85% të vitit 2024.	Databaza 100% funksionale
2. Përqindja e të rejave dhe të rinjve të moshës 18-29 vjeç të cilët përjetuan dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç (Treguesi i OZHQ 16.2.3)	Do përcaktohet gjatë 2022	Zvogëluar me 10%	Nuk është përcaktuar vlera bazë për vitin 2022 dhe matja e treguesve të OZHQ nuk ka përfunduar ende; për vitin 2024 nuk ka të dhëna të disponueshme që të raportohet për këtë tregues.	Zvogëluar me 20%
Treguesi në nivel objektiv specifik III.5. Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës.	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
Numri i viktimave / të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës të cilat/cilët përfitojnë ndihmë juridike falas	1803 persona kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë vitit 2020	Rritur me 40%	Të dhënat tregojnë rritje të qëndrueshme të përfituesve / përfituesve të ndihmës juridike falas krahasuar me vitin bazë 2020. Në ANJF, rastet e dhunës në familje u rritën nga 44 raste në vitin 2020 në 214 raste në vitin 2024, që paraqet një rritje prej rreth 386%, duke tejkaluar dukshëm objektivin e vitit 2024. Në ZMNV, rastet që kanë kërkuar ndihmë juridike falas (90–93% DHF) u rritën nga 1,720 raste (2020) në 2,902 raste (2023), duke reflektuar një rritje prej 20.5% mbi synimin e ndërmjetëm. Në këtë kuadër, treguesi për vitin 2024 konsiderohet i arritur dhe i tejkaluar.	Rritur me 70%

<b>Numri i grave që kanë qasje në drejtësi</b>	Çdo 1.83 në 4 gra	Çdo 2.5 në 4 gra	Të dhënat e ANJF-së tregojnë se në vitin 2024, 3,534 gra përfituan ndihmë juridike falas nga gjithsej 8,049 përfituese / përfitues, duke përfaqësuar një raport prej 1.76 në 4 gra me qasje në drejtësi. Megjithëse ky rezultat reflekton përmirësim të vazhdueshëm krahasuar me vitet pararendëse, objektivi i vitit 2024 (2.5 në 4 gra) nuk është arritur.	Çdo 4 në 4 gra
--	-------------------	------------------	--	----------------

Treguesi në nivel objektiv strategjik: IV SIGURIMI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR VIKTIMAT/TË MBIJETUARAT/MBIJETUARIT	VLERA BAZË	SYNIMI 2024	ARRITJA 2024	SYNIMI 2026
<b>Linjë buxhetore përcaktuar sipas një analize dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës.</b>	Buxheti për strehimoret në 2020: 495,000 EUR	Rritur me 5 %	Buxheti i destinuar për qendrat e shërbimeve mbështetëse ka vijuar rritjen progresive, duke u rritur nga 400,000 EUR në vitin 2022 në 692,000 EUR në 2023 dhe në 739,000 EUR në 2024, me një buxhet kumulativ prej 2,874,000 EUR për periudhën 2022–2025. <sup>81</sup> Rritja nga 2022 në 2024 (nga 400,000 EUR në 739,000 EUR) përfaqëson një rritje prej rreth 84.8%, duke e tejkaluar ndjeshëm synimin prej +5% të vitit 2024	Rritur me 10%
<b>Numri i grave që gëzojnë të drejtat pronësore në mënyrë të barabartë si edhe burrat</b>	Çdo 0.62 në 1 grua	Çdo 0.85 në 1 grua	Deri në nëntor 2025 <sup>82</sup> janë regjistruar gjithsej 643,569 regjistrime pronësore: 501,192 burra (77.34%), 134,479 gra (20.75%) dhe 12,347 persona juridikë (1.91%). Përfaqësimi i grave si pronare individuale mbetet 0.21 në 1 grua, dukshëm nën synimin për 2024, ndërsa bashkë-pronësia është rritur me 15% (nga 6,157 në 2022 në 7,082 në 2024), duke treguar progres modest, por ende larg synimit për rritjen e pronësisë individuale të grave.	Çdo 1 në 1 grua
<b>Treguesi në nivel objektiv specifik IV.1. Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat nga të gjithë grupet, si dhe fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë të dhunës</b>	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026

<sup>81</sup> Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, Divizioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Departamenti i Politikave për Shërbime Sociale dhe Familjare, dërguar në kuadër të përgatitjes së këtij raporti vlerësimi.

<sup>82</sup> Për më shumë shih: <https://akk-statistics.rks-gov.net/>

<b>Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, të zgjeruara e fuqizuara, ndarë sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10 %	Hartëzimi fillestar nuk është kryer në vitin 2022; për pasojë, treguesi nuk mund të matet për vitin 2024. Vlerësimi i progresit mbetet i hapur dhe kërkon vendosjen e bazës matëse përpara matjes së synimeve të tjera.	Rritur me 30 %
Treguesi në nivel objektiv specifik IV.2. Zbatimi i politikave që mundësojnë ri integrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës	Vlera bazë	Synimi 2024	Arritja 2024	Synimi 2026
<b>Numri i viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të ri integruara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal.</b>	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 30 %	Nuk ka të dhëna bazë për vitin 2022, pasi hartëzimi fillestar nuk është kryer; si rrjedhojë, treguesi nuk mund të matet për vitin 2024. Vlerësimi i progresit kërkon vendosjen e bazës matëse funksionale gjatë fazës së ardhshme të zbatimit.	Rritur me 50%

## SHTOJCA 6. KORNIZA E PROPOZUAR E TREGUESVE PËR STRATEGJINË 2027–2030/2032

Treguesi	Niveli i treguesit	Vlera bazë (2027)	Synimi 2030	Burimi i të dhënave	Frekuenca	Institucioni përgjegjës
Përqindja e popullsisë që refuzon dhunën ndaj grave	Ndikim	Do të përcaktohet përmes studimit kombëtar 2027	+15%	ASK	Çdo 2–3 vjet	ASK
Përqindja e të rejave/rinjve me qëndrime jo-toleruese ndaj të gjitha formave të dhunës	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	+20%	Anketime	2 vjet	MASHTI
Përqindja e shkollave me programe parandalimi	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	80%	EMIS	Vjetore	MASHTI
Numri i mësueseve/mësuesve të trajnuar	Produkt	Do të përcaktohet në 2027	+50%	MASHTI	Vjetore	MASHTI
Numri i mediave/bizneseve me protokolle kundër ngacmimit dhe dhunës seksuale	Produkt	Do të përcaktohet në 2027	+40%	Raporte	Vjetore	MD
Përqindja e kryerësve që përfundojnë programe trajtimi	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	60%	MD	Vjetore	MD
Përqindja e harmonizimit ligjor	Ndikim	Analizë bazë 2027	100%	MD	2 vjet	MD
Numri i profesionisteve/profesionistëve të trajnuar	Produkt	Ekziston	+30%	Institucione	Vjetore	MD
Përqindja e MKL-ve funksionale	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	100%	MKL	Vjetore	MD
Përqindja e institucioneve në databazë	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	100%	MD + ASK	Vjetore	MD

Përqindja e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve që përfitojnë ndihmë juridike	Rezultat	Ekziston	+20%	ANJF	Vjetore	MD
Koha mesatare e trajtimit të rasteve	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	-30%	Gjykatat	Vjetore	KGJK
Numri i shërbimeve të specializuara	Produkt	Hartëzim 2027	+30%	MD	Vjetore	MD
Përqindja e komunave të mbuluara me shërbime	Rezultat	Do të përcaktohet në 2027	80%	MKL	Vjetore	MD
Përqindja e viktimave të mbijetuarave të punësuar pas 12 muajsh	Ndikim	Do të përcaktohet në 2027	40%	QPS + AP	Vjetore	MPMS

